

NDIKIMI I SISTEMIT ELEKTORAL NË FORMËN E QEVERISJES NË SHQIPËRI 1991-2013

Aurora Balukja

Dorëzuar
Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca Sociale, me profil Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare,
për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Tonin Gjuraj

Numri i fjalëve: 67 300 fjalë

Tiranë, Qershor 2018

DEKLARATA E AUTORESISË

Ky dizertacion është shkruar nga unë, nën udhëheqjen e Prof. Dr. Tonin Gjuraj, udhëheqës shkencor. Ky punim nuk është paraqitur më parë në ndonjë institucion tjetër për t'u vlerësuar. Çdo material që është publikuar nga të tjerët dhe që është përdorur për nevojat e trajtimit të çështjeve të ndryshme të shtjelluara në këtë disertacion është cituar.

E drejta e autorit, 2018 të gjitha të drejtat i rezervohen autorit.

ABSTRAKTI

Punimi ka objekt studimin/analizimin e ndikimit të sistemeve elektorale në formën qeverisëse. Pra, në qendër të studimit do të jetë analizimi se si ka ndikuar sistemi elektoral në formën qeverisëse në vendin tonë. Në këtë punim do të studiohen gjërësisht sistemet elektorale në Shqipëri në periudhën paskomuniste, do të shqyrtojmë ndikimet pozitive dhe negative që mund të kenë këto sisteme në formën qeverisëse dhe do të studiojmë kabinetet qeveritare që janë formuar gjatë kësaj periudhe.

Në qendër të hulumtimit do të jetë edhe sistemi elektoral, ku deri në vitin 2008-të me Ndryshimet Kushtetuese, kemi kaluar nga sistemi mazhoritar në proporcional dhe si rrjedhojë, kemi ndryshimin e marrëdhënieve / raportit midis pushteteve (Qeveri-Parlament dhe President-Kryeministër). Kemi analizuar gjërësisht kabinetet qeveritare që janë formuar gjatë periudhës së tranzicionit shqiptar dhe kjo është risia që sjell ky studim. Çdo kabinet qeveritar të formuar nga viti 1991-2013 e kemi analizuar sipas gjashtë teorive të koalicionit të Lijphart.

Teza ka objekt studimi *sistemet elektorale dhe formën e qeverisjes* nga viti 1991-2013 në Shqipëri dhe arrihet në përfundim se, **sistemet elektorale ndikojnë drejtëpërdrejtë në formën e qeverisjes dhe në formimin e kabineteve qeveritare**. Ato ndikojnë drejtëpërdrejtë në formën qeverisëse dhe kjo testohet nëpërmjet teorisë së Arend Lijphart “*Ndikimi i sistemit elektoral në formën e qeverisjes*”. Gjithashtu, në fund të punimit përtej analizimit të hollësishëm të indikatorëve të mësipërm, të marrëdhënies

shkak-pasojë midis tyre dhe të përcaktimit të kabineteve qeverisëse të formuara në pluralizmin shqiptar, do të nxjerrim përfundimet rreth studimit.

Metodologjia e përdorur në këtë punim shkencor është analitike. Puna për përgatitjen e këtij punimi kërkimor ka konsistuar në mbledhjen e materialeve dhe të dhënave nëpërmjet monografive, studimeve dhe revistave shkencore, punimeve të ndryshme të paraqitura si disertacione, artikujve të gazetave dhe periodikëve, raporteve të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare dhe të qeverisë shqiptare, materiale të marra nga interneti, arkivat etj. Pra është përdorur metoda cilësore dhe kemi shfrytëzimin e pasur të burimeve dytësore, si edhe janë zhvilluar tre intervista me specialistë të fushës.

Fjalët kyçe: sistemi elektorale, postkomunizmi, sistemi partiak, forma qeverisëse, kabinetet-koalicionet, marrëdhënia legjislativ-ekzekutiv (Qeveri-Parlament dhe President-Kryeministër).

ABSTRACT

The object of this study is to analyze the influence of electoral systems in the governing form, which means it aims analyze how the electoral system has influenced the governing form of our country in the post-communist period. This study also focuses on examining the positive and negative impacts that electoral systems might have in the governing form. Another aim of this study is to analyze the governmental cabinets that were formed during the post-comunist period.

At the center of the research is the electoral system, considering that by 2008 with the Constitutional Amendments, we have shifted from the majority system to proportional and as a result we have a change in relations / rapports between the governments (Government-Parliament and Prime Minister). For this reason, this research analyzed different government cabinets that were created during the Albanian transition period and this is the innovation that this study brings. Each government cabinet formed from 1991-2013 has been analyzed according to six theories of the Lijphart coalition.

The thesis deals with *electoral systems* and *governance form* from 1991 to 2013 in Albania and concludes that **electoral systems directly influence the form of government and the formation of government cabinets**. They directly affect the governing form and this is tested according to Arend Lijphart's theory of "*The Impact of the Electoral System in the Form of Governance*". The conclusions of this study are drawn based on detailed analysis of the above indicators, the cause-and-effect relationship between them and the determination of governing cabinets formed in Albanian pluralism.

The methodology used in this study is analytical. The work for the preparation of this research consisted on the collection of materials and data through monographs, studies and scientific journals, various works presented as dissertations, newspaper articles and periodicals, reports of various international institutions and Albanian government, material received from various sources such as, archives and so on. For this study the qualitative method was used and there is evidence of rich use of secondary resources, as well as three interviews with field specialists.

Key words: electoral system, post-communism, party system, governance forms, cabinets-coalition, legislative-executive relationship (Government-Parliament and Primeminister-President).

DEDIKIMI

Këtë punim i'a dedikoj familjes time, prindërve dhe motrës time Anjezës,
për mbështetjen dhe kurajon që më kanë përcjellë për të realizuar këtë punim shkencor.

FALENDERIME

Me shumë kënaqësi do të doja të shprehja falenderimet e mia të sinqerta për të gjithë ata që më ndihmuan dhe më mbështetën moralisht gjatë realizimit të kësaj teme disertacioni.

Së pari, dua të falenderoj dhe t'i shpreh mirënjohjen time të veçantë për ndihmën e pakursyer në realizimin e kësaj sipërmarrjeje kaq të rëndësishme për mua, Udhëheqësit tim Shkencor, Prof. Dr. Tonin Gjuraj, i cili me kontributin e tij shkencor dhe metodik, me konsulencën e tij profesionale më ofroi orientimin e duhur për realizimin e këtij punimi. Në bazë të inkurajimeve të vazhdueshme, këshillave, orientimeve, sugjerimeve dhe vërejtjeve, më ka ndihmuar që të paraqes këtë punim voluminoz në këtë formë.

Dëshiroj të falenderoj të gjithë ata miq, kolegë e punonjës të institucioneve të ndryshme, të cilët nuk më kanë kursyer materialet, mendimet, sugjerimet dhe vërejtjet e tyre. Si edhe nuk mund të rri pa përmendur, Prof. Asoc. Dr. Ervis Iljazaj dhe profesoreshën Anjeza Xhaferraj, për ndihmën dhe konsulencën e tyre profesionale për këtë punim shkencor.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KAPITULLI I: HYRJE

1.1	Parathënie.....	fq. 1
1.2	Hyrje.....	fq. 5
1.3	Metodologjia.....	fq.11
	<i>Analiza e të dhënave cilësore.....</i>	<i>fq.20</i>
1.3.1	Objektivat e studimit.....	fq. 25
1.4	Kufizimet e punimit.....	fq. 26
	Hapat e punimit	fq. 30

KAPITULLI II: KUADRI TEORIK

Ndikimi i sistemit zgjedhor në formën e qeverisjes dhe Perspektiva teorike e Ndikimit të sistemit elektoral në sistemin partiak, si edhe ndikimi i sistemit partiak në formën qeverisëse të vendit.

2.1	Sistemet elektorale	fq. 35
	<i>Rëndësia e sistemit elektoral në konturimin e sistemit politik.....</i>	<i>fq. 43</i>
2.2	Klasifikimi i sistemeve zgjedhore dhe efektet në përbërjen partiake, strategjitë zgjedhore dhe përfaqësimin politik i tyre	fq. 46
	<i>Sistemi një partiak</i>	<i>fq. 48</i>
	<i>Sistemi mazhoritar - sistemi dypartiak dhe forma qeverisëse</i>	<i>fq. 50</i>

	<i>Sistemi proporcional - sistemi shumëpartiak dhe forma qeverisëse.....</i>	fq. 55
2.3	<i>Numri i partive politike efektive në sistemin politik.....</i>	fq. 60
	<i>Sistemi zgjedhor, sistemi partiak dhe forma e qeverisjes.....</i>	fq. 66
2.4	<i>Teoria e Ndikimit të sistemit elektoral në formën qeverisëse të Arend Lijphart</i>	fq.69

KAPITULLI III: KUADRI TEORIK

Format e qeverisjes dhe modelet teorike

3.1	<i>Forma e Shtetit / Qeverisjes</i>	fq. 78
3.2	<i>Format e qeverisjes</i>	fq. 82
3.2.1	<i>Forma parlamentare e qeverisjes (Republikë parlamentare)</i>	fq. 87
	<i>Doktrina dualiste dhe moniste e parlamentarizmit</i>	fq. 90
3.2.2	<i>Republikë parlamentare me tendencë maxhoritare (Rasti i Britanisë së Madhe)</i>	fq. 92
3.2.3	<i>Republikë parlamentare me tendencë proporcionale (Rasti i Italisë)</i>	fq. 95
3.3	<i>Republikë presidenciale (Rasti i ShBA-së)</i>	fq. 98
3.4	<i>Republikë gjysmëpresidenciale (Rasti i Francës)</i>	fq. 101
	<i>Dallimet midis republikës parlamentare dhe presidenciale.....</i>	fq. 103

KAPITULLI IV: KONTEKSTI HISTORIK

Format e qeverisjes në Shqipëri përgjatë tranzicionit

4.1	<i>Shqipëria gjatë viteve të ndryshimeve rrënjësore 1990-1991</i>	fq. 110
4.2	<i>Ligjit Nr.7491, më datë 29.4.1991 “Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese” sanksionon Shqipërinë Republikë Parlamentare</i>	fq. 114

4.2.1	Ligji i parë elektoral i vitit 1991	fq. 119
4.2.2	Situata politike para dhe pas zgjedhjeve të para demokratike për Kuvendin Popullor më 31.03.1991 dhe krijimi i “Qeverisë së Stabilitetit”	fq. 122
	<i>Analizimi i zgjedhjeve të para pluraliste të vitit 1991 sipas teorisë së Arend Lijphart</i> <i>“Ndikimi i sistemit elektoral në formën qeverisëse”</i>	fq. 127
4.3	Ligji elektoral i vitit 1992.....	fq. 129
4.3.1	Zgjedhjet e parakohshme të zhvilluara më 22 mars të vitit 1992	fq. 132
	<i>Analizimi i zgjedhjeve të parakohshme të vitit 1992 sipas teorisë së Arend Lijphart</i> <i>“Ndikimi i sistemit elektoral në formën qeverisëse”</i>	fq. 136
	<i>Marrëdhënia parlament dhe presidencë pas zgjedhjeve të vitit 1992.....</i>	fq. 138
4.4	Ligji i zgjedhjeve Parlamentare të vitit 1996	fq. 141
4.4.1	Rezultatet e zgjedhjeve Parlamentare të zhvilluara më 26 majit 1996	fq. 144
	<i>Analizimi i zgjedhjeve parlamentare të vitit 1996-të sipas teorisë së Arend Lijphart</i> <i>“Ndikimi i sistemit elektoral në formën qeverisëse”</i>	fq. 147
4.5	Disa ndryshime në ligjin elektoral të vitit 1997	fq. 149
4.5.1	Rezultatet e zgjedhjeve parlamentare të parakohshme të 29 qershorit 1997 ...	fq. 151
	<i>Analizimi i zgjedhjeve të dyta parlamentare si të parakohshme të vitit 1997-të sipas</i> <i>teorisë së Arend Lijphart “Ndikimi i sistemit elektoral në formën qeverisëse”</i>	fq. 155
4.6	Ndryshimet Kushtetuese të vitit 1998-të.....	fq. 157
	<i>Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Shqipërisë.....</i>	fq.162
	<i>Përfundime</i>	fq.165

KAPITULLI V: ANALIZA EMPIRIKE

Ndikimi i sistemeve zgjedhore në sistemin partiak dhe formën e qeverisjes në Shqipëri

5.1	Sistemi elektoral i zgjedhjeve Parlamentare të 24 Qershorit 2001	fq. 170
	<i>Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2001</i>	<i>fq. 171</i>
	<i>Dushku i vogël ose Mega Dushku</i>	<i>fq. 175</i>
	<i>Analizimi i zgjedhjeve parlamentare të vitit 2001 sipas teorisë së Arend Lijphart</i>	
	<i>“Ndikimi i sistemit elektoral në formën qeverisëse”</i>	<i>fq. 177</i>
5.2	Sistemi elektoral i zgjedhjeve Parlamentare të vitit 2005	fq. 179
	<i>Rezultatet e zgjedhjeve parlamentare të 3 Qershorit të vitit 2005</i>	<i>fq. 181</i>
	<i>Analizimi i zgjedhjeve politike të vitit 2005 sipas teorisë së Arend Lijphart “Ndikimi</i>	
	<i>i sistemit elektoral në formën qeverisëse”</i>	<i>fq. 183</i>
	<i>Fenomeni Dushku i madh dhe fenomeni Demokristian</i>	<i>fq. 185</i>
5.3	Ndryshimet Kushtetuese të vitit 2008-të	fq. 187
5.4	Sistemi elektoral i përdorur në zgjedhjet politike të vitit 2009-të.....	fq. 191
	<i>Zgjedhjet Parlamentare të 28 qershorit 2009-të</i>	<i>fq. 195</i>
	<i>Fenomeni Ruzhdie e Fierit</i>	<i>fq. 198</i>
	<i>Analizimi i zgjedhjeve politike të vitit 2009-të sipas teorisë së Arend Lijphart</i>	
	<i>“Ndikimi i sistemit elektoral në formën qeverisëse”</i>	<i>fq. 199</i>
5.5	Ligji elektoral dhe zgjedhjet parlamentare të vitit 2013-të	fq. 203
	<i>Rezultatet e zgjedhjeve parlamentare të vitit 2013-të</i>	<i>fq. 205</i>

	<i>Analizimi i zgjedhjeve politike të vitit 2013 sipas teorisë së Arend Lijphart “Ndikimi i sistemit elektoral në formën qeverisëse”</i>	fq. 206
5.6	Dallimet midis Ligjit Nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe Ndryshimeve Kushtetuese Ligji Nr. 9904, datë 21.4.2008	fq. 208

KAPITULLI VI: KONKLUSIONE

	Konkluzione dhe përfundime	fq. 216
	SHTOJCA 1	fq. 236
	SHTOJCA 2	fq. 242
	SHTOJCA 3	fq. 249
	SHTOJCA 4	fq. 254
	Fjalorth	fq. 264
	BIBLIOGRAFIA.....	fq. 268

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku nr. 1: Grafiku që vërteton këtë lidhje shkakësie të variablave dhe indikatorëve kryesorë të analizuar.....	fq. 21
Grafiku nr. 2: Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 1991	fq. 124
Grafiku nr. 3: Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 1992.....	fq. 135
Grafiku nr. 4: Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 1996	fq. 146
Grafiku nr. 5: Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 1997.....	fq. 154
Grafiku nr. 6: Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2001.....	fq. 173
Grafiku nr. 7: Shtrebrërimi i sistemit elektoral (fenomeni Dushku), ku në këtë grafik paraqiten votat popullore në përqindje dhe mandatet parlamentare të paraqitura në përqindje	fq. 173
Grafiku nr. 8: Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2005	fq. 182
Grafiku nr. 9: Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2009.....	fq. 197
Grafiku nr. 10: Votat e marra në Qarkun Fier sipas subjekteve politike në zgjedhjet e vitit 2009.....	fq. 199
Grafiku nr. 11: Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2013	fq. 206

LISTA E TABELAVE OSE DIAGRAMEVE

Tabela nr.1: Renditja e formulave, sipas nivelit të favorizimit që bëjnë partive të mëdha..	58
Tabela nr. 2: Klasifikimi i Jean Blondel 1968, 184 – 87.....	fq. 63
Tabela nr. 3: Gjashtë teoritë e koalicionit.....	fq. 64
Tabela nr. 4: Gjashtë teoritë e koalicionit.....	fq. 75
Tabela nr. 5: Forma klasike e Shtetit sipas Aristotelit	fq. 79
Tabela nr. 6: Forma e Shtetit sipas Montesquieue.....	fq. 79
Tabela nr. 7: Karakteristika të regjimeve autoritare.....	fq. 85
Tabela nr. 8: Karakteristika të regjimeve totalitare.....	fq. 85
Tabelë nr. 9: Sistemi parlamentar (Meidani, R. 2009: 112)	fq. 89
Tabela nr. 10: Parlamenti – organ përfaqësimi	fq. 89
Tabela nr. 11: Parlamenti – organ shqyrtues.....	fq. 90
Tabela nr. 12: Parlamenti – organ legjislativ	fq. 90
Tabela nr. 13: Parlamenti – miraton qeverinë.....	fq. 90
Tabela nr. 14: Sistemi presidencial.....	fq. 99
Tabela nr.15: Alternimi i detyrave të tre pushteteve dhe kontrolleve përkatëse të tyre	100
Tabelë nr. 16: Sistemi parlamentar presidencial ose gjysmëpresidencial	fq. 102
Tabela nr. 17: Krahasimi midis sistemit parlamentar me atë presidencial.....	fq. 103
Tabela nr. 18: Dallimet midis republikës presidenciale dhe parlamentare.....	fq. 104
Tabela nr. 19: Tiparet kryesore e dallimet mesmodelit Westminster (mazhoritar) dhe consensus (proporcional).....	fq. 104
Tabela nr. 20: Kompetencat e detyrat e Organeve të Larta të Pushtetit Shtetëror, të përcaktuara në Kushtetutën e Shqipërisë në vitin 1991.....	fq. 118

Tabela nr. 21: Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 1991.....	fq. 123
Tabela nr. 22: Partitë të cilat kanë fituar mandate parlamentare të radhitura sipas spektrit politik nga A deri në D, për zgjedhjet politike të vitit 1991.....	fq. 130
Tabela nr. 23: Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 1992.....	fq. 134
Tabela nr 24: Partitë të cilat kanë fituar mandate parlamentare të radhitura sipas spektrit politik nga A deri në E, për zgjedhjet e para si të parakohshme të vitit 1992.....	fq. 137
Tabela nr. 25: Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 1996.....	fq. 146
Tabela nr 26: Partitë të cilat kanë fituar mandate parlamentare të radhitura sipas spektrit politik nga A deri në E, për zgjedhjet politike të vitit 1996.....	fq. 148
Tabela nr. 27: Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 1997.....	fq. 152
Tabela nr. 28: Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 1997 në përqindje.....	fq. 153
Tabela nr. 29: Partitë të cilat kanë fituar mandate parlamentare të radhitura sipas spektrit politik nga A deri në M, për zgjedhjet e dyta të parakohshme të vitit 1997	fq. 155
Tabela nr 30: Kompetencat e Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë të përcaktuara (Neni 102) në Kushtetutën e Shqipërisë në vitin 1998-të.....	fq. 160
Tabela nr 31: Kompetencat e Presidentit të Shqipërisë të përcaktuara (Neni 92) në Kushtetutën e Shqipërisë në vitin 1998-të.....	fq. 160
Tabela 32: Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2001 sipas koalicioneve...	fq. 172
Tabela nr. 33 : Rezultatet e zgjedhjeve parlamentare të vitit 2001 për subjekte politike për Zonën nr. 60 (Zona e Dushkut)	fq. 175
Tabela nr 34: Partitë të cilat kanë fituar mandate parlamentare të radhitura sipas spektrit politik nga A deri në J, për zgjedhjet politike të vitit 2001.....	fq. 177
Tabela 35: Përbërja e Kuvendit sipas subjekteve që i mbështesin për zgjedhjet e 2005	fq 182

Tabela nr 36: Partitë të cilat kanë fituar mandate parlamentare të radhitura sipas spektrit politik nga A deri në M, për zgjedhjet politike të vitit 2005	fq. 183
Tabela nr. 37: Koalicioni i djathtë ALDM, subjektet politike dhe përqindja e votave të marra për çdo forcë politike.	fq. 183
Tabela nr.38: Mandatet shtesë në proporcional të shpërndara midis 10 partive politike të vogla	fq. 186
Tabela nr. 39. Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2009	fq. 196
Tabela nr 40: Partitë të cilat kanë fituar mandate parlamentare të radhitura sipas spektrit politik nga A deri në M, për zgjedhjet politike të vitit 2009	fq. 200
Tabela nr. 41: Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2013	fq. 205
Tabela nr. 42: Partitë të cilat kanë fituar mandate parlamentare të radhitura sipas spektrit politik nga A deri në M, për zgjedhjet politike të vitit 2013	fq. 206
Tabela nr. 43: Lista e Presidentëve të Shqipërisë pas vitit 1990	fq. 212
Tabela nr. 44: Kryeministrat e Shqipërisë pas vitit 1990.....	fq. 212
Tabela nr. 45: Zgjedhjet e zhvilluara në vendin tonë pas vitit 1990-të, sistemi elektoral i aplikuar, konturimi i sistemit partiak dhe forma e qeverisjes (kabineti i formuar).....	fq. 232
Tabela nr. 46: Përkthkimi i votës në mandate.....	fq. 258
Tabela nr. 47: Përparësitë dhe mangësitë e sistemit të shumicës relative me zonë një mandatëshe (SMP).....	fq. 261
Tabela nr. 48: Përparësitë dhe mangësitë e Votës alternative (VA).....	fq. 262
Tabela nr. 49: Përparësitë dhe mangësitë e sistemit proporcional (VVT).....	fq. 263

LISTA E FIGURAVE

Figura nr. 1: Marrëdhënia e ndërsjellë e sistemit elektoral - sistemit partiak - formës së qeverisjes	fq. 9
Figura nr. 2: Lidhja midis sistemit elektoral – sistemit partiak – formës së qeverisjes.	fq. 12
Figura nr. 3: Variablat e ndërmarra në studim	fq. 12
Figura nr. 4: Sistemi një partiak	fq. 51
Figura nr. 5: Sistemi dy partiak	fq. 54
Figura nr. 6: Sistemi shumëpartiak.	fq. 60

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

BS – Bashkimi Sovjetik

RPSH – Republika Popullore e Shqipërisë

PPSH – Partia e Punës së Shqipërisë

RPSSH – Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë

BE – Bashkimi Evropian

MPB – Ministria e Punëve të Brendshme

MSA – Marrëveshja e Stabilizim – Asociimit

PKSH – Partia Komuniste Shqiptare

PPSH – Partia e Punës e Shqipërisë

PD – Partia Demokratike

PS – Partia Socialiste

EQL – Evropa Qendrore dhe Lindore

VEQL – Vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore

ODIHR – Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

MSE - Modeli Social European

USAID - Agjensia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar

NDI - Instituti Demokratik Amerikan / National Democratic Institute for the International Affairs

KQZ - Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve

R.SH – Republika e Shqipërisë

OKB - Organizata e Kombeve të Bashkuara

FMN – Fondi Monetar Ndërkombëtar

BB – Banka Botërore

UNESCO - United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization (e përkthyer si, Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara

NATO - The North Atlantic Treaty Organization (e përkthyer si, Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior)

KE – Komisioni European

PSD - Partia Social Demokratike

NDIIA -National Democratic Institute for International Affairs

KAPITULLI I: HYRJE

1.1 Parathënie

Në çdo shtet demokratik ekziston sistemi zgjedhor/elektoral, por pa u ndalur në dallimet dhe rregullat zgjedhore që bëjnë të mundur realizimin e tij. Parimet zgjedhore dhe mekanizmat e realizimit të tij në tërësi, përbëjnë në këtë mënyrë sistemin zgjedhor. Duhet theksuar, se zgjedhja e sistemit zgjedhor është një nga vendimet më të rëndësishme institucionale për çdo demokraci të re, por gjithashtu edhe për demokracitë që janë në zhvillim (Balukja, 2015 a: 846). Sistemi zgjedhor është pjesë e sistemit politik dhe kushtetues së një vendi. Sistemin zgjedhor e krijojnë normat ligjore, që janë pjesë e sistemit politik (Aziri, 2012: 35).

Historia na ka treguar se në përgjithësi në vendin tonë, sistemet zgjedhore nuk zgjidhen në mënyrë të lirë dhe të ndërgjegjshme, por nga kombinime rrethanash ose ndryshimeve historike të vendit. Historiku i përzgjedhjes së sistemit elektoral, pra, mund të jetë aq i rëndësishëm sesa përzgjedhja (Balukja, 2015 a: 847). Ndërsa në rastin e demokracive të reja, ku përfshihet edhe rasti i Shqipërisë, sistemet zgjedhore zgjidhen me qëllim, ku në qendër të cilit qëndron zgjedhja e Parlamentit.

Si rrjedhojë, këto 25-së vitet e fundit të tranzicionit postkomunist në vendin tonë kanë mbizotëruar debate mbi zhvillimet politike në tavolina të rrumbullakta midis aktorëve politikë, analistëve dhe grupeve të interesit. Dhe çështje themelore për një vend në tranzicion si Shqipëria, si ndërtimi i shtetit dhe institucioneve demokratike, zhvillimi i zgjedhjeve të përgjithshme, pranimi ose jo i rezultateve paszgjedhore nga subjektet politike

humbëse, si edhe sistemi partiak dhe ndikimi në formën qeverisëse të vendit, kanë përbërë edhe thelbin e debateve gjatë këtyre tre dekatave të fundit në skenën politike.

Shqipëria para viteve '90 ka qenë nën pushtetin e një partie-shtet (Partia Komuniste), këtë e vëmë re edhe në formën qeverisëse të vendit tonë. Në këtë periudhë vërehet një mbyllje e vendit nga tërë bota (Perëndimi), ku kemi mungesë të lirisë së fjalës, të drejtave themelore të njeriut, si të drejtat politike, sociale dhe kulturore. Vendi ynë ishte në një diktaturë të vërtetë, ku partia komuniste kishte liri veprimi mbi çdo individ dhe në çdo fushë në vend.

Pas viteve 1990-të, për herë të parë u lejua krijimi i një partie të re (Partia Demokratike) dhe më pas kemi krijimin e një numri të madh të partive politike. Ky fenomen shihet si një kundërshtim i sistemit politik të atëhershëm. Pas zhvillimit të zgjedhjeve të para 'demokratike' të vitit 1991, pas pesë dekadash në një sistem një partiak, kemi krijimin e një sistemi dypartiak. Nëse do të analizonim programet e tyre politike, këto parti nuk kanë shumë ndryshim nga njëra-tjetra dhe mund të themi se ky fenomen nuk ka rezultuar i 'shëndetshëm' për demokracinë e vendit. Si rrjedhojë, gjatë këtyre viteve, vendi ynë njeh për herë të parë pluralizëm partiak, pas një pushteti prej pesë dekadash të një partie-shtet (Partia Komuniste).

Por, mungesa e eksperiencës politike në ndërtimin e shtetit dhe të institucioneve demokratike, e gjen klasën e re politike shqiptare përpara shumë sfidash të rëndësishme. Sfida e parë dhe më e rëndësishmja për elitën politike ka të bëjë me zgjedhjen e një sistemi elektoral, pra, me projektimin e institucioneve të reja demokratike, të rregullave institucionale, ligjeve dhe normave të reja. Tërësia e të gjithë elementeve së bashku, do të përbënin bazën mbi të cilën do të funksiononte demokracia më e re, e cila më shumë sesa e

mirë studiuar duhet të ketë qenë një domosdoshmëri e kohës. Shqipëria ka hyrë në fazën e zhvillimit demokratik që në vitet 1990-të, që nga ajo kohë vendi ynë ka njohur disa sisteme politike të ndryshme (Balukja, 2016: 446).

Historia e zgjedhjeve politike dhe e proceseve elektorale në Shqipëri është po aq e brishtë dhe e shtrirë në kohë, si edhe në problematika, sa edhe vetë historia e shtetit shqiptar (Krasniqi, 2009: 13). Shqipëria me një shoqëri pak të arsimuar, ekonomikisht e varfër dhe me mungesë të modeleve referuese politike thekson autori, nuk pati elementë tjerë nxitës të lëvizjeve politike dhe garuese midis grupeve, klasave e niveleve të ndryshme përbërëse të shoqërisë shqiptare. Procesi zgjedhor sipas Krasniqit ka marrë gjithnjë e më shumë karakter institucional, ku aktorët kryesorë politikë kanë zgjeruar midis tyre konsensusin, për të pranuar rregullat e garës elektorale, kjo e arrirë përtej kontestimeve nga humbësit e zgjedhjeve të përgjithshme.

Nënvizojmë se historia shqiptare pas viteve 1990-të, është një histori pluripartiake, ku kemi krijimin e një numri të konsiderueshëm të partive të reja politike dhe ky fenomen është shfaqur si një nevojë e kohës. Si pasojë kemi kalimin nga një sistem njëpartiak (partia-shtet) në një sistem dypartiak dhe përcaktimin e një sistemi zgjedhor mazhoritar deri në miks me atë proporcional. Sistemi mazhoritar me një miksim të vogël proporcional, erdhi si një domosdoshmëri historike që do të sillte në parlamentin shqiptar të pas viteve '90, parti politike të gjithfarë ngjyrave dhe nuancave të tyre (NDIHA, 2005 “Politikani i Ri”, fq. 5-6). Ka një sërë faktorësh, që tregojnë se sistemi elektoral ndikon në sistemin partiak, dhe ky i fundit ndikon në formën qeverisëse në vendin tonë.

Themelimi i Partisë Demokratike Shqiptare nga studentët dhe intelektualët, në dhjetor të vitit 1990-të, shënon fillimin e shpërbërjes së shtetit të diktaturës komuniste prej

më shumë se gjysëm shekulli. Shënohet gjithashtu edhe fillimi i pluralizmit politik me një spektër të gjërë politik. Por, nëse do t'i bënim një analizë situatës politike së atëhershme, do të vërejmë një mungesë totale të traditës politike pluraliste dhe një mungesë të pluralizmit së mendimit, ku sigurisht nëse i referohemi fakteve historike nuk mund të presupozohet ekzistenca plurale e mendimit.

Arben Cejku, tek libri i tij “Demkracia e imponuar” (2000: 6), argumenton se pas shembjes së diktaturës komuniste, shteti ynë ishte përballë një sfide shumë të madhe, atë të bërjes së shtetit demokratik:

Shqipëria bashkë me shumë vende të tjera të Europës Lindore, bënte pjesë në botën post – komuniste, e përfshirë nga përpjekjet për të gjetur një identitet demokratik dhe një stacion të sigurtë në familjen e madhe dhe të pasur të perëndimit, e lodhur nga diktatura, pa një infrastrukturë demokracie dhe ekonomie tregu, ajo sikurse vendet e tjera, përballë realiteteve të tjera të kapitalizmit dhe demokracive liberale, po ecën përpara me vështirësi të mëdha, deri në deziluzion dhe frikë për kthim tek një sistem i ndërmjetëm anarshie post – komuniste, as diktaturë dhe as demokraci (Cejku, 2000: 5).

Në vitet e para të ndryshimeve të mëdha, Shqipëria ndodhej në kushtet e një varfërie ekstreme ekonomike, gjithashtu kishim mungesë të shtetit ligjor, të kulturës demokratike-politike dhe të institucioneve ‘të konsoliduara’ demokratike.

Shqipëria krahasuar me shtetet e Lindjes ishte vendi i fundit komunist që hyri në rrugën e demokracisë. Si rrjedhojë, zhvillimi i zgjedhjeve në Shqipëri gjatë kësaj periudhe tranziti janë shoqëruar me klimë të ashpër politike, me devijime dhe defekte të konsiderueshme, të cilat kanë pasur ndikimin e tyre edhe në rezultatin e zgjedhjeve (Berhani, 2009: 11). Kjo vjen edhe si rezultat i trashëgimisë nga periudha komuniste, ku nuk mungonin konfliktet politike, si edhe mungesës të traditës demokratike shqiptare (Omari, L. 2002: 307). Prandaj në Shqipëri, thekson autori, janë vërejtur dukuri të tilla, si

zgjedhje të zhvilluara me manipulime ose ku është përdorur edhe dhuna, bojkotime të parlamentit, shkelje të përsëritura të të drejtave të njeriut etj.

Duke u bazuar në historinë parlamentare të pas viteve '90, vendi ynë ka aplikuar sisteme të ndryshme zgjedhore kryesisht një sistem zgjedhor mazhoritar, me përjashtim të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2009-të dhe 2013-të. Gjatë këtyre viteve në Parlament kemi përfaqësimin e shumë partive të vogla politike, por që kanë shfrytëzuar situatën politike për përfitime personale dhe jo në mbrojtje të një kauze që prek një grup të caktuar shoqëror. Këtë ndryshim do ta mundësonte aplikimi i një sistemi të pastër proporcional me një prag elektoral rreth 4 % të votave të përgjithshme. Por më konkretisht, zgjedhjet politike të zhvilluara në Shqipërinë e pas viteve '90, sistemet elektorale, si edhe sistemet partiake të formuara prej tyre, si edhe forma e qeverisjes ndër vite dhe formimi i kabineteve qeverisëse (një partiak ose qeverisje me një koalicion fitues), do të trajtohen në mënyrë më të gjërësishme në kapitujt e mëposhtëm, ku do të bëhet edhe një trajtim më i detajuar i tyre.

1.2 Hyrje

Punimi synon të analizojë *ndikimin e sistemeve elektorale*, duke trajtuar gjërësisht familjen e madhe të sistemeve zgjedhore në *formën qeverisëse* të vendit tonë. Në koncept, sistemi elektoral përcakton se si votohet në zgjedhjet e përgjithshme dhe se si këto vota shndërrohen më pas në mandate parlamentare. Pasi kemi formimin e Parlamentit shqiptar prej 140 deputetësh (numri i mandateve parlamentare të viteve të fundit), rrjedhimisht sistemi elektoral bën më pas konturimin e sistemit partiak dhe ky i fundit, ndikon në

mënyrë të drejtëpërdrejtë në formën qeverisëse të vendit tonë dhe në formimin e kabineteve qeverisëse.

Në spektrin politik, pasojat e sistemit mazhoritar është dypartitizmi (Çili, 2002: 7). Një sistem elektoral mazhoritar favorizon partitë e mëdha dhe si rrjedhojë, kemi krijimin e një sistemi dypartiak, ndërsa partitë e vogla mbeten jashtë Kuvendit duke mos pasur mundësinë e përfaqësimit të elektoratit të tyre. Ky sistem elektoral thekson rëndësinë e stabilitetit qeverisës, si edhe politikë-bërësit mbajnë përgjegjësi përpara elektoratit të tyre. Votuesit mund të ndëshkojnë ose jo partinë, në bazë të reformave të ndërmarra gjatë mandatit qeverisës për të cilën ata janë votuar.

Mund të ndodhë edhe e kundërta, ku një sistem proporcional favorizon partitë e vogla (me prag të ulët) dhe kemi krijimin e një sistemi shumëpartiak. Në qendër ndodhet rëndësia e përfaqësimit të gjitha grupimeve politike dhe krijimi i një qeverisje mbi bazë të gjërë koalicioni, ku rritet pesha e partive të vogla në vendimmarrje. Si rrjedhojë, sistemi proporcional vendos një raport barazie mes përqindjes së votave të marra dhe përqindjes së vendeve parlamentare për një subjekt politik. Ky sistem frymëzon marrëveshjen, si mënyrë thelbësore të vendimmarrjes, si në raportet e forcave brenda shumicave qeverisëse, si mes pozitës e opozitës (Çili, 2002: 14).

Qëllimi qëndror i këtij punimi shkencor është mundësimi i një panorame teorike, konkrete dhe analitike të marrëdhënies ndërmjet sistemit elektoral (rregullave dhe ligjeve elektorale) - sistemit partiak (konturimi i tyre) - dhe formës qeverisëse, për periudhën kohore 1991 - 2013. Për të eksploruar dhe analizuar këtë marrëdhënie, secili nga dimensionet e mësipërme do të trajtohen teorikisht, duke u përkthyer konkretisht në realitetin shqiptar të 23 viteve të tranzicionit.

Në këtë punim kemi përdorur kushtet e ndërveprimit, ku analiza institucionale e politikës sipas Hall (1986: 19), thekson marrëdhëniet institucionale, konvencionale dhe formale, të cilat së bashku me komponentët e shtetit, strukturojnë marrëdhëniet e saj me analizën empirike të shkencave sociale. Në mënyrë cilësore ose sasimore, një përlllogaritje empirike mbështetet në argumentet që ka kontrolluar ose ka bërë të rastësishme mbi shkaqet e tjera të mundshme. Si rrjedhojë, punimi është i natyrës së analizimit dhe aplikimit të teorisë së Arend Lijphart, ku kemi përcaktuar modelin empirik dhe kushtëzimit kontekstual për të ndjekur një formë specifike funksionale të sugjeruar nga teoria (Franzese 1999, 2003).

Arsyeja e trajtimit të kësaj tematike për hulumtim është se Shqipëria pas viteve '90- pësoi ndryshimin e sistemit politik nga autoritar në sistem demokratik dhe që prej një çerek shekulli ndodhet në fazën e tranzicionit. Dhe në këto 25-së vitet e fundit, vendi ynë ka njohur ndryshime të shpeshta të sistemeve elektorale, ku janë konturuar forma të ndryshme të sistemeve partiake. Nga sistemi njëpartiak për një periudhë 46 vjeçare, vetëm pas këtyre viteve Shqipëria ka njohur sistemin dypartiak dhe pas vitit 2008-të me Ndryshimet Kushtetuese, vendi ynë ka njohur sistemin shumëpartiak. Këta faktorë kanë ndikuar ndjeshëm në formën qeverisëse të vendit tonë dhe kjo periudhë tranziti është diçka e re për ne si shtet, ku vetëm pas viteve 1990 përkrahëm demokracinë dhe akoma ndodhemi në fazën e tranzicionit.

Pas viteve 2000, në Shqipëri janë bërë disa studime shkencore cilësore që kanë trajtuar sistemin elektorale dhe partitë politike, të cilat janë fokusuar më shumë në lidhjen që ekziston midis sistemit zgjedhor dhe sistemit partiak (Çili, 2002; Kajsio, 2004; 2005; Çeka, 2013), sistemit partiak dhe organizimit të partive politike në Shqipëri (Xhaferaj, 2016). Në

punimet e tyre shkencore, Çili (2002) dhe Kajsio (2004; 2005) dalin në konkluzion se sistemi elektoral kushtëzon partitë politike shqiptare ose e konturon sistemin partiak në Shqipëri. Ndërsa Çeka (2013) ka studjuar gjërësisht luhatshmërinë e elektoratit shqiptar pas vitit 1990-të, ku autori trajton partitë politike shqiptare në fazën e tranzicionit. Autori ka trajtuar gjërësisht shkallën e përshfirjes së partive në aktivitete të caktuara politike (në fushata elektorale dhe procese zgjedhore).

Por, tematika e këtij dizertacioni, që analizon një lidhje të gjërë shkakësie (sistemi zgjedhor-sistemi partiak-forma e qeverisjes dhe analizimi i kabineteve qeveritare) për një periudhë kaq të gjatë nga viti 1991-2013, nuk është trajtuar më parë në Shqipëri dhe si pasojë ka pasur vështirësitë e saj. Por nënvizojmë, se ky punim është i një rëndësie të madhe sepse jep një kontribut të madh në këtë fushë dhe është një risi në trajtimin e kësaj tematike. Ky punim i hap rrugën një sërë hulumuntimsh të mëvonshme duke u plotësuar me zhvillimin e zgjedhjeve të përgjithshme të 25 qershorit të vitit 2017, 2021 etj.

Kontributi kryesor i këtij punimi është analizimi dhe i gjithë këtyre variablave së bashku në një studim të vetëm, si edhe analizimi i indikatorëve me realitetin shqiptar, duke parashtruar e analizuar një panoramë të gjërë të sistemeve elektorale – sistemit partiak dhe formën e qeverisjes së vendit tonë gjatë 23 viteve të fundit. Por, kontributi më i rëndësishëm është studimi për herë të parë në Shqipëri, i kabineteve qeverisëse nga vitit 1991-2013 në bazë të gjashtë teorive të koalicionit të Arend Lijphart.

Në fund të punimit do të dalim në konkluzion për sistemin elektoral më të përshtatshëm për vendin tonë, ku një sistem elektoral i përshtatshëm me kushtet politike të vendit prodhon një formë qeverisëse më demokratike dhe mund të bëjë të mundur kalimin e kësaj faze tranziti dhe arritjen e konsolidimit të demokracisë. Sipas Çilit (2002: 8), vendi

ynë është në kërkimit të një formule elektorale që i kënaq të gjithë, duke kërkuar versionin më të përshtatshëm të proporcionalit: i pastër me prag parlamentar 4-5 %, që rritet gradualisht për dy-tre legjislaturat. Por duhet theksuar, se nuk ka sistem elektorale të mirë ose të keq, por sistem zgjedhor i përshtatshëm ose jo duke u bazuar me kushtet politike dhe me kulturën demokratike të vendit ku aplikohet. Sistemi elektorale, sipas autorit bëhet shkak për mosfunksionimin e spektrit politik, në funksionimin e brendshëm jodemokratike të partive të mëdha dhe në krizën e funksionimit normal e demokratik të shtetit shqiptar.

Teza ka objekt studimi sistemet elektorale/ (sistemet partiake) formën qeverisëse në Shqipëri. Gjithashtu, duke u bazuar në rezultatet zgjedhore të zgjedhjeve të përgjithshme nga viti 1991-2013, kemi formimin e kabineteve qeverisëse, të cilat në këtë punim janë analizuar dhe trajtuar sipas gjashtë teorive të koalicioneve të Arend Lijphart. Dhe në fund të punimit arrihet të konfirmohet një marrëdhënie shkak-pasojë midis variablave, kjo nëpërmjet teorisë të përdorur në këtë dizertacion.

Figura Nr. 1: Marrëdhënia e ndërsjellë e sistemit elektorale – sistemit partiak – formës së qeverisjes.



Dhe pyetja kërkimore e studimit është: ***Si ka ndikuar sistemi zgjedhor në formën e qeverisjes në Shqipëri?***

Figura nr. 2: Lidhja midis sistemit elektoral – sistemit partiak – formës së qeverisjes.



Si edhe hipoteza e këtij punimi është: **Sistemi elektoral ndikon në formën qeverisëse në vendin tonë.** Ky dizertacion pohon ekzistencën e një lidhje shkakësie midis variablave të ndërmarrë në analizë, duke aplikuar teorinë e Arend Lijphart “Ndikimi i sistemit elektoral në formën qeverisëse”. Dhe në këtë studim, sistemi elektoral është variabli i pavarur dhe forma qeverisëse e vendit tonë është variabli i varur. Ku kemi një ndikim të drejtëpërdrejtë të sistemit elektoral në formimin e kabineteve qeveritare gjatë viteve 1991-2013 në vendin tonë.

Pra, kemi një ekuacion shumë të thjeshtë, ku teza qëndrore e studimit është:

Sistemi Elektoral (Variabël i pavarur) → ndikon në *Formën Qeverisëse* (Variabël i varur).

Në ndërtimin e variablave është tentuar të ruhet njëtrajtshmëria duke e bërë sa më të besueshëm punimin për ilustrimin teorik. Dhe në vijë logjike, kemi këtë trajektore:

Figura Nr. 3: Variablat e ndërmarra në studim.



Në shpjegimin teorik të marrëdhënies së mësipërme ndërmjet sistemeve elektorale, sistemit partiak dhe formës qeverisëse në rastin shqiptar, duket se funksionon më mirë perspektiva teorike e ***ndikimit të sistemit elektoral në formën qeverisëse të vendit***.

Midis variablave ekziston një marrëdhënie shkakësie, ku sistemi elektoral është variabli i pavarur, në përcaktimin e dy dimensioneve të tjera të cilat kanë varësi nga ky variabël por dhe e ndikojnë atë në mënyrë të parashikuar ciklike. Si edhe sistemi partiak është një indikator shumë i rëndësishë në këtë marrëdhënie shkakësie dhe qëndron në mes të variablave, si një variabël i ndërmjetëm, ndërsa forma e qeverisjes është variabli i varur.

1.3 Metodologjia

Studimi ndjek një metodologji të përzier, ku kemi përdorur sëbashku metodat sasiore dhe cilësore. Gjithashtu, studimi është i natyrës së testimit të teorisë së Arend Lijphart “*Ndikimi i sistemit elektoral në formën qeverisëse*” në realitetin shqiptar. Dizertacioni bazohet në literaturën bashkëkohore mbi tipologjitë e sistemeve elektorale, sistemit partiak e formës qeverisëse në Evropën Perëndimore dhe USA. Në fillim do të trajtojmë konceptet bazë të variablave të cituara më sipër, më pas do të paraqesim kontekstin teorik të metodologjisë që do të përdorim në këtë punim. Githashtu, do të paraqesim disa shembuj konkretë dhe arsyen se përse e kemi zgjedhur këtë metodologji.

Qëllimi qëndror i këtij dizertacioni është mundësimi i një panorame të përgjithshme teorike, konkrete dhe analitike të marrëdhënies ndërmjet tre variablave, sistemit elektoral (rregullave dhe ligjeve elektorale) - sistemit partiak (konturimi i tyre) - formës qeverisëse (formimi i kabineteve qeverisëse-koalicioneve), për periudhën kohore nga viti 1991 deri në

vitin 2013-të në Shqipëri. Për të analizuar këtë marrëdhënie shkakësie, secili nga variablat e mësipërme do trajtohen teorikisht, duke u përkthyer konkretisht në realitetin tonë shqiptar.

Pra, teza ka objekt studimi *sistemet elektorale/* (sistemet partiake) *formën qeverisëse* në Shqipëri. Duke u bazuar në rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 1991-2013, kemi edhe formimin e kabineteve qeverisëse dhe në këtë punim janë analizuar e trajtuar sipas gjashtë teorive të koalicioneve të Arend Lijphart. Dhe në fund të punimit arrihet të konfirmohet marrëdhënia shkak-pasojë midis variablave, kjo nëpërmjet teorisë të përdorur në këtë punim “*Ndikimi i sistemit elektoral në formën qeverisëse*” të studiuesit Lijphart.

Por le t’i trajtojmë këto variabla më specifikisht, duke i trajtuar nga ana konceptuale secilën prej tyre, për të kuptuar më mirë edhe lidhjen e shkakësisë që ekziston midis tyre. Variabla i parë është sistemi zgjedhor/elektoral, i cili është pranuar nga të gjithë se ka një rëndësi të madhe në sistemin politik dhe në krijimin e qeverisë/kabineteve qeveritare. Zgjedhja/përzgjedhja e sistemit zgjedhor është vendim institucional shumë i rëndësishëm për çdo vend demokratik sepse sistemi elektoral është pjesë e sistemit politik dhe kushtetues së një vendi.

Në koncept, sistemi elektoral përcakton se si votohet në zgjedhje dhe se si këto vota shndërrohen në mandate parlamentare. Pra, ne zgjedhim përfaqësuesit e popullit dhe në këtë mënyrë kemi edhe formimin e Parlamentit. Rrjedhimisht sistemi elektoral më pas bën konturimin e sistemit partiak dhe ky i fundit, ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në formën qeverisëse të vendit tonë dhe në formimin e kabineteve qeverisëse.

Nënvizojmë se sistemi elektoral bën konturin e sistemit partiak dhe pasi është formuar Parlamenti, më pas del numri i partive politike parlamentare. Një partie politike mund t’i lindë e drejta që të krijojë Qeverinë ose dy ose më shumë se dy parti politike. Dhe

nëse analizojmë sistemin elektoral, në të shumtën e rasteve kemi përdorimin e sistemit elektoral mazhoritar ose proporcional, kjo në varësi se çfarë duan lidërt e partive kryesore politike si rezultat të zgjedhjeve dhe situatës politike në vend.

Çdo sistem zgjedhor është i bazuar në një parim të caktuar të zgjedhjeve që mund të jetë në pjesën më të madhe mazhoritar, proporcional ose të dyja bashkë (sistem i përzier) dhe propozon për të arritur efekte të caktuara në një sistemin politik të caktuar. Pasojat e sistemit mazhoritar në spektrin politik është dypartitizmi, ku ky sistem elektoral favorizon partitë e mëdha dhe si rrjedhojë kemi krijimin e një sistemi dypartiak. Theksohet rëndësia e stabilitetit qeverisës dhe politikë-bërësit mbajnë përgjegjësi përpara elektoratit të tyre.

Ndërsa sistemi proporcional favorizon partitë e vogla dhe kemi krijimin e një sistemi shumëpartiak, ku të gjitha grupimet politike përfaqësohen. Ky sistem frymëzon një mjedis politik me shumë aktorë dhe kemi krijimin e një qeverisje mbi bazë të gjërë koalicioni. Si rrjedhojë, qeveritë parlamentare që zgjidhen në këtë mënyrë, priren drejt sistemeve shumëpartiake ose drejt një koalicioni të gjërë, ku mund të përfaqësohen edhe grupime të vogla politike.

Nëse analizojmë rastin e parë, nga sistemi elektoral mazhoritar kemi një sistem dypartiak dhe më pas kemi krijimin e një kabineti minimal. Ku një partie politike i lind e drejta për të formuar kabinetin qeveritar, e cila kontrollon numrin më të madh të mandateve parlamentare. Ndërsa në rastin e dytë, nga sistemi elektoral proporcional kemi një sistem shumë partiak dhe më pas kemi krijimin e një kabineti të gjërë. Ku disa parti, dy ose më shumë nëpërmjet një marrëveshje/bashkëpunimi formojnë kabinetin qeveritar. Në këtë mënyrë, nënvizojmë se kemi ekzistencën e një lidhje të ngushtë midis sistemit partiak dhe

llojit qeverisës, vërejmë se nëse numri i partive parlamentare rritet atëherë mundësia e kabinetit minimal ulet.

Dallimi midis dy formave të qeverisjes ose dy formave të kabineteve qeveritare, ka të bëjë me gjerësinë e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të popullit në degën ekzekutive të qeverisë, ku kemi një dallim midis të qeverisurve me shumicë një-partiake e koalicioneve të gjëra shumëpartiake. Kontrasti midis parimit të shumicës të përqëndrimit të pushtetit në duart e shumicës dhe parimit të konsensusit të gjerë në ndarjen e pushtetit, është një dimension që do të trajtohet gjërësisht në këtë punim shkencor.

Por, më parë le të trajtojmë konceptin qeverisje (formë qeverisëse), ku në një përcaktim më të përgjithshëm, është agjencia thelbësore përmes së cilës formulohen e realizohen veprimet dhe funksionet e saj në kuadrin e një komb-shteti të caktuar e të marrëdhënieve me komb-shtetet e tjera (Filo, 2007: 17). Qeveria (ose qeverisja) përgjithëson institucionet, ku shoqëria aplikon politikat e saj publike.

Ndërsa qeverisja, si formë/koncept, përfshin tre pushtete, si pushtetin legjislativ (miraton ligjet), ekzekutiv (zbaton ligjet) dhe juridik (interpretin ligjet). Këto tre pushtete i shohim në çdo qeverisje, por mund të ndryshojë natyra e strukturimit dhe e funksionimit të tyre. Natyra e funksionimit të tre pushteteve është kriter përcaktues të llojit qeverisës. Dhe në këtë punim, marrëdhënia midis këtyre pushteteve do të analizohet gjërësisht, si në rastin e parë dhe në rastin e dytë të trajtuara pak më sipër.

Duke analizuar këto variabla së bashku ne arrijmë që të konfirmojmë empirikisht edhe hipotezën e këtij punimi shkencor, **se kemi një ndikim të drejtëpërdrejtë të sistemit elektoral në formimin e kabineteve qeveritare gjatë viteve 1991-2013 në vendin tonë.** Ndërsa nënpyetjet kërkimore të nënvizuara tek hyrja, do të analizohen specifikisht në çdo

kapitull të më poshtëm dhe do të mundohemi që t'i japim përgjigje secilës prej tyre. Në këtë punim doktoral pohojmë se konteksti ka shumë rëndësi, sepse analizojmë disa faktorë që ndikojnë tek e tëra, një ose dy faktorë që ndikojnë ose konturojnë faktorin e tretë. Më poshtë do të analizojmë edhe këtë fenomen, por do ta trajtojmë nga ana teorike metodologjinë e përdorur në këtë dizertacion.

Atëherë nëse argumentojmë se konteksti ka rëndësi, pra si funksionojnë shkaqet e veçanta dhe ndoshta gjithë struktura e procesit shkakësor, atëherë kjo është shumë kontekstuale. Procesi shkakësor ndryshon në kontekste dhe konteksti është i kushtëzuar. Përsa i përket çështjeve të kontekstit, proceset dhe rezultatet ndryshojnë në mënyrë unike, ku secili vend i caktuar substancial, në çdo kohë, ka proceset e veta unike në lidhje me rezultatet e tij. Nëse biem dakord në këtë përfundim, atëherë çdo krahasim brënda ose jashtë rasteve, kohëve ose vendosjeve, do të jetë gjithmonë i pajustificuar ose i padobishëm. Në këto kushte, nuk mund të mësojmë më shumë se përshkrimi nga krahasimi, historia ose historia krahasuese.

Duke u bazuar në librin 'Comparative Politics' (2007: 45), autorët argumentojnë se në qasjet institucionale, efekteti i interesave të strukturave shoqërore formohet dhe varet nga struktura institucionale e shoqërisë, të ekonomisë dhe politikës. Analiza institucionale e politikës sipas Hall (1986, 19) thekson marrëdhëniet institucionale, si konvencionale dhe formale, të cilat së bashku me komponentët e shtetit strukturojnë marrëdhëniet e saj me analizën empirike të shkencave sociale. Shoqëria (institucionet shtetërore) i referohen rregullave formale, procedurave të pajtueshmërisë dhe praktikave standarde të veprimit që strukturojnë marrëdhëniet midis individëve në njësi të ndryshme të politikës e ekonomisë.

Faktorët institucionalë ndikojnë në shkallën e pushtetit që çdo grup i aktorëve ka mbi rezultatet e politikave, si edhe në përcaktimin e një aktori për interesat e tij, duke vendosur përgjegjësitë e tij dhe marrëdhënien me aktorët e tjerë. Me kaq shumë mundësi për të shqyrtuar ndërveprimet me natyrë interaktive logjike të ndërveprimit të teorisë së politikës krahasuese, modeli sasior empirik i kushtëzimit të tillë kontekstual mund të jetë mjaft i thjeshtë (Brambor, Clark, dhe Golder 2006).

Së pari, duhet të kuptojmë modelet empirike që përfshijnë hipoteza interaktive. Lidhur me numrin e ndërveprimeve, hulumtuesit krahasues kanë katër opsione, por secila me rreziqe karakteristike: 1. *Injorojnë kontekstualitetin e argumenteve të tyre* duke mos përmendur terma interaktivë. Shumica e analistëve e bëjnë këtë, por kjo dëmton e ka efekte në të vërtetë me paragjykime dhe mungesë efikasiteti të ndryshuar;

2. *Zvogëlon kontekstualitetin* duke lejuar vetëm një ose disa ndërveprimeve hipotetike në modelin e tyre empirik. Kjo mundëson përqëndrimin në ato që përfshijnë ndërveprimet, zvogëlon paragjykimet dhe mungesën e variablave të përjashtuara; 3. *Përcakton modelin empirik e kushtëzimit kontekstual për të ndjekur një formë specifike funksionale të sugjeruar nga teoria* (Franzese 1999, 2003). Redukton kërkesat empirike, duke reduktuar më tej problemet e mungesës së specifikimit dhe joefikasitetit të qasjeve të mëparshme; 4. *Janë kryer analiza më specifike (cilësore)* për të plotësuar ose zëvendësuar analizën sasiore. Kjo kundërshton mungesën e informacionit, duke pasuruar detajet e thellësinë e empirikës, rrit cilësinë e informacionit me koston e reduktimit të sasisë.

E treta e këtyre opsioneve, duket më premtuese sepse problemet e ngritura nga kushte kontekstuale komplekse janë logjikisht të qenësishme, kështu që burimet kualitative nuk mund t'u shmangen atyre dhe dy opsionet e tjera i shmangen vetëm deri në masën që e

shtypin kushtëzimin. Hulumtuesit mund të aplikojnë me sukses këtë qasje për të studiuar peshën relative në kontrollin e politikave, p.sh. ekzekutiv dhe ligjvënës në sistemet presidenciale (gjysmë) ose dhomat e ndryshme në sistemet shumëpartiake, ose mesataren e kryeministrit, kabineti mediatik dhe ministrat e portofolit në sistemet parlamentare. Është pikërisht kjo qasje që do të përdorim në këtë punimin shkencor për të testuar teorinë “*Ndikimi i sistemit elektoral në formën qeverisëse*” në realitetin shqiptar, për të pohuar hipotezën dhe për t’i dhënë përgjigje nënpyetjeve kërkimore.

- Efekti i X (p.sh. institucionet) në Y (rezultatet) varet nga ose ka dhënë kontrollin për Z (kultura, struktura, etj.): formalisht, $\partial Y / \partial X = f(Z)$.
- X (sistemi elektoral-variabël i pavarur) në Y (formën qeverisëse-variabël i varur) është një funksion i Z (sistemi partiak).

Arend Lijphart ka botuar librin “Patterns of Democracy” në dy edicione, në vitin 1999 dhe 2012. Lijphart ka studiuar format e qeverisë dhe performancën e tridhjetë e gjashtë vendeve. Këto janë vende demokratike dhe autori ka studiuar disa variabla, si: Modelin mazhoritar dhe konsensual të demokracisë; Sistemin partiak: dy-partiak dhe shumëpartiak; Kabinetet: përqendrimi ose ndarja e pushtetit ekzekutiv; Marrëdhëniet midis pushtetit ekzekutiv-legjislativ: modele të dominimit dhe bilanci i pushtetit; Sistemet zgjedhore: metodat e shumicës dhe pluraliste kundrejt përfaqësimit proporcional; Ndarja e pushtetit: kontrasti federal-unitar dhe i centralizuar-decentralizuar; Parlamentet dhe Kongreset: përqendrimi/ndarja e pushtetit legjislativ; Kushtetutat; Harta konceptuale dy-dimensionale e demokracisë; Menaxhimi makro-ekonomik e kontrolli ndaj dhunës etj.

Atëherë ky studim shkencor disa vjeçar do të testojë teorinë e Arend Lijphart “*Ndikimin e sistemit elektoral në formën qeverisëse*”, por në realitetin shqiptar dhe gjatë

periudhës 1991-2013, duke analizuar shumicën e variablave të analizuara nga studiuesi. Periudhë kjo kur vendi ynë njohu demokracinë dhe nënvizojmë se ky punim është i një rëndësie të madhe sepse nuk ka punime të ngjashme në Shqipëri kur janë analizuar kaq shumë variabla së bashku në një periudhë kohore kaq të gjatë.

Variablat që do të marrin në analizë janë përshtatur me kontekstin shqiptar, si: Modelin mazhoritar dhe konsensual të demokracisë; Sistemin partiak: dy-partiak dhe shumëpartiak; Kabinetet: përqendrimi ose ndarja e pushtetit ekzekutiv; Marrëdhëniet midis pushtetit ekzekutiv-legjislativ: modele të dominimit dhe bilanci i pushtetit; Sistemet zgjedhore: metodat e shumicës e pluraliste kundrejt përfaqësimit proporcional; Parlamenti: përqendrimi /ndarja e pushtetit legjislativ; Kushtetuta (e ndryshuar ndër vite).

Si rrjedhojë, punimi është i natyrës së analizimit dhe testimit të teorisë së përdorur, ku kemi përcaktuar modelin empirik dhe kushtëzimit kontekstual për të ndjekur një formë specifike funksionale të sugjeruar nga teoria (Franzese 1999, 2003). Shumë teori krahasuese mund të mos jenë mjaft të sakta për të përcaktuar formën e ndërveprimeve, por forca e fituar vjen nga mbështetja më e madhe në teori dhe shqetësimet e shumëkombësimit rishfaqen në një ritëm më të vogël.

Dizertacioni bazohet në literaturën klasike e bashkëkohore të Evropës Perëndimore dhe USA. Kemi realizuar tre intervista gjysmë të strukturuar me specialistë të fushës së studimit. Kemi intervistuar Kastriot Islamin, Marko Bellon dhe Ilir Rusmalin, të cilët i janë përgjigjur gjashtë pyetjeve gjysmë të strukturuar. Më poshtë, tek analiza e të dhënave cilësore, do të shpjegojmë më gjërësisht se ku jemi bazuar që kemi zgjedhur këta tre të intervistuar dhe do të paraqesim në mënyrë sa më transparente gjashtë pyetjet e intervistës.

Në këtë dizertacion kemi shfrytëzuar një numër të madh burimeve dytësore, si monografi, revista shkencore, punime dhe studime të ndryshme të paraqitura si disertacione, artikuj të gazetave, periodikëve, raporte të institucioneve ndërkombëtare dhe të qeverisë shqiptare, materiale të marra nga interneti, arkivave të institucioneve shtetërore etj. Literatura e shfrytëzuar ka qenë një pjesë e madhe në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhën angleze dhe italiane, ku janë shfrytëzuar studime më në zë për fushat përkatëse.

Për sa i përket literaturës dhe shqyrtimit të saj, logjika e përdorur në këtë studim është si ajo e hinkës. Së pari, për të përshkruar dhe për të përdorur konceptet teorike mbi sistemet elektorale, të sistemeve partiake dhe formave qeverisëse, jemi fokusuar gjerësisht në literaturën përkatëse e autorëve më në zë të fushës në Evropën perëndimore dhe USA. Së dyti, për të kuptuar dhe përdorur saktë teoritë e kabineteve qeverisëse, të implementuara në rastin shqiptar. Si rrjedhojë, jemi fokusuar në literaturën përkatëse dhe autorët më në zë të fushës në të dy pjesët e Evropës. Së treti, për të kuptuar përshtatjen teorike në rastin shqiptar dhe specifikat përcaktuese të modelit që shfaq Shqipëria në marrëdhënien e shkakësisë, jemi fokusuar në autorët më domethënës shqiptarë dhe botimet zyrtare të kohës që hedhin dritë mbi këtë shkakësi të analizuar.

Në këtë punim shkencor, metodologjia e përdorur është kryesisht e bazuar në të dhëna dytësore, të cilat më pas janë përdorur sipas qëllimeve specifike të punimit. Të dhënat dytësore janë marrë nga botimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) mbi rezultatet e zgjedhjeve nga viti 1991-2013. Analiza empirike është shtrirë në të gjithë treguesit kryesorë të ndikimit të sistemit elektoral në formën qeverisëse të vendit. Pra Studim Rasti është Shqipëria, duke shfrytëzuar në këtë mënyrë të dhënat e marra nga raportet periodike të përgatitura nga institucione të ndryshme, si të Bashkimit Evropian,

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Insituti Shqiptar i Studimeve Ndërkombëtare etj. Studimi është burim të dhënash të besueshme për lexuesin dhe për studiuesit që përpiqen të kuptojnë ndikimin e sistemit elektoral në formën qeverisëse të vendit tonë.

Lidhur me nivelin e përpunimit të të dhënave, në këtë punim ai ka variuar nga natyra përshkruese deri në përpunimin me natyrë analizuese, duke na bërë të mundur një panoramë të produkteve elektorale dhe lidhjes me variabla të ndryshëm që mund të karakterizohet si shoqëruese e shkakësore. Për analizimin e treguesve kryesor, si sistemet elektorale, ndarja e mandateve, sistemet partiake dhe formës qeverisëse, janë përdorur metodat e lartpërmendura. Në pjesën empirike, ky studim shkencor fokusohet më shumë në grumbullimin e të dhënave mbi sistemet elektorale, duke trajtuar gjërësisht tre familjet e mëdha, analizimi i sistemeve partiake, trajtimi i formave të ndryshme shtetërore etj.

Analiza e të dhënave cilësore


Kvale (1996) identifikon tre kontekste të ndryshme të interpretimit në analizën e të dhënave: 1) *vetë-kuptimi*, ku studiuesi përpiqet të formulojë në mënyrë të përmbledhur, atë që shprehin pjesëmarrësit në studim; 2) *të kuptuarit kritik*, ku studiuesi përdor njohuritë e përgjithshme në lidhje me kontekstin e deklaratave, për t'i përmbledhur ato në një fushë më të gjerë veprimi; 3) *të kuptuarit teorik*, ku interpretimi është vendosur në një perspektivë më të gjerë teorike (cituar nga Lewis, J. dhe Ritchie, J., 2003). Gjatë procesit të krijimit të kategorive duhet të merren në konsideratë çështjet e përfshira në studim (Dey, 1993).

Analiza e përmbajtjes së të dhënave është një proces i rëndësishëm sepse përfshin rishikimin e të dhënave dhe kategorizimin e tyre, deri kur hulumtuesi është i sigurt se temat

dhe kategoritë e përdorura përmbledhin në këtë mënyrë të gjitha të dhënat e nevojshme. Familjarizimi me të dhënat edhe pse mund të konsiderohet si një hap i qartë, është një aktivitet i rëndësishëm në fillim të analizës (Lewis & Ritchie, 2003). Sipas Dey (1993) leximi në analizën cilësore të të dhënave nuk është një proces pasiv. Ne lexojmë për të kuptuar, por qëllimi kryesor i leximit të të dhënave është përgatitja e terrenit për analizë.

Në këtë punim doktoral synohet të shpjegohet perspektiva teorike, pjesë e këtij studimi dhe mënyrën sesi ato përkthejnë marrëdhënien e shkakësisë ndërmjet sistemit elektoral - sistemit partiak, si edhe ndikimin në formën qeverisëse në Shqipëri. Do të prezantohet perspektiva e “*Ndikimi i sistemit elektoral në formën qeverisëse*”. Mekanizmi i kësaj teorie në shpjegimin e shkakësisë ku, sistemi elektoral shihet direkt dhe indirekt si variabël i pavarur dhe forma qeverisëse shihet si variabël i varur. Ndërsa sistemi partiak ka një rëndësi shumë të madhe në këtë shkak-pasojë të tyre dy variablave.

Grafiku Nr. 1: Lidhje e shkakësisë të variablave dhe indikatorëve kryesorë të analizuar.



Intervistat zënë një vend të rëndësishëm, ku në këtë studim për realizimin e tyre janë përdorur intervista të thelluara gjysmë të strukturuar, me përfaqësues nga sektori publik dhe politik në vitet e tranzicionit shqiptar. Si përfaqësues të Komisionit Qëndror të

Zgjedhjeve, politikanë dhe studiues që operojnë në fushën tonë të studimit, të cilat përbëjnë edhe një ndër kontributet kryesore të studimit, i cili bazohet në disa hapa të rëndësishme.

Për realizimin e intervistave është e rëndësishme që, *së pari*, të përcaktohet parimi mbi të cilën do të përzgjidhen individët që do të intervistohen. Dhe në këtë punim, individët /personalitetet janë përzgjedhur në bazë të disa kriterëve përfaqësues, të cilat kanë për qëllim të shmangin çdo lloj subjektiviteti, njëanshmërie ose edhe konfuzioni për sa i përket përafrimit të vërtetës. *Së dyti*, përcaktohet përmbajtja e skedës mbi të cilën do të zhvillohen intervistat. Për zhvillimin e këtyre intervistave është ndjekur procesi i hartimit të një skede të përcaktuar qartë të pyetjeve. Më konkretisht në këtë studim përfshihen përfaqësues të nivelit më të lartë të politikëbërjes dhe vendimmarrjes nga viti 1991-2013. Në fokus të analizës do të jenë këto target grupe: listat legislative, specialist të fushës, profesor.

Atëherë kemi realizuar tre intervista, ku kemi intervistuar Kastriot Islamin, Marko Bellon dhe Ilir Rusmalin. Kastriot Islami, në vitet 1991-1992 ka qenë në pozicionin e Kryetar i Parlamentit. Gjatë viteve 1992-1998 Kryetar/anëtar i Komisionit për Hartimin e Projektushtetutës; 1998-2001: anëtar i Komisionit të Ligjeve dhe Çështjeve Kushtetuese; 2001-2002: Sekretar i Komisionit Parlamentar të Politikës së Jashtme. Si edhe ka pasur poste ministrore të shumta si Ministër i Arsimit (1991), Ministër i Shtetit (1997-1998), Zëvendëskryeministër (1998), Ministër i Financave (2002-2004), Ministër i Punëve të Jashtme (2004-2005).

Marko Bello, me PhD në Drejtësi dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në Fakultetin Juridik “Nicolae Titulescu”, në Rumani. Ka pasur poste të larta institucionale, si Ministër i Shtetit për Koordinim (2003-2005), Ministri i Shtetit për Integritet Evropian (2002), Zëvendësministër në Ministrinë e Mbrojtjes (2000-2001), Ambasador i Shqipërisë në

Rumani (1997-2000). Ndërsa Ilir Rusmali, ekspert konstitucionalist dhe ish zv. Kryeministër në qeverinë Berisha. Ka drejtuar për një kohë të gjatë Komisionin e Ligjeve dhe deputet i Partisë Demokratike. Profesor në dhënien e lëndës Kushtetuta që prej viteve 1991 dhe njohës shumë i mirë i sistemeve zgjedhore.

Kemi përzgjedhur për të intervistuar këta personalitete sepse kanë pasur pozicione të larta institucionale gjatë viteve të ndryshimeve të mëdha në Shqipëri, si edhe kanë dhënë kontributin e tyre në hartimin e Kushtetutës së Shqipërisë dhe në zgjedhjen/formulimin e sistemeve zgjedhore. Gjithashtu, ata kanë dhënë kontributin e tyre të madh në përcjelljen e dijes ndër breza të tërë në çështjen e ligjit dhe të kushtuteshmërisë. Pra, janë përzgjedhur kategoritë e mësipërme, jo vetëm për shkak të pozicionit që kanë në majat më të larta formale të sektorit të politikës, por edhe për shkak të vendimmarrjes aktive në politikën shqiptare që kanë në funksion të vet, secili prej institucioneve të përzgjedhura.

Kështu, funksioni më i dukshëm i parlamenteve është funksioni legjislativ. Ky funksion është i lidhur ngushtë me funksionin përfaqësues të tyre, pasi në vendet me demokraci të zhvilluar, deputetët prej vullnetit të votuesve marrin autoritetin e nevojshëm për bërjen e ligjeve. Është zgjedhur kjo periudhë për disa arsye sepse studimet për këtë kategori mungojnë dhe është një fazë delikate ‘tranziti’ për Shqipërinë.

Intervista gjysmë e strukturuar përfshin një seri pyetjesh të hapura duke i'u referuar tematikave që studiuesi dëshiron të hulumtojë (Hancock, 1998). Këto pyetje lejojnë për të zbuluar dhe për të përpunuar informacionin që është i rëndësishëm për pjesëmarrësit në studim (Gill; Stewart; Treasure; Chadwick, 2008). Mundëson pasqyrimin e pikëpamjeve të individëve lidhur me fushën e kërkimit. Si rrjedhojë, kërkuesit trajtojnë ngjarjet sociale, duke u bazuar në këndvështrimet e ndryshme të subjekteve të intervistuar (Berg, 2001).

1. *Si mund t'i vlerësoni vitet 1991-1992, këto vite të 'transformimit të madh' të Shqipërisë, duke përfshirë këtu zgjedhjet e para pluraliste demokratike, si edhe miratimit të ligjit elektoral të vitit 1991. Ku në këtë periudhë, përpara deputetëve të zgjedhur të atij legjislacioni, qëndronte një problem i madh juridik dhe politik, i cili ishte abrogimi i Kushtetutës së vitit 1976-të, si edhe miratimi i Kushtetutës së re, që do të hidhte bazat e demokracisë në Shqipëri.*
2. *Në periudhën e gjatë të tranzicionit, Shqipëria ka njohur disa ndryshime në ligjin elektoral, nga sistemi maxhoritar me dy raunde në zgjedhjet e vitit 1991, në sistem miks të varur dhe të pavarur, në sistem proporcional të personalizuar, si edhe në sistem proporcional rajonal me lista të mbyllura. Si i vlerësoni këto ndryshime të ligjit elektoral, që kanë ndodhur në një periudhë kaq të shkurtër kohore, si edhe si kanë ndikuar këto ndryshime në stabilitetin e vendit?*
3. *Si i vlerësoni ju Ndryshimet Kushtetuese të vitit 2008-të?*
4. *Në hartimin e listave me kandidaturat për deputet, çfarë mendoni se duhet të kenë parasysh liderët e partive politike? Mendoni se me ndryshimet e fundit në Kushtetutë, ku është aplikuar sistemi zgjedhor proporcional rajonal me lista të mbyllura, "sindromi" i servilizmit mund të ketë përfshirë Kuvendin Shqiptar?*
5. *Në këto 25-së vitet e fundit të pluralizmit shqiptar, gjatë zhvillimit të zgjedhjeve elektorale në realitetin shqiptar është krijuar kultura e kontestimit të rezultatit zgjedhor nga humbësit e zgjedhjeve. Sipas mendimit tuaj, cilat mund të jenë arsyet e këtyre kontestimeve nga ana e kundërshtarëve politikë?*

6. Sipas mendimit tuaj ____, duke u nisur edhe nga eksperiencia juaj politike, cili sistem elektorale është më i përshtatshmi për vendin tonë, duke pasur parasysh edhe situatën politike të vendit, kulturën politike dhe mungesën e theksuar të kulturës demokratike?

Organizimi i pyetjeve të intervistës është realizuar në funksion të objektivave të përcaktuara në studim dhe janë formuluar këto pyetje për t'i dhënë përgjigje pyetjes sonë kërkimore. Mendimi dhe opinioni i të intervistuarve duke u bazuar në eksperiencën e tyre të gjatë (para viteve 1991-të) në çëshjen e ligjeve dhe të Kushtetutës, na ka ndihmuar shumë në plotësimin e kuadrit teorik dhe në paraqitjen e këtij dizertacioni në këtë formë.

1.3.1 Objektivat e studimit

Ky studim ka si objektiv të përcaktojë:

- Efektet e ndikimit të sistemit elektorale në sistemin partiak, si edhe ndikimi i sistemit partiak në formën qeverisëse të vendit.
- Efektet e ndikimit të sistemit elektorale në marrëdhënien Qeveri-Parlament (ekzekutiv - legjislativ).
- Përcaktimin e kabineteve qeverisëse të formuara në Shqipëri gjatë periudhës së tranzicionit shqiptar në vitet 1991-2013.
- Kufizimet dhe përparësitë e sistemeve të ndryshme elektorale (mazhoritar dhe proporcional) dhe ndikimi i tyre në qeverisjen shqiptare (qëndrueshmëri politike ose qeveri e gjërë e bazuar në konsensus).

- Një analizë e mirëfilltë empirike të këtyre indikatorëve dhe formulimin e përfundimeve rreth kësaj teme studimi.

1.4 Kufizimet e punimit

Si çdo studim në fushën e shkencave sociale, edhe ky studim mbart limite dhe kufizime, të cilat janë marrë në konsideratë gjatë realizimit të kërkimit, si edhe janë përmendur gjatë punimit. Por në krahasim me gjetjet e punimit, këto kufizime janë të një rëndësie të vogël, duke pasur parasysh qëllimin, objektivat dhe pyetjet kërkimore të tij. Si edhe duke nënvizuar rëndësinë se për herë të parë në Shqipëri është testuar teoria e Arend Lijphart “*Ndikimin e sistemit elektoral në formën qeverisëse*”, duke analizuar së bashku disa variabla njëkohësisht në një kohë të gjatë kohore (1991-2013).

Siç e përmendëm më lart, ky studim ka një gamë të gjërë variablash që studiohen njëkohësisht dhe nisur nga vetë natyra e punimit, një ndër kufizimet ka të bëjë me faktin, se nuk mund të konsiderohet si shterues për asnjë nga dimensionet e analizuara/trajtuar. Ky punim i hap rrugën punimeve të ngjashme në të ardhmen, për të plotësuar gjithnjë më shumë kuadrin mbi shkakësinë në vendin tonë. Si rrjedhojë, lind nevoja që të analizohen zgjedhjet e ardhshme të përgjithshme sepse edhe politika në Shqipëri po merr tjetër drejtim. Në vitet në vazhdim, studius të shkencave politike mund të thellohen duke analizuar zgjedhjet e ardhshme të përgjithshme në vendin tonë, për të plotësuar edhe më shumë kuadrin e shkakësisë të variablave të studiuara në këtë punim, por në një periudhë edhe më të gjatë kohore.

Së dyti, një kufizim që kemi hasur gjatë punimit të këtij dizertacioni është edhe mungesa e punimeve të ngjashme. Në vendin tonë kemi një prezencë të pakët të punimeve të ngjashme në këtë fushë dhe shpesh në rrugëtimin e këtij punimi shkencor shkelet në terrene të pashkelura më parë. Si rrjedhojë, duke bërë të domosdoshme ballafaqimin e gjetjeve të këtij punimi me punime tjera në të ardhmen, si e vetmja mënyrë për të testuar vlefshmërinë e tij. Në vendin tonë ekzistojnë punime që kanë në fokus sistemin elektoral, por nuk analizojnë të gjithë variablat e studiuara së bashku. Si edhe, risia e këtij punimi është aplikimi i teorisë së Arend Lijphart në realitetin shqiptar dhe njëkohësisht është edhe një vështirësi më vete.

Si rrjedhojë, theksojmë se në këtë dizertacion do të analizojmë një numër të madh variablash dhe këto të analizuar në çdo zgjedhje të përgjithshme të mbajtura në Shqipëri gjatë periudhës 1991-2013. Vërejmë, se është një periudhë shumë e gjatë kohore dhe është një studim ku për herë të parë do të analizohen një numër kaq i gjërë i variablash. Duhet theksuar se është një periudhë tranzioni për vendin tonë, ku elita politike pa përvojë të mëparshme politike dhe me një mungesë të kulturës demokratike, ka një detyrë shumë të rëndësishme.

Duke nënvizuar se nuk ka studime të mirëfillta dhe të ngjashme me këtë studim doktoral, si rrjedhojë realizimi i këtij punimi ka pasur vështirësi e tij. Theksojmë se në këtë punim shkencor jemi mbështetur gjërësisht në të dhëna dytësore dhe karakteri i këtyre të dhënave është sipërfaqësor. Si edhe faktimi i shkakësisë në rastin tonë të studimit bëhet edhe më e vështirë. Mungesa e të dhënave më të përpunuara, ka bërë që në punim një sërë gjetjesh të faktohen në mënyrë indirekte duke bërë të diskutueshme dhe të ritestueshme karakterin e tyre.

Një kufizim tjetër është fokusi i përqëndruar në një rast të vetëm studimi (Shqipëria) ku nuk kemi krahasime me vende/raste tjera. Kjo si arsye edhe nga pamundësia kohore për të trajtuar raste tjera, duke analizuar një sërë zgjedhjesh, si ky studim shkencor. Por, në këtë studim kemi tendencën për të krahasuar brenda vetë hapësirës shqiptare zgjedhjet e përgjithshme të zhvilluara pas vitit 1990-të. Krahasimi me karakter analitik me rastet e ngjashme brenda hapësirës shqiptare në këtë kontekst, do të bëjë të mundur një artikulum të një niveli tjetër, më të bazuar në gjetje krahasuese të shpjegimit teorik të rastit Shqiptar.

Nënvizojmë, se çdo shtet ka karakteristikat e tij kontekstuale, duke marrë parasysh edhe kushtet e tjera unike që ka secili vend. Dhe më sipër argumentuam se konteksti ka rëndësi, pra si funksionojnë shkaqet e veçanta dhe ndoshta gjithë struktura e procesit shkakësor, atëherë kjo është shumë kontekstuale. Përsa i përket çështjeve të kontekstit, proceset dhe rezultatet ndryshojnë në mënyrë unike, ku secili vend i caktuar substancial, në çdo kohë, ka proceset e veta unike në lidhje me rezultatet e tij. Sipas këtij pohimi, çdo krahasim brënda ose jashtë rasteve, kohëve ose vendosjeve, do të jetë gjithmonë i pajustificuar ose i padobishëm. Në këto kushte, nuk mund të mësojmë më shumë se përshkrimi nga krahasimi ose historia krahasuese.

Edhe pse ky punim ka karakter longitudinal duke u fokusuar në një seri zgjedhjesh dhe shkakësisë (sistem elektorale-sistem partiak-forma qeverisëse) për një periudhë 23 vjeçare, vetë periudha e marrë në analizë nuk mund të konsiderohet si një e tërë në kontekstet dhe në zhvillimet që e kanë përbërë atë. Dekada e parë post-komuniste në vendin tonë është bazuar në ndryshimet radikale të sistemit politik, si edhe periudha e dytë post-komuniste është bazuar në “stabilitetin” institucional, të sjelljes dhe të konkurrimit.

Ndërsa në dekadën e tretë, skena e politikës ka ndryshuar shumë dhe aktorë të ri (parti e tretë) po fitojnë rëndësi në vendimmarrje dhe në formimin e kabineteve qeveritare. Në këtë logjikë gjetjet e këtij studimi do të ishin edhe më bindëse nëse do të përfshiheshin dhe treguesit e shkakësisë për disa palë tjera zgjedhjeje të përgjithshme, ato të vitit 2017-të dhe 2021, duke u bazuar edhe në situatën politike që është krijuar. Në këtë rast do të ishim më të sigurt mbi “ngrirjen” kontekstuale të shkakësisë në rastin shqiptar duke hedhur një sërë hipotezash mbi zhvillimet e pritshme në të ardhmen.

Dhe një vështirësi që është hasur gjatë punimit të këtij dizertacioni ka qenë edhe realizimi i intervistave nga ana e personaliteteve të politikës ‘deputetëve’ ose specialistëve të fushës. Kjo është arsyeja që ky punim voluminoz ka vetëm tre intervista sepse në realizimin e intervistave duhet të ruajmë paanshmërinë midis forcave të ndryshme politike dhe individët që janë përzgjedhur për t’u intervistuar në bazë të disa kriterëve përfaqësues, të cilat kanë për qëllim të shmangin çdo lloj subjektiviteti, njëanshmërie apo edhe konfuzioni për sa i përket përafrimit të së vërtetës.

Por, pavarësisht të gjithë kufizimeve të renditura më sipër, ky punim shkencor është një arritje e madhe sepse kemi arritur që të testojmë teorinë e studiuesit Arend Lijphart. Si rrjedhojë, punimi është i natyrës së analizimit dhe testimit të teorisë së përdorur, ku kemi përcaktuar modelin empirik dhe kushtëzimit kontekstual për të ndjekur një formë specifike funksionale të sugjeruar nga teoria. Shumë teori krahasuese mund të mos jenë mjaft të sakta për të përcaktuar formën e ndërveprimeve, forca e fituar vjen nga mbështetja më e madhe në teori dhe shqetësimet e shumëkombësimit rishfaqen, por në një ritëm më të vogël.

Dhe në një punim kemi arritur që të marrim në analizë një numër të madh variablash dhe i kemi dhënë përgjigje shumë nënpyetjeve kërkimore. Nënvizojmë se në

realitetin shqiptar, kemi arritur që të konfirmojmë hipotezën e punimit, ku ekziston një lidhje shkakësie midis variablave të studiuara.

Hapat e punimit

Ky punim është ndërtuar në gjashtë kapituj. *Punimi hapet* me parashtrimin e parathënies dhe hyrjen, ku në këtë seksion është trajtuar gjërësisht metodologjia e përdorur në këtë punim shkencor. Ky kapitull është i një rëndësie të madhe sepse shpjegohen instrumentat e përdorura, ku me anë të tyre është arritur paraqitja e këtij dizertacioni. Në këtë kapitull trajtohet metodologjia e përdorur në studim, parashtrohet historiku i kërkimit dhe fazat e përdorura. Gjithashtu jepet informacion për mbledhjen e të dhënave parësore dhe dytësore, kemi trajtimin e paraqitjen e instrumentave të kërkimit, si edhe prezantohen kufizimet e kërkimit.

Në fillim të punimit, bëhet dallimi midis sistemit elektoral dhe rregullave zgjedhore, ku sistemet elektorale përcaktojnë se si votohet në zgjedhje dhe se si këto vota shndërrohen në mandate parlamentare (Gallagher dhe Mitchell, 2008: 3). Sipas këtij përkufizimi, sistemi elektoral përcakton përbërjen e Parlamentit ose të një organi tjetër përfaqësues të popullit (ligjvënësit) të zgjedhur me votën popullore. Në mënyrë indirekte kemi përcaktimin e përbërjes së ekzekutivit për katër vitet e ardhshme, si rrjedhojë edhe vendimet dhe proceset politike të një vendi janë më të parashikueshme. Duke u plotësuar përbërja parlamentare atëherë bëhet konturimi i sistemit partiak të vendit (i cili mund të jetë një sistem njëpartiak, dypartiak ose shumëpartiak), si edhe kemi ndikimin në formën qeverisëse të vendit.

Ndërsa në kapitullin e dytë janë trajtuar gjërësisht nga ana teorike sistemet elektorale. Në pjesën e parë të këtij kapitulli do të prezantohen sistemet elektorale dhe klasifikimi i tyre sipas tre familjeve të mëdha. Do të trajtohen në mënyrë të hollësishme avantazhet dhe disavantazhet e secilës prej familjeve të mëdha elektorale, duke i analizuar në kontekstin e avantazheve (qëndrueshmërisë dhe stabilitetit) që kanë kur aplikohen. Analizohet ndikimi i tyre dhe bëhet lidhja e shkakësisë me konturimin e sistemit partiak dhe në formën qeverisëse të vendit.

Teoria e Arend Lijphart, që është aplikuar në këtë punim shkencor është e një rëndësie të madhe. *Ndikimi i sistemit elektoral në formën qeverisëse* është aplikuar në çdo zgjedhje të zhvilluara në vendin tonë pas viteve 1990-të, ku pas rezultateve zgjedhore kemi formimin e kabineteve qeveritare. Këto kabinete janë të analizuara sipas gjashtë teorive të koalicionit të Lijphart. Duke e pranuar si fakt, rëndësinë e sistemit elektoral në konturimin e sistemit politik, nga studime të shumta të studiuesve më të mëdhenj, atëherë do të trajtojmë marrëdhënien që ekziston midis sistemit mazhoritar - sistemit dypartiak dhe formës qeverisëse, si edhe të sistemit proporcional - sistemit shumëpartiak dhe formës qeverisëse.

Në kapitullin e tretë është shtjelluar sërish kuadri teorik. Në këtë pjesë të punimit janë trajtuar materiale teorike (literature review) që shqyrtojnë jo vetëm pikëpamjet teorike mbi formën e qeverisjes. Në këtë kapitull kemi bërë dallimin midis republikës parlamentare (me tendencë mazhoritare - Britania e Madhe dhe proporcionale - Italia) dhe republikës presidenciale (ShBA) dhe gjysëmpresidenciale (Francë). Kemi trajtuar konceptet bazë të formës së shtetit/qeverisjes, duke analizuar edhe konceptet bazë të variablës kryesore në këtë punim shkencor.

Kuadri i gjërë teorik i trajtuar në kapitullin e parë dhe të dytë të këtij punimi shkencor, na ka ndihmuar të kuptojmë arsyet dhe të analizojmë gjërësisht këtë marrëdhënie shkakësie midis variablave. Po kështu, trajtimi i këtyre koncepteve na ka ndihmuar në analizimin e shkallës së formës së qeverisë, të sistemit politik dhe të kulturës politike/demokratike të vendit tonë.

Në kapitullin e katërt dhe të pestë, specifikisht në kapitullin e katërt është trajtuar ligji elektoral i vitit 1991, 1992 dhe ai i vitit 1996-të, si edhe ndryshimet që i janë bërë këtij ligji, specifikisht ndryshimet e vitit 1997-të. Ndërsa në kapitullin e pestë janë trajtuar Ndryshimet Kushtetuese të vitit 2008-të dhe zgjedhjet politike të zhvilluara në Shqipërinë deri në vitin 2013-të. Gjatë këtyre 23 viteve të tranzicionit shqiptar, sistemi elektoral është ndryshuar pothuajse në çdo zgjedhje të zhvilluara në vendin tonë, duke ndryshuar në këtë mënyrë formulën e përzgjedhjes së deputetëve dhe si rrjedhojë duke ndikuar direkt në përbërjen e legjislaturës së Kuvendit të Shqipërisë.

Gjithashtu në këtë kapitull, kemi trajtuar gjërësisht marrëdhëniet e formuara midis Qeverisë dhe Parlamentit (pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ) dhe si kanë ndikuar këto marrëdhënie në formën qeverisëse të vendit tonë. Kemi trajtuar kompetencat e Presidentit dhe të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, përpara dhe pas ndryshimeve Kushtetuese të vitit 2008-të dhe raporti midis tyre.

Pasi kemi ofruar një panoramë teorike të përmbledhur (në kapitujt e mëparshëm) mbi sistemet elektorale dhe mbi efektet e tyre (pozitive/negative), do të fokusohemi në rastin shqiptar duke analizuar gjithë sistemet elektorale të aplikuara në Shqipëri pas vitit 1990 deri në vitin 2013-të, duke i analizuar ato sipas gjithë treguesve përkatës të trajtuar më sipër. Në rastin e Shqipërisë do të shihet në mënyrë të hollësishme legjislacioni zgjedhor,

rregullat zgjedhore, si koncepti i zonës elektorale, pragu natyror, dimensionimi mazhoritar ose proporcional i sistemeve zgjedhore etj.

Pasi janë trajtuar sipas treguesve të dhënë çdo sistem elektoral i përdorur në vendin tonë dhe efektet e tyre, më pas synohet të trajtohet aplikimi i teorisë së *Ndikimi i sistemit elektoral në formën qeverisëse*. Kjo për arsye që të shpjegojmë më mirë objektin tonë të studimit, duke analizuar indikatorët e lartëpërmendur në çdo zgjedhje të përgjithshme të zhvilluar në Shqipërinë e pas viteve 1990-të.

Kapitulli i gjashtë përmbledh tërë përfundimet e punës doktorale për mendimet dhe argumentat e përdorura, të cilat bazohen në trajtesën disavjeçare të saj. Në këtë kapitull, janë trajtuar gjërësisht sistemet elektorale, si edhe është shpjeguar se si struktura politike e një vendi mund të ndikohet nëpërmjet përpunimit të sistemit elektoral. Punimi mbyllet me paraqitjen e përfundimeve kryesore rreth trajtimit disavjeçar të kësaj teme hulumtimi me një rëndësi kaq të madhe për vendin.

KAPITULLI II: KUADRI TEORIK

Ndikimi i sistemit zgjedhor në formën e qeverisjes të vendit.

Si ka ndikuar sistemi zgjedhor në formën e qeverisjes në Shqipëri?

Kjo është pyetja kërkimore që do të trajtojmë gjërësisht në këtë dizertacion. Fillimisht duhen trajtuar disa koncepte teorike për t'i dhënë përgjigje më pas kësaj pyetjeje kërkimore. Në kapitullin e parë teorik, do të japim një përcaktim të saktë të sistemeve elektorale dhe të tre familje të mëdha të tyre.

Duke e pranuar si fakt, rëndësinë e sistemit elektoral në konturimin e sistemit politik, nga studiuesit më me zë të kësaj fushe, atëherë do të trajtojmë lidhjen ose marrëdhënien që ekziston midis sistemit mazhoritar-sistemit dypartiak dhe formës qeverisëse, si edhe të sistemit proporcional - sistemit shumëpartiak dhe formës qeverisëse. Atëherë në këtë kapitull do të trajtojmë çështje, si: *Cilat janë rregullat zgjedhore të vendosura për fituesit e garës elektorale dhe për interesat e të cilëve, qeveria duhet të jetë i përgjegjshëm kur njerëzit janë në mospajtim dhe të ketë preferenca të kundërta? Si ka ndikuar sistemi mazhoritar në konturimin e një sistemi dypartiak dhe në formën qeverisëse? Si ka ndikuar sistemi mazhoritar në konturimin e një sistemi shumëpartiak dhe në formën qeverisëse?*

Një pjesë të rëndësishme në këtë kapitull zë edhe matja e numrit të partive politike efektive në sistem, ku në rastin tonë të studimit do të trajtojmë mënyrën matëse të Arend Lijphart, i cili ritestoi modelin e Duverger, mbi marrëdhënien e sistemeve elektorale dhe numrit të partive politike në sistemet partiake etj. Teoria e aplikuar në këtë disertacion është Teoria e Arend Lijphart “*Ndikimit të sistemit elektoral në formën qeverisëse*”. Gjithashtu, do të

analizojmë disa nga stimujt për formimin e kabineteve të minoritetit dhe të shumicës (të tepërt). Dhe risia e këtij punimi doktoral është analizimi i zgjedhjeve nga viti 1991-2013 në Shqipëri sipas gjashtë teorive të koalicionit të Lijphart, që do të analizohen gjërësisht në kapitujt e mëposhtëm.

2.1 Sistemet elektorale

Sistemet zgjedhore përcaktojnë mënyrën dhe rregullat juridike për llogaritjen e votave për kandidatët që konkurojnë në garën elektorale, si edhe në këtë mënyrë përcaktojnë formulën e ndarjes së mandateve në organin përfaqësues, duke shpallur fituesit në zgjedhje (Berhani, 2009: 151).

“Çdo sistem elektoral, përbën një filtër të vërtetë ndërmjet shoqërisë dhe politikës, ose më mirë ndërmjet shoqërisë dhe institucioneve. Për këtë arsye sistemet elektorale janë instrumente të një rëndësie të madhe dhe të një vlere jashtëzakonisht të madhe për funksionimin e sistemeve politike dhe për vetë dinamikën e formës së qeverisjes (Amato & Barbera, 1977: 67 – 68)”.

Autorë të ndryshëm japin versione të ndryshme për konceptin e sistemeve zgjedhore. Sistemi elektoral paraqet bashkimin e të drejtave, principeve dhe garancive të njeriut, mbi të cilën më pas realizohet edhe pjesëmarrja e qytetarëve në zgjedhje. Pra, janë rregulla që përcaktojnë ose bëjnë përkthimin e votave të elektoratit në ndarjen e mandateve në legjislaturë. Autorë të ndryshëm të shkencave politike bien në konkluzion se, baza themelore për shpjegimin e sistemeve elektorale është e drejta e qytetareve për të zgjedhur organet e tyre përfaqësuese (në nivel lokal dhe qendror), duke shprehur në këtë mënyrë vullnetin e tyre të lirë përmes zgjedhjeve periodike dhe të drejta.

Një nga disiplinat më të zhvilluara politologjike në shoqëritë demokratike është *psefologjia*, e cila merret me studimin e zgjedhjeve dhe të sistemeve elektorale. Fjala ‘psefologji’ rrjedh nga greqishtja e vjetër, ku psephos do të thotë ‘guralec’ sipas së cilës grekët e lashtë nënkuptonin votat, ku specifikisht merreshin me analizën e statistikave të zgjedhjeve. Ky term për herë të parë është përdorur në vitin 1952 në Britani nga historiani RB McCallum për të përshkruar analizën shkencore të pas zgjedhjeve. Çështje thelbësore që trajton kjo shkencë është *sqarimi i rolit të sistemeve elektorale për formën qeverisëse të vendit*. Shtetet me demokraci të konsoliduar, fillimisht zgjedhin sistemin e tyre elektoral që do të aplikohet në vend, e analizuar kjo nga një ekip ekspertësh të fushës që t’i përshtatet kushteve politike/sociale të vendit.

Përtej faktorëve të përmendur më sipër, si procedurat, kultura politike e vendit që ndikojnë në cilësinë e procesit zgjedhor, theksojmë se sistemi elektoral në vetvete ka një peshë shumë të madhe sepse ndikon drejtëpërdrejtë si në sistemin partiak, ashtu edhe në formën qeverisëse të vendit. Nëse duam që të kemi një ndikim pozitiv të sistemeve elektorale në vendin ku aplikohet, atëherë sistemi duhet të zgjidhet në përshtatje të kushteve politike, ekonomike, sociale dhe kulturës demokratike. Krijimi i sistemit elektoral, tashmë i pranuar gjërësisht si me rëndësi të madhe për çështjet e mëdha qeverisëse (pra, të formës qeverisëse), si edhe me ndikimin në të gjitha institucionet e tjera politike. Dhe variabla kryesore është se: Formula elektorale e përdorur (sistem elektoral i përdorur, formula matematikore përdoret për të llogaritur caktimin e vendeve parlamentare).

Struktura e sistemit elektoral lidhet ngushtësisht me aspekte tjera, si procedurat administrative të zgjedhjeve, siç janë shpërndarja e vendeve të votimit, caktimi i kandidatëve për deputetë, regjistrimi i votuesve etj. Është pranuar gjërësisht, se forma e

sistemit elektoral ndikon në fushat e tjera të rregullave elektorale, si në përzgjedhjen e sistemit elektoral, i cili ka ndikim në mënyrën me të cilën caktohen kufijtë rajonal, projektimi i fletëvotimit, mënyrën se si numërohen votat, krahas aspekteve të tjera të shumta të procesit elektoral.

Në nëntor të vitit 2001, Komiteti i Përhershëm i Asamblesë Parlamentare miratoi një rezolutë që i drejtohej Komisionit të Venecias dhe i kërkonte që të hartonte një kod praktik për çështje elektorale, ku të përcaktoheshin qartë parimet bazë të sistemeve zgjedhore europiane. Dhe në zbatim të kësaj rezolute, në datat 5–6 korrik dhe 18–19 tetor të vitit 2002, Komisioni i Venecias miratoi “Kodin e praktikës së mirë në çështjet zgjedhore”. Ky kod përmbante gjithashtu udhëzime dhe raportin shpjegues. Më konkretisht, në kapitullin e parë paraqiten parimet bazë të trashigëmisë elektorale evropiane, si: E drejta universale për votim; Votim i barabartë; Votim i lirë; Votim i fshehtë; Votim i drejtëpërdrejtë; Zvillim periodik i zgjedhjeve (në mbështetje të paktit ndërkombëtar “Për të drejtat civile dhe politike” si edhe të protokollit shtesë të konventës evropiane “Për të drejtat e njeriut”).

Rregullat elektorale të vendeve të zhvilluara, analizonin gjëndjen aktuale të njohurive, në lidhje me pasojat që mund të sjellin këto sisteme dhe ofronin drejtimet të përgjithshme për hartimin e ndërtimin e sistemeve të reja elektorale. Përmes këtyre modeleve racionalë, ato flasin për ndikimin e madhësisë së zonës zgjedhore (mandatet parlamentare që dalin nga kjo zonë zgjedhore) të formulave elektorale në proporcionalitetin përfaqësues dhe në numrin e partive politike (Taagepera dhe Shugart, 2004: 9).

Pra, është kaq e rëndësishme studimi i rregulla elektorale sepse përtej pasoja politike që mund të sjellë një sistem elektoral, ato janë edhe krijuese të vetë politikës. Mund të theksojmë, se rregullat e sistemit elektoral të një vendi janë aq të rëndësishme, sa këto

mund të jenë edhe përcaktuese për rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, pavarësisht votimeve popullore të marra.

Disa vende nuk e kanë ende të qartë se si mund të funksionojnë rregullat zgjedhore dhe miratojnë rregulla të caktuara me qëllime të caktuara, por rezultati mund të jetë edhe i kundërt me të. Disa nga qëllimet mund të jenë, si përfaqësimi më proporcional, përjashtimi i partive të vogla politike nga Parlamenti, përforcimi i partive politike më të mëdha etj.

Këto rregulla zgjedhore zbatohen pasi miratohen nga autoritetet përkatëse (anëtarët e parlamentit ekzekutiv), si edhe ndryshimet e rezultateve zgjedhore mund të jenë mjaft mirë të llogaritshme nga subjektet më të mëdha politike, por theksojmë gjithsesi se duhet marrë në konsideratë kushtet dhe traditat politike e lokale të vendit ku do të aplikohen këto rregulla. Jaho (2006: 7), thekson se, zgjedhja e sistemit elektoral është një proces që kërkon studim të gjithanshëm dhe përgjithësim të praktikës së zgjedhjeve periodike dhe të lira. Rregullat e sistemit elektoral, janë me një rëndësi aq të madhe sa ato mund të jenë përcaktuese të rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, pavarësisht votave popullore të marra.

Le ti trajtojmë më gjërësisht tre familjet e mëdha të sistemeve elektorale:

- ❖ *Sistemi mazhoritar*: sistem elektoral ku kandidatët zgjidhen mbi bazën e shumicës së votave që marrin në një zonë të caktuar elektorale. Brënda vetë këtij sistemi, ekzistojnë pesë tipe të ndryshme nënsistemesh.
- ❖ *Sistemi proporcional*: partitë politike marrin në përqindje të drejtë aq mandate parlamentare që i korrespondojnë me totalin e votave. Sistemi elektoral i aplikuar në Shqipëri është sistemi me listë, ku kemi një përcaktim nga përqindja e votave të secilës parti që merr në raport me partitë e tjera në garën elektorale. Kemi dy mënyra votimi: e para me listë të mbyllur, ku votuesit votojnë për partitë politike ose për kandidatët

konkurues (pa shprehur preferenca) dhe mënyra e dytë është votimi me lista të hapura, ku votuesit votojnë për partinë e tyre dhe shprehin preferencën e tyre për një kandidat të caktuar.

- ❖ *Sistemi i përzier ose miks*: sistem elektoral që aplikohen dy format e sistemeve të cituara më sipër. Kandidatët zgjidhen në dy forma; një grup deputetësh zgjidhen sipas sistemit elektoral mazhoritar, ndërsa pjesa tjetër, sipas sistemit elektoral proporcional. Shqipëria ka aplikuar këtë sistem që nga viti 1991, ku 100 mandate zgjidhen sipas sistemit mazhoritar dhe 40 mandatet e tjera sipas sistemit proporcional.

Një ndër hapat më të rëndësishme për demokracinë është mënyra e zgjedhjes së udhëheqësve dhe të përfaqësuesve të saj (USAID, 1991: 23-24), përgjithësisht ekzistojnë dy mënyra kryesore për zgjedhje. Në një sistem parlamentar, partia që ka shumicën e mandateve në legjislaturë ose në një koalicion formon qeverinë e kryesuar nga kryeministri. Ndërsa mënyra tjetër është zgjedhja e drejtëpërdrejtë e presidentit pa u varur nga legjislatura dhe dallimi kryesor i këtyre dy sistemeve qëndron në lidhjen midis pushtetit legjislativ e ekzekutiv. Mënyra se si përcaktohet fituesi dhe bëhet ndarja e mandateve është shumë e rëndësishme dhe dy janë kategoritë kryesore. E para, që zbatohet në zonat zgjedhore njëemërore dhe e dytë, që zbatohet në zonat zgjedhore shumëemërore.

Por shpërndarja e një mandati mund të ndodhë në mënyra të ndryshme. Le t'i trajtojmë më hollësisht disa nga to (Taagepera dhe Shugart, 2004: 50-52):

- *Rregulli i shumicës në zonat zgjedhore njëemërore*. Rregulli i shpërndarjes së mandateve, i cili jep një mandat në çdo zonë zgjedhore ($M = 1$) kandidatit që ka grumbulluar më shumë vota, pavarësisht nëse kandidati ka fituar shumicën absolute (50

- + 1) të votave të hedhura ose jo. Kjo vjen nga vende të diktuar nga eksperiencia Britanike. Ky sistem inkurajon një sistem të qëndrueshëm dypartiak, në të cilën njëra parti pothuajse gjithmonë zotëron një shumicë legislative.
- *Vota simultane e dyfishtë*, është përdorur për zgjedhjet presidenciale në Urugaj dhe në Honduras. Kjo përdoret kur me simbolet e të njëjtës parti, konkurojnë më shumë se një kandidat. Fitues shpallet kandidati që ka marrë më shumë vota në partinë, e cila ka marrë më shumë vota në zgjedhje.
- *Shumica në zonat zgjedhore njëemërore*. Për të parandaluar një situatë sipas së cilës mandatet fitohen nga kandidati që merr më pak se 50 % të votave, disa rregulla të shpërndarjes parashikojnë procedura për mbajtjen e një votimi të dytë ose të mbajtjes parasysh të preferencave të votuesve përveç përzgjedhjes së tyre të parë, nëpërmjet përdorimit të një fletë votimi renditëse.
- *Rregullat e shpërndarjes së mandatëve në zonat zgjedhore shumëemërore* ($M > 1$). Ndryshimet në sistemin me listë të përfaqësimit proporcional (PP me listë) përbëjnë në përgjithësi edhe formulën më të zakonshme të sistemit elektoral proporcional.

Pragu elektoral, përcakton numrin minimal të votave që një parti politike duhet të arrijë për të fituar një mandat parlamentar. Sipas Taagepera dhe Shugart (2004: 82-83), pragu mund të përfshihet në sistemet PP për t'iu kundërvënë difektit të sistemit PP të përmendur më shpesh. Mund të përmendim edhe një disavantazh të pijës ndarëse (pragut), ku nëse pragu elektoral është përcaktuar 4 %, atëherë nëse një parti ka marrë 3,9 % të votave, ajo nuk mund të fitojë një mandat parlamentar dhe këto vota shkojnë dëm.

Është e domosdoshme të respektohen dhe zbatohen parimet themelore, në bazë të cilave ndërtohen dhe zhvillohen zgjedhjet periodike në një vend demokratik (Jaho, 2006: 17–18). Këto parime i gjejmë në Kodin e Praktikës së Mirë miratuar nga Komisioni i Venecias, në dokumentin e Kopenhagës të vitit 1990-të, të OSBE, të Moskës të vitit 1991, të OSBE-së, në Kushtetutën tonë etj. Jurisprudenca regjionale dhe rezolutat e mëvonshme të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, e pranojnë se *‘nuk ka një sistem politik ose një metodë elektorale që do t’u përshtatej njësoj të gjitha kombeve...’* (APKB rez. 46 / 137, “Rritja e efektivitetit të parimit të zgjedhjeve të lira dhe të rregullta”, 17 dhjetor, gjithashtu, APKB rez. 47 / 130, 18 dhjetor të vitit 1992, si edhe APKB rez. 48 / 124, dhjetor të vitit 1993).

Një pyetje të cilës do t’i japim përgjigje më poshtë është, nëse sistemet elektorale të aplikuara ndër vite në Shqipëri pas vitit 1990-të, a e kanë arritur funksionin e tyre kryesor/parësor apo jo?! Është e vërtetë se synimi kryesor i zgjedhjeve është të arrihet një qeverisje legjitime dhe një regjim i lirë e demokratik, por në një proces tranzicioni siç ndodhet vendi ynë, mund të theksojmë se pa zgjidhjen e kësaj çështjeje themelore nuk është e mundur të zgjidhet pjesa tjetër e problemeve sociale ose politike të vendit.

Nëse i referohemi disa nga efektet ose funksionet kryesore të sistemit elektorale, sipas Kajsiut (2005) janë frytshmëria në qeverisjen e vendit, stabiliteti politik, përfaqësimi i interesave dhe i grupeve të ndryshme shoqërore, si dhe ndikimi i sistemit zgjedhor mbi procesin zgjedhor, përfaqësimi më proporcional, përjashtim i partive politike të vogla nga Parlamenti dhe përforcimi i partive politike më të mëdha ose e kundërta etj. Pasojat e sistemit elektorale duhet të jenë gjithnjë pozitive, por kjo mund të arrihet nëse kemi aplikuar sistemin zgjedhor të përshtatshëm me kushtet politike të vendit ku aplikohet.

Pra, siç nënvizuam edhe më sipër, zgjedhja dhe zbatimi i një sistemi elektoral mund të ketë efekt të drejtëpërdrejtë në të drejtat politike të një vendi. Por, mënyra e organizimit të zgjedhjeve është një çështje me rëndësi, ku mund të realizohen në dy mënyra: së pari, me zgjedhje me shumicë votash, ku fiton kandidati që merr shumicën e votave në një zonë të caktuar. Zgjedhjet me shumicë votash priren të favorizojnë partitë më të mëdha politike, ku mbizotëron stabiliteti qeverisës edhe pse partitë e vogla nuk kanë peshë në Parlament. Së dyti, me përfaqësim proporcional, në zhvillimin e zgjedhjeve me sistem elektoral proporcional, zakonisht votohet për partitë politike dhe jo për kandidat në veçanti. Numri i përfaqësuesve të një partie në legjislaturën kombëtare përcaktohet nga përqindja e votave që secila parti merr në garën elektorale.

Në qoftë se nuk kemi një fitues, atëherë liderët e partive kryesore hyjnë në bashkëbisedime midis tyre dhe në bazë të peshës parlamentare (mandateve), mund të krijojnë një koalicion qeverisës. Qeveritë parlamentare që zgjidhen në këtë mënyrë, priren drejt sistemeve shumëpartiake ose drejt një koalicioni të gjërë, ku mund të përfaqësohen edhe grupime politike të vogla. *Por ky sistem mund të prodhojë paqëndrueshmëri qeverisëse në vend sepse koalicionet me shumë parti mund të jenë të brishta dhe mund të shpërbëhen shumë shpejt nga një krizë e vogël politike që mund të kalojë vendi.*

Por le t'i trajtojmë gjërësisht më poshtë secilin prej këtyre familjeve të mëdha të sistemeve elektorale, duke analizuar gjithashtu në mënyrë të hollësishme efektet e tyre në sistemin partiak dhe në formën qeverisëse të vendit.

Rëndësia e sistemit elektoral në konturimin e sistemit politik

Sistemi elektoral përcakton tërësinë e rregullave se si votohet dhe sesi këto vota përkthehen në mandate parlamentare. Përzgjedhja e sistemit elektoral është e një rëndësie të veçantë, kryesisht në sistemin demokratik të përfaqësimit, ku sistemi zgjedhor përcakton se cilët do të jenë kandidat që do të përfaqësojnë zgjedhësit e tyre, cilat do të jenë partitë fituese që do të formojnë qeverinë dhe partitë që do të formojnë opozitën. Pra, përcaktimi i qeverisjes së shtetasve, kalon përmes zgjedhjeve, ku në themel të cilave qëndron sistemi elektoral.

Të gjitha sistemet elektorale vlerësohen si demokratike, por ato mund të prodhojnë efekte të ndryshme në vende të ndryshme mbi sistemin politik (qeverisjen e vendit). Impakti i tyre është ndikues edhe mbi sistemin partiak, pra mbi mënyrat e ndërtimit të qeverive ose të koalicioneve qeverisëse. Pranohet nga teoritë dhe eksperiencia e vendeve të ndryshme, se sistemi elektoral ndikon në sistemin politik. Ka sisteme të cilat mundësojnë bipolarizmin, e sisteme që mundësojnë përfaqësimin shumëpartiak. Ka sisteme të cilat prodhojnë deputetë të ‘popullit’ dhe sisteme që prodhojnë ‘deputetë të listës partiake’, por nuk duhen harruar avantazhet dhe dizavantazhet e secilit sistem elektoral.

Sistemet zgjedhore janë edhe një përcaktues i rëndësishëm edhe pse nuk do të thotë përcaktim i vetëm i sistemeve partiake (Lijpart, 1999: 144). Madhësia e një zonë zgjedhore tregon numrin e kandidatëve për deputetë dhe formula pluraliste ose me shumicë (150), mund të zbatohet në të dyja zonat zgjedhore (njëemërore dhe shumëemërore). Magnitudë e lartë në PR kanë tendencë për të maksimizuar proporcionalitetin dhe për të lehtësuar përfaqësimin e partive shumë të vogla (153).

Një faktor tjetër që ndikon në proporcionalitetin e rezultateve të zgjedhjeve dhe numrit të partive politike është madhësia e vendeve parlamentare. Për arsye se sistemet

zgjedhore janë metoda të përkthimit të votave në mandate, numri i vendeve në dispozicion për këtë përkthim është pjesë integrale e sistemit të përkthimit (Lijpart, 1999: 154). Për legjislaturat me 100 ose më shumë anëtarë, madhësia bëhet e parëndësishme. Modeli i përgjithshëm, është se vende të populluara kanë legjislaturë të mëdha dhe vendet me popullsi të vogël kanë legjislatura më të vogla, si rrjedhojë nënvizojmë se, madhësia e legjislaturës tregon madhësinë e popullsisë.

Reformat elektorale realizohen me idenë, se ndryshimet e rregullave formale do të sjellin pasoja të dëshirueshme në dimensionin social dhe politik të vendit. Gjërësisht pranohet se, rregullat elektorale kanë efekte mekanike në përcaktimin e kandidatëve, si edhe të partive fituese në Parlament (Sakamoto, 1999). Ashtu siç u trajtua më lart, sistemet elektorale ndryshojnë nga njëri-tjetri sipas një sërë dimensionesh të ndryshme, si nga formula elektorale, modeli i fletës së votimit, pragu elektoral, madhësia e zonës së votimit, madhësia e legjislaturës (në Shqipëri numri i deputetëve ka variuar nga 250 deri në 140), listat e hapura ose të mbyllura, përcaktimi i zonave zgjedhore etj. Kombinimi i ndryshëm i këtyre dimensioneve sjell gjithashtu edhe produkte të ndryshme politike në vend.

Ligjet zgjedhore përfaqësojnë një nga mjetet më të rëndësishme që sistemet moderne politike kanë në ushtrimin e drejtpërdrejtë të sovranitetit popullor. Nga ky parim, sistemet elektorale i ndajmë në dy lloje themelore qeverisëse, atë të shumicës dhe qeverisë së gjërë. Sipas shumicës së studiuesve, qeverisja me shumicë thekson rëndësinë e stabilitetit politik, ndërsa e dyta, qeveria e gjërë, thekson rëndësinë e përfaqësimit të gjithave grupeve shoqërore (pluralizëm). Gjithashtu kemi edhe një tjetër model, atë të sistemeve të përziera.

Si rrjedhojë, dalim në konkluzion se qëllimi primar i sistemit elektoral është që të garantojë e të plotësojë dy principe të cilat janë në konflikt me njëra-tjetrën, përfaqësimin

dhe qeverisjen. Struktura politike e një vendi ndikohet drejtëpërdrejtë nga sistemi elektoral, si në raportin mes partive politike dhe marrëdhëniet midis Qeverisë e Parlamentit. Mbi efektet që sistemet elektorale prodhojnë në sistemet partiake, si edhe në dy format e qeverisjes së vendit. Por që të kemi efekte pozitive për sistemin politik dhe shoqërinë në tërësi, zgjedhja e sistemit elektoral duhet të përshtatet me kontekstin/kushtet politike në të cilin ai do të aplikohet. Sipas Pippa Norris (2007: 261):

“Në vendet ku një sistem elektoral ka ekzistuar për dekada të tëra, ndikimi i sistemeve në llojin e konkurrimit partiak dhe produktit politik është i dukshëm. Ndërkohë që në ato vende ku sistemet elektorale kanë pak jetëgjatësi, është shumë më pak e pritshme që të kemi një logjikë shkak-pasojë me një drejtim ndërmjet sistemeve (rregullave) dhe konkurrimit partiak apo produktit politik”.

Ajo çka pritet në këto vende (ku bën pjesë edhe vendi ynë) është një marrëdhënie ciklike, ku lloji i garës politike dhe produktit partiak në një vend të caktuar, njëson edhe llojin e sistemit politik.

Kastriot Islami në një intervistë të dhënë tek Gazeta Panorama, me temë “Sistemi zgjedhor, pjesëmarrja dhe përzgjedhja”, ka përcaktuar disa faktorë të rëndësishëm që do të mund të ndihmonin në përzgjedhjen e sistemit elektoral, si edhe në vlerësimin e tij si të efekshëm ose jo për vendin ku aplikohet (Islami, 2008): *Legjitimiteti, Përfaqësueshmëria, Mundësi zgjedhjeje për votuesit, Sistem efikas i partive politike, Qeverisje e qëndrueshme dhe efikase, Parlament efikas, Pjesëmarrje aktive dhe masive në zgjedhje, Përgjegjshmëri*.

Duke u bazuar në këto karakteristika, të listuar nga Islami, që përcaktojnë një sistem elektoral të efekshëm ose jo për qeverisjen e vendit, në këtë mënyrë ne do të mund t'i japim përgjigje një nga nënpyetjet kërkimore të studimit, nëse e kanë arritur ose jo sistemet elektorale të aplikuara në Shqipëri qëllimin e tyre kryesore. Por këtë do t'a trajtojmë gjërësisht më poshtë në kapitujt pasues.

Vetëm disa sisteme elektorale janë në gjendje për të arritur të gjitha këto qëllime së bashku në të njëjtën kohë. Rehfeld dhe Schëartzberg në esenë e tyre, shënojnë se barazia politike mund të interpretohet si një shans i barabartë për të votuar për një kandidat fitues (pra nënkupton proporcionalitetin dhe përfshirjen), mundësi të barabarta për të ndikuar një krijues të politikave (një qeveri njëpartiake) apo reagimi i përfaqësuesve të zgjedhur në preferencat politike e votuesve (harmoni ideologjike). *Shumë nga këto parime janë të papajtueshme me të tjerat, si edhe zgjedhja e sistemit elektoral kërkon domosdoshmësisht qartësimin e prioriteteve të një vendi, duke mos anashkuar nga specialistët kulturën politike.* Përzgjedhja e një nga sistemet elektorale ndikon direkt në formën e qeverisjes, pra në sistemin politik të vendit, duke u theksuar më shumë një nga parimet e mësipërme sesa të tjerat.

2.2 Klasifikimi i sistemeve zgjedhore dhe efektet në përbërjen partiake, strategjitë zgjedhore dhe përfaqësimi politik i tyre

Sistemet zgjedhore janë rregulla që rregullojnë dhe përcaktojnë shpërndarjen e mandateve për përfaqësimin e një elektorati të caktuar (Martines, 2013: 224). Bëhet fjalë për një mjet kompleks (Pasquino, 2006: 8) me të cilat rregullon jo vetëm mekanizmin e përkthimit të votave në mandate parlamentare, por edhe procedurat për zgjedhjet, informacionin politik, procedurat për zhvillimin e fushatave, financimin e partive politike etj. Sistemi zgjedhor konfiguror një sërë rregullash për përfaqësimin politik dhe është plotësisht pjesë e rregullave ligjore kushtetuese që përcaktojnë formën e qeverisjes së një vendi (Luciani, 2014: 572).

Çdo sistem zgjedhor është i bazuar në një parim të caktuar të zgjedhjeve që mund të jetë në pjesën më të madhe mazhoritar, proporcional ose të dyja së bashkë (sistem i përzier) dhe në themel ka si qëllim për të arritur efekte të caktuara në një sistemin politik të caktuar. Por, mund të lindin mospërputhje të mundshme midis parimit themelor dhe efektet që rezultojnë, dhe si rrjedhojë, këto parime duhet të vlerësohen duke marrë parasysh edhe zbatimin praktik të mekanizmave elektorale.

Çështje me rëndësi të madhe në analizën e efekteve të ligjeve elektorale nënvizojmë marrëdhëniet mes llojit të sistemeve zgjedhore me shumicë të thjeshtë, shumicë me votim të dyfishtë, si dhe formave të ndryshme të përfaqësimit proporcional dhe numri i partive politike që kontestojnë zgjedhjet. Formulimi i Duverger, se sistemi me shumicë favorizon sistemin dypartiak, zakonisht i referohemi të "ligji i Duverger", ndërsa metodat PR e sistemi i dyfishtë i votimit favorizon sistemin shumëpartiak, ku referohemi të "hipoteza e Duverger" (Lijphart dhe Grohman, 2003: 4).

Një "sistem i thjeshtë me shumicë të vetme të votimit favorizon sistemin dypartiak", ndërsa "sistemi i shumicës me votim të dyfishtë dhe proporcional favorizon përfaqësimin shumëpartiak" (Duverger, 1963: 239). Autori, thekson se votimi me shumicë ku fituesi i vetëm është kandidati me më shumë vota, mes dy kandidatëve fituesi ka një shumicë të thjeshtë të votave. Mes tre ose më shumë kandidatë, fituesi mund të ketë vetëm një shumicë. Duverger nënvizon se marrëdhëniet mes rregullave zgjedhore dhe sistemeve partiake nuk janë mekanike dhe automatike. Një regjim i veçantë elektorale nuk prodhon domosdoshmërisht një sistem partiak të veçantë, por thjesht ushtron presion në drejtim të këtij sistemi.

Përsa i përket numrit të partive që konkurojnë në sistem, ky numër është i lidhur në përpjestim të drejtë me luhatshmërinë elektorale (Pedersen, 1979; Bartolini dhe Mair, 2005). Është një fakt i pranuar dhe i njohur tashmë, se sistemi elektoral është një prej përcaktuesve kryesorë të numrit të partive që konkurojnë në zgjedhje (Rae, 1971; Taagepera dhe Shugart, 1989). Një faktor i tretë që ndikon në luhatshmërinë e sistemit elektoral është *ndryshimi i sistemit zgjedhor*. Sistemet shtrënguese (Birch, 2001:7) me zona zgjedhore të vogla (prag të lartë)/ me prag formal të lartë në nivel kombëtar, i shkurajojnë partitë për të marrë pjesë në konkurrencën partiake për pushtet duke ulur luhatshmërinë e elektoratit.

Më poshtë do të analizojmë hollësisht tre familjet e mëdha të sistemeve elektorale, si edhe do të paraqesim ndikimin ose përcaktimin e tyre në konturimin e sistemit partiak dhe në formën qeverisëse të një vendi.


Sistemi një partiak

Sistemi i qeverisjes njëpartiake, sipas Besnik Muratit (2014: “Qeverisja njëpartiake”, Gazeta online Shenja), nënkupton qeverisjen e vendit vetëm nga një parti politike, duke u mohuar ekzistimin e partive tjera edhe në opozitë. Ky sistem i të qeverisurit nga një parti e vetme, ndalojnë formimin dhe funksionimin e partive të tjera politike (nuk ekziston pluralizmi partiak). Partia në pushtet udhëheqet vendin në çdo sferë të jetës, si politike, shoqërore, kulturore, ekonomike etj. Në studimet e shumta të autorëve të ndryshëm, bien në një konkluzin se në sistemin njëpartiak, partia politike ka tërë pushtetin (pushtetin politik dhe ekonomik).

Në sisteme të tilla qeverisëse, Qeveria dhe partia njësohen me njëra-tjetrën sepse Qeveria zbaton ligjin që nuk lejon parti tjera të jenë aktive, si edhe partia kontrollon më nga afër aparatin qeverisës. Nëse analizojmë kushtet historike të lindjes/krijimit të qeverisjes një partiake, ato shihen si pasojë e faktorëve të ndryshëm, si historikë, politik, kulturor e ekonomik edhe si pasojë e revolucioneve ushtarake e ekonomike. Dhe synimi i tyre i vetëm ka qenë ardhja në pushtet, qeverisja e vendit dhe qëndrimi/mbajtja sa më gjatë e pushtetit.

Nga qeverisjet një partiake kanë lindur regjimet totalitare (regjime që vijnë dhe qëndrojnë në pushtet përmes dhunës). Koncepti i partisë totalitare sipas Duverger (marrë nga artikulli “Partia Politike në sistemet totalitare”), ku autori thekson se nuk ka ndonjë dallim thelbësor në strukturën ndërmjet Partisë Një (Single Party) dhe partive në regjimet demokratike. Tendenca për të barazuar partinë-një me partinë totalitare, bie në kundërshtim nga disa fakte, ka raste që partia-një nuk janë totalitare, ka raste tjera që ekzistojnë parti totalitare në sistemet multi-partiake. Sipas autorit, nuk mund të biem në konkluzion se është kopjuar strukturën e partive në sistemet një-partiake se kërkonin t’i imitonin e t’i shtypnin rivalët e tyre politikë, dhe për pasojë ato janë me të vërtetë Parti Një (Single Party).

Figura nr. 4: Sistemi një partiak.



Këto sisteme kanë qenë karakteristikë për ish-Shtetet Socialiste, të bazuara në rolin udhëheqës të Partisë Komuniste (vendi ynë e ka jetuar 46 vite partinë-shtet). Sistemi i qeverisjes njëpartiake e nënshtron tërësisht individin, e shkëput nga realiteti i zgjedhjes së

nevojave të përditshme dhe e vë në pozitën e luftës për shoqërinë e ardhshme. Nuk ekziston stabiliteti politik, ku nuk respektohet ligji e drejtësia dhe nuk zhvillohen zgjedhjet e përgjithshme (mundësinë e ndëshkimit të partisë në pushtet nga ana e elektoratit). Si rrjedhojë, në këtë sistem qeverisje nuk ekziston pluralizmi partiak dhe nuk mund të flasim për një qeverisje efikase ose të një qeverisje me bazë të gjërë koalicioni.

Sistemi mazhoritar - sistemi dypartiak dhe forma qeverisëse

Përzgjedhja e sistemit elektoral është vendim institucional me rëndësi të madhe për çdo shtet me demokraci të re ose jo. Çdo shtet demokrat përzgjedh një sistem zgjedhor, për të formuar në këtë mënyrë Parlamentin e ri, por rrallë bëhet përzgjedhja e një tij me vetëdije të plotë dhe me qëllim. Përzgjedhja e sistemit elektoral mund të jetë e rastit, rezultat i kombinimit të rrethanave të veçantë, të një trendi kalimtar ose historisë së huaj. Megjithatë, përzgjedhja e një sistemi të veçantë të zgjedhjeve ka ndikim themelor në jetën e ardhshme politike të vendit.

Përzgjedhja e sistemit elektoral mund të duket si diçka mekanike dhe teknike, por produkti i tyre politik sjell në vëmendje një sërë debatesh teorike mbi modelin e demokracisë dhe të përfaqësimit (Dunleavy, P.dhe Margetts, H. (1995) “Understanding the dynamics of electoral reform”, *International Political Science Review*” 16(1): 9–30). Le t’i trajtojmë më gjërësisht këto avantazhe e disavantazhe të këtyre dy familjeve të mëdha elektorale, në kontekst me krijimin e sistemit partiak.

Sistemi mazhoritar u përshtatet vendeve me demokraci të fortë dhe me traditë të gjatë demokratike. Dhe në këto demokraci të qëndrueshme sipas Çilit (2002:14) numërohen të paktën gjashtë aktorë publikë që ndikojnë në jetën politike, siç janë sindikata e

punëtorëve, sindikata e sipërmarrësve, media, shoqëria civile, bota akademike, sistemi gjyqësor dhe kurora mbretëtoare aty ku ka mbretëri kushtetuese, si Anglia.

Sipas studiusve të shkencave të politikës, përparësitë e sistemit të shumicës mund të përmbliken me sa vijon si mëposhtë:

- Sistemi i shumicës favorizon sistemin dypartiak, ku mund të arrihet një raport i qartë shumice në Parlament;
- Bëhet mbrojtja nga copëtimi i madh partiak i Parlamentit;
- Njësitë zgjedhore janë të vogla dhe kandidati ka një kontakt të drejtpërdrejtë me zgjedhësit e tij (lidhja e ngushtë kandidat-zgjedhës);
- Krijohet një qeveri e qëndrueshme dhe e aftë për të funksionuar për katër vjet, si edhe një opozitë e fortë (si rasti i SHBA-së);
- Nxitet matura politike dhe shmanget ekstremizmi, ku partitë e mëdha politike luftojnë për të fituar zgjedhësit e matur të mesit (vijës gri);
- Një pjesë e madhe e elektoratit, votojnë vetëm dy parti politike, sidomos në vendet me një ndarje të thella etnike ose rajonale;
- Votuesit në mënyrë të drejtpërdrejtë përcaktojnë udhëheqjen e ardhshme të qeverisë;
- Ky sistem konsiderohet më shumë i fokusuar në stabilitetin qeverisës dhe më pak i bazuar në zbatimin e drejtësisë;
- Konsiderohet si një sistem mjaft i thjeshtë për tu zbatuar dhe për tu kuptuar.


Të metat ose disavantazhet e sistemit të shumicës sipas studiusve të shkencave të politikës:

- Kemi një humbje të madhe të votave sepse në secilën prej njësisë zgjedhore fiton vetëm një kandidat, të gjithë kandidatët e tjerë përjashtohen automatikisht;

- Sistemi i shumicës mund të sjellë shumë padrejtësi;
- Përfaqësimi në Parlament mund të mos i përgjigjet gjithmonë vullnetit real të shumicës
- Një parti, e cila në asnjë njësi zgjedhore nuk mund të fitojë shumicën, por ajo ka një përkrahje solide politike. Në këtë sistem elektorale kjo parti politike do të mbetet jashtë Parlamentit edhe nëse ka një përkrahje të gjërë në nivel vendi;
- Përjashton mundësinë e përfaqësimit të minoriteteve të ndryshme;
- Përjashtohet mundësia e përfaqësimit të gruas, por edhe të të rinjve;
- Mund të nxisë klanizimin dhe rajonalizimin, psh. partitë që nuk renditen në vendin e parë/dytë në nivel vendi, synojnë përqendrimin e punës në rajone të caktuara të vendit.

Në sistemin mazhoritar kemi ndarjen e zonave elektorale në po aq qendra zgjedhore sa është edhe numri i ofruar i vendeve parlamentare. Fiton kandidati (i mbështetur nga partitë e mëdha) që ka fituar shumicën absolute ose shumicën relative të votave. Këta kandidatë duhet të heqin dorë nga përfaqësimi i interesave të veçanta dhe duhet të tërheqin grupe sa më të mëdha të popullsisë, me qëllimin e vetëm që të arrijnë shumicën e votave të fituara.

Figura nr. 5: Sistemi dypartiak.



Sistemi mazhoritar krijon një konfigurim politik dhe frymëzon luftën e fortë politike, skualifikon aktorët e tretë, por favorizon një vendimarrje politike të shpejtë dhe

operative (Çili, 2002: 13). Ky sistem sipas autorit, shkurajon procesin e ‘fragmen-tarizimit’ e në këtë mënyrë, partitë e vogla për të mbijetuar duhet të ecin bashkë me partitë e mëdha.

Në perspektivën historike, zgjedhja e mazhorancës dhe sistemet dypartiake janë të lidhura shumë ngushtë me njëra-tjetrën. Sipas studiuesve, sistemi elektoral mazhoritar nuk mund t’i prodhojë sistemet dypartiake, por mund t’i ruajë dhe t’i sigurojë shumë mirë ato. Ky sistem ndikon në konturimin e sistemit dypartiak, ku i ofron votuesve mundësinë e zgjedhjes midis dy alternativave dhe këto dy parti kryesore kanë influencë sepse do të konkurojnë për shumicën e vendeve parlamentare (Lijpart, 63). Nga natyra e sistemit elektoral, përcaktohet natyra e spektrit politik dhe natyra e përbërjes së parlamentit, që qëndron në origjinë të gjithë institucioneve kryesore të shtetit, por jashtë ekzekutivit (Çili, 2002: 13).

Ajo që nxit debate dhe kritika, sipas studiuesit Bruce Larson, është pushteti që kanë dy partitë kryesore, të cilat e kanë përdorur pushtetin e tyre për të parandaluar palët e tjera kundërshtare që të marrin pjesë në zgjedhje. Për këtë arsye, sukcesi i sistemit mazhoritar parashikon që dy partitë e mëdha të jenë të hapura nga të gjitha anët dhe të mos qëndrojnë në opozitë thelbësore ndaj njëra-tjetrës. Sipas Lijpart, kabinetet qeverisëse me një parti janë më jetëgjata dhe dominante sesa kabinetet me koalicion partiak. Rregullat e tij për numërim (mandatet parlamentare), pra, komponentët e një partie e cila mund të jetë pjesë e sistemit partiak janë potenciali i saj për koalicion dhe potenciali i saj për shantazh (65). Variablat themelore që karakterizojnë dallimin midis formave të shumicës e konsensusit demokratik, kanë të bëjnë me gjerësinë e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të popullit në ekzekutiv (90).

Ky sistem mazhoritar karakterizohet nga pragje elektorale të larta dhe partitë e mëdha politike përshtasin strategji gjithëpërfshirëse me dallueshmëri të ulët. Në këtë

mënyrë, partitë kërkojnë vota në çdo segment të elektoratit, pa bërë ndonjë dallim ndërmjet grupeve të ndryshme sociale në shoqëri (Bogdanor, 1985). Këto parti kanë si synim të krijojnë koalicione të mëdha, me natyrë ideologjike e sociale. Kryesisht fokus i platformave elektorale të këtyre partive politike janë një sërë çështjesh që shqetësojnë pjesën më të madhe të gjërë të publikut (Rohrschneider (2002) "Electoral Studies" 21(3): 367–382). Si rrjedhojë, partitë kanë natyrë centripetale si në shoqëri dhe ideologjikisht, ku konkurrimi politik i tyre është i organizuar në qendrën e spektrit politik (Duschinsky, 2002).

Sistemi elektoral është një element i rëndësishëm i sistemit politik, i cili është i lidhur drejtëpërdrejtë me sistemin partiak. Në fakt dy janë elementët që realisht ndikojnë tek njëri-tjetri. Në lidhje me formën e shtetit / qeverisjes, marrëdhënien legjislativ / ekzekutiv (Parlament – Qeveri) në sistemin dy partiak dhe shumë partiak, do t'i trajtojmë gjërësisht më poshtë po në këtë kapitull. Ndërsa, këtu është trajtuar gjërësisht lidhja midis sistemit të shumicës (mazhoritar) – sistemit dypartiak – forma qeverisëse (ndikimi i sistemit dy partiak në qeverisjen e vendit).

Kabinetet me shumicë njëpartiake dhe koalicionet e gjëra shumëpartiake, ndryshojnë nga njëra-tjetra në dy aspekte, kabineti përbëhet nga një parti ose një qeveri koalicioni dhe lloji mbështetës parlamentar që kabineti ka. Përsa i përket bazës mbështetëse të kabinetit sipas Lijphart, së pari, fituesit minimal të kabinetit, të cilat janë të "fituara" nga një parti ose partitë në kabinetin që e kontrollojnë shumicën e vendeve në Parlament, por "minimal" në kuptimin se kabineti nuk përfshin asnjë parti që nuk është e nevojshme për të arritur një shumicë në Parlament. Së dyti, kabinete të tepërta, të cilat përmbajnë më shumë parti se sa janë të nevojshme për mbështetjen e shumicës në legjislaturë, dhe së treti, pakicës ose kabinet "i vogël", që nuk janë të mbështetura nga një Parlamentar mazhoritar.

Autori argumenton, se lloji më mazhoritar i kabinetit është një-parti dhe fitues minimal i kabinetit është vetëm një parti në kabinetin e shumicës. Lloji më konsensual i kabinetit është shumëpartiak dhe kabinetet e minoriteteve ngjajnë me kabinetet e tepërta dhe kabinet shumëpartiake i përkasin fundit të spektrit konsensual. Dy llojet e kabineteve, të cilat janë në një pozitë të ndërmjetme: Sistemet shumëpartiake me kabinet minimal të fituar dhe një parti me pakicë në kabinet (Lijpart,1999: 90–91).

Sistemi proporcional - sistemi shumëpartiak dhe forma qeverisëse

Struktura politike e një shoqërie ndikohet nga zgjedhja e sistemit zgjedhor. Në sistemin proporcional, në parimin vendet parlamentare ndahen saktësisht në proporcion të drejtë me votat e marra nga partitë politike në të gjitha qendrat elektorale të vendit. Në këtë mënyrë, Parlamenti shndërrohet në një lloj pasqyre politike të zgjedhjesve të ndryshme të elektoratit. Dhe sipas një përkufizimi, një sistem elektoral i zgjedhur është ai që ndikon në mënyrën sesi formohet spektri politik, sesi ndërtohet Parlamenti, ku nis gjithçka, si ndërtimi i qeverisje dhe ajo e institucioneve, ku nis procesi i shtetit të ardhshëm (Çili, 2002: 13).

Le të trajtojmë në mënyrë të përmbledhur avantazhet dhe disavantazhet e sistemit proporcional, ku do të analizojmë ndikimin/konturimin e tij në sistemin shumëpartiak. Disa nga përparësitë ose avantazhet e sistemit proporcional, të pranuar nga autorët e fushës, janë:

- Shpërndarja e vendeve parlamentare paraqet raportin e rezultateve në zgjedhje, duke shmangur në këtë mënyrë mangësitë e sistemit mazhoritar;
- Votat nuk shkojnë dëm;

- Mund të përfaqësohen të gjitha grupet dhe interesat politike në Parlament, në raport me forcën e tyre brenda zgjedhësve (partitë e vogla, partitë që përfaqësojnë minoritetet, parti që mbrojnë interesat e grave, partitë që përfaqësojnë të rinjve etj);
- Partitë politike kanë mundësinë të dërgojnë në Parlament ekspertët e tyre;
- Nuk është e mundur që përmes përcaktimit të njësisë zgjedhore, të ndikohet në këtë mënyrë në rezultatin e zgjedhjeve;
- Mënjanohet qeverisja vetëm të një partie politike dhe kështu mund të evidentohet më lehtë mundësia për keqpërdorim të pushtetit nga partia qeverisëse;
- Ky sistem konsiderohet i bazuar më shumë në drejtësinë se sa në stabilitetin qeverisës;
- Krijimi dhe forcimi i lokalizmave në kuptimin partiak është më i vogël, pasi partitë zakonisht orientohen në nivel kombëtarë.

Të metat ose disavantazhet e sistemit proporcional të pranuar nga autorët e fushës:

- Rreziku i ndarjes së Parlamentit në grupe të shumta dhe të vogla parlamentare;
- Krijimi i Qeverisë është i vështirë sepse është i domosdoshëm krijimi i koalicioneve midis partive politike, që shpesh kanë programe partiake të ndryshme;
- Qeveritë mund të jenë jo të qëndrueshme, kjo si pasojë e koalicioneve qeverisëse;
- Një parti e vogël përmes koalicionit fiton një fuqi qeverisëse shumë më të madhe se sa mund të fitojë nga votat e marra nga elektorati, si pasojë e kalkulimit të interesave të partnerëve në koalicionin e krijuar;
- Partitë e vogla mund të ndikojnë në ndryshimin e shumicës, gjithashtu mund të vështirësojnë në këtë mënyrë punën në Qeveri dhe Parlament;
- Zgjedhësi nuk mund të vendosë më kush (cili partner koalicioni) do të qeverisë vendin;

- Mungon kontakti personal midis zgjedhësit dhe të zgjedhurit (kandidatit);
- Shumë kandidatë të listave të partive nuk janë të njohur nga zgjedhësit;
- Zgjedhësi nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë mbi kandidatët, të cilët fitojnë mandatin parlamentar, pasi listat përpilohen nga partia (lideri i saj).
- Rriten mundësitë e përfaqësimit të partive ekstremiste (Kiçmari, S. (2006) “Drejtimit e reformimit të sistemit të zgjedhjeve në Kosovë”).

Përparësitë e sistemit proporcional janë të shumta, si përfaqësimi real i partive politike në Parlament, përfaqësim real i shtresave shoqërore në spektrin politik, kontrolli i opozitës mbi pushtetin e shumicës parlamentare, zbatueshmëria e marrëveshjes, shfarosja e ndarjes elektorale ‘veri-blu, jugu-kuq’, eliminimi i copëtimit të procesit elektoral, shmangia e ndeshjes lokale mes kandidatëve, shanse për një kuvend elitar, shkurajimi i partizanëve e ‘partive fasadë’ me rritjen e pragut natyror (Çili, 2002: 8).

Sistemi proporcional i përfaqësimit cakton vendet e partive politike (mandatet e marra) proporcionalisht me forcën e tyre politike, por ato mund të inkurajojnë shumicën e partive politike dhe të kërkojnë votimin në bazë të listave partiake, duke distancuar votuesit nga kandidatët e tyre dhe duke kufizuar mundësitë për kandidatura individuale ose jopartiake (Goodwin-Gill, cit. 1994: 38 - 39). Ky sistem karakterizohet nga pragje elektorale të ulta dhe aplikohet nga partitë politike strategji jo gjithëpërfshirëse me dallueshmëri të lartë, ku në thelb partitë kërkojnë votat në segmente të mirë përcaktuara të shoqërisë. Këto strategji adresohen në ato pjesë të elektoratit që konsiderohen si homogjene në disa aspekte kryesore, si klasa, besimi fetar, identiteti etnik, ideologjia e nacionalizmi (Lijphart, 1994).

Duke ndjekur këtë logjikë, nënvizojmë se marrëdhënia ndërmjet partive politike dhe votuesve, ndryshon në varësi të pragut elektoral të përcaktuar ose të sistemeve mazhoritare, proporcionale dhe sistemeve të kombinuara. Sistemi elektoral proporcional bën të mundur themelimin e partive të reja dhe përfaqësim të tyre në Kuvend. Si rrjedhojë, kemi grupe të vogla parlamentare të përfaqësuara në Parlament dhe krijohen qeveri të paqëndrueshme koalicioni, me udhëheqje të dobët. Përfaqësimi politik më gjithëpërfshirës është një avantazh tjetër, e cila redukton ndjeshëm mundësinë e mbizotërimit vetëm të një partie politike (me një shumicë absolute).


Në këtë tabelë, është përcaktuar emri i formulës së përdorur dhe shkalla e favorizimit të partive të mëdha (ndikimi i sistemit elektoral në sistemin partiak).

Tabela nr. 1: Renditja e formulave, sipas nivelit të favorizimit që i bëjnë partive të mëdha.

Renditja e formulave, sipas nivelit të favorizimit që i bëjnë partive të mëdha	Emri formulës
Favorizon shumë partitë e mëdha	Kuota Imperiale
Favorizon partitë e mëdha	D'Hondt
Favorizon partitë e mëdha	Kuota Rënëse
Favorizon shumë pak partitë e mëdha	Saint Lague i modifikuar
Efekt neutral si për partitë e mëdha dhe ato të vogla	Kuota Hare dhe Saint Lague i pastër
Favorizon partitë e vogla	Metoda Daneze

Në këtë sistem elektoral theksohet roli i konsensusit, të negociatave e koalicioneve parlamentare dhe qeveritare. Përfaqësimi i grupeve të ndryshme në Parlament përmirësojnë mekanizmin e përfaqësimit politik të shoqërisë.

Figura nr. 6: Sistemi shumëpartiak.



Bello, në pyetjen e gjashtë të intervistës, rreth avantazheve dhe disavantazheve të secilit sistem për vendin tonë, argumenton se:

“Në rastin e sistemit proporcional, garantohet stabilitet, votohen partitë dhe vihet edhe një prag, duke mos i’a ngrënë hakun askujt. Sigurisht, që për qytetarin, më mirë do të ishte ta njihte të zgjedhurin, ti kërkonte llogari dhe ta votonte, duke peshuar vlerat e tij individuale, integritetin e profesionalizmin. E këtë e garanton mazhoritari, zona një emërore, ku çdo parti ofron një kandidat, duke ia lënë zgjedhësve të vendosin. E keqja është se njerëz të dhunshëm, të tjerë që janë pasuruar brenda natës në mënyrë të dyshimtë, mund të imponohen, me forcë a me para dhe ta blenë një vend në parlament, duke speculuar me varfërinë e njerëzve... Rezultati: kriminelë në parlament. Nëse partitë mbyllen, nuk lejojnë shprehjen e lirë, kritikën, llogaridhënien dhe garën apo konkurrencën, është e kotë të flasim pastat për institucione demokratike që pritet të krijohen prej tyre pas zgjedhjeve...”.

Sistemi partiak në ato vende ku aplikohet sistemi proporcional, ka natyrë centrifugale, ku konkurimi politik shtrihet në gjithë spektrin ideologjik dhe në gjithë hapësirën e çështjeve të kontekstit social-politik, dhe nuk është i përqendruar rreth qendrës (Scholdan (2000) Javnost-The Public 7(1):25–40). Kandidatët në sistemet proporcionale me lista të mbyllura, kanë motivim të ulët për të ofruar përfitimeve të veçanta elektoratit të tyre ose për të krijuar lidhje të fortë me ta. Dhe energjinë e fokusojnë në programin e përbashkët të partisë dhe në përfitimet që rrjedhin prej saj.

Ndërsa disa nga disavantazhet e proporcionalitetit janë, mungesa e besueshmëri të përfaqësuesve të saj në një tërësi të caktuar zonash (Beetham dhe Boyle, 2001: 54) dhe elektorati nuk ndikon me votën e tij në radhitjen e kandidatëve në listën përfundimtare të partisë që përfaqësojnë. Sistemi proporcional jo përherë rezulton një sistem multipartiak sepse në praktikë zbatohen strategji të ndryshme për të ulur proporcionalitetin e tij. Dhe sipas Sartorit, sa më e vogël të jetë zona zgjedhore aq më i vogël është dhe proporcionaliteti i tij, edhe sa më i madh që të jetë pragu elektoral aq më i vogël është proporcionaliteti. Ky sistem eliminon partitë e vogla dhe minoritetet, të cilat nuk kanë elektorat të përqendruar në

një zonë, por e kanë të shpërndarë atë në të gjithë vendin, aq sa shpërndarja të ndikojë në mosarritjen e pragut natyror elektoral (POLIS 11, 2011: 44 - 45).

Rreth diskutimeve të fundit midis partive politike kryesore, përsa i përket listave të hapura apo të mbyllura, Marko në pyetjen 4 të intervistës ka shprehur mendimin e tij, duke parashtruar disa nga avantazhet dhe disavantazhet e secilit prej sistemeve elektorale:

“Më të interesuarit për listat e mbyllura janë drejtuesit e partive, të cilët synojnë të vendosin njerëzit ose mbështetësit e tyre në vendet e para, duke i'u imponuar bazës apo anëtarëve të thjeshtë të partisë që drejtojnë. Listat e hapura janë më demokratike, lejojnë garën, garantojnë konkurrencën dhe japin mundësi për t'u votuar më të mirët. Rreziku i vetëm, që vjen edhe nga mjedisi shqiptar është se në këtë rast, partia mund të rrezikojë kohezionin e saj të brendshëm, pasi gara mund të ashpërsohet dhe ajo të kthehet në një fushatë denigruese brenda partisë, duke ndihmuar indirekt kundërshtarin politik. Nëse partitë i zgjedhin kandidatët për deputetë apo kandidatët për zgjedhjet vendore, sipas rregullave demokratike, edhe listat e mbyllura mund të jenë të pranueshme. Pra, nëse përpara se listat t'i dërgohen KQZ, respektohen kriteret, kontributi, bëhet votim brenda partisë etj., atëherë nuk do të kishte asnjë problem që renditja e kandidatëve të bëhej edhe nga vetë Partia. Fatkeqësisht, partitë në Shqipëri janë zëvendësuar nga kryetari, nga njeshi, i cili ka të drejtën ekskluzive të hartojë listën, të cilën e vulos dhe firmos, pa pyetur as kryesinë apo forume të tjera drejtuese”.

Si rrjedhojë, nënvizojmë se sistemi elektoral proporcional krijon parlamente/qeveri të dobëta, joefektive dhe të paqëndrueshme. Elektorati e ka të vështirë të identifikojnë përgjegjësitët për politikat e pakryera ose premtimet e pambajtura sepse kemi disa parti në bashkëqeverisje (dhe partitë politike nuk mbajnë përgjegjësi politike, kur janë pjesë e një koalicioni qeverisës). Mekanizmat e kontrollit e balancës shpesh krijojnë ngërçe politike, paralizim të administratës shtetërore dhe mungesë të mbajtjeve/miratimit të reformave si pasojë e vështirësisë për të gjetur konsensusin politik brenda vetë koalicionit qeverisës.

2.3 Numri i partive politike efektive në sistem

Njohja e rolit themelor që luajnë partitë politike në dinamikën e formës qeverisë është identifikimi midis elementeve të sistemit zgjedhor që shënon ripërtëritje metodolo-

gjike dhe një revolucion të thellë brenda të së njëjtës ligj kushtetues. Dhe më konkretisht Duverger (431) në shkrimet e tij për partitë politike shkruan se: *"Kush njih ligjin klasik kushtetues e injoron rolin e partive, ka ide të gabuar rreth regjimeve bashkëkohore politike; kush njih funksionet e partive politike dhe injoron ligjin klasik kushtetues, ka ide jo të plotë, por të sakta për regjimet bashkëkohore politike"*.

Shumica e shteteve janë organizuar politikisht nga partitë politike, ku nga mesi i shekullit të kaluar, rreth 80 % të tyre drejtoheshin nga parti politike. Ndërsa në vitet 1980-1990 pas rënies së regjimit komunizëm, kemi një rritje të numrit të partive politike (multipartizmit). Politologu i njohur italian, Sartori jep një formulim më sintetik të këtij koncepti: "një parti është një grup politik i identifikuar me një etiketë zyrtare që paraqitet në zgjedhje dhe është i aftë të vendos nëpërmjet zgjedhjeve kandidatët në poste publike". Ky përkufizim përmban kërkesat minimale për të identifikuar një parti politike përkundrejt organizimeve të tjera që synojnë të kryejnë veprimtari politike.

Formulim më i plotë të termit parti politike, do të ishte përcaktimi sipas të cilit, *"Partitë politike paraqesin bashkimin e lirë të qytetarëve me qëndrime të njëjta, të cilët, për zgjidhjen e problemeve politike bëjnë propozime programore dhe paraqesin kandidatë për mandate në parlament dhe për poste qeveritare, me qëllim që pas zgjedhjeve të suksesshme të zbatojnë në praktikë programin e tyre"* (Marrë nga libri Tempulli i Demokracisë, "Çfarë janë partitë politike?"). Sepse qëllimi politik i partive politike është të fitojë sa më shumë mandate parlamentare, në mënyrë që të sigurojë shumicën e duhur për të qeverisur vendin.

Ndërsa sipas Rexhep Meidanit (2015), misioni dhe objektivi i partive politike, së pari është për të garantuar fuqi e ndikim për të fituar sa më shumë vende në Parlament në zgjedhje (këshilla bashkiakë) dhe për të drejtuar e kontrolluar qeverisjen; së dyti, për të

luajtur rolin e opozitës, mbikëqyrur e kritikuar qeverinë (qendrore e vendore) ose për të zhvilluar alternativat e veta.

Një parti politike arritin qëllimin e saj primar kur fiton përfaqësim të gjërë parlamentar dhe kur e vetme arrin të qeverisë vendin. Në shkencën e politikës ekzistojnë mënyra të ndryshme të përshkrimit së partive politike (parlamentare), të përdorura nga studiues të ndryshëm në bazë të studimit dhe të rezultateve që ata duan të prodhojnë. Disa nga instrumentet bazë të klasifikimit të partive politike, është klasifikimi i bërë nga Jean Blondel në vitin 1968; Giovani Sartori bazohet në konceptin e ‘relevancës’ që ka një parti politike; Numri i partive efektive parlamentare sipas instrumentit matës të Taagepera dhe Laakso; Pippa Norris konfirmon tezën e Duverger, që sistemet elektorale ndikojnë në konturimin e sistemeve partiake; Arend Lijphart riestoi modelin e Duverger, mbi marrëdhënien e sistemeve elektorale dhe numrit të partive politike në sistemt partiake etj.

Por le t’i trajtojmë më gjërësisht secilën nga instrumentet matëse të cituara më sipër dhe do të specifikojmë se cilën nga këto instrumenta matëse do të përdorim në këtë studim doktoral, që do të na mund të na ofrojë rezultatet e duhura.

Pippa Norris, studiuesja angleze e specializuar në shkencat politike, zbaton një klasifikim në disa nivele sipas një renditje bazuar në disa indikatorë (Ceka, “Tezë Doktorale” 2013: 85), si: 1. Numri i partive parlamentare (parti që kanë fituar të paktën një mandat në Kuvend); 2. Numri i gjithë partive me domethënie parlamentare (partitë të cilat kanë fituar mbi 3% të mandateve në Kuvend) 3. Numri i partive efektive parlamentare (të përllogaritura nrm instrumentit matës të Laakso e Taagepera). Norris, gjithashtu konfirmon tezën e Duverger, që sistemet e Shumicës Minimale kanë tendencë të prodhojnë sisteme dypartiake, ndërsa sistemet proporcionale kanë tendencë të prodhojnë sisteme

shumëpartiake. Pra, ekziston një lidhje ose ndikimi midis sistemeve elektorale dhe sistemeve partiake.

Gjithashtu, kemi instrumentin NEEP (Numrin Efektiv të Partive Parlamentare) sipas Taagepera dhe Laakso. Ky model klasifikues është shumë i përdorur sepse korrigjon problemet që mund të dalin nga përdorimi i sistemeve tjera klasifikuese. NEPP na tregon fragmentizimin e sistemit partiak, por jo peshën reale të partive politike në sistemin partiak. Markuu Laakso dhe Rein Taagepera (1979) krijuan indeksin e numrit të partive politike në sistem, ku ky indeks përlogaritet si më poshtë (Xhaferraj, “Tezë Doktorale” 2016: 47-48): $N = \frac{1}{\sum Si^2}$, ku indeksi Si është dhe proporcioni i vendeve për çdo parti.

$$\sum Si^2$$

Një prej klasifikimeve më të vjetra, është ai i bërë nga Jean Blondel (1969), i përdorur për të përshkruar sistemin partiak. Dhe në analizën e sistemit partiak përlogaritet numri i partive politike dhe forca e tyre relative. Si pasojë, autori dallon katër tipologji të sistemit partiak: 1) sistemi dy-partiak; 2) sistemi dy-parti e gjysëm; 3) sistemi multipartiak me një parti dominuese; 4) sistemi multipartiak pa asnjë parti dominuese. Në tabelën e mëposhtme kemi të specifikuar llojin e sistemit partiak me numrin e mandateve për partitë, si edhe Numrin Efektiv të Partive Parlamentare.

Tabela nr. 2: Klasifikimi i Jean Blondel 1968, 184 – 87.

Sistemi partiak	Numri mandateve për parti	NEP
Sistem dypartiak	55 – 45	2.0
Sistem dy parti e gjysëm	45 – 40 – 15	2.6
Sistem shumëpartiak me një parti dominante	45 – 20 – 15 – 10 – 10	3.5
Sistem shumëpartiak pa parti dominante	25 – 25 – 25 – 15 – 10	4.5

Në një sistem dypartiak, me dy parti të forta në mënyrë të barabartë, numri efektiv i partive është 2.0 (Lijpart, 1999: 66 – 67). Nëse njëra parti është më e fortë se tjetra (mandatet 70 dhe 30 %), NEP është 1.7. Jemi larguar nga sistemi dy-partiak i pastër në drejtim të sistemit njëpartiak. Me tri parti të barabarta, NEP është 3.0. Nëse njëra parti është më e dobët se dy të tjerat, NEP do jetë midis 2.0 dhe 3.0. Ndërsa në sistemin

partiak me dy parti e gjysmën, me tre parti që mbajnë 45-40-15% të vendeve parlamentare, NEP është shumë afër 2.5 - 2.6. Kur partitë nuk janë të barabarta në forcë, atëherë NEP do të jetë më i ulët se numri aktual. Dy shembuj të sistemeve shumëpartiake përmbajnë pesë parti secila, nëse ka një palë dominante, atëherë NEP është 3.5. Pa një parti dominante, kemi vende parlamentare të barabartë dhe NEP rritet në 4.5, në afërsi të numrit të parë të partive.

Arend Lijphart ritestoi modelin e Duverger, mbi marrëdhënien e sistemeve elektorale dhe numrit të partive politike në sistemet partiake, duke analizuar gjithsej 27 demokraci të konsoliduara nga viti 1945 - 1990. Sipas Lijphart (Ceka, “Tezë Doktorale” 2013: 83) duke përdorur modelin matës së Laakso dhe Taagepera, numri efektiv i partive politike në sistem është 2.0 në ato vende ku përdoren sisteme të familjes mazhoritare Shumicë Minimale, 2.8 në ato vende ku përdoren sisteme të familjes mazhoritare me dy raunde dhe 3.6 në ato vende ku përdoren sisteme të familjes proporcionale.

Gjithashtu, Lijphart ka studiuar 36 demokraci për një periudhë të gjatë kohore dhe në librin e tij “Patterns of Democracy. Government Forms and Performance in Thirty-Six Countries” (1999), ka përcaktuar gjashtë teori të koalicioneve qeverisëse.

Tabela Nr. 3: Gjashtë teoritë e koalicionit.

Partitë politike	A (Majtas)	B	C	D	E (Djathtas)
Mandatet parlamentare	8	21	26	12	33
Teoritë: 1. Koalicion minimal i fituar: $ABC=55$, $ADE=53$, $BCD=59$, $BE=54$, $CE=59$. 2. Koalicionet me madhësi minimale: $ADE = 53$. (4 hapësirë dhe mbulon të gjithë spektrin majtas-djathtas) 3. Koalicionet me numrin më të vogël të partive: $BE=54$, $CE=59$. 4. Koalicionet me varg minimal: $ABC=55$ (2 hapësirë), $BCD=59$ (2 hapësirë), $CE=59$ (2 hapësirë). 5. Koalicionet minimale fituese: $ABC=55$, $BCD=59$, $CDE=71$ 6. Koalicionet politike – praktike: $ABC=55$, $BCD=59$, $CE=59$.					

Kriteri themelor për përzgjedhjen e partive politike në sistemin partiak është fuqia ose potenciali i saj qeverisës dhe kërcënues. Sartori (2005) përdor konceptin e ‘relevancës’ si instrumentin e tij matës dhe bën lidhjen e relevancës së partisë me forcën elektorale. Me anë të forcës elektorale që fiton në zgjedhjet e përgjithshme, me potencialin që ka partia politike për të qeverisur vendin ose për të qenë në një koalicion qeveritar. Sartori (2015:

107-108) nënvizon faktin se *rëndësi në balancën e multipartizmit është se sa e nevojshme është një parti si partnere koalicioni për një ose më tepër të shumicave qeverisëse*. Një parti e vogël mund të ketë aftësi negociuese të mëdha për të qenë në një koalicion qeverisës, por ndodh që edhe një parti mund të jetë e madhe/fuqishme por i mungon potenciali negociues për të qenë në një koalicion.

Sartori argumenton se vetëm ato parti që llogariten si komponentë të sistemit partiak, janë parti të rëndësishme në aspektin për të pasur "potencial të koalicionit" ose "potencial për shantazh". Një parti është relevante kur ka potencial për koalicion ose për kërcënim, ka relevancë qeveritare (për të qenë në arenën e formimit të koalicionit qeverisës) ose konkurruese në arenën opozitare. Dhe për të dalë në përfundim, nëse një parti politike është relevante ose jo, atëherë duhet t'i referohemi mandateve parlamentare të fituara nga secila parti në zgjedhjet elektorale, si nga koalicionet e formuara dhe kabinetet qeveritare. Vetëm në këtë mënyrë do të shohim fuqinë e kërcënimit/shantazhit që ka një forcë politike.

Sartori, ofron një tipologji të sistemit partiak duke u përqendruar edhe në natyrën dhe drejtimin e konkurimit partiak, nëse është centripetal ose centrifugal. Nëse partitë politike synojnë të pushtojnë qendrën ideologjike të sistemit partiak ose të marrin pozicione ideologjike radikale e të lëvizin drejt ekstremeve. Për pasojë Sartori krijoi këtë tipologji: 1) sistem partiak i predominuar (një parti merr më shumë se 50% të vendeve); 2) sistem dy-partiak; 3) pluralizëm i moderuar (sistem multipartiak i fragmentuar në shkallë të moderuar me tendencë centripetale; 4) pluralizëm i polarizuar (sistem multipartiak i fragmentuar me tendencë centrifugale).

Dhe në përfundim, duke trajtuar gjërësisht instrumentat klasifikuese dhe duke u fokusuar edhe në gjetjet/rezultatet e këtij punimi, konkludojmë se në këtë punim doktoral rezultatet zgjedhore do t'i analizojmë duke përdorur teorinë e Arend Lijphart. Ku të gjitha rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme nga vitit 1991-2013 do të analizohen nga gjashtë teoritë e koalicione qeverisëse.

Në këtë mënyrë do të paraqesim një tablo të qartë të sistemeve elektorale dhe sistemeve partiake në Shqipëri pas viteve 1990-të. Mënyrat e renditjes së partive politike në sistem, na ndihmon të kuptojmë rëndësinë e këtyre partive në formën qeverisëse të vendit tonë. Në këtë studim do të analizojmë sipas vijës logjike sistemin elektoral, i cili në Shqipëri ka prodhuar sistem partiak të ndryshëm (partitë kryesore, kanë rëndësi të madhe në vendimmarrjen e vendit, të përkthyer në % më të lartë të mandateve parlamentare) dhe këto sisteme partiake kanë ndikuar në formën qeverisëse të vendit.

Sistemi zgjedhor, sistemi partiak dhe forma e qeverisjes

Sistemi elektoral është një element i rëndësishëm i sistemit politik, i cili është i lidhur me sistemin partiak (Bisha, 2010). Si rrjedhojë, sistemi zgjedhor mazhoritar favorizon dy partitë e mëdha që kanë mbështetje më të madhe të zgjedhësve, ku krijohet një shumicë njëpartiake në Parlament. Partia e vetme mund të krijojë kabinetin qeveritar dhe të zbatojë programin e saj elektoral. Dhe me sistemin proporcional, me përfshirjen e një numri të madh të partive politike në Parlament, krijohet mundësia e ndërtimit të koalicione me qëllim formimin e kabinetit qeveritar (qeverisje e gjerë mbi bazë koalicionesh) sepse vetëm një parti nuk mundet të krijojë qeverinë e vetme. Në varësi të mandateve që fiton një parti

politike, ato mund të formojnë më pas koalicione qeverisëse, të krijojnë një program qeverisës dhe gjithashtu të ushtrojnë e gëzojnë privilegjet e lidhura me pushtetin.

Partitë politike qëndrojnë në themel të sistemit të qeverisjes dhe sistemit politik të një vendi. Ndërsa, marrëdhëniet midis partive politike dhe shtetit ndryshojnë në varësi të modelit të sistemit politik që aplikohet në vend. Mund të ekzistojë një marrëdhënie bashkëpunimi të ndërsjelltë ose marrëdhëniet të ndara. Në modelin klasik të ndarjes së pushtetit, bëhet një ndarje e qartë mes ekzekutivit (qeverisë) dhe legjislativit (parlamentit). Në praktikë ky model funksionon në kuptimin e gërshetimit ose të ndarjeve të detyrave midis këtyre dy organeve (Konrad Adenauer Stiftung, “Partitë Politike”). Vlen të theksohet për sistemet parlamentare, ku ekzekutivi varet më shumë në ndihmën e parlamentit.

Kemi ekzistencën e një lidhje të ngushtë midis sistemit partiak dhe llojit qeverisës. Nëse numri i partive efektive parlamentare rritet, atëherë mundësia e kabinetit minimal një-partiak ulet. Marrëdhënia e fortë midis sistemeve partiake dhe llojit të kabinetit është pjesë e një grupi prej pesë variablave të lidhura ngushtë, që përbëjnë dimensionin e drejtuesit të partive në kundërshtim midis demokracisë mazhoritare dhe konsensusit. Tre variablat e tjera, sipas Lijpart (1999) janë marrëdhëniet mes ekzekutivit dhe legjislativit, sistemet zgjedhore dhe grupet e interesit. Kjo analizë, sipas autorit, tregon një marrëdhënie të fortë empirike, jo aq i fortë si lidhja e ngushtë midis sistemeve partiake dhe kabinete qeverisëse.

Kemi një neglizhencë nga shkencëtarët socialë të trajtimit të sistemeve elektorale edhe se rregullat zgjedhore kanë efekte të rëndësishme në elementë të tjerë të sistemit politik, sidomos të sistemit partiak. Të cilat ofrojnë një instrument praktik për shkencëtarët e politikës, që dëshirojnë për të bërë ndryshime në sistemin politik. Sartori i karakterizon

sistemet elektorale si "instrumenti më specifik manipulues i politikës" (Lijphart dhe Grohman, 2003: 2).

Për shembull, variablat e pavarura të analizuara nga Rae, si struktura e votimit, lloji i zgjedhjeve, numri i përfaqësuesve që zgjidhen në çdo rreth dhe numri i përgjithshëm i përfaqësuesve në legjislaturë, janë vetëm një inventar i pjesshëm i atyre që mund të kenë një ndikimin kritik. Dhe variablat kryesore të varura, si proporcionaliteti i përfaqësimit të partisë dhe krijimin e shumicave legjislative, ndërsa ndër elementet më të rëndësishme të një analize të duhur të ligjeve zgjedhore dhe pasojat e tyre politike, ka një numër të madh konceptesh. Kjo pasqyrë mbulon rikonstruksionet kryesore doktrinare që kanë zbuluar e analizuar gjithashtu, lidhjen e ndërsjellë që ekziston mes sistemit zgjedhor, sistemit partiak dhe formës së qeverisjes, sidomos në qeverisjen parlamentare (Duverger, M; Elia, L; Luciano, M). Në përgjithësi, rezulton se partitë politike edhe në konfigurimin e tyre të veçantë, janë faktori kryesor për racionalizimin e formën e qeverisjes.

Partitë fitojnë rëndësi ligjore nëpërmjet prodhimit të normave konvencionale që kontribuojnë për të integruar disiplinën në formën e qeverisjes (Cosi, 2012: 4). Ndryshe nga udhëzimet e mëparshme doktrinare, që përfshinin partitë politike në strukturën e formës së qeverisjes, doktrina e tanishme përfshin partitë politike në elementet kushtetuese. Në elementet përbërse të formës së qeverisjes përfshihet sistemi zgjedhor, i cili ka të bëjë me një kompleks rregullash të një rëndësie themelore se rregullon vendosjen e përfaqësimit politik (Luciani, 2014: 565).

Pavarësisht nga kjo, edhe nga vendosjet doktrimore, arrihet në përfundimin, si në doktrinën kushtetuese dhe në shkencën politike, pranohet njohja thelbësore e natyrës së partive politike dhe të sistemit zgjedhor në format e qeverisjes të një vendi. Sistemi partiak,

sistemi zgjedhor dhe forma e qeverisjes janë reciprokisht të ndërlidhura, kështu që studimi i një nga elementët e këtij raporti nuk mund të ndahet nga vlerësimi i tjetrit.

2.4 Teoria e Ndikimit të sistemit elektoral në formën qeverisëse të Arend Lijphart

Nga variablat kryesore që karakterizojnë dallimin në mes formave të shumicës dhe konsensusit të demokracisë, kemi të bëjmë me gjerësinë e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të popullit në degën ekzekutive të qeverisë. Ky variabël mund të konsiderohet si variabli më tipik midis dy formave mazhoritar-konsensusit, ku në formën e parë kemi një qeverisje me shumicë një-partiake dhe në formën e dytë, koalicione të gjëra shumëpartiake. Del kontrasti midis parimit të shumicës së përqëndrimit të pushtetit në duart e shumicës dhe parimit të konsensusit të gjerë në ndarjen e pushtetit. Nga këto forma qeverisëse lindin kabinetet qeveritare dhe si rrjedhojë, kemi dy forma të kabineteve.

Kabinetet e shumicës njëpartiake dhe koalicionet e gjëra shumëpartiak të cilat ndryshojnë në dy aspekte: kabineti është i përbërë nga një parti ose një koalicion partish dhe përse i përket llojit të mbështetjes parlamentare që kabineti ka. Përse i përket bazës së mbështetjes është përqëndruar në klasifikimin e standartit të trefishtë në teori të koalicionit (Lijphart, 1999: 79-80): (1) Kabinete minimale të fituar, të cilat janë "fituese" në kuptimin se partia ose partitë në kabinet kontrollojnë shumicën e vendeve në parlament. Por "minimale" në kuptimin se kabineti nuk përfshin asnjë parti që nuk është e nevojshme për të arritur një shumicë parlamentare. (2) Kabinete të tepërta, të cilat përmbajnë më shumë parti se sa janë të nevojshme për mbështetjen e shumicës në legjislaturë, dhe (3) Minoritete ose kabinet "i vogël", të cilat nuk janë të mbështetura nga një shumicë parlamentare.

Lloji më mazhoritar i kabinetit është një-parti e vetme dhe fituese minimale është një kabinet shumice njëpartiake. Lloji më konsensual i kabinetit është shumëpartiak dhe i tepërt. Ka dy lloje të kabineteve në pozicion të ndërmjetëm, si kabinete shumëpartiake minimale të fituar dhe kabinete një-partiake të minoriteteve.

Gjithashtu, sipas shkencëtarëve ekzistojnë edhe tre dallime thelbësore midis sistemit presidencial dhe parlamentar. Së pari, ndarja e pushtetit në sistemet presidenciale merret në kuptimin e pavarësisë së ndërsjellë midis ekzekutivit dhe legjislativit, por edhe si rregull i njëjti person nuk mund të shërbejë njëkohësisht në të dyja pozicionet. Së dyti, presidentët nuk kanë të drejtë për të shpërndarë legjislaturën, ndërsa kryeministrat e kabinetet të tyre e kanë këtë të drejtë (Lijpart, 1999: 124-126). Së treti, sistemet parlamentare zakonisht kanë drejtuesit të dyfishtë, si një simbolik/ceremonial si kokë shteti (monark/president), i cili ka pak pushtet dhe një kryeministër, i cili është kreu i qeverisë dhe së bashku me kabinetin e tij ushtrojnë fuqinë ekzekutive.

Sistemet presidenciale mund të ketë një efekt të tërthortë, por të rëndësishëm në numrin efektiv të partive parlamentare (Lijpart, 1999: 155). Për arsye, se presidenti është çmimi më i lartë politik për të fituar dhe vetëm partitë më të mëdha e kanë mundësinë për t'a fituar atë. Si rrjedhojë, këto parti të mëdha kanë një avantazh të konsiderueshëm mbi partitë më të vogla. Në demokracitë presidenciale, zgjedhja e presidentit është po aq e rëndësishme sa zgjedhjet legislative, pothuajse e njëjta rëndësi si në sistemet me balance midis ekzekutivit dhe legjislativit.

Ndërsa në sistemet parlamentare të qeverisjes, kabinetet që të formohen duhet të gëzojnë besueshmëri ose të tolerohen nga një shumicë parlamentare. Por, a mund të parashikohet se cili kabinet do të formohet duke ditur pikat e forta të partive parlamentare?

Nëse një parti ka shumicën e vendeve parlamentare, atëherë parashikohet formimi i një kabinet njëpartiak, por gjithashtu është e mundur që shumica të formojë koalicion me një ose më shumë parti të pakicës.

Nëse asnjë parti nuk ka një shumicë parlamentare, nëse nuk mund të formohet një kabinet i pakicës një-partiake, atëherë një qeveri koalicioni do të formohet. Por cili koalicion është më i mundshëm? Disa teori janë propozuar për të parashikuar se cilat koalicione do të formohen në sistemet parlamentare dhe gjashtë janë teoritë më të rëndësishme e teorive të koalicionit, të cilat parashikojnë si më poshtë llojet e koalicioneve. Teoritë e koalicionit janë parashikues të dobët të llojeve të kabineteve që janë formuar në demokracitë. Një arsye është se ato janë bazuar pothuajse në supozime të shumicës, si edhe e kanë tendencë të injorojnë karakteristikat institucionale që nxisin formimin e pakicës dhe të kabineteve të tepërta.

Autori ka studjuar marrëdhënien mes llojeve të kabineteve dhe numrit efektiv të partive në 36 demokraci. Në qoftë se njëra parti ka shumicën e vende parlamentare, atëherë partia që ka shumicën ka gjasa të formojë një kabinet njëpartiak (cit. Lijpart, 1999:92 – 96):

1. Koalicion minimal i fituar, William H. Riker's (1962, 32–46) “parimi i madhësisë” / “size principle”, parashikon se koalicionet minimale fituese do të formohen me koalicion fitues (shumicë), në të cilën vetëm ato parti pjesëmarrëse që janë minimalisht të nevojshme për t’i dhënë kabinet statusin e shumicës. Supozimi themelor i teorisë koalicionit minimal fitues është se *partitë politike janë interesuar për maksimizimin e pushtetit të tyre*. Në sistemet parlamentare, pushtet do të thotë pjesëmarrje në kabinet/qeveri dhe fuqia maksimale do të thotë mbajtjen sa më shumë të pozicioneve të kabinetit që të jetë e mundur. Për të hyrë në kabinet, një parti pakicë do të duhet të bashkohet me një ose më

shumë parti tjera, por ajo do të rezistojë përfshirjen e partive të panevojshme në koalicion sepse kjo do të zvogëlojë pjesën e saj të kabineteve ministrore në qeveri.

Për shembull, në kabinetin e koalicionit të CE, në tabelën e mëposhtme, partia C kontribuon pothuajse gjysmën e mbështetjes parlamentare dhe kështu ka të ngjarë të marri pothuajse gjysmën e emërimeve ministrore. Nëse partia B shtohet në koalicion, atëherë pjesa e pozicioneve të partisë C-së në kabinet do të jetë vetëm një e treta. Vetëm kur ka një parti shumicë në parlament mund të kemi një koalicion minimal fitues, teori që ka të bëjë me një parashikim të vetëm të veçantë: kabinet njëpartiak ose kabineti formuar nga partia e shumicës. Kur nuk ka parti shumicë, teoria gjithmonë parashikon më shumë se një rezultat dhe në shembullin e tabelës së mëposhtme janë parashikuar pesë koalicione.

Koalicion minimal i fituar: $\underline{ABC}=55$, $ADE=53$, $BCD=59$, $BE=54$, $CE=59$.

2. Koalicionet me madhësi minimale. Madhësia minimale është bazuar në të njëjtën supozim të maksimizimit, si fitues minimal në teorinë e koalicionit. Nëse partitë politike duan të përjashtojë partnerët partiak të panevojshëm nga një kabinet koalicioni dhe për të maksimizuar pjesën e tyre të pushtetit qeverisës, ata gjithashtu duhet të priten që të preferojnë kabinetin që do të bazohet në pjesën më të ngushtë të mundshme parlamentare.

Për shembull, është më e dobishme për partinë E për të formuar koalicionin me partitë ADE që ka 53 vende parlamentare, sesa koalicioni CE me 59 vende. Në të parën, partia E ka 33 vende në parlament dhe në këtë mënyrë kontribuon me 62 % të mbështetjes parlamentare të kabinetit, ndërsa në koalicionin e fundit vetëm me 56 % të mbështetjes parlamentare. Në një kabinet me njëzet ministra, kjo diferencë është lehtësisht me vlerë një shtesë ministror për partinë E. Koalicioni ADE me 53 vendeve është parashikuar më tepër se katër koalicionet e tjera fituese minimale, madhësia e varion nga 54 te 59 vende.

Koalicionet me madhësi minimale: $ADE = 53$. (4 hapësirë dhe mbulon të gjithë spektrin majtas-djathtas)

3. Koalicionet me numrin më të vogël të partive. Këto koalicione do të prirën për të formuar qeverinë që përfshin numrin më të vogël të mundshëm të partive se "negociatat në lidhje me formimin e një koalicioni janë më të lehta për të përfunduar dhe një koalicion i tillë është më i lehtë për t'u mbajtur, gjëra të tjera bëhen të barabartë, me më pak parti".

Kriter tjetër për të zgjedhur midis koalicioneve të parashikuara është koalicioni me numrin më të vogël të partive, teoria e Michael Leiserson (1970, 90) "bisedime propozimet". Ai argumenton se këto koalicione minimale fitues do të prirën për të formuar kabinetin duke përfshirë numrin më të vogël të mundshëm të partive sepse negociatat dhe marrëveshjet në lidhje me formimin e një koalicioni janë më të lehtë me më pak parti. Nga pesë koalicionet minimale fituese në tabelën e mëposhtme, pazar-propozimet parashikojnë që koalicionet BE ose CE do të formohen se përfshijnë vetëm dy parti dhe jo një prej koalicioneve që përbëhen nga tre parti politike të pakicës.

Koalicionet me numrin më të vogël të partive: $BE=54$, $CE=59$.

4. Koalicionet me varg minimal. Teoria bazohet te madhësia dhe numri i partive politike, por injorojnë programet e tyre dhe preferencat politike. Teoria bën supozimin se është më e lehtë për të formuar dhe për të ruajtur koalicionet midis partive me politikë të ngjashme, se në mesin e partive që janë shumë larg në këtë drejtim.

Disa nga versionet të kësaj teorie, në tabelën e mëposhtme paraqiten më themeloret: partitë janë vendosur në një shkallë nga e majta në të djathtë, me partinë A në ekstremin e majtë dhe partinë E në të djathtën ekstreme dhe distanca në mes tyre janë matur

në aspektin e numrit të "hapësira" të cilat i ndan ato. Pesë koalicionet minimale fituese shkojnë në dy, tre dhe katër "hapësira". Nëse partitë kërkojnë të formojnë një koalicion me partnerët e të njëjtit mendim, koalicioni ABC, me një gamë të dy "hapësira" është me shumë gjasa se koalicioni ADE, me një gamë të katër "hapësirave" dhe që mbulon të gjithë spektrin e majtë-djathtë. Teoria e koalicionet me varg minimal gjithashtu parashikon koalicionet BCD dhe CE, të cilat kanë të njëjtën gamë minimale të dy "hapësira" si ABC. Koalicionet me varg minimal: ABC=55 (2 hapësirë), BCD=59 (2 hapësirë), CE=59 (2 hapësirë).

5. Koalicionet minimale fituese. Koalicionet do të formohen nga dy partitë që janë të "lidhur", pra, nga partitë që janë ngjitur në politikë dhe pa partnerë të panevojshme. Supozimi themelor i kësaj teorie është se palët do të përpiqen për tu rritur së bashku me fqinjët e tyre të menjëhershëm dhe palët e tjera fqinje do të të shtohen, deri në formimin e një koalicioni të shumicës. Kjo teori është propozuar nga Robert Axelrod (1970, 165-87). Sipas teorisë së fundit, koalicioni CDE përmban një partner të tepërt, partinë D, por në teorinë e Axelrod-së, partia e D është e nevojshme për të bërë një koalicion të lidhur. Koalicionet minimale fituese: ABC=55, BCD=59, CDE=71

6. Koalicionet politike-praktike, është një koalicion i qëndrueshëm. Fokusi mbi preferencat politike e partive është marrë për përfundimin e saj përfundimtar nga Teoria e koalicionit të politikë-praktikë. Në qoftë se ne supozojmë se partitë me të vërtetë kujdesen vetëm në lidhje me politikën, në vend të mbajtjes së detyrës, pushteti i vërtetë është te legjislatura, ku politikat e mëdha duhen miratuar. Në legjislaturë është "thelbësore" partia që është me rëndësi të madhe; partia kryesore është partia që në një shkallë politike dimensionale, si shkallë e majtë-djathtë, përmban anëtar mesatare të parlamentit. Kjo do të

thotë se, në kushtet strikte të politikës, kjo është krejtësisht e parëndësishme se sa dhe cilat parti do të marrin pjesë në kabinetin qeveritar.

Laver dhe Schofield (1990, 55) pranojnë se duhet të bëhet një dallim midis pyetjeve të politikave të mëdha dhe çështjeve më të hollësishme të politikës. Për të ndikuar në çështjet e hollësishme të politikës, mund të jetë mjaft i rëndësishëm pas të gjithave të jenë në kabinet dhe në krye të një departamenti ministror. Dhe kjo konsideratë "mund të ofrojë një nxitje të fortë për partitë që nuk janë të interesuara aspak për shpërblimet e brendshme të zyrës megjithatë për një vend në tryezën e kabinetit". Rëndësia se cila parti mban cilin portofol në kabinet, është theksuar edhe në punën e Michael Laver dhe Kenneth A. Shepsle (1996).

Koalicionet politike – praktike: ABC=55, BCD=59, CE=59.

Implikimi është se partitë janë me sa duket të interesuara për sa më shumë vende të kabinetit dhe portofole ministrore të jetë e mundur, e cila na kthen prapa në logjikën e koalicioneve minimale fituese, me kushtin që parti të rëndësishme të përfshihen në koalicione të tilla, koalicionet ABC, BCD, CE. Në analizën e fundit, teoria e Koalicionet politike-praktike nuk bën asnjë parashikim në lidhje me përbërjen e kabineteve ose parashikon koalicione minimale fituese të ngjashme me ato të parashikuara nga teoria me varg minimal. Siç e theksuam dhe më sipër, Laver dhe Schofield (1990, 88), për formimin e kabineteve të politika-praktike "ajo nuk ka [as] rëndësi nëse janë ose jo parti të rëndësishme".

Tabela Nr.4: Gjashtë teoritë e koalicionit.

Partitë politike	A (Majtas)	B	C	D	E (Djathtas)
Mandatet parlamentare	8	21	26	12	33
Teoritë: 1. Koalicion minimal i fituar: <u>ABC</u> =55, ADE=53, BCD=59, BE=54, CE=59.					

2. Koalicionet me madhësi minimale: $ADE = 53$. (4 hapësirë dhe mbulon të gjithë spektrin majtas-djathtas)
3. Koalicionet me numrin më të vogël të partive: $BE=54$, $CE=59$.
4. Koalicionet me varg minimal: $ABC=55$ (2 hapësirë), $BCD=59$ (2 hapësirë), $CE=59$ (2 hapësirë).
5. Koalicionet minimale fituese: $ABC=55$, $BCD=59$, $CDE=71$
6. Koalicionet politike – praktike: $ABC=55$, $BCD=59$, $CE=59$.

Nga gjashtë teoritë e koalicionit, politikat e bazuara kanë qenë në gjendje të parashikojnë koalicionet aktuale të qeverisë më të suksesshme se sa teoritë e politikave të verbëra (de Sèaan 1973). Por ndikim ka caktimi i pozicioneve të partive në shkallën e majtë-djathtë, e cila mund të përfshijë një arsytim rrethorë. Kur një parti qëndron në çështjet e majtë-djathtë mund të nxirret nga programi i saj formal edhe votat e tij në parlament. Ka mundësi të ndikohen nga fakti nëse partia është ose ka qenë anëtar i qeverisë dhe me të cilën ka formuar një koalicion me parti tjera.

Problemi themelor i të gjitha teorive është se ata parashikojnë koalicione fituese minimale të një lloji ose një tjetër. Teoria e Axelrod është vetëm një përjashtim i pjesshëm për shkak se, disa nga koalicionet minimale fituese të lidhura janë më të mëdha se sa fituesit minimale. Parashikimi i fituesit minimal është i bazuar në një supozim të shumicës dhe kjo është në konflikt me një numër të madh të minoritetit aktual dhe koalicioneve të tepërt që janë formuar në demokracitë parlamentare. Siç trajtohet më sipër, kur një parti ka një shumicë të mandateve parlamentare është e lehtë dhe parashikimi i saj është i saktë, ku më pas formohet një kabinet i shumicës një-partiake.

KAPITULLI III: KUADRI TEORIK

Format e qeverisjes dhe modelet teorike

Në këtë kapitull teorik do të trajtojmë në mënyrë të hollësishme format e qeverisjes në një regjim demokratik. Do të analizojmë formën parlamentare të qeverisjes, si Republikën parlamentare me tendencë mazhoritare, rasti i Britanisë së Madhe, ku Parlamenti për herë të parë ka lindur si institucion politik. Do të trajtojmë Republikën parlamentare me tendencë proporcionale, rasti i Italisë. Republikën presidenciale (Rasti i ShBA-së) dhe Republikën gjysmëpresidenciale (Rasti i Francës). Në fund të këtij kapitulli do të nënvizojmë dallimet midis republikës parlamentare dhe presidenciale, si edhe do të kemi të qartë marrëdhënien midis pushtetit ekzekutiv-legjislativ në format qeverisëse të trajtuara në këtë kapitull.

Për t'i dhënë përgjigje pyetjes kërkimore të këtij dizertacioni, si edhe për të kuptuar si ka ndikuar sistemi elektoral në formën qeverisëse në vendin tonë, është e domosdoshme të kemi njohuri dhe të njohim modelet teorike të formave të ndryshme të qeverisjes. Atëherë në këtë kapitull do të trajtojmë problematika/çështje të ndryshme, si: *Si ka ndikuar sistemi mazhoritar në konturimin e një kabineti njëpariak? Si ka ndikuar sistemi proporcional në konturimin e një kabineti të gjërë? Pra, Si ka ndikuar sistemi zgjedhor në formimin e kabineteve qeveritare?*

Duke pasur një tablo të qartë rreth formave qeverisëse, në kapitujt e mëposhtëm pasi do të kemi trajtuar gjërësisht sistemet elektorale të aplikuara ndër vite në Shqipëri, do të japim një rekomandim për sistemin elektoral më të përshtatshëm për vendin tonë. Nëse duam një republikë parlamentare me një president me kompetenca të kufizuara apo një republikë

parlamentare me një president me kompetenca të gjëra, duke u bazuar edhe në shembujt e trajtuar në këtë kapitull.

3.1 Forma e Shtetit / Qeverisjes

Shprehja "forma e shtetit" tregon llojin e marrëdhënieve që ekzistojnë midis të qeverisurve dhe të qeverisurit, ose marrëdhëniet që janë vendosur midis autoritetit e lirisë. Si rrjedhojë, lloje të ndryshme të formave të shtetit varen nga mënyra në të cilën janë vendosur këto marrëdhënie. Forma e shtetit është e përcaktuar në bazë të objektivave që shteti ndjek, për vlerat që frymëzohet, të drejtat dhe, si ehe nga shkalla e pjesëmarrjes politike të qeverisjes (shtetit absolut, liberale, shtetit të së drejtës, totalitar / autoritare, socialist dhe social).

Me kalim e shekujve, kemi një rindërtim doktrinar të konceptit "forma e qeverisjes", ku sot diskutohet për "formën e qeverisë". Ky term i referohet tërësisë së rregullave ligjore, që rregullojnë ndarjen e funksioneve dhe kompetencave midis organeve më të larta kushtetuese të qeverisë. Pra, përshkruan marrëdhëniet që janë të vendosura midis këtyre kompetencave dhe organeve kushtetuese që mbajnë fuqitë vendimmarrëse të natyrës politike në një shtet demokratik. Më poshtë, do të trajtojmë konceptet kryesore, si:

- *Forma e Shtetit*: nënkuptojmë mënyrën sesi është organizuar drejtimi i shtetit dhe si ushtrohet pushteti shtetëror (Shqipëria është Republikë).
- *Forma e sundimit*: përcaktohet nga mbajtësit e pushtetit shtetëror (Demokraci).
- *Forma e Qeverisjes*: përcaktohet nga kryetari i shtetit (Demokraci parlamentare).
- *Sistemi i qeverisjes*: përcaktohet nga organet kushtetuese veçanërisht Parlament / Qeveri (Republikë parlamentare).

Në tabelat e mëposhtme janë dhënë klasifikimet për formën e shtetit nga Aristoteli dhe Montesquieu, si edhe në mënyrë të përmbledhur tregohet mënyra e udhëheqjes së pushtetit. Në varësi të faktit nëse fuqia i përket një, disave ose shumë individëve, doktrina klasike ka identifikuar tri forma qeverisjeje: monarkisë, aristokraci dhe demokraci.

Tabela nr. 5: Forma klasike e Shtetit sipas Aristotelit.

Nr. pushtetit mbajtësve	Forma pozitive	Shndërrime në forma të tjera
Një	Monarki	Tirani
Disa / Pakicë	Aristokraci	Oligarki
Populli	Demokraci	Politia

Tabela nr. 6: Forma e Shtetit sipas Montesquieu.

Nr. pushtetit mbajtësve	Parimi Etik	Forma e Shtetit	Shndërrime në forma të tjera
Një	Nderi (Honneur)	Monarki	Despotizëm
Disa	Moderimi (Moderation)	Aristokraci	Despotizëm
Populli	Virtyti (Virtu)	Demokraci	Despotizëm

Ekzistojnë disa forma të ndryshme të qeverisjes, të përcaktuara nga studiues të ndryshëm dhe sipas Laura Lewis (“Format e Qeverisjes”, datë 17.01.2014) ekzistojnë pesë forma kryesore të qeverisjes, si Monarki dhe diktaturë (sundon një individ), Oligarki (sundojnë disa), Anarki (nuk sundon askush), Demokraci (sundon shumica), Republikë (sundon ligji) dhe Meritokraci (sundon aftësia individuale).

Përsa i përket (1) formës së sundimit, sipas Artës (Vorpsi, A. (2013) “Shteti”), kemi këtë ndarje: Demokraci (sundon populli), Aristokracia (sundon shtresa fisnike), Teokraci (sundon shtresa e klerikëve). (2) Nga forma e qeverisjes, kemi: Demokraci parlamentare (pushteti rrjedh nga parlamenti), Monarki parlamentare (monarku ka më pak kompetenca se në monarkitë kushtetuese), Demokraci direkte (pushteti rrjedh nga populli). (3) Nga sistemi i qeverisjes, kemi ndarjen, si Republikë presidenciale (kryetari shtetit ka kompetenca të gjithanshme e të forta), Republikë gjysmë-presidenciale (kryetari shtetit ka kompetenca të kufizuara) dhe Republikë parlamentare (parlamenti dhe qeveria drejtojnë shtetin).

Le të trajtojmë më gjërësisht termat ‘qeveri’ e ‘qeverisje’ dhe dallimin midis tyre. Qeverisja ka një kuptim më të gjerë se qeveria, ajo shtrihet në disa degëzime të cilat ‘janë të pranishme në të gjitha sistemet’ politike. Ekzistojnë përkufizime të ndryshme të qeverisjes dhe sipas Lerner, me qeverisje nënkupton *“efektin në objektin, i cili e përmirëson funksionimin ose zhvillimin e tij dhe i cili është zgjidhur nga një numër më i madh efektesh të mundshme, në bazë të informacioneve që janë në dispozicion”*.

Lerner e përkufizon si një *“proces i cili e bën të mundshëm që ai objekt (sistem) të ruhet, me gjithë ndryshimet e vazhdueshme të kushteve, ndikimeve të jashtme e të ngjashme”* sepse mjedisi ka ndikim në sistem. Ndërsa e kundërta ndodh me qeverisjen, ku ajo *“i’u kundërvihet ndikimeve destruktive të mjedisit, ruan ose shton organizimin, siguron funksionimin dhe zhvillimin e sistemit ose riprodhimin e tij, megjithëse mjedisi në të cilin ekziston dhe ndikimet e tij ndryshojnë”*.

Qeverisja në një përcaktim më të përgjithshëm, është agjencia përmes së cilës formulohen e realizohen veprimet dhe funksionet e saj, në kuadrin e një komb-shteti të caktuar dhe të marrëdhënieve me komb-shtetet e tjera (Filo, 2007: 17). Qeveria (ose qeverisja) sintetizon institucionet, ku shoqëria aplikon politikat e saj publike. Ekzistojnë katër pushtete, pushteti ekzekutiv (administron ligjet e miratuara), pushteti legjislativ (harton ligje dhe projekton politikat publike), pushteti juridik (interpreton ligjet dhe zgjidh kontraditat midis institucioneve e individëve) dhe media. Në bazë të raportit të katër pushteteve, kemi edhe forma të ndryshme të qeverisjes, si qeverisja diktatoriale (një individ i vetëm mban dhe ushtron gjithë pushtetin) dhe qeverisja demokratike (pushtetet ushtrohen nga përfaqësuesit e zgjedhur).

Në kohët moderne, qeverisja ka marrë një tjetër kuptim dhe konceptohet si pjesë e sistemit politik të qeverisjes. Ekzistojnë lidhjet midis qeverisjes dhe politikave, qeverisë e organizmave jashtë qeverisë, siç janë partitë politike, grupimet politike, grupet e interesit dhe presionit etj. Pra, me qeverisje nënkuptohet shteti bashkë me tërë këto komponentët, por edhe me institucionet shtetërore, si drejtësia, policia, partitë politike, organizat fetare dhe grupet e ndryshme jashtë qeverisë.

Termi “qeveria” sipas Didier Maus, ekspertit të së drejtës kushtetuese, i referohet grupit të njerëzve, që qëllimi kryesor është të sigurojnë të ardhmen e një shoqërie politike. Sipas këtij përcaktimi, kemi dy dallime të rëndësishme sipas autorit: *Dallimi i parë*, ka të bëjë me origjinën e qeverisë dhe mënyrën se si titullarët e marrin detyrën. Ekzistojnë disa mënyra të marrjes së funksionit qeverisës, me anë të legjitimitetit teokratik, trashëgimisë së dinastive ose nëpërmjet një procesi partizan (në vendet me një parti të vetme) ose nëpërmjet zgjedhjeve të hapura dhe pluraliste, ku shumica garojnë për marrjen e pushtetit.

Dallimi i dytë, sipas Didier, konsiston në regjimet ku qeveritë krijohen përmes zgjedhjeve të përgjithshme, si sistemet presidenciale dhe sistemet parlamentare. Në rastin e parë, modeli është SHBA, ku ka një paqartësi midis funksionit të kreut të Shtetit dhe funksionit të drejtuesit të Qeverisë, ku ekipi qeverisës konsiderohet përgjegjës vetëm para Parlamentit. Në rastin e dytë, modeli është Britania, ekipi qeverisës dallohet nga kreu i Shtetit (monark/president). Qeveria mund të funksionojë për aq kohë sa gëzon besimin e Parlamentit ose Dhomës së zgjedhur me votim të drejtpërdrejtë. Ekzistenca e kësaj lidhjeje të besimit politik midis Parlamentit dhe Qeverisë përbën kriterin më të rëndësishëm për të dalluar këtë formë të organizimit politik nga të tjerat.

3.2 Format e qeverisjes

Në teorinë politiko-ligjore, një shtet është një institucion që legjitimon një qeverisje të veçantë. Kushtetuta e vendeve të ndryshme kodifikojnë pikëpamje, fuqi dhe forma përkatëse të qeverisjes (Meidani, R. 2009: 26). Mendimtari i Kinës antike, Konfuci (1996: 97), e përcaktonte qeverinë si drejtësi, e cila kishte prirje për barazi. Sipas tij, “të qeverisësh do të thotë të bësh gjithçka në mënyrë korrekte”. Ndërsa Rusoi (Jean-Jacques Rousseau) me anë të kontratës sociale, nënkuptonte se populli i kalon disa të drejta qeverisë me qëllimin e vetëm për krijimin dhe ruajtjen e rendit social. Rusoi (1998: 138), lirinë e shihte të mundur vetëm kur qeverisja ishte e drejtëpërdrejtë nga populli. Shteti sipas tij mbijeton me anë të pushtetit legjislativ dhe jo me anë të ligjeve.

Ndërsa Monteskje përcaktonte tre lloj qeverisjeje (2000: 40), si qeverisja republikane, monarkiste dhe despotike. Në qeverisjen republikane, populli ose një pjesë e tij vishet me sovranitetin e plotë; në qeverisjen monarkiste, një individ i vetëm qeveris të gjithë sistemin politik nëpërmjet ligjeve; dhe në qeverisjen despotike, një njeri i vetëm pa u bazuar në ligje, tërheq pas vetes gjithçka sipas dëshirës së tij. Ndërsa qeverisja, si formë/koncept, përfshin tre pushtete, si pushtetin legjislativ (miraton ligjet), ekzekutiv (zbaton ligjet) dhe juridik (interpretin ligjet). Tre pushtetet i shohim në çdo qeverisje, por mund të ndryshojë natyra e funksionimit të tyre.

Natyra e funksionimit të tre pushteteve është kriter në përcaktimin e llojit të qeverisjes, ku mund të kemi qeverisje demokratike-liberale ose qeverisje autoritare, totalitare dhe monarkike. Filo (2007: 17) nënvizon, se shkalla e ndërveprimit të këtyre tre pushteteve (kontrolli ose kufizimi) përcakton tipat e vetëqeverisjes së demokracisë liberale në qeverisje parlamentare, presidenciale dhe gjysmë-presidenciale. Kriter tjetër sipas autorit

është marrëdhënia midis pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv, të cilat përcaktojnë modelet uestminster dhe consensus. Si rrjedhojë, qeverisja paraqitet edhe trajtohet si një qeverisje federale dhe unitare, e cila ka lidhje me ushtrimin territorial të qeverisjes së një vendi.

Ndarja e fuqisë në tre pushtete bëhet sipas Monteskjës (2000: 223) për të pasur liri dhe mbrojtje ndaj abuzimit të pushtetit. Dhe ndërvarësia midis pushteteve duhet të jetë në atë formë, ku asnjë nga pushtetet e tjera mos të ketë mundësi mbi pushtetet e tjera. Në shumicën e shteteve me kushtetutë demokratike përfshihet parimi i ndarjes së pushteteve, kjo në efekt për të ndaluar shumicën që të realizojë një qeverisje ose një sundim absolut, ku mund të ketë edhe forma dhune. Monteskjë pushtetin juridik e quan pushtet të gjykuarit, ndërsa pushtetin ekzekutiv e sheh në kontekstin e pushtet ekzekutiv të shtetit dhe kur në të njëjtin person ose trup magjistrature, pushteti ligjvënës i bashkangjitet pushteti ekzekutiv, atëherë për të liria nuk ekziston më.

Ndërsa Krik (1994: 43) argumenton, se nëse duam t'i japim qeverisjes demokratike kuptimin më të bukur, nëse vlerësojmë lirinë, opozitën, të drejtën për të diskutuar, për të përzgjedhur qeverinë popullore, ajo përsëri është një formë politike. Ndërsa Robert Dahl në studimin e tij “Who Governs? Democracy and power in on American City” dhe Keith Boulding “In Three Faces of Power”, përcaktojnë tre përmasa të realizimit të pushtetit, si pushteti si vendimmarrje, pushteti nëpërmjet kontrollit dhe pushteti i kufizuar në shtrimin e axhendës, që shprehet si mos marrje e vendimeve.

Me anë të këtyre përcaktimeve të qeverisjes, dalin edhe përgjegjësitë e qeverisjes në tre format e saj (Filo, Ll. 2007: 35), si: 1- përgjegjshmërinë ligjore, qeverisje nëpërmjet ligjit, ku sundon ligji dhe të gjithë janë të barabartë përpara ligjit; 2- përgjegjshmëri politike, ku të qeverisurit kanë dhënë pëlqimin e tyre për realizimin e programeve partiake;

dhe 3-përgjegjshmëri financiare, pushteti mbahet nga të ardhurat që vijnë nga taksapaguesit. Sundimi i ligjit, pra qeverisja e së drejtës nënkupton epërsinë e ligjit ndaj qytetarëve dhe ndaj vetë shtetit si autorë të tij (Lijphart, 1999: 51).

Meidani bën një klasifikim të qeverisjes (2009: 52): 1. Sipas organizimit politik, federal ose unitar; 2. Organizimit ekonomik, kapitalist, socialist ose me ekonomi përzier; 3. Përqëndrimit ose shpërndarjes së fuqisë, demokratike (përfaqësuese/drejtëpërdrejtë), totalitare ose autoritare; 4. Tipi i qeverisjes, forma monarkike ose republikane, sistem presidencial, gjysmëpresidencial ose parlamentar. Sistemi i një vendi është një strukturë ku pjesët e saj janë të ndërthurura me njëra-tjetrën dhe ndryshimi i njëres sjell ndryshimin e gjithë pjesëve tjera të sistemit. Kur sistemi ka të bëjë me çështje të natyrës politike quhet sistem politik. Dallojmë disa organizime të ndryshme të sistemit politik pluralist, si monarkinë kushtetuese, republikë parlamentare, gjysmëpresidenciale dhe presidenciale.

Përsa i përket qeverisjes demokratike, nëse bazohemi tek pjesëmarrja, atëherë kemi demokraci të drejtëpërdrejtë dhe përfaqësuese (Meidani, 2009: 51). Demokracia e drejtëpërdrejtë i ka fillesat në Athinën e Lashtë, ku populli drejtëpërdrejtë merr pjesë në ligjbërjen e vendit. Ndërsa në demokracinë përfaqësuese, populli zgjedh me votë përfaqësuesit e tij, për të miratuar ligje dhe për të vendosur për çështje të rëndësishme.

Monarkia kushtetuese është formë qeverisje që i kufizon pushtetin monarkut dhe zëri i popullit është më i fortë se i tij. *Patriarkati*, pushteti ushtrohet nga burrat dhe *matriarkati*, drejtimi i dominuar nga gratë. *Anarkia*, formë qeverisje ku mungon qeverisja, ligji, rendi dhe stabiliteti. Ndërsa në qeverisjen autoritare vendi drejtohet nga

një individ ose grup i vogël individësh, të cilët kërkojnë bindje të plotë. Një qeverisje e tillë ka të bëjë me kontrollin politik të gjithë shoqërisë dhe arrihet nëpërmjet shtypjes.

Qeverisja totalitare, ku në formë qeverisjeje kemi kontrollin e shoqërisë në të gjitha sferat e jetës publike dhe private. Totalitarizmi është një mënyrë organizimi të drejtimit tiranik ose despotik, i cili zhvillon institucionet e reja politike dhe i shkatarron të gjitha traditat politike, sociale dhe ligjore të vendit.

Tabela nr. 7: Karakteristika të regjimeve autoritare.

Disa karakteristika të regjimeve autoritare:
❖ Qeverisja ose drejtimi është arbitrar dhe i pakushtëzuar nga ligji;
❖ Vendimet politike merren në interes të drejtuesit dhe jo në interes të qytetarëve;
❖ Pluralizmi është i kufizuar;
❖ Kemi mungesë të tolerancës ose mosshpërfillje të opozitës;
❖ Qeverisja mbështetet mbi koercitet, ku terrori është mjet kontrolli dhe komandimi;
❖ Policia shpesh shfrytëzohet për të kontrolluar qytetarët;
❖ Edhe ushtarakët shfrytëzohen nga drejtuesi dhe është një mbështetje e madhe.

Tabela nr. 8: Karakteristika të regjimeve totalitare.

Disa karakteristika të regjimeve totalitare:
❖ Shoqëria udhëhiqet nga një ideologji specifike, përgjithësisht pseudodemokratike;
❖ Vendi drejtohet nga një parti e vetme, nga një lider karizmatik;
❖ Nuk ka një opozitë;
❖ Policia ushtron terror për kontrollin e popullit;
❖ Shteti kontrollon ushtrinë dhe ka monopolin e armëve;
❖ Shteti kontrollon shtypin dhe median në përgjithësi;
❖ Ligji gjithashtu vihet në funksion të shtetit;
❖ Kemi një ekonomi qendrore ose të centralizuar.

Përsa i përket shtetit federal dhe unitar, ekzistojnë disa ndryshime duke u bazuar në shpërndarjen gjeografike të fuqisë. Si rrjedhojë, kemi qeveri unitare (tre pushtetet ushtrohen nga një agjensi qendrore, rasti Britania), qeverisje federale (pushtetet ndahen midis një qeverie qendrore dhe vendore, rasti ShBA) dhe qeverisja konfederale (ekziston një lidhje të shteteve të pavarura dhe agjensia qendrore ka fuqi të kufizuara). Në shtetin unitar, qeverisja qendrore ka autoritet ligjor të plotë mbi gjithë organet e tjera, ku mund të

delegojë në nivel vendor disa nga autoritetet e saj. Shteti federal i ka të ndara kompetencat e qeverisjes dhe shpërndarja e autoritetit qeveritar bëhet nga pikëpamja territoriale.

Kemi disa tipare të përbashkëta në të gjitha sistemet federale demokratike. Kushtetuta është e shkruar në rang federal, pushteti legjislativ përbëhet nga një legjislaturë dydhomësh dhe në procesin e amendamenteve të kushtetutës federale kemi pjesëmarrjen e qeverive të shteteve rajonale. Kushtetuta në shtetet federale është e domosdoshme dhe e rëndësishme sepse në këtë ligj të shkruar saktësohen qartë ndarjet territoriale të pushteteve dhe të kompetencave të nivelit federal e të shteteve.

Siç e kemi trajtuar edhe më sipër, qeverisja në kohët moderne ka marrë kuptim më të gjërë, ku kemi përfshirjen e lidhjeve edhe të politikave, edhe të organizmave jashtë qeverisë, si partitë politike, grupimet politike, grupet e interesit dhe presionit etj. Ekzistojnë tre lloj pushtetesh, si pushteti ekzekutiv, pushteti legjislativ dhe pushteti juridik, si pjesë e sistemit politik të qeverisjes. Dhe në bazë të raportit të tre pushteteve, kemi qeverisjen diktatoriale dhe qeverisje demokratike. Në varësi të shkallës së ndërveprimit të tre pushteteve, kemi edhe qeverisjen parlamentare, presidenciale dhe gjysmëpresidenciale.

Nëse do të vështrojmë mënyrën e qeverisjes së shteteve më të rëndësishme, atëherë në Europë, monarkitë kushtetuese (Meidani, 2009 a: 112-113) janë shtetet si Hollandë, Britania e Madhe, Danimarkë, Belgjikë, Luksemburgu, Spanjë, Norvegji, Suedi, Spanjë, Monarko, Andorra dhe Lihtenshtajni. Franca është republikë gjysmëpresidenciale, ku epërsi ka parlamenti dhe presidenti zgjidhet nga populli. Ndërsa në Rusi, presidenti është figura dominuese. Kemi raste të ndryshme, ku epërsi mund të ketë parlamenti ose presidenti.

Ndërsa në vendet ish-socialiste të Europës Lindore, kemi sistem të republikës parlamentare dhe presidenti zgjidhet nga populli. Në shtetin fqinj Greqinë, presidenti zgjidhet nga parlamenti, në Itali zgjidhet nga parlamenti e senati dhe në Gjermani nga konventa federale.

Më poshtë do të trajtojmë në mënyrë më të hollësishme format parlamentare me tendencë mazhoritare ose propocionale, formën presidenciale dhe gjysmëpresidenciale, duke trajtuar edhe raste konkrete. Kjo tablo teorike do të na ndihmojë që në fund të këtij kapitulli të bëjmë një dalim midis formave qeverisëse dhe marrëdhënieve që ekziston midis pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ, si edhe raportin që ekziston midis tyre (raport varësie ose kontrolli).

3.2.1 Forma parlamentare e qeverisjes (Republikë parlamentare)

Siç e trajtuam gjërësisht më sipër, kemi disa organizime të sistemit politik pluralist, ku veçojmë monarkinë kushtetuese, republikë parlamentare, presidenciale dhe gjysmëpresidenciale. Republika parlamentare është forma qeverisëse më e përhapur në botën e sotme moderne, por pavarësisht veçorive dalluese që mund të ketë secili vend, ka disa karakteristika të përbashkëta që do t'i trajtojmë gjërësisht më poshtë (Will Hoite, F. H. 1988: 135-136).

Parlamenti, si institucioni më i lartë i shtetit, është shprehje e qeverisjes përfaqësuese sepse zgjidhet nga populli. Pushteti ligjvënës (Parlamenti) miraton ligje dhe jetëgjatësia e tij varet nga pëlqimi i shumicës parlamentare. Kemi ekzistencën e një raporti të ngushtë midis pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv, ku ekzekutivi (qeveria) formohet nga partia që ka

dalë fituese në zgjedhjet e përgjithshme (ka fituar shumicën e vendeve parlamentare). Qeveria merr mandatin qeverisës nga votëbesimi i Parlamentit, si edhe përgjigjet përpara tij. Parlamenti nuk ka fuqi urdhëruese për legjislaturat pasardhëse sepse çdo legjislaturë ka pushtet për të shfuqizuar ose jo dispozitat e mëparshme.

Kabineti qeveritar sapo krijohet bëhet qendra e procesit të qeverisjes sepse ka funksion kryesor për formulimin e ligjeve dhe për hartimin e projektligjeve, të cilat kanë përparësi ndaj propozimeve të bëra në mënyrë individuale nga parlamentarët. Parlamenti në raport me Qeverinë, miraton të gjitha ligjet dhe mund të rrëzojë një projektligj të propozuar prej saj.

Ndërsa roli i *kryetarit të shtetit* (mbret/president) është mjaft i kufizuar. Kreu i shtetit shihet si simbol i unitetit kombëtar dhe qëndron mbi partitë politike (ka pozicion paanshmërisë dhe luan rolin e ndërmjetësit). Roli i kryetarit të shtetit është i rëndësishëm në momentin pas zhvillimit të zgjedhjeve se thërret kryetarin e partisë fituese dhe e ngarkon atë me formimin e qeverisë së re, më pas miraton përbërjen e saj. Por, më shumë ndikim ka kur asnjë nga partitë politike nuk ka fituar shumicën parlamentare, atëherë kryetari i shtetit thërret partinë me më shumë vota. Ndikimi i tij rritet me zhvillimin e mëtejshëm të ngjarjeve deri në miratimin e qeverisë së re, ku theksohet roli ndërmjetës i presidentit.

Në këtë formë qeverisëse, roli i *partive politike* ka një rëndësi të madhe, ku kryetari i partisë fituese bëhet edhe kryetari i qeverisë. Rëndësi kanë gjithashtu partitë opozitare sepse përshkruajnë tërë veprimtarinë e Parlamentit, i cili vepron si një organ kolegjal. Rëndësi të madhe ka *elektorati* sepse nëse kemi një rrëzim të qeverisë, atëherë elektorati zgjedh nëpërmjet votës së lirë qeverinë e re. Por, gjithashtu theksojmë se elektorati ka rëndësi sepse nëpërmjet zgjedhjeve të lira të përgjithshme, zgjedh qeverinë e re.

Tabela nr. 11:Parlamenti – organ shqyrtues.

2- Organ Shqyrtues Përmbajtja e funksionit	Tiparet
▪ Diskutimi publik i çështjeve me rëndësi kombëtare është ‘gur themeli’ i parlamentit ▪ Diskutimi bëhet kryesisht për veprimtarinë e qeverisë	▪ Diskutimi me pyetje dhe përgjigje, zë një vend të rëndësishëm dhe është publik ▪ Në disa vende, si në Kongresin Amerikan, diskutimi zhvillohet në komitete

Tabela nr. 12:Parlamenti – organ legjislativ.

3- Organ Legjislativ Përmbajtja e funksionit	Tiparet
▪ Organi i vetëm me të drejtë miratimin e ligjeve	▪ Në modelin uestminster - mbizotërimi i ekzekutivit. Projektligjet e qeverisë miratohen me lehtësi dhe nuk i bëhen ndryshime ▪ Në modelin consensus, legjislativi dhe ekzekutivi kanë më shumë përparësi në bërjen e ligjeve. Gjithashtu, kompetenca të mëdha kanë edhe komisionet parlamentare në hartimin e ligjeve të reja.
▪ Qeveria ka të drejtën e iniciativës ligjore	
▪ Vendos për çështje të rëndësishme, si për buxhetin e shtetit, për të drejtat dhe liritë e shtetasve etj. ▪ Në vende të vogla, të dyja pushtetet ekzekutiv dhe legjislativ punojnë së bashku për nismën e miratimin të ligjeve	

Tabela nr. 13: Parlamenti – miraton qeverinë.

4- Miraton Qeverinë Përmbajtja e funksionit	Tiparet
▪ Për formimin e qeverisë bazë është përbërja partiake e parlamentit	▪ Në modelin uestminster, partia që ka shumicën parlamentare, formon qeverinë automatikisht. Qeveria zgjidhet npm (jo prej) parlamentit ▪ Në modelin consensus, parlamenti është arenë përcaktuese për formimin e qeverive të koalicionit. Favorizon shumë interperlancat, të cilat janë të lidhura me votëbesimin.
▪ Parlamenti mund të japë votëbesimin dhe mocione votëbesimi	
▪ Mbikqyr ekzekutivin, monitoron dhe kontrollon efikasitetin e qeverisë	

Doktrina dualiste dhe moniste e parlamentarizmit

Siç e nënvizuar edhe më sipër, pavarësisht veçorive specifike të secilit vend, regjimi parlamentar ka disa karakteristika thelbësore të përbashkëta si p.sh. asamblatë përfaqësuese kanë pushtetin më të lartë (qeveria merr mandatin nga asambleja/parlamenti). Parlamenti nuk përbën burimin e të gjithë pushteteve tjera, ai mban pushtetin më të lartë në rendin politik e juridik, por kjo nuk përjashton ekzistencën e një autonomie krahinore dhe lokale (rasti i Republikës së Italisë).

Qeveria del politikisht nga Parlamenti si një pushtet i pavarur dhe si rrjedhojë, kemi një bashkëpunim ndërmjet dy pushteteve (ekzekutiv dhe legjislativ). Por kemi një marrëdhënie kontrolli, ku qeveria (pushteti ekzekutiv) përgjigjet para Parlamentit (pushtetit legjislativ). Qeveria krijohet vetëm pas marrjes së besimit nga Parlamenti, por Parlamenti me anë të mosbesimit ndaj qeverisë së re ose përmes parlamentarëve, të cilët mund të votojnë një mocion mosbesimi ndaj qeverisë.

Parlamenti është një organ kolegjal (Omari, 2005: 74) për nga struktura sepse përbëhet nga shumë individë që operojnë si një trup i tërë. Gjithashtu, është organ i degëzuar sepse përfshin organe të ndryshme operative, siç janë komisionet parlamentare. Ndërsa partitë politike, veçanërisht partisë mazhoritare thekson autori, e cila fiton të drejtën e formimit të qeverisë, i jep një karakter relativ ndarjes së pushteteve. Qeveria nxjerr dispozita që hyjnë në kompetencat e Parlamentit si dekretligjet dhe si rrjedhojë, Qeveria ka një raport varësie ndaj Parlamentit.

Përsa i përket shkallës së demokratizimit të sistemit parlamentar, e cila shihet në raport me pushtetin ekzekutiv, sipas studiuesve kemi dy teori (doktrina dualiste e moniste). Nga fundi i shek. XIX-të deri në periudhën midis dy Luftërave Botërore, kemi një periudhë tranziti ku kalohet nga dualizmi (sistem i bazuar në besimin e dyfishtë që Qeveria duhet të ketë te Parlamenti dhe kryetari i shtetit), në monizëm (sistem ku Qeveria duhet të ketë vetëmbesimin e Parlamentit, kryetari shtetit nuk ka funksione politike dhe ruan pushtet asnjëherë). Në shumicën e shteteve është vendosur parlamentarizmi monist, që ecën në të njëjtën kohë me zgjerimin e trupit elektoral dhe kemi një rritje të madhe të rolit të Parlamentit. Në teorinë moniste, kryetari i shtetit është i pajisur me autoritet moral duke qenë konsideruar si një simbol i unitetit kombëtar.

3.2.2 Republikë parlamentare me tendencë mazhoritare (Rasti i Britanisë së Madhe)

Një përcaktim i përgjithshëm i sistemit përfaqësues nga studiues të fushës është se, përfaqësuesit e popullit, të votuar ose të zgjedhur nga vota e lirë, me anë të votëbesimit të tyre si parlamentarë, ngarkojnë qeveritarët me funksionin e qeverisjes. Parlamenti si institucion politik, ka lindur në Britaninë e Madhe, por, në kohën moderne kemi rritjen e rolit të tij, si sistem përfaqësues/parlamentar.

Paraardhësi i largët i Parlamentit, ishte Curia Regis (Këshilli i Mbretit), ku tre pushtetet ishin njëhsuar (pushteti gjyqësor, ekzekutiv dhe legjislativ). Brënda Curia Regis ekzistonte ‘curia minor’ (këshilli i vogël) dhe ‘curia major’ (këshilli mbretëror), ku merrnin pjesë vasalët e monarkut. Këshilli që u mbledh në vitin 1295 u quajt ‘Great and Model Parliament’ (Parlamenti i madh dhe model), ku përfaqësonte tërë kombin. Ndërko, filloj të përdorej fjala ‘parlamentum’ (flas), tregon karakteristikën themelore si tribunë diskutimesh. Parlamenti në fillim përbënte një tërësi të vetme, ndërsa më vonë, klasat e ndryshme të interesit për të ruajtur interesat e tyre, mbledheshin të ndarë. Dhe si rrjedhojë, në vitin 1351 u krijua parlamenti i dy dhomave (Dhoma e Komuneve me Dhomën e Lordëve).

Në kohët e sotme, Kryeministri e anëtarët e tjerë të kabinetit, të emëruar formalisht nga monarku, përcaktojnë drejtimet e përgjithshme të politikës dhe përgjigjen para Dhomës së Komuneve. Parlamenti Anglez përbëhet nga tre organe ligjvënëse, si Dhoma e Komuneve, organi i vetëm ligjvënës me fuqi vendimore (Omari, 2005: 14). Dhoma e Lordëve, e cila nuk ka peshë reale në politikë dhe Parlamenti anglez ose bikameralizmi më i vjetër në histori, sot është fiktiv. Dhe sipas Paolo Biskareti di Rufia, funksionimi i mirë i sistemit parlamentar britanik u kushtohet tre faktorëve, si ekzistencës së sistemit dy partiak

(bipartitizëm), ndjenjës së lirisë e të ‘fair play’ (luajalitetit që është rrënjësor thellë në popullin britanik) dhe së treti, pavarësisë së plotë të gjykatave.

Në Angli kemi një republikë parlamentare me tendencë mazhoritare sepse në skenën politike mbizotërojnë dy parti të mëdha politike, ku kemi dy drejtime, torët (laburistët) dhe uigët (konservatorët). Parlamentarizmi britanik është i pandarë nga partitë politike, ku opozita ka një status të vërtetë, që i lejon asaj të informohet dhe të shprehet lirisht. Ajo formon ‘kabinetin e saj hije’ dhe lideri i partisë opozitare quhet ndryshe si ‘Lideri i opozitës së Lart Madhërisë’ sepse ka disa përfitime materiale, si edhe Kryeministri këshillohet me të për çështje të një rëndësie të madhe.

Semuel Fainer (1987: 25-27) në studimin e tij “Modern Political Systems” krahason zhvillimet politike të Britanisë së Madhe, me të vendeve të tjera. Autori përcakton pesë karakteristika të qeverisjes britanike, siç janë konsensusi, shkallëzimi, bindja ndaj ligjit, pragmatizmi dhe demokratizimi. Në Britani janë vënë në zbatim parimet e konstitucionalizmit, mbi bazën e të cilave kishte arritur një baraspeshim në shpërndarjen e pushteteve, të pjesëmarrjes në qeverisje e arritjes së marrëveshjeve me anë të konsensusit. Bithman dhe Bajte shprehen për konstitucionalizmin, se elementet bazë të saj janë: kushtetuta e shkruar, sundimi i ligjit, ndarja e pushteteve ndërmjet legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit, si edhe garantimi i të drejtave dhe lirive të individit (Beethman, 1995: 67).

Ndërsa Arend Lijphart në librin e tij “Patterns of Democracy. Government Forms and Performance in Thirty-Six Countries” (1999: 9-21) specifikon karakteristikat e “The Westminster Model in the United Kingdom” ose Qeverisë së mazhoritarit në Britani, si:

1. Përqendrimi i *pushtetit ekzekutiv* në *kabinetin një-partiak*, me një shumicë të zhveshur.

2. *Kabineti dominon*. Kur udhëheqja e kabinetit dhe kohezionit të partisë së shumicës është e fortë, atëherë kabinetet humbasin disa prej pozitës së tyre mbizotëruese kur njëra nga të dyja nga këto kushte mungojnë.
3. *Sistemi Dy-partiak*, kanë tendencë të jenë sisteme njëpartiake, ku programet dhe politikat e partive kryesore zakonisht ndryshojnë nga njëri-tjetri, kryesisht me dimension e çështjeve socio-ekonomike.
4. *Sistemi mazhoritar dhe joproporcionale të zgjedhjeve*. Dhoma e Përfaqësuesve zgjidhen në rrethe një emërore sipas metodës pluraliste, ku zakonisht në Britani është referuar si "first past the post", kandidati me shumicën e votave ose me shumicën e votave të pakicës fiton. Ky sistem ka tendencë për të prodhuar rezultate shumë disproporcionale.
5. *Interesat e grupit të shumicës*. Duke përqëndruar pushtetin në duart e shumicës, modeli Westminster i demokracisë krijon model kundrejt-opozitë të qeverisë që është konkurruese.
6. *Qeveria unitare dhe e centralizuar*. Qeveritë lokale kryejnë një sërë funksionesh të rëndësishme, por duke qenë nën kontrollin e qeverisë qendrore kompetencat e tyre nuk janë garantuar me kushtetë. Për më tepër, ata janë financiarisht të varura nga pushteti qendror.
7. *Përqendrimi i pushtetit legjislativ në një legjislaturë me një dhomë*. Parimi i shumicës e ka përqëndruar pushtetin dhe pushteti legjislativ është i përqëndruar në një dhomë të vetme.
8. *Fleksibiliteti i Kushtetutës*. Britania duke mos patur një kushtetutë të shkruar, atëherë Parlamenti ka fuqinë për ta ndryshuar atë, si bëjnë me ligjet e tjera të vendit.
9. *Mungesa e shqyrtimit gjyqësor*. Implikimi tjera të rëndësishme e një kushtetute të pashkruar është mungesa e shqyrtimit gjyqësor.
10. *Ekzistenca e një banke qendrore, e cila kontrollohet nga ekzekutivi*. Bankat qendrore janë përgjegjëse për politikën monetare. Bankat e pavarura janë konsideruar më pak të

kontrollueshme për kontrollin e inflacionit dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, se bankat që janë të varur nga ekzekutivi.

3.2.3 Republikë parlamentare me tendencë proporcionale (Rasti i Italisë)

Në shtetin tonë fqinjë, Italinë, parlamentarizmi është më i ri krahasuar me vendet e tjera. Pas vitit 1848-të, me përjashtim të Mbretërisë së Sardenjës, të gjithë monarkitë në shtetet e ndryshme të Italisë i shfuqizuan kushtetutat e tyre. Në Mbretërinë e Sardenjës, Statusi i Mbret Karl Alberti, u quajt ‘Statusi Albertin’, me karakter të moderuar dhe bazohej në parimin e përfaqësimit. Tre pushtetet kryesore ishin të ndara, ndërsa mbreti ishte bashkërenduesi i funksioneve të tyre. Në vitin 1860-të, Statusi i Sardenjës u bë statusi i Mbretërisë së Italisë. Gjatë periudhës së Mbretit Viktor Emanueli II, kemi kalim të kompetencave nga Mbreti tek Parlamenti, ku doli fuqishëm në skenë figura e Kryeministrit.

Në Itali parlamenti përbëhet nga dy dhoma, Dhoma e Deputetëve (630 mandate me votim të përgjithshëm) dhe Senati (315 anëtarë të zgjedhur), të cilat janë zgjedhur me anë të sistemit proporcional dhe përbërja politike ka qenë pothuajse e njëjtë. Kemi funksione të barabarta, si nga pikëpamja juridike dhe fuqia vendimmarrëse midis tyre. Nëse arrihen të mbledhen rreth 50 000 nënshkrime nga zgjedhësit, atëherë iniciativën legislative mund ta ketë çdo deputet, senator, qeveritar dhe populli. Në raste të veçanta, funksioni legjislativ mund të ushtrohet edhe nga Qeveria, duke i’u deleguar kjo e para.

Krytari i shtetit zgjidhet çdo 7 vite dhe përfaqëson unitetin e Kombit Italian. Italia edhe se është një republikë parlamentare, Presidenti ka një numër të madh funksionesh në tre pushtet kryesore, si në ekzekutiv, legjislativ dhe juridik. Presidenti dekreton ligjet,

emëron drejtuesit e disa organizmave të rëndësishme institucionale dhe drejton Këshillin e Lartë të Drejtësisë, gjithashtu shqyrton ankesa të veçanta ndaj administratës publike, kthen në parlament aktet legislative të miratuar prej tij, jep falje etj. Kryetari i shtetit nuk është titullari i pushtetit ekzekutiv sepse ky funksion ushtrohet nga qeveria. Në raport me pushtetit ekzekutiv (qeverinë), Presidenti është garant i zbatimit të Kushtetutës e parimeve bazë të saj. Dhe Presidenti ka pozitë më të lartë se organet e tjera shtetërore, por nuk mund të ndërhyjë në veprimtarinë e tyre kushtetuese.

Italia, si një republikë parlamentare tipike me tendencë proporcionale, ku krizat qeveritare janë shkaktuar më shumë nga mospajtimet brenda koalicionit midis partive në pushtet, por zgjidhja e këtyre krizave ka ardhur nga partitë politike jashtë parlamentit. Si rrjedhojë, kemi ekzistencën e ‘partitokracisë’, ku pushteti i partive politike ka kufizuar rolin e parlamentit dhe në skenën politike të Italisë, po rritet ndjeshëm kërkesa për ndryshime në Kushtetutë, ku të përmirësohet funksionimi i organeve kryesore të shtetit.

Lijphart në librin e tij (1999) specifikon karakteristikat kryesore të “The Consensus Model of Democracy” ose të Modelit Konsensual të Demokracisë. Lijphart ka zgjedhur shtetet si Zvicra, Belgjika dhe Bashkimin Evropian, si subjekt multietnik për të ilustruar këtë model. Zvicra është shembulli më i mirë, ndërsa BE konsiderohet si një shtet federal, ku institucionet e tij janë shumë të afërt me modelin konsensual të demokracisë.

Modeli Konsensual në Zvicër dhe Belgjikë, kanë përqëndruar pushtetin e tyre në duart e shumicës. Ky model qeverisës përpiket për të ndarë, shpërndarë dhe të frenojë pushtetin në mënyra të ndryshme. Dhe më specifikisht, këto janë karakteristikat kryesore të modelit konsensual të qeverisjes sipas Lijphart (1999: 31-41) janë si më poshtë:

1. *Ndarja e pushtetit të ekzekutivit në kabinete koalicioni më të gjërë.*

2. *Balanca e pushtetit ekzekutive-legjislativë.* Ndarje formale e kompetencave ka bërë që pushtetet të jenë më të pavarur ndaj njëri-tjetrit dhe lidhja është shumë më e balancuar.
3. *Sistemi shumëpartiak.* Shfaqja e sistemeve shumëpartiake në Zvicër e Belgjikë mund të shpjegohet sipas dy faktorëve, së pari, dy vendet janë shoqëritë plurale e shumëllojshmëria e ndasive pasqyrohet në karakterin shumëdimensional të sistemeve partiake.
4. *Përfaqësimi proporcional.* Shpjegimi i dytë për shfaqjen e sistemeve shumëpartiake në Zvicër dhe Belgjikë është se sistemet e tyre proporcionale nuk e kanë penguar përkthimin e ndasive shoqërore në ndasi të sistemit partiak.
5. *Grupi i interesit korporativist.* Bashkimi i punës ka tendencë të jetë organizuar më mirë dhe me më pak ndikim se biznesi. Kjo mosmarrëveshje mund të zgjidhet duke bërë dallimin midis dy variante të korporatizmit: korporatizmit social në të cilën sindikatat mbizotërojnë dhe korporatizmit liberale në të cilën shoqatat e biznesit janë forcë e madhe.
6. *Qeveria Federale dhe decentralizuar.* Zvicra është një shtet federal, në të cilën pushteti është i ndarë në mes të qeverisë qendrore dhe qeverisë lokale.
7. *Bikameralisëm i fortë.* Justifikimi kryesor për fillimin e një Parlamenti dydhomësh është për të patur një përfaqësim të veçantë për minoritetet, duke përfshirë edhe shtetet më të vogla në sistemet federale, në një dhomë të dytë ose dhomën e lartë.
8. *Ngurtësi Kushtetuese.* Të dy shtetet, Belgjika dhe Zvicra kanë një kushtetutë të shkruar, një dokument i vetëm që përmban rregullat themelore të qeverisjes, që mund të ndryshohet vetëm në një rast të veçantë dhe që kërkojnë shumicat e votave.
9. *Shqyrtimi gjyqësor.* Zvicra devijon në një drejtim nga modeli i pastër konsensusit: gjykata e saj supreme, Gjykata Federale nuk ka të drejtën e shqyrtimit gjyqësor.

10. *Pavarësia qendrore e bankës*. Banka qendrore e Zvicrës prej kohësh konsiderohet si një nga bankat qendrore më të fortë dhe më të pavarura. Në të kundërt, Banka Kombëtare e Belgjikës ishte një nga bankat më të dobëta qendrore.

3.3 Republikë presidenciale (Rasti i ShBA-së)

Zanafilla e formës presidenciale të qeverisjes ndodhet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Karakteristika e përbashkët në këtë formë qeverisje është ndarja e tre pushteteve, kontrolli ose barashpesha e tyre (Will Hoite, F. H. 1988: 133), si rrjedhojë, secila ka një pushtet të veçantë. Pushteti ligjvënës (Kongresi) dhe pushteti ekzekutiv (Presidenti), nuk varen nga njëri-tjetri dhe shpesh midis tyre ekzistojnë konflikte. Por në zbatimin e politikave të mëdha është e domosdoshme marrëveshja midis këtyre dy pushteteve.

Ndodh, që partia nga ku zgjidhet Presidenti, mund të mos ketë shumicën në Kongres dhe si rrjedhojë, është shumë e vështirë arritja e një kompromisi me pushtetin ligjvënës. *Presidenti*, është njëkohësisht kryetar qeverie dhe kryetar shteti në sistemin presidencial. Midis pushteteve ka një raport *kontrolli* dhe *balancimi*, që është përshkruar gjërësisht edhe në Kushtetutë. Njëri pushtet barazpeshohet nga kompetencat e dy pushteteve të tjera dhe secili pushtet kontrollon pushtetet e tjera (Lambert, 1996: 35-36). Asnjë nga pushtetet, në këtë mënyrë nuk fuqizohet më shumë dhe nuk mund të keqpërdorë kompetencat e tij.

Kongresi ka të drejtën e nxjerrjes së ligje dhe Presidenti ka të drejtën e vetos (vetëm me 2/3 e votave të Kongresit mund të hidhet poshtë). Kemi një lloj marrëdhënie kontrolli dhe balancimi midis pushteteve, ku Kongresi e kufizon nismën ligjore, se vetëm me

miratimin e Presidentit mund të kalojë një projektligj. Presidenti duhet të arrijë në një kompromis sepse në këtë sistem qeverisës është i domosdoshëm. Dhe ky është ndryshimi i dytë midis sistemit presidencial dhe parlamentar, ku Presidenti duhet të arrijë një kompromis me pushtetin ligjvënës.

Tabela nr. 14: Sistemi presidencial.

Sistem presidencial	
Presidenti	Kongresi
Propozon buxhetin vjetor	Përcakton shumën e parare të buxhetit, qëllimin e shpenzhimeve, kush do paguaj taksat si burim të ardhurash
Komandanti i përgjithshëm i forcave të armatosura	Ka të drejtën për shpalljen e luftës dhe të nënshkrimit të paqes
Emëron gjyqtarët e Gjykatës së Lartë	Miraton ose jo gjyqtarët e Gjykatës së Lartë.

Vërejmë se ekzekutivi është i përqëndruar tek Presidenti dhe veprimet e tij janë të kufizuara nga organi ligjvënës. Roli i *partive politike* në sistemin presidencial ndryshon nga ai parlamentar sepse partitë përcaktojnë si kandidatët për president dhe për kongres. Por, Presidenti ka më pak kontroll mbi partinë në Kongres sepse presupozohet se presidenti duhet të vendosë një lidhje bashkëpunimi me partitë e tjera politike parlamentare.

Dy parimet thelbësore për një qeverisje demokratike, është parimi i ndarjes së pushteteve dhe i kontroll-balancimit midis tyre, si edhe në shtetin modern theksohet parimi i decentralizimit të pushteteve. Shpesh në sistemet politike, duke u bazuar në parimin e ndarjes dhe kontroll-balancimit midis pushteteve, vërehet një ‘interferencë’ midis pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ, kjo shihet si një llogaridhënie e Qeverisë (ekzekutivit) përpara Parlamentit (në legjislativ). Dhe quhet supremaci parlamentare dhe është më e dukshme në Britaninë e Madhe, ku nuk kemi një Kushtetute të shkruar.

Ndërsa, supremacia kushtetuese është më e dukshme në ShBA, ku kemi një ndarje tërësore të pushtetit ekzekutiv e legjislativ. Në kuadër të supremacisë kushtetuese është kontrolli i pushtetit juridik mbi pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv. Ndërsa, përse i

përket supremacisë parlamentare, lidhet me praninë e Kryeministrit në legjislaturë, me veprimin e tij tërësor në Parlament etj. Në ShBA lidhja midis tre pushteteve është sa e pavarur dhe ndërruar. Presidenti i ShBA-së konsiderohet si politikani më me peshë gjatë mandatit të tij se përtej fuqive në pushtetin ekzekutiv, legjislativ dhe juridik, ka gjithashtu fuqi të veçanta në kohë lufte. Në tabelën e mëposhtme, në mënyrë të përmblendhur pasqyrohet alternimi i detyrave të tre pushteteve dhe kontrolleve përkatëse:

Tabela nr. 15: Alternimi i detyrave të tre pushteteve dhe kontrolleve përkatëse të tyre.

<u>Dega ekzekutive</u>		<u>Dega legjislative</u>		<u>Dega juridike</u>	
<i>Kontrolli mbi legjislativin</i>	<i>Kontrolli mbi degën juridike</i>	<i>Kontrolli mbi ekzekutivin</i>	<i>Kontrolli mbi degën juridike</i>	<i>Kontrolli mbi ekzekutivin</i>	<i>Kontrolli mbi legjislativin</i>
Vetoja e Presidentit	Emëron gjykatësit në Gjykanën e Lartë	Me 2/3 e votave të dy dhomave hedh poshtë veton presidenciale	Kongresi krijon gjykatat më të ulta	Gjykata e Lartë shfrytëzon fuqinë e rishikimit juridik për të deklaruar si jokushtetuese një ligj	Gjykata e Lartë shfrytëzon fuqinë e rishikimit juridik për të vlerësuar si jokushtetuese veprime të Presidentit
I propozon ligje Kongresit	Emëron gjykatësit në sistemin federal të gjykatave	Senati hedh poshtë traktate të propozuara me 2/3 e votave	Kongresi nis procedurat e largimit të gjykatësve e heqjen e tyre		Gjykata e Lartë shfrytëzon fuqinë e rishikimit juridik për të konsideruar si jokushtetues një traktat të caktuar
I propozon buxhetin federal Dhomës së Përfaqësuesve	Presidenti mund të bëjë amnisti ndaj një klase	Senati mund të hedh poshtë emërimet presidenciale të zyrtarve/gjykatësve federalë	Kongresi amendon Kushtetutën për të hedh posht vendimet e Gjykatës së Lartë		
Emëron zyrtarë federal që nxjerrin, ndjekin e zbatojnë ligjet	Presidenti ka të drejtën e faljes	Kongresi mund të nisë procesin e gjykimit të Presidentit dhe heqjen e tij	Senati refuzon emërimet për Gjykatat federale / Gjykatën e Lartë		

Kushtetuta amerikane që prej vitit 1789-të, nuk i ka ndryshuar parimet e saj themelore. Tre pushtetet janë të ndara nga njëra-tjetra dhe kompetencat e tyre janë të balancuara dhe kontrolluese me njëra-tjetrën. Shtetasit dhe shtetet janë të barabartë dhe trajtohen në mënyrë të barabartë përpara ligjit (shtetasit) dhe përpara qeverisë federale

(shtetet). Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës kemi një presidencë të fuqishme dhe të njësuar, gjithashtu ekziston një marrëdhënie kontrolli dhe balancimi nga dy degët e tjera të legjislativit dhe gjyqësorit.

3.4 Republikë gjysmëpresidenciale (Rasti i Francës)

Republika gjysmëpresidenciale qëndron midis republikës presidenciale dhe parlamentare, e cila është një formë e ndërmjetme qeverisëse. Franca është një republikë gjysmëpresidenciale, ku pushteti ekzekutiv ndahet midis kryetarit të shtetit dhe kryetarit të Qeverisë. Në këtë formë qeverisëse gjysmëpresidenciale, Presidenti zgjidhet nga populli, por nuk është kryetar i Qeverisë. Ndërsa në sistemin parlamentar, pushtetin ekzekutiv e ka kryetari i Qeverisë dhe Presidenti ka kompetenca të kufizuara. Në rastin e ShBA-së, që ka një sistemin presidencial, Presidenti është kryetari i Qeverisë dhe i shtetit, si rrjedhojë ka kompetenca të rëndësishme në të tre pushtetet.


Nëse i rikthehemi historisë franceze, Republika e Pestë, e cila u aprovua nëpërmjet një Referendumi më 28 shtator të vitit 1958, kemi një forcim të pushtetit ekzekutiv në raport me pushtetin legjislativ (Parlamentin). Pushteti ekzekutiv ka njëkohësisht dy kryetar, Presidentin e Republikës, i cili zgjidhet me votë për një mandat pesë vjeçar dhe Kryeministrin, që caktohet ose zgjidhet nga Presidenti. Pra, në Francë vërejmë një rëndësi më të madhe të Presidentit ndaj Kryeministrit sepse ky i pari zgjedh të dytin.

Parlamenti i Francës ka një legjislaturë dydhomëshe, e formuar nga Asambleja Kombëtare (490 anëtarë zgjidhen me votë për 5 vjet) dhe Senati (283 anëtarë zgjidhen nga një komision zgjedhor për 6 vjet). Asambleja mund të shpërbëjë kabinetin dhe si rrjedhojë,

shumica në Asamble zgjedhë Qeverisë. Fuqitë legislative të Senatit janë të kufizuara dhe midis dy dhomave vendos Asambleja Kombëtare në një moment të divergjencave.

Sipas kushtetutës në fuqi (data 4.10.1958), Franca është Republikë sekulare. Presidenti i Francës është Presidenti i Shoqërisë Franceze, që zgjidhet nga populli me shumicë vote dhe njëkohësisht, kryetar i shtetit dhe rojtar i Kushtetutës. Presidenti është kryekomandant i forcave të armatosura, që kryeson marrëveshjet e kontratat internacionale dhe në raste të gjendjes së veçanta, ka fuqi të plota në gjitha aspektet pa kufizim. Ai emëron Presidentin e ministrave dhe me propozimeve të këtij të fundit emëron edhe ministrat.

Tabelë nr. 16: Sistemi parlamentar presidencial ose gjysmëpresidencial (Meidani, 2009: 113)



Kemi një ndikim indirekt të *partive politike* të opozitës mbi Parlamentin dhe gjithashtu Parlamenti ka një ndikim indirekt te Kabineti i Qeverisë (Kryeministri dhe ministrat). Ndikim indirekt kemi edhe të partive të shumicës mbi Kryetarin e shtetit, si edhe Gjyqësori ndikon indirekt mbi Kabinetin qeveritar dhe mbi Kryetarin e shtetit.

Dallimet midis republikës parlamentare dhe presidenciale

Kriter bazë të përdorur për të formuluar klasifikimin e formave të qeverisjes në një shtet demokratik është *ndarja e pushteteve*, si pushteti legjislativ dhe ekzekutiv. Klasifikimi i formave të qeverisjes është i ndarë në tre ndarje, e cila përfshin formën qeverisëse parlamentare, presidenciale dhe gjysmë-presidenciale, të cilat u trajtuan më sipër gjërësisht me raste konkrete. Në ditët e sotme, shumica e formës qeverisëse në botë ndahet midis *Republikë presidenciale dhe parlamentare* dhe në mënyrë të përmbledhur do të paraqesim dallimet që ekzistojnë midis këtyre dy sistemeve të qeverisjes.

Tabela nr. 17: Krahاسimi midis sistemit parlamentar me atë presidencial.

Sistemi presidencial	Sistemi parlamentar
Ndarja e pushtetit (kontroll reciprok)	Kufizimi i pushtetit
Ekzekutivi dhe legjislativi janë të ndarë në mënyrë strikte	Ekzekutivi dhe legjislativi janë të lidhur nëpërmjet personelit
Qeveria dhe Parlamenti janë pavarura nga njëra-tjetra	Qeveria dhe shefi i Qeverisë, dalin nga Parlamenti, përgjigjen përpara tij dhe mund të rrëzohen prej tij
Partitë luajnë rol të vogël	Partitë kanë një pozitë të fortë

Në sistemet presidenciale, kabineti është i Presidentit dhe pozita kushtetuese e tij e bën atë të shquar. Ky pozicion mund të quhet (Sartori, 1994 b: 109) një "Solus Primus", si në rastin e Presidentit Amerikan. Në sistemet parlamentare, kabineti është i Kryeministrit dhe fuqia e tij mund të ndryshojnë në masë të madhe, duke përdorur terminologjinë e Sartorit "i pari sipër të pabarabartëve" në një medium "i pari në mesin të pabarabartëve", për një relativitet i dobët "i pari midis të barabartëve" (Lijpart, 1999: 113 – 114).

Dallimi parësor midis sistemit presidencial dhe parlamentar është se në sistemin parlamentar, kryetari i Qeverisë është Kryeministri, i cili është përgjegjës për legjislaturën dhe me votë mund të hiqet nga pozicioni drejtues që ka. Ndërsa në sistemin presidencial, kryetari i Qeverisë është Presidenti, i zgjedhur për një periudhë të përcaktuar, i cili nuk mund të hiqet/detyrohet nga një votë mosbesimi nga ana e legjislativit.

Dallimi i dytë është se presidentët janë zgjedhur nga populli ose drejtpërdrejtë ose nëpërmjet një kolegji të zgjedhur nga populli, ndërsa Kryeministri zgjidhet nga legjislatura. *Dallimi i tretë* është se sistemet parlamentare kanë drejtues kolektive ose kolegjiale, ndërsa sistemet presidenciale kanë drejtues një person e jo drejtuesve kolegjiale (116-118). Dallimi i tretë midis shumicës dhe modelit konsensual të demokracisë, ka të bëjë me marrëdhëniet midis ekzekutivit dhe legjislativit. Ku modeli mazhoritar është një prej dominimit të ekzekutiv, ndërsa modeli konsensual karakterizohet nga një marrëdhënie më të balancuar midis tyre (116).

Tabela nr. 18: Dallimet midis republikës presidenciale dhe parlamentare.

Republikës presidenciale (ShBA)	Republikës parlamentare (Britania e Madhe/Angli)
Kushtetuta e shkruar	Kushtetuta e pashkruar
Shtet Federal	Shtet Unitar
Republikë	Parlamenti
Kryetar Shteti Presidenti	Kryetar Shteti Kryeministri
Ndarja e pushteteve (kontroll/balanca)	Sintezë midis ekzekutivit dhe legjislativit (llogari/dhënie)
Supermaci kushtetuese	Supermaci parlamentare

Aarend Lijphart (6–31), në studimin e tij “Democracies”, trajton tiparet e modelimit Westminster (ose në mazhoritar) dhe të atij consensus (ose proporcional), si edhe dallimet që ekzistojnë midis këtyre dy sistemeve. Për këtë arsye ai mbështetet në organizimin dhe funksionimin e sistemit qeverisës në Britaninë e Madhe dhe në vendet e tjera anglofolëse, si edhe në disa vende të tjera europiane (cit Filo. 2011: 161 - 162). Në tabelën e mëposhtme janë përmbledhur tiparet kryesore të dy modeleve me dallimet mes tyre:

Tabela nr. 19: Tiparet kryesore e dallimet mesmodelit Westminster (mazhoritar) e consensus (proporcional).

1. Pushteti legjislativ me mbizotërim të kabinetit qeveritar: • Parlamenti përbëhet nga shumica njëpartiake (që mund të jetë edhe shumicë e thjeshtë) dhe pakica kryesisht njëpartiake. • Kabineti qeveritar formohet mbi bazën e shumicës parlamentare njëpartiake. • Qeveria e mbështetur në shumicën	1. Mbizotërimi i asamblesë: • Parlamenti nuk përfaqëson shumicë njëpartiake qoftë dhe një shumicë të thjeshtë. • Kabineti qeveritar është koalicion me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të disa partive. • Hartimi dhe miratimi i ligjeve është në varësi
---	---

parlamentare e ka të lehtë të hartojë ligje e po aq të marrë miratimin për ekzekutimin e tyre. • Epërsia e parlamentit shprehet në të drejtën e tij për votëbesimin apo mosbesimin për qeverinë dhe sidomos nëpërmjet veprimtarisë tepër efektive të opozitës. • Kabinetet qeveritare janë të qëndrueshme dhe realizojnë mandatin e plotë të fituar nga zgjedhjet elektorale. 2. Parlamenti me dy dhoma në lidhje asimetrike: ✚ Në Britani, Dhoma e Lordëve ose Dhoma e Lartë, ka kompetenca mjaft të kufizuara gjë që ka forcuar së tepërmi rolin e Dhomës së Komunave, e cila është dhoma e vetme që realizon qeverisjen përfaqësuese. ✚ Përqëndrimi i kompetencave legjislativë në njëërën dhomë (Dhoma e Komunave) shpreh lidhjen asimetrike në mes dy dhomave dhe është në favor të qeverisjes me shumicë njëpartiake. 3. Sistemi dypartiak: ✚ Dy parti të mëdha në përputhje me vullnetin elektorale formojnë shumicën parlamentare (pozitën) dhe pakicën (opozitën). Partitë e tjera kanë rol të vogël shpesh të papërfillshëm. ✚ Dallimi midis dy partive të mëdha janë të një përmase kryesisht për probleme e çështje sociale dhe ekonomike. ✚ Spektri politik partiak është kryesisht i qendrës së majtë dhe i qendrës së djathtë. 4. Sistemi elektorale mazhoritar: ✚ Zonat elektorale përcaktohen për zgjedhjen e një deputeti. Kandidati me numrin më të madh të votimeve, pra jo me shumicën e votimeve (mbi 50 %) shpallet deputet dhe pëlqimet e elektoratit për kandidatët e tjerë mbeten të papërfaqësuar. ✚ Favorizohet së tepërmi krijimi i shumicës ose mazhorancës njëpartiake. ✚ Partia që fiton shumicën e votave në shkallë kombëtare me numrin e vendeve që siguron në parlament, bëhet si të thuash “mbipërfaqësuese”. 5. Pluralizmi i grupeve të interes: ✚ Në përputhje me ndarjen e qartë të pozitës	tepër të madhe nga përbërja e parlamentit, nga koalicionet që krijohen dhe rikrijohen midis partive. • Qeveritë e koalicionit janë tepër të paqëndrueshme. Mosmarrëveshjet ndërmjet pjesëmarrësve të partive të ndryshme në to, çojnë në shpërbërjen e tyre të herëpashershme. 2. Parlamenti me dy dhoma: ✚ Të dyja dhomat janë me kompetenca të ndara pothuajse në mënyrë të barabartë, me ndonjë epërsi të vogël të njëres apo tjetres dhomë. ✚ Funksionimi i dy dhomave është në varësi të madhësisë hapësinore të vendit dhe të strukturës federative. ✚ Në shtetet federale dhoma e dytë përfaqëson ndryshimin e madh të interesave të popullsisë dhe njësive territoriale, si shtete, province. 3. Sistemet shumëpartiake: ✚ Parlamenti përbëhet nga përfaqësuesit e shumë partive. ✚ Dallimet ndërmjet partive janë shumëpërmasore, si për problemet ekonomike, fetare, etnike, urbane e rurale, për marrëdhëniet me vendet e tjera. ✚ Spektri politik është i shumanshëm përfshirë orientimin nga e majta, e djathta, qendra, ekstremi i majtë, ekstremi i djathtë. 4. Sistemi elektorale proporcional: ✚ Organizimi i sistemit elektorale është i tillë që synon të sigurojë përfaqësimin në parlament të të gjitha partive. • Vendet në parlament ndahen në mënyrë proporcionale me përqindjen e votave të fituara nga secila parti. • Është shumë e vështirë që të krijohet shumica njëpartiake. 5. Grupet e interes: ✚ Grupet e interes orientohen sipas partive politike e pak prej tyre shprehin qëndrime të
--	--

dhe opozitës, në qeverisje funksionojnë dhe grupet e interesit. ✚ Konkurrenca dhe konfliktet janë të pranishme në marrëdhëniet ndërmjet grupeve të ndryshme sociale. ✚ Koperimi ose bashkëpunimi me qeveritë është i rrallë. Grupet sociale të interesit janë më tepër grupe që ushtrojnë trynë ndaj politikave qeveritare. 6. Raportet ndërmjet qeverisë qendrore dhe institucioneve të qeverisë rajonale dhe vendore: ✚ Përqendrimi tepër i madh i pushtetit në organet qendrore. ✚ Organet e qeverisjes vendore janë në varësi të plotë nga qeveria qendrore. ✚ Strukturimi i tillë i qeverisjes është në përputhje me mbizotërimin e mazhorancës dhe është në favor të saj. 7. Rishikimi i legjislacionit: ✚ Nuk ekzistojnë organet e posaçme me detyrë përjashtimore për rishikimin e legjislacionit.	pavarura. • Është e fuqishme prirja për bashkëpunim dhe organizimin e takimeve të rregullta midis tyre dhe përfaqësuesve të qeverive në kërkim të marrëveshjeve për politikat sociale dhe ekonomike. 6. Raportet, qeverisja qendrore dhe rajonale: ✚ Dëqendërsimi i pushteteve. ✚ Organet qeverisëse rajonale dhe vendore me kompetenca të veçanta. 7. Rishikimi juridik i legjislacionit: ✚ Ekzistojnë organe të posaçme juridike për rishikimin e legjislacionit në përputhje me dispozitat kushtetuese.
--	--

Ndërsa në librin “Patterns of Democracy. Government Forms and Performance in Thirty-Six Countries” Arend Lijphart (1999: 3-4), përcakton dhjetë dallime në drejtim të kontraste midis modeleve të shumicës dhe konsensuale. Karakteristika mazhoritare është radhitur e para në çdo rast.

Pesë dallimet mbi dimensionin e ekzekutiv-parti politike, janë si më poshtë:

1. Përqendrimi i pushtetit ekzekutiv në partinë e vetme të kabinetit me shumicë kundrejt ndarjes së pushtetit ekzekutiv në koalicione të gjëra shumëpartiake.
2. Marrëdhëniet ekzekutive-legjislative, ekzekutivi është dominant ndaj bilancit ekzekutive-legjislative të pushtetit.
3. Sistem dypartiak kundrejt sistemeve shumëpartiake.
4. Sistemet e shumicës dhe joproporcional kundrejt përfaqësimit proporcional.

5. Sistemet pluraliste të grupit të interesit më i hapur për të gjitha garat mes grupeve, kundrejt sistemeve "korporatiste" të grupit interesit që synojnë kompromisin.

Pesë dallimet në dimensionin federal-unitar, janë formuluar si më poshtë:

1. Qeveri unitare dhe e centralizuar kundrejt qeverisë federale dhe të decentralizuar.
2. Përqendrimi i pushtetit legjislativ në një legjislaturë një dhomësh kundrejt ndarjes së pushtetit legjislativ në mënyrë të barabartë e të fortë mes dy dhomave.
3. Kushtetutat fleksibile që mund të ndryshohet me shumicë të thjeshtë kundrejt kushtetutave të ngurta që mund të ndryshohen vetëm me një shumicë të jashtëzakonshme.
4. Sistemet në legjislatura kanë fjalën e fundit mbi kushtetutshmërinë e legjislacionit të tyre kundrejt sistemeve ku ligjet janë subjekt i shqyrtimit gjyqësor të kushtetutshmërisë së tyre.
5. Bankat qendrore që janë të varura nga ekzekutivi kundrejt bankave qendrore të pavarura.

Në Britani dhe në ShBA është krijuar qëndrueshmëria në sistemin e qeverisjes së demokracisë liberale. Këto shtete ofruan modelin mazhoritar që më vonë u emërtua modeli Uestminster i sistemit të demokracisë liberale (Filo, Ll. 2011: 179). Modeli ofron sistemin elektoral pluralist, fitues është kandidati që merr më shumë vota. Sistemi elektoral favorizon sistemin dypartiak, ku partitë e mëdha alternoheshin në pozitë dhe opozitë. Kemi një qeveri një partiake, ku qeveria mban përgjegjëshmëri për qeverisjen e jep llogari elektoratit.

Modeli konsensus gjeti zbatim në vendet europiane të dala nga totalitarizmi dhe autoritarizmi. 'Qeverisje e sa më shumë vetave', ku nëpërmjet sistemit proporcional, në Parlament përfaqësohen të gjitha partitë politike. Sistemi proporcional favorizon sistemin shumëpartiak dhe në Parlament kemi shumë parti politike. Kemi sistemin shumëpartiak me mbizotërimin e një partie politike dhe sistemin shumëpartiak pa mbizotërimin e një partie. Pra, ekziston një lidhje midis sistemit elektoral dhe sistemit partiak (sistemi elektoral

mazhoritar favorizon sistemin dypartiak/sistemi elektoral proporcional favorizon sistemin shumëpartiak), që do t'i trajtojmë më gjërësisht në kapitujt e mëposhtëm.

Në këtë kapitull teorik trajtuam në mënyrë të hollësishme format e qeverisjes së demokracisë-liberale. Në mënyrë të përmbledhur kemi trajtuar formën parlamentare, gjysmë-presidenciale dhe presidenciale, duke trajtuar raste konkrete të shteteve më të zhvilluara në botë si ShBA, Angli, Itali. Duke analizuar formën qeverisëse, marrëdhënien midis legjislativit dhe ekzekutivit, marrëdhënien midis sistemit partiak dhe llojit qeverisës, si edhe marrëdhënia e fortë midis sistemeve partiake dhe llojit të kabinetit.

Rëndësi i është kushtuar analizimit të përfaqësuesve të popullit në degën ekzekutive të qeverisë, duke përcaktuar edhe kabinetin qeverisës. Kontrasti midis parimit të shumicës të përqëndrimit të pushtetit dhe parimit të konsensusit të gjerë në ndarjen e pushtetit, pra dallimi midis të qeverisurve me shumicë njëpartiake e koalicioneve të gjëra shumëpartiake. Si rrjedhojë, duke pasur një tablo të gjërë teorike të formave të ndryshme të qeverisjes në vende të ndryshme, do t'a kemi më të qartë se si bëhet ndarja e pushtetit, kush është posti më i lartë politik midis kryeministrit dhe presidentit, kush ka të drejtë për të shpërndarë legjislaturën, pra, kush ka të drejtë të ushtrojë pushtetin ekzekutiv në format e ndryshme të qeverisjes.

Dhe në kapitujt e mëposhtëm do të trajtojmë Shqipërinë si rast studimor, duke trajtuar në mënyrë të hollësishme të gjitha variablat e mësipërme, si raporti midis legjislativit dhe ekzekutivit, marrëdhënia midis sistemit elektoral dhe llojit qeverisës, lidhjen midis sistemeve elektorale dhe llojit të raportit midis qeverisjes parlamentare me ato presidenciale, marrëdhënia midis sistemit partiak dhe llojit qeverisës, marrëdhënia midis sistemeve elektorale, sistemeve partiake dhe llojit të kabinetit.

KAPITULLI IV: KONTEKSTI HISTORIK

Format e qeverisjes në Shqipëri përgjatë tranzicionit

Punimi bën një analizë të gjërë të sistemit elektoral që është aplikuar në vendin tonë përgjatë viteve të tranzicionit, e cila na ndihmon për të kuptuar qëndrueshmërinë e sistemit elektoral dhe sesi ky sistem zgjedhor ka ndikuar në formën qeverisëse të vendit tonë. Gjithashtu, punimi analizon gjithashtu edhe legjislacionin e sistemeve elektorale shqiptare, gjë që e ndihmon për të kuptuar se çfarë formë qeverisëse favorizon legjislacioni. Bëhet një analizë e legjislacionit shqiptar mbi sistemin zgjedhor për të parë sesi ky legjislacion inkurajon lidhje më të forta të sistemit njëpartiak me kabinetin njëpartiak dhe të sistemit shumëpartiak që inkurajon lidhje me kabinetin e shumicës ose të tepërt.

Si rrjedhojë, kemi ekzistencën e një lidhje të ngushtë midis sistemit zgjedhor, partiak dhe llojit qeverisës. Nëse numri i partive efektive parlamentare rritet, atëherë mundësia e kabinetit minimal një-partiak ulet. Marrëdhënia e fortë midis sistemeve zgjedhore dhe llojit të kabinetit është pjesë studimi, ku ne kuptojmë fuqinë e ndikimit që ka sistemi elektoral në formën qeverisëse në vend.

Atëherë në këtë kapitull do të trajtojmë çështje të tilla, si: *Si ka ndikuar/inkurajuar legjislacioni i sistemeve elektorale në favorizimin e formave qeverisëse? Këto rezultate zgjedhore janë ekzaminuar nga perspektiva teorike e Arend Lijphart. Si ka ndikuar Ligji Nr.7491, më datë 29.4.1991 “Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese” që sanksionon Shqipërinë Republikë Parlamentare në marrëdhënien midis pushteteve (ekzekutiv-legjislativ / Parlament dhe Presidencë)? Si kanë ndikuar Ndryshimet Kushtetuese të vitit*

1998-të në marrëdhënien midis pushteteve (ekzekutiv-legjislativ, Parlament dhe Presidencë)? Cila është formula e zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Shqipërisë me Ligjit e vitit 1991 dhe me Ndryshimet Kushtetuese të vitit 2008-të dhe cilat janë kompetencat e tij duke u bazuar në këto ligje?

Dhe risia në këtë punim doktoral, që do ta trajtojmë në këtë kapitull edhe në kapitullin e pestë, është analizimi i të gjithë zgjedhjeve të përgjithshme të mbajtura në Shqipëri nga viti 1991-2013 sipas teorisë së Arend Lijphart “*Ndikimi i sistemit elektoral në formën qeverisëse*” dhe çdo rezultat do t’i analizojmë nëpërmjet gjashtë teorive të koalicionit të Lijphart. Do të trajtojmë gjërësisht sistemin zgjedhor (legjislacionin shqiptar) dhe ndikim e tij në rezultatet paszgjedhore. Pas një analize të mirfilltë, duke u bazuar në rezultatet dhe në numrin e mandateve për çdo parti politike të djathtë dhe të majtë, do të përcaktojmë edhe krijimin e kabinetit qeveritar (duke u bazuar në gjashtë koalicionet e Lijphart). Në këtë mënyrë do të analizojmë ndikimin e sistemit zgjedhor në formën qeverisëse në vendin tonë nga viti 1991 deri në vitin 2013-të.

4.1 Shqipëria gjatë viteve të ndryshimeve rrënjësore 1990-1991

Shqipëria para viteve '90 ka qenë nën pushtetin e një partie-shtet dhe këtë e vëmë re edhe në formën qeverisëse të vendit tonë. Gjatë kësaj periudhe prej pesë dekatash, vendi ynë kishte një mbyllje totale nga Perëndimi dhe nga vendet fqinje Ballkanike. Në vend nuk kishte të drejtën/lirinë e fjalës, veprimit dhe të drejtave më themelore të njeriut, si sociale, kulturore, politike etj. Por, pas viteve 1990-të vërehet krijimi i një numri shumë të madh të partive politike dhe kjo vjen si kundërshti e sistemit politik të atëhershëm. Pas zgjedhjeve të

para ‘demokratike’ plurale, kemi krijimin e sistemit dypartiak në vendin tonë, të cilën do ta analizojmë gjërësisht më poshtë.

Klasa politike shqiptare në fillim të viteve 90’ nuk kishte eksperiencë në ndërtimin e shtetit, si edhe të institucioneve demokratike. Si rrjedhojë, kjo klasë kishte përpara sfida të rëndësishme dhe prioritare, si zgjedhja e një sistemi elektoral, si projektimi i institucioneve demokratike, të rregullave institucionale, ligjeve e normave të reja. Periudha e gjatë kohore nën pushtetin e një partie-shtet (Partia e Punës Shqiptare) prej 46 vitesh, ka ndikuar dhe kjo kulturë është pasqyruar gjërësisht në funksionimin e brendshëm të partive politike, në praktikat dhe në perceptimin e tyre. Gjatë 25-së viteve tranzicioni, vërehet se partitë politike janë përcaktuese në raport me institucionet shtetërore dhe me vetë shoqërinë shqiptare.

Historia e zgjedhjeve politike dhe proceseve elektorale është po aq e brishtë dhe e shtrirë në kohë dhe në problematika, sa edhe vetë historia e shtetit shqiptar (Krasniqi, 2009: 13). Zhvillimi i zgjedhjeve gjatë kësaj periudhe ishte shoqëruar me klimë të ashpër politike, me devijime të konsiderueshme, të cilat kanë pasur ndikim në rezultatin e zgjedhjeve (Berhani, 2009: 11). Ky është rezultat i një trashëgimie nga periudha komuniste, ku kemi konflikte politike të vazhdueshme dhe mungesë të traditës demokratike shqiptare. Prandaj në Shqipëri, thekson Luani (2002: 307), janë vërejtur dukuri të tilla, si zgjedhje të zhvilluara me manipulime ose ku është përdorur edhe dhuna, bojkotime të parlamentit, shkelje të përsëritura të të drejtave të njeriut etj.

Me një vend ekonomikisht të varfër, me mungesë të modeleve referuese dhe mungesë të eksperiencës demokratike/plurariste të klasës politike, Shqipëria nuk pati elementë të brendshëm nxitës të lëvizjeve politike ose nivele përbërëse të shoqërisë, si

intelektualë dhe shoqëria civile. Në tërësinë e tij procesi zgjedhor ka marrë më shumë karakter institucional, ku aktorët politikë humbës të zgjedhjeve pavarësisht kontekstive që mund të kenë, i kanë pranuar rregullat e garës elektorale duke rënë në konsensus ndërpartiak. Sipas studjuesve kjo ka mundësuar një stabilitet relativisht të dukshëm në dekadën e dytë post-komuniste, krahasuar me dekadën e parë të saj.

Nënvizojmë se historia shqiptare e pas viteve 1990-të është një histori pluripartiake, ku janë krijuar një numër i konsiderueshëm të partive politike. Rreth këtij fenomeni kemi një shpjegim historik pasi plotësimi i këtij vakumi partiak, pasi për një periudhë të gjatë nën drejtimin e një sistemi njëpartiak, solli edhe përcaktimin e një sistemi zgjedhor mazhoritar deri në miks me atë proporcional. Sistemi mazhoritar me një miksim të vogël proporcional, erdhi si një domosdoshmëri historike që do të sillte në parlamentin shqiptar, parti politike të gjithfarë ngjyrave dhe nuancave të tyre (NDIHA, (2005) “Politikani i Ri”, f. 5-6). Dhe themelimi i Partisë Demokratike në dhjetor të vitit 1990, shënon fillimin e shpërbërjes së shtetit të diktaturës komuniste dhe fillimin e pluralizmit politik.

Dalja në pohim të PD-së, lidhet me krijimin e një kulture të re politike, përkatësisht demokratike, duke respektuar të drejtat e njeriut (Zogaj, 2014 f: 412), duke i dhënë fund komunizmit që ishte shtrirë thellë në vendin tonë. Në zgjedhjet e vitit 1991, u regjistruan partitë e reja, duke përfshirë Partinë Republikane, Partinë Agrare, Partinë Ekologjike e Bashkimit Demokratik për Minoritetin Grek (Omonia). E gjithë media botërore dhe 260 vëzhgues ndërkombëtarë perëndimorë kishin mbërritur në kryeqendrën Shqiptare. Por le t'i trajtojmë pak në vija më të përgjithshme rreth themelimit të tyre:

Partia Demokratike, u themelua duke dalë nga revolta e studentëve kundër Qeverisë Shqiptare dhe PPSH, u legalizua më 19 tetor 1990. Gazeta e saj periodike ishte Rilindja

Demokratike. PD premtonte se do sillte një ndryshim rrënjësor dhe një transformim të nivelit të jetesës, ku kjo do të arrihej me anëtarësimin e Shqipërisë në Komunitetin European (KE). Në zgjedhjet e vitit 1992, PD vuri 97 prej 100 kandidatëve në 100 zonat zgjedhore. Në shkurt të po këtij viti, hyri në koalicion me PSD dhe PR, ku mori 60% të votave e 92 mandate në parlament. Aleksandër Meksi u besua të formojë qeverinë e re.

Partia Socialiste: PPSH e mbajti kongresin e saj të dhjetë në qershor të vitit 1991, ku mori emrin Partia Socialiste e Shqipërisë, duke spastruar pjesën më të madhe të udhëheqësve të huaj. Fatos Nano, për shkak të background-it të tij u besua që të drejtojë partinë. PS paraqiti 100 kandidatë në 100 zonat zgjedhore, por në këto zgjedhje mundën të marrin vetëm 38 mandate, ku prej kësaj liste mundën të merrnin vetëm 6 mandate.

Partia Republikane (PR), partia e dytë opozitare, u formua pas dhjetorit të vitit 1990 dhe u legalizua në janar të vitit 1991. Sabri Godo ishte kryetari i saj. Gazetën e tyre ishte “Republika”, që publikohej dy herë në javë. PR mori pjesë në këto zgjedhje, por u dëmtua nga sistemi 50 + 1 dhe nuk arriti të kishte përfaqësues në parlament sepse mori vetëm 2 % të votave. PR, ishte partia më e rëndësishme ndër partitë e vogla, me një program të ngjashëm me atë të PD-së (Vickers dhe Pettifer, 1998: 56).

Partia Social Demokrate (PSD), u legalizua në prill të vitit 1991. Kryetar i saj ishte Skënder Gjinushi. Kjo parti e re mori 4,3 % të votave dhe arriti të marrë 7 vende në Kuvendin Popullor. Gjinushi ishte i vetmi i zgjedhur nga një zonë zgjedhore.

Bashkimi për të Drejtat e Njeriut. Në vitin 1991, minoriteti grek mbështeti Omonian. Ato në këto zgjedhje morën vetëm 3 mandate, por në zgjedhjet e viti 1992 u përjashtuan se sipas dy partive të mëdha nuk mund të quhej parti. Por në shkurt të vitit 1992, ata krijuan një parti të re të quajtur Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, ku arriti të

nxjerrë 29 kandidatë dhe ku morën vetëm 2,9 % të votave. Në këtë mënyrë ata fituan 2 deputetë në parlament.

Ndërsa partitë e tjera të vogla janë:

- Partia Agrare (u legalizua në vitin 1991);
- Partia Komuniste (u legalizua në vitin 1992);
- Partia Demokristiane (u legalizua në vitin 1992);
- Partia Ekologjike (u legalizua në vitin 1991);
- Partia e Unitetit Kombëtar (u legalizua në vitin 1991).

4.2 Ligji Nr.7491, më datë 29.4.1991 “Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese” sanksionon Shqipërinë Republikë Parlamentare

Shqipëria pas një periudhe relativisht të gjatë, me miratimin e Asamblesë Kushtetuese të vitit 1946-të, të Statutit të Republikës Popullore të Shqipërisë; më pas të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë, më 5 korrik të vitit 1950, që Shqipërinë e shpallte Republikë Popullore; dhe më pas të Kushtetutës së vitit 1976-të, Ligji Nr.5506, datë 28.12.1976, që sanksiononte Shqipërinë Republikë Popullore Socialiste, ka qenë nën udhëheqjen e partisë komuniste (sistem njëpartiak). Prej një gjysëm dekate, vendi ynë ka qenë nën drejtimin e partisë-shtet, ku liritë themelore dhe të drejtat e njeriut nuk zbatoheshin, kishim një varfëri ekstreme dhe nivel arsimimi tepër të dobët.

Por, me rrëzimin e komunizmit në Europën Lindore edhe në vendin tonë u krijuan kushtet e përshtatshme për rrëzimin e partisë-shtet, e cila ka qenë paralizuese për vendin në të gjitha sferat e jetës sociale, kulturore, ekonomike, politike etj. Vetëm në vitin 1991, në

Shqipëri kemi përpjekjet e para për miratimin e një Kushtetute demokratike, por komisioni kushtetues i ngarkuar nga ish-Partia e Punës së Shqipërisë (PPSh) nuk arriti të marrë miratimin e opozitës së atëhershme. Orientimi demokratik i shtetit, sipas Bashkim Dedes¹, kërkonte kryerjen e një reforme institucionale të thellë, ku do t'i hapte rrugë shndërrimeve të mëdha, për ndërtimin e shtetit të së drejtës dhe respektimit të drejtave të njeriut.

Si rrjedhojë, në kushtet e anulimit të kushtetutës së vitit 1976, kemi miratimin e Ligjit Nr.7491, më datë 29.4.1991 “Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese” që shpalli Shqipërinë Republikë parlamentare (Neni 1). Partitë politike lejohen të funksionojnë dhe të ushtrojnë veprimtarinë e tyre, pra pluralizmi politik është kusht për funksionimin e qeverisjes demokratike. Ky dokument sanksiononte pluralizmin politik dhe sistemin shumëpartiak, si të domosdoshëm për qeverisjen e vendit. Kufizonte kompetencat e Presidentit, i cili zgjidhej nga Parlamenti për një periudhë pesë vjeçare, ndërsa Kuvendi kishte kompetenca të gjëra në përcaktimin e drejtimit të politikave të brendshme dhe të jashtme të shtetit.

Në nenin 3 të Kushtetutës nënvizohet parimi themelor i organizimit shtetëror, që është ndarja e tre pushteteve (legjislativ, ekzekutiv e gjyqësor) dhe kompetencat/detyrat e tyre janë të përcaktuara specifikisht në këtë ligj. Populli/qytetarët ushtrojnë pushtetin e tij nëpërmjet organeve përfaqësuese, por edhe me anë të referendumit populli mund të vendosë vetë për vendime të rëndësishme që kanë të bëjnë me vendin dhe qeverisjen. Ndërsa në nenin 5, specifikohet se:

¹ Bashkim Dedja, nga shtatori i vitit 2012 deri tani është në pozicionin si Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Fjalimi hyrës në “100 vjet – Shtet. Drejtësia Kushtetuese në forcimin e shtetit të së drejtës”, marrë më 9 maj 2013, faqa nr. 4, Tiranë.

Pushteti ligjvënës i takon Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë. Kryetari i Shtetit është Presidenti i Republikës i zgjedhur nga Kuvendi Popullor. Të drejtat dhe detyrat e Presidentit përcaktohen me këtë ligj. Organi më i lartë i pushtetit ekzekutiv është Këshilli i Ministrave. Të drejtat dhe detyrat e Këshillit të Ministrave përcaktohen me këtë ligj. Pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat që janë të pavarura dhe udhëhiqen vetëm nga ligji.

Në kreun e II, për “Organet e Larta të Pushtetit Shtetëror”, Kuvendi Popullor (Neni 15) është organi më i lartë i pushtetit shtetëror dhe i vetmi organ ligjvënës. Kuvendi përbëhet nga 250 deputetë, të cilët zgjidhen për një kohë prej katër vjetësh. Iniciativë ligjvënëse ka Presidenti i Republikës, Këshilli i Ministrave, deputetët, si edhe grupi prej 20000 shtetasish me të drejtë vote (Neni 23). Ligjet dhe aktet e tjera të Kuvendit Popullor, përveç atyre kushtetues, quhen të miratuara kur ka shumicë votash, por jo më pak se 1/3 e deputetëve.

Kuvendi zgjedh Kryesinë e tij, kryetarin dhe dy zëvendëskryetarët. Në raste lufte ose gjendjeje të jashtëzakonshme Kuvendi mund ta zgjatë veprimtarinë e tij përtej afatit të caktuar. Kuvendi Popullor zgjedh komisione të përhershme e të përkohshme dhe në sesionin e parë zgjedh një komision për shqyrtimin e mandatave të deputetëve, ku Kuvendi vërteton ose anulon mandatet e deputetëve. Komisionet e përhershme shqyrtojnë projektligjet dhe dekretet normative të Presidentit, ndjekin e kontrollojnë veprimtarinë e ministrave dhe të organeve tjera shtetërore. Ndërsa komisionet e përkohshme krijohen për çështje të caktuara.

Në kreun e II, për “Organet e Larta të Pushtetit Shtetëror”, pika B specifikohet roli i kryetarit të shtetit. Presidenti i Republikës së Shqipërisë është kryetari i shtetit e përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti (Neni 25) ka një mandat 5 vjeçar dhe zgjidhet nga Kuvendi me votim të fshehtë prej 2/3 të votave. Në rast se në votimin e parë nuk sigurohet shumica e kërkuar, atëherë bëhet një votim i dytë ku kanë të drejtë të paraqiten dy kandidatët që kanë fituar numrin më të madh të votave në votimin e parë dhe Presidenti zgjidhet me shumicën

absolute të votave. Funkzioni i Presidentit është i papajtueshëm me çdo funksion tjetër, veç atyre të parashikuara në këtë ligj. Presidenti shkarkohet përpara mbarimit të mandatit, nëse ka kryer krimin e tradhtisë ndaj Atdheut ose kur gjendja shëndetësore e tij nuk e lejon të përmbushë detyrat, ose kur jep dorëheqjen me vullnet të lirë. Presidenti është Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe Kryetar i Këshillit të Mbrojtjes.

Në Kreun e III-të, “Organet e Larta të Administratës Shtetërore”, në Nenin 33 të Kushtetutës specifikohet se, Këshilli i Ministrave është organi më i lartë ekzekutiv e urdhërdhënës. Këshilli i Ministrave emërohet në sesionin e parë të Kuvendit, ku Presidenti emëron Kryetarin e Këshillit të Ministrave e me propozim të tij edhe ministrant e kabinetit. Në rast se nuk merr votëbesimin, Kryetari i Këshillit të Ministrave i paraqet menjëherë dorëheqjen Presidentit, i cili cakton Kryetarin e ri të Këshillit të Ministrave. Vetëm 1/10 e deputetëve të Kuvendit kanë të drejtë të paraqesin një mocion mosbesimi ndaj Këshillit të Ministrave ose anëtarëve të veçantë të tij (Neni 34). Mosmiratimi nga Kuvendi i propozimit të Qeverisë, detyrimisht Qeveria nuk jep dorëheqje.

Këshilli i Ministrave është organ kolegjal dhe vendimet merren kur miratohen nga shumica absolute të anëtarëve të tij. Përbërja, atributet e organizimi i Këshillit rregullohen me ligj. Ministrat përgjigjen kolegjalisht për aktet e Këshillit të Ministrave e individualisht për aktet e dikastereve të tyre. Ministrat, për çështjet që janë në kompetencën e tyre, nxjerrin urdhra, rregullore e udhëzime në bazë të ligjeve dhe të urdhëresave e të vendimeve të Këshillit të Ministrave dhe për zbatimin e tyre. Në nenin 43, nënvizohet se projektet për ndryshimet në këtë ligj mund të paraqiten prej Presidentit, prej Këshillit të Ministrave ose prej 1/4 së deputetëve dhe miratimi i ndryshimeve bëhet nga Kuvendi me një shumicë prej 2/3 të votave të deputetëve.

Tabela nr. 20: Kompetencat e detyrat e Organeve të Larta të Pushtetit Shtetëror, të përcaktuara në Kushtetutën e Shqipërisë në vitin 1991.

Presidenti i Republikës	Kuvendi Popullor	Këshilli i Ministrave
Kryetari i shtetit e përfaqëson unitetin e popullit (Mandat 5 vjeçar)	Organi më i lartë i pushtetit shtetëror, i vetmi organ ligjvënës	Është organi më i lartë ekzekutiv dhe urdhërdhënës
Ka të drejtë të iniciativës ligjvënëse	Iniciativë ligjvënëse kanë deputetët	Iniciativë ligjvënëse Këshilli i Ministrave
Emëron Kryetarin e Këshillit të Ministrave dhe pranon dorëheqjen e tij.	Zgjedh e shkarkon Presidentin	Nxjerr vendime/urdhëresa/udhëzime në bazë të Kushtetutës dhe të ligjeve, për zbatimin e tyre
Emëron e shkarkon me propozimin të Kryetarit Ministrave, anëtarë të veçantë të Qeverisë; drejtuesit e institucioneve tjera qendrore.	Zgjedh/emëron/shkarkon Gjykatën e Lartë, Prokurorin e Përgjithshëm e zëvendësit e tij.	Këshilli i Ministrave emërohet në sesionin e parë të Kuvendit, ku Presidenti emëron Kryetarin e Këshillit Ministrave, e me propozim e tij edhe ministrant e kabinetit.
Midis dy sesioneve të Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave emëron/shkarkon anëtarë të veçantë të Qeverisë; diplomatikë	Miraton/ ndryshon Kushtetutën, ligjet projektprogramet ekonomik dhe sociale;buxhetin e shtetit.	Drejton veprimtarinë për realizimin e politikës së brendshme dhe të jashtme të shtetit.
Pasi merr mendimin e Kryetarit të Ministrave e Kryetarit të Kuvendit, mund të shpërndajë Kuvendin kur nuk kemi ushtrimin e funksioneve të tij dhe e bën të pamundur qeverisjen e vendit	Vendos krijimin ose prishjen e ministrave dhe të organeve të tjera të njësuara me to.	Harton programet ekonomik/sociale të zhvillimit të vendit dhe treguesit ekonomikë sintetikë, buxhetin e shtetit, ndjek/kontrollon zbatimin etyre, disiplinon/kontrollon financat e shtetit e sistemin monetar/të kreditit.
Ushtron të drejtën e faljes.	Vendos për referendumet.	Bën ndarjen ose bashkimin e njësive administrativo-tokësore
Jep dekorata dhe tituj nderi.	Jep amnistinë.	Merr masa për ruajtjen/ mbrojtjen e mjedisit, kushtet e përshtatshme të punës; mbrojtjen shëndetit shtetasve.
Jep të drejtën e strehimit politik.	Ratifikon dhe denoncon traktatet me karakter politik; ushtarak	Merr masat për sigurimin/forcimin e rendit juridik e të drejtave shtetasve.
Brënda 15 ditëve nga miratimi i një ligji prej Kuvendit, mund ti'a kthejë për rishqyrtim vetëm një herë.	Vendos për mobilizimin të pjesshëm/përgjithshëm, gjendje tëjashtëzakonshme, gjendje luftës	Lidh marrëveshje ndërkombëtar, miraton/denoncon ato që nuk i nënshtrohen ratifikimit
Është Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe Kryetari i Këshillit të Mbrojtjes.	Kontrollon RTSH dhe ATSH; mjetet zyrtare të informacionit public që janë nën varësi	Kryetari përfaqëson Këshillin e Ministrave, kryeson mbledhjet, drejton veprimtarinë e përgjithshme dhe përgjigjet për të, siguron unitetin e drejtimit politik e administrativ të Qeverisë, duke bashkërenduar punët e ministrave/institucioneve qendrore.

Shqipëria u shpall Republikë Parlamentare (Neni 1) dhe është shtet juridik e demokratik. Pluralizmi politik është kusht për funksionimin e qeverisjes demokratike. Në

nenin 3 të Kushtetutës nënvizohet parimi themelor i organizimit shtetëror, që është ndarja e tre pushteteve (legjislativ, ekzekutiv e gjyqësor) dhe kompetencat e tyre janë të përcaktuara specifikisht në këtë ligj. Populli ushtron pushtetin e tij nëpërmjet organeve përfaqësuese, por në raste të veçanta edhe me anë të referendumit. Në këtë Ligj specifikohet se, Pushteti ligjvënës i takon Kuvendit, ndërsa Kryetari i Shtetit është Presidenti i Republikës i zgjedhur nga Kuvendi Popullor. Organi më i lartë i pushtetit ekzekutiv është Këshilli i Ministrave. Ndërsa pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat që janë të pavarura dhe udhëhiqen nga ligji.

Presidenti zgjidhet (Neni 25) për një mandat 5 vjeçar nga Kuvendi, me votim të fshehtë prej 2/3 të votave. Si rrjedhojë mund të nënvizohet faktin, se Presidenti është një personalitet që përkrah Kuvendin ekzistues ose i dalur prej tij sepse kemi një votim me një shumicë vote. Presidenti më pas emëron Kryetarin e Këshillit të Ministrave, i cili është edhe kryetari i partisë fituese e me propozim të tij, emëron ministrat e kabineteve qeveritare. Presidenti është Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe Kryetari i Këshillit të Mbrojtjes. Nga ky Ligj del një figurë e Presidentit jo e fortë politikisht dhe me kompetenca të pakta, i cili nuk ndikon në qeverisjen e vendit.

Sigurisht, në këtë kushtetutë shohim një Kryeministër i cili ka të gjitha kompetencat. Gjithashtu Kuvendi zgjedh/emëron/shkarkon Gjykatën e Lartë, Prokurorin e Përgjithshëm dhe zëvendësit e tij. Kuvendi është organi më i lartë i pushtetit shtetëror në Shqipëri dhe është i vetmi organ ligjvënës. Shteti kontrollohet dhe drejtohet nga Qeveria nëpërmjet Kuvendit.

4.2.1 Ligji i parë elektorale i vitit 1991

Në mars të vitit 1991, për herë të parë në Shqipëri u arrit të krijohet një kuadër ligjor demokratik i ri, që krijoi mundësinë e pjesëmarrjes së qytetarëve në zgjedhje të lira dhe demokratike. Kuadri ligjor është përgatitur vetëm katër muaj përpara datës së zgjedhjeve, si rrjedhojë ligji zgjedhor ishte përgatitur kur Shqipëria ishte një shtet njëpartiak dhe është hartuar për fitoren e komunistëve në zgjedhje (Biberaj, 2011: 144). I referohemi në këtë mënyrë Ligjit Nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese” që sanksionon Shqipërinë Republikë Parlamentare. Por, nuk kemi të bëjmë me një ligj të plotë, ky ishte një ligj i përkohshëm sepse në zgjedhjet që janë zhvilluar në vitet në vazhdim, ky kuadër ligjor ka pësuar ndryshime dhe përmisime të vazhdueshme.

Në një deklaratë të përbashkët të dy partive më të mëdha opozitare, të Partisë Demokratike dhe Partisë Republikane, duke e cilësuar këtë ligj zgjedhor të shtrembëruar në favor të partisë komuniste dhe jo të plotë, kërkuan një sistem përpjestimor në vend të atij mazhoritar (Gazeta Republika, 14 shkurt 1991, fq. 1). Lidërt e partive opozitare të sapo formuara, duke i'u referuar sistemit zgjedhor që do të përdorej për zgjedhjet e para pluraliste në Shqipëri, parashikuan fitore të Partisë së Punës. Gjithashtu, PPSH kishte epërsi të dukshme ndaj partive tjera, në burime dhe ishte e shtrirë në gjithë vendin.

Zgjedhjet e para të cilësuar si shumëpartiake më 31 mars 1991, u zhvilluan me votim të përgjithshëm dhe të fshehtë, ku u votua me një ligj mazhoritar me dy turne. Nëse asnjë nga kandidatët në zonat njëemërore nuk arrinin të fitojnë më shumë se 50% + 1 vota, atëherë dy kandidatët me rezultatin më të mirë (me më shumë se 30% të votave) të arritur në raundin e parë, kalojnë në raundin e dytë i mbajtur në 7 Prill të vitit 1991. Fitues në raundin e dytë është kandidati që ka fituar numrin më të madh të votave.

Pas 46 vitesh, Partia e Punës do të përballej për herë të parë me votën e fshehtë dhe do të kishte një parti kundërshtare. Ndryshimet ligjore të dekretuara me Dekretin 7442, datë 17.12.1990, të cilat ligjëruan pluralizmin politik, në këtë mënyrë i hapën rrugë krijimit të partive të reja politike dhe konkurimit shumëpartiak në zgjedhjet e marsit 1991. Zgjedhjet e para pluraliste u hartuan në një periudhë të shkurtër dhe Ramiz Alia sipas një manovre ka krijuar një lloj ‘pluralizmi’, por pa parti (Çili, 2002: 19). Në legjislaturën e parë pluraliste u miratua ligji “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë” (ligji nr. 7556), Neni 17, paragrafi i parë sanksiononte përbërjen e Kuvendit prej 250 deputetë. Në logjikën e mazhoritarit vendi ishte ndarë në 250 zona elektorale njëemërore (Katz, 1997).

Morën pjesë 11 parti politike dhe partitë që shiheshin si rrezik për Partinë Komuniste ishte PD dhe PR. Gjithashtu morën pjesë edhe 17 kandidatë të pavarur (Gazeta Zëri i Popullit, 21 mars 1991, fq. 1). Partia e Punës, Partia Demokratike, Partia Republikane dhe shoqata politike “Omonia” të minoritetit grek, konkuruan për 250 vendet parlamentare. PPSH pas dy muajsh do të shndërrohej në Partinë Socialiste të Shqipërisë, e cila fitoi përafërsisht 2/3 e vendeve në Parlament. Ndërsa PD ishte partia opozitare e parë dhe më e madhe në vend, e cila fitoi 70 deputetë me sistemin mazhoritar dhe rreth 40 % të votimeve me sistemin proporcional. Ndërsa 5 deputet i fitoi shoqata politike “Omonia”.

Sipas Bellos, rëndësi përtej zgjedhjes së sistemit elektoral, ka edhe vullneti politik sepse është pikërisht kjo klasë që bën të mundur zbatueshmërinë e sistemit zgjedhor, si dhe ndikimin e sistemit zgjedhor mbi procesin zgjedhor. Dhe në pyetjen e gjashtë të intervistës, rreth sistemit më të përshtatshëm për vendin tonë, Bello ka argumentuar se:

Është e vështirë të thuash se cili do të ishte sistemi elektoral më i mirë për kushtet e vendit tonë, pasi jam i sigurt se do ta kundërshtonin sa herë partitë humbasin dhe i’a vënë fajin sistemit. Gjithsesi, nga

sa kam parë, ndoshta një sistem i pastër proporcional kombëtar ose mazhoritar i pastër kombëtar do të ishte më pranë së vërtetës.

Këto zgjedhje ishin një test i rëndësishëm politik për aftësinë e klasës së re politike dhe për përshtatjen e saj me standartet demokratike. Vërejmë një ngjashmëri të rezultateve zgjedhore me Vendet e Ballkanit, në lidhje me mënyrën sesi kanë votuar pjesa më e madhe e fshatrave. Kjo vjen edhe për faktin se, partitë opozitare të sapoformuara në këto zgjedhje nuk kishin një shtrirje në tërë territorin (sidomos me zonat rurale), kishin mungesë të mjeteve (burimeve), si edhe pamundësi të ndërhyrjes në media.

4.2.2 Situata politike para dhe pas zgjedhjeve të para demokratike për Kuvendin Popullor më 31.03.1991 dhe krijimi i “Qeverisë së Stabilitetit”

Zgjedhjet e para pluraliste u mbajtën në 31 mars të vitit 1991. Përpara deputetëve të atij legjislacioni qëndronte problemi i abrogimit të Kushtetutës së vitit 1976-të dhe miratimi i një Kushtetute të re demokratike, në këtë mënyrë do të hidhte bazat e demokracisë në Shqipëri. Në këtë situatë, sipas Fugës (2008: 207-208) me propozim të opozitës, ranë në një konsensus për të miratuar një ligj bazë ose themelor me një numër të kufizuar nenesh dhe Shqipëria u shpall Republikë Parlamentare. Për herë të parë, në vitin 1991 në Shqipëri u krijua një kuadër ligjor demokratik, por sipas autorëve të librit “Paradigma e tranzicionit demokratik” (Tarifa et al. 2009: 82), ky kuadër ligjor ishte i paplotë dhe i përkohshëm.

Edhe pse në një shoqëri pluraliste një konsensus universal nuk është kurrë i mundur, ndryshimet kushtetuese dhe, si pjesë e tyre, ndryshimet e sistemeve elektorale, janë ndër ato zhvillime politike, të cilat kërkojnë një konsensus të gjërë apo një shumicë të kualifikuar, mbështetur në parimin demokratik ‘sundimi i shumicës, duke respektuar të drejtat e pakicës (po aty, 83).

Duke qenë të ndërgjegjshëm se hartimi i një Kodi të ri Penal është një punë shumë e vështirë, Lush Përpali ka nënvizuar se është e domosdoshme që të bëhen kërkime në kohë,

në mënyrë që sistemi t'i përshtatet situatave që kalon vendi dhe të ketë një jetë relativisht më të gjatë se sa në formën siç është projekti (2004: 72). Në rend të ditës u shtruan çështje të rëndësishme si, zëvendësimi i regjimit politik të mëparshëm me një sistem demokratik pluralist, kalimi nga ekonomia e komanduar socialiste në ekonominë e tregut dhe respektimi i lirisë e të drejtave të njeriut (Mezini, 2010: 221-222).

Prej 250 zona elektorale një emërore, në raundin e parë të zgjedhjeve janë fituar 242 mandate, ku Partia e Punës fitoi 162 prej tyre, ndërsa 66 mandate Partia Demokratike, 3 mandate organizata Omonia dhe 1 mandat Komiteti i Veteranëve. Në 17 zona zgjedhore u mbajt raundi i dytë i zgjedhjeve dhe në një prej zonave zgjedhore u përsëritën edhe një herë zgjedhjet sepse vetëm një kandidat kishte arritur të merrte më shumë se 30% të votave. Partia Demokrate mori 10 mandate, PPSH mori 7 mandate dhe Omonia mori 2.

Rezulati përfundimtar, PPSH mori në total 169 mandate, më shumë se 2/3 (167) e mandateve dhe me këtë numër ata mund të miratonin një Kushtetutë të re. PD mori 75 mandate dhe Omonia mori 5 mandate (Vickers dhe Pettifer, 1998: 56-58). Në këto zgjedhje janë regjistruar 1.984.933 zgjedhës. Në votim për Kuvendin Popullor morën pjesë 1.963.568 zgjedhës ose 98.92% e tyre (Njoftim i KQZ, 15.01.1991, Gazeta Zëri i Popullit, nr. 90, fq. 1-3), një përqindje shumë e lartë e votuesve, e cila na tregon një ndikim në mentalitetin e mëparshëm dhe një formë ndikimi në rezultatet e para pluraliste.

Tabela nr. 21: Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 1991.

Nr.	Emërtimi i partive	Mandate të fituara në Kuvendin Popullor	% e mandateve në raport me mandatet totale 250	Përqindja në vota
1	Partia e Punës e Shqipërisë	169	67.6 %	56.17 %
2	Partia Demokrate	75	30 %	38.71 %
3	Partia Republikane	-	-	1.77 %
4	Organizata Omonia	5	2 %	0.73 %

5	Komiteti i Veteranëve	1	0.4 %	0.28 %
6	Partia Agrare	-	-	0.07 %

Pasi u zhvilluan zgjedhjet e para pluraliste parlamentare, PD nuk doli fituese në garën elektorale. Ky rezultat ishte zhgënjyes për anëtarët e saj, si edhe për një pjesë të madhe të popullsisë (intelektualë/studentë/të dënuar politik). Zonat urbane i shihnin këto zgjedhje si mundësinë e ndryshimeve, mundësinë e miratimit të reformave të mëdha. Dhe për këtë arsye, për të mos rënë vendi në destabilitet të thellë, u krijua Qeveria e Stabilitetit (11.06.1991-06.12.1991). PD priste një rezultat që të rrëzonte regjimin aktual, por negativisht kanë ndikuar disa faktorë. Si zonat rurale, nga frika ose mos arsimimi, ata votuan përsëri për regjimin aktual. Ka ndikuar gjithashtu negativisht edhe media, e cila ka qenë e kontrolluar nga regjimi komunist.

Pas zgjedhjeve në vendin tonë u krijua sistemi dypartiak dhe kjo është e dukshme në përbërjen e Parlamentit. Ramiz Alia kishte lejuar në këtë mënyrë *kalimin paqësor të vendit në pluralizëm*, aq edhe në konceptin e diferencimit të butë prej tij dhe regjimit të tij (Zogaj, 2014: 89).

Grafiku Nr. 2: Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 1991.



Partia e Punës së Shqipërisë (PPSH) mund të konsiderohet mazhorancë fituese sepse partia ka njëkohësisht shumicën e mandateve fituese dhe shumicën e votave popullore.

Nga rezultatet e deklaruar nga faqja zyrtare e KQZ-së, na rezulton se në Kuvend kanë fituar të drejtën e përfaqësimit të elektoratit të tyre katër parti politike, por vetëm dy prej tyre na rezultojnë se kanë marrë më shumë mandate parlamentare. Si rrjedhojë, në zgjedhjet e para pluraliste kemi një sistem dypartiak, që në situatë tjetër politike do kishte prodhuar stabilitet dhe qëndrueshmëri qeverisëse (nëse i referohemi edhe shifrave të mësipërme). Por në situatën politike të vendit tonë, pas një sistemi diktatorial (sistem njëpartiak), këto ishin zgjedhjet e para plurale dhe shohim mungesë stabiliteti e mungesë besimi tek udhëheqësit.

Vëzhguesit dolën në konkluzionin, se: “Zgjedhjet në përgjithësi ishin të rregullta dhe se manipulimet kishin qenë minimale”. Gjithsesi vëzhguesit e pranuan kontrollin e PPSH-së tek numëruesit e votave, në disa zona të thella fshatare dhe se kishin një dominim në media. Ata konkluduan se fitorja, në pjesën më të madhe ishte pasojë e një kulture politike të pazhvilluar e të painformuar mirë (Vickers & Pettifer, 1998: 59). Pa përmendur parregullsi të tilla si: hapja e votimeve pa qenë prezent përfaqësuesit e opozitës, shpërndarja e veshmbathjeve e ushqimeve duke lobuar që të votonin për PPSH (Shyti, 2001: 10).

Ramiz Alia në postin e Presidentit Ekzekutiv të vendit u votua me një numër shumë të konsiderueshëm të votave në datë 30.04.1991 deri më 09.04.1992. U krye votimi për Presidentin Ekzekutiv të vendit dhe jo për Presidentin e Kuvendit Popullor, në këtë mënyrë shënohet një shprehje e përkohshme nga e kaluara e vendit (Vickers dhe Pettifer, 1998: 63). Ramiz Aliu dha dorëheqjen më pas si Sekretar i Parë i PPSH-së dhe u formua Qeveria e parë me në krye ekonoministin Fatos Nano. Pasi shpалosi reformat e tij themelore shumë

nuk e përkrahën dhe si rrjedhojë, PD filloi grevën. Dhe më 19 Maj pasi mbaroi afati i grevave, vendi u zhyt në një pasiguri politike.

Kemi një President të zgjedhur nga partia PPSH dhe një Qeveri e krijuar po nga kjo parti, pra të gjitha pozicionet drejtuese Qeveria (Kryeministri) dhe Presidenti vijnë nga e njëjta forcë politike e majtë, si rrjedhojë partia e parë opozitare e ndjente veten të pafuqishme përballë këtij pushteti të kapur nga një forcë politike. Në 4 Korrik, Fatos Nano dha dorëheqjen nga posti i Kryeministrit, ku në këtë mënyrë i'u dha fund sundimit prej më shumë se 47 vitesh të komunizmit të egër (Vickers dhe Pettifer, 1998: 67). Ylli Bufi u ngarkua të krijojë qeverinë e re “Qeveria e Stabilitetit Kombëtar”. PPSH në këtë periudhë mori emrin Partia Socialiste e Shqipërisë. Shtatë anëtarë nga njëzetënjë anëtarëve të kabinetit u tërhoqën nga qeveria e koalicionit.

John Locke (253), në librin e tij “Traite du Gouvernement civil”, ka parashikuar se:

Atje ku shumica nuk mund të vendosë dhe ta detyrojë pjesën tjetër t'u nënshtrohet dekreteve të saj, atje ajo nuk mund të zgjidhë asnjë problem dhe të zbatojë gjënë më të vogël; atje nuk mund të vërehet ndërmarrja e asnjë veprimi, e asnjë lëvizjeje të trupit të shoqërisë; dhe për rrjedhojë, ky farë trupi shoqëror do të shpërbëhet qysh në fillim.

Në këtë situatë me propozim të opozitës (Fuga 2008: 207-208), ranë në një konsensus të gjërë për të miratuar një ligj bazë me një numër të kufizuar nenesh. Shqipëria u shpall Rebublikë Parlamentare, por në këtë ligj nuk parashikohej asnjë kompetencë e Presidentit mbi drejtësinë (pozita e tij dobësohej), ndërsa Kuvendi bëhej qendra e pushtetit e dominuar nga shumica parlamentare.

Duke filluar nga vjeshta e vitit 1991, mbështetja e brendshme politike filloj të dobësohej për “Qeverinë e Stabilitetit”. Në vend kemi një moment krize politike dhe pakënaqësie të gjërë në popull. Si rezultat i kësaj gjëndje të rënduar të vendit, pas një viti u

mbajtë edhe zgjedhjet e para të parakohshme, ato të 22 marsit të vitit 1992. Kemi një ndërprerje të grevës së përgjithshme dhe ulje të tensioneve politike në vend.

Analizimi i zgjedhjeve të para pluraliste të vitit 1991 sipas teorisë së Arend Lijphart “Ndikimi i sistemit elektoral në formën qeverisëse”

Arend Lijphart ka përdorur gjashtë teori të koalicionit për të parashikuar rezultatet zgjedhore dhe formën e kabinetit qeverisës që formohet, duke u nisur nga sistemi zgjedhor që aplikohet dhe nga partitë që fitojnë mandate parlamentare. Gjashtë teoritë e koalicionit janë (Lijpart, 1999: 92-96): 1.Koalicion minimal i fituar; 2.Koalicionet me madhësi minimale; 3.Koalicionet me numrin më të vogël të partive; 4.Koalicionet me varg minimal; 5.Koalicionet minimale fituese; 6.Koalicionet politike-praktike.

Nëse do të analizojmë rezultatet e zgjedhjeve të para pluraliste në Shqipëri sipas 6 teorisë të koalicioneve, do të vëmë re se vetëm një parti politike ka fituar numrin më të madh të mandateve dhe në këtë rast formohet një kabinet njëpartiak. Në sistemet parlamentare të qeverisjes, kabinetet duhet të formohen në mënyrë që të gëzojnë besimin ose të tolerohen nga një shumicë parlamentare. Nëse një parti ka shumicën e vendeve në Parlament, atëherë partia që ka shumicën ka gjasa të formojë një kabinet njëpartiak.

Tabela nr. 22: Partitë të cilat kanë fituar mandate parlamentare të radhitura sipas spektrit politik nga A deri në D, për zgjedhjet politike të vitit 1991.

Partitë politike	PPSh (Majtas) A	Organizata Omonia B	Komiteti i Veteranëve C	PD (Djathtas) D
Mandatet parlamentare	169	5	1	75

Në çdo zgjedhje parlamentare të zhvilluar në vendin tonë pas vitit 1990-të, do të analizohen sipas teorisë së Lijphart, ku gjithashtu do të bëjmë parashikime në lidhje me mundësinë e formimit të kabineteve qeveritare. Këto parashikime do të bëhen duke u

bazuar në rezultatet finale të zgjedhjeve për çdo subjekt politik, duke u fokusuar edhe në spektrin politik të tyre. Dhe në fund, do të përcaktojmë llojin e kabinetit qeveritar që do të formohet në Shqipërinë e tranzicionit.

Komiteti i Veteranëve dhe shoqata “Omonia” të minoritetit grek, fituan mandate parlamentare dhe në këtë mënyrë kemi Parlamentin e parë pluralist Shqiptar, ku parti të vogla politike arrijnë të përfaqësojnë elektoratin e tyre në Kuvend. PPSH fitoi 169 mandate, ndërsa PD, partia e parë opozitare më e madhe në vend fitoi 75 deputetë. Shoqata politike “Omonia” fitoi 5 deputetë dhe Komiteti i Veteranëve fitoi 1 mandat. PPSH fitoi më shumë se 2/3 e mandateve dhe si rrjedhojë kemi një mazhorancë e cila ka numrat e duhura për të qeverisur e vetme vendin. Por kjo nuk u prit mirë nga partitë opozitare, të cilat hynë në zgjedhje të vetme përballë partisë që ka qenë në pushtet për një periudhë 46 vjeçare.

Nëse i referohemi zgjedhjeve të para pluraliste në vendin tonë, nuk mund t’i analizojmë këto rezultate sipas gjashtë teorive të koalicioneve të përmbledhura nga Lijphart (1999: 92 – 96) sepse vetëm një parti politike ka fituar mbi 2/3 e mandateve parlamentare dhe ka tejkaluar në këtë mënyrë edhe numrat e nevojshme (125 mandate) që nevojiten për të përbërë shumicën parlamentare. Si rrjedhojë, nuk ka qenë domosdoshmëri formimi i një kabineti me anë të koalicioneve mes partive politike. Ky rezultat ka ardhur si pasojë e mentalitetit politik, si vazhdimësia e votimit të të njëjtës parti dhe frikës nga pushteti të brendësuar në vetëdijen e shqiptarëve. Edhe nëse PD do të bashkohej me dy partitë e tjera opozitare ($75+5+1=81$ mandate), nuk mund të formonte një shumicë e nevojshme për të qeverisur vendin.

Por Lijphart argumenton se kemi dy lloje të kabineteve të pakicave në parim, njëra është një kabinet i vërtetë minoriteti, që duhet të negociojë vazhdimisht me një ose më

shumë parti joqeverisëse, për të qëndruar në zyra dhe për të kërkuar mbështetje për propozimet e saj legislative (ngjajnë me koalicione të tepërta). Ndërsa lloji tjetër është dhënë nga Strom (1997: 56) " shumica qeverisëse në maskim" kabinete pakice që janë më shumë si kabinete me shumicë se kanë një bashkëpunim të fortë mbështetës nga një ose më shumë parti të veçanta në legjislaturë edhe se nuk kanë zgjedhur të marin portofole qeverisëse.

Kontrasti është mes kabineteve minimale fituese nga njëra anë dhe kabinete të tepërta ose të pakicave nga ana tjetër. **Në zgjedhjet e përgjithshme të zhvilluara në Shqipëri në vitin 1991 kemi kabinete një partiake (kabineteve minimale fituese), ku partia e vetme ka numrat e nevojshme për të miratuar reforma të mëdha e nuk ka domosdoshmëri që të bashkëpunojë me parti tjera joqeveritare.**

4.3 Ligji elektoral i vitit 1992

Siç e nënvizuam edhe më sipër, në vitin 1991 kemi miratimin e Ligjit Nr.7491, më datë 29.4.1991 "Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese". Por, ky komision kushtetues nuk arriti të paraqesë një dokument të besueshëm për forcat politike kundërshtare dhe si rrjedhojë, në vitin 1992 e 1993 disa dispozita u plotësuan në mënyrë të njëanshme sepse mazhoranca fituese kishin numrat e nevojshme për ndryshime të kushtetutës.

Ndërsa në vitin 1993 një komision kushtetues i ngritur nga Partia Demokratike dështoi të kalojë në Parlament në mënyrë të njëanshme (në mungesë të 6 votave) draftin kushtetues. Shqipëria në nëntor të vitit 1994 zhvilloi referendumin e parë për ndryshimet kushtetuese dhe në bazë të të dhënave zyrtare të KQZ-së, nga 84,30% zgjedhës, 53%

votuan kundër ndërsa 41% pro draftit kushtetues. Si rrjedhojë, drafti kushtetues humbi votbesimin dhe vendi ynë mbeti pa një kushtetutë (Krasniqi, 2015).

Pas vitit 1990 për Kuvendin Popullor u mbajtën më 22 Mars të vitit 1992 zgjedhjet e dyta pluraliste, por të parat si të parakohshme sipas Ligjit për Zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë 1992. Sipas këtij ligji “Kuvendi Popullor përbëhet nga jo më pak se 140 deputetë, nga të cilët 100 zgjidhen drejtpërdrejt në zona një emërore, ndërsa mandatet shtesë kompensuese u jepen kandidatëve që janë në listat e subjekteve në shkallë vendi, sipas proporcionit të votave të fituara në raundin e parë”. Sistemi elektoral ishte miks i varur, ku 100 deputetë zgjidheshin sipas modelit mazhoritar me dy raunde dhe 40 deputetë zgjidheshin nëpërmjet sistemit proporcional kombëtar.

Ligji elektoral ishte proporcional i pastër në thelb dhe lejonte që çdo votë mbi pragun 4 % të përfaqësohej në Kuvend. Por, kuota 4 % kishte vlerë për një subjekt elektoral konkurues, por jo për një koalicion. Gjithashtu një formacion me dy parti për të fituar një mandat në parlament duhej të fitonte 8 % të votave në shkallë vendi, një formacion me tre parti 12 % të votave dhe kështu me radhë.

Në rrethet me një mandat të vetëm do të fitonte kandidati me 50 % të votave në turin e parë ose me shumicën e votave në turin e dytë. Partitë politike që paraqesnin kandidatë të paktën në 33 zona zgjedhore, në 9 rrethe administrative dhe arrijnë të kalojnë pragun e 4 %, do të merrnin pjesë në ndarjen e 40 vendeve të tjera (Biberaj, 2011: 186). Partitë e mëdha që në raundin e parë fitonin një përqindje më të lartë vendesh sesa përqindja e votave dhe nuk kishin dobi nga sistemi zgjedhor, ndërsa partitë në gjendje të kundërt do të përfitonin nga ndarja e vendeve plotësuese. Ky ligj elektoral përjashtonte partitë me bazë etnike të konkuronin në zgjedhje, si pasojë Omonia nuk u lejua të paraqesë

kandidatët e saj. Pas protestave u krijua një kompromis dhe u krijua partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, e cila në këtë mënyrë përfaqësonte pakicën greke.

Mund të dalim në përfundim se në zgjedhjet e para si të parakohshme të vitit 1992 kemi dy ndryshime thelbësore, së pari kemi një ulje të numrit të mandate nga 250 deputetë në 140 dhe së dyti, u bë ndryshimi i sistemit elektoral nga mazhoritar në një sistem elektoral miks i varur. Shpërndarja e mandateve parlamentare u bë sipas një formule, e cila përpqej të ilustronte ngushtimin e diferencës midis ‘superpërfaqësimit’ dhe ‘nënpërfaqësimit’ (Çili, 2002: 20). Ky sistem elektoral përqindjen e votave të përgjithshme të partive e afronte me përqindjen e mandateve në Parlament. Si edhe favorizonte partitë që kishin marrë përqindjen më të vogël të votave të fituara në votimin e përgjithshëm, kryesisht nga partia e dytë e poshtë.

Sipas Raportit Informues për Zgjedhjet në Shqipëri (22 dhe 29 mars 1992), nga raporti i Socialdemokratit Stig Gustafsson, Suedi, ndryshimin e ligjit të ri elektoral e argumenton në këtë mënyrë:

Pjesërisht sepse një Kuvend me 250 vende, u mendua si tepër i madh. Pjesërisht për të shkuar më përpara drejt pluralizmit politik. Pjesërisht për të futur një element proporcionaliteti. Pjesërisht, pa dyshim, për të rregulluar një nen të Ligjit të Korrikut të vitit 1991 për Partitë Politike, i cili i ndalonte krijimin e tyre në baza etnike, fetare ose rajonale (Këshilli i Europës, 2000: 24).

Ligji elektoral i vitit 1992 ishte proporcional në thelb, ku diferencat midis zonave njëemërore nuk kishin efekt në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve. Diferenca e numrit të votuesve nga një zonë në tjetrën, kishte peshë të madhe në fatin e zgjedhjeve të përgjithshme (Zogaj, 1997 d: 168).

Zgjedhjet e vitit 1992, ishin njëherazi edhe zgjedhjet e para të parakohshme në gjithë historinë e Republikës së Shqipërisë. Dhe këto zgjedhje u realizuan me anë të ligjit të miratuar më 4 shkurt të vitit 1992, Ligjit “Mbi zgjedhjet e Kuvendit Popullor”. Ndryshim

ky i ligjit që solli uljen e numrit të mandateve (nga 250 në 140) dhe ndryshimin e sistemit elektorale (ku 100 mandate zgjidheshin me sistem mazhoritar dhe 40 do të ndaheshin midis partive tjera që do të kalonin pragun e 4 % të votave në shkallë vendi). Një ndryshim që mundësoi përfshirjen në parlament edhe të partive të vogla dhe në këtë mënyrë nuk do të kishim rotacionin një herë të njëjës parti të madhe e më pas të tjetrës parti në qeveri. Por, partitë e mëdha mund të qeverisnin vendin edhe me parti tjera të vogla, të cilat kanë ideale dhe programe të ndryshme nga to.

4.3.1 Zgjedhjet e parakohshme të zhvilluara më 22 mars të vitit 1992

Opozita pretendonte se socialistët po shfrytëzonin pjesëmarrjen në qeverinë e koalicionit për të diskriminuar opozitën, si rrjedhojë shtatë anëtarë të opozitës lanë portofol ministror dhe u tërhoqën nga qeveria e koalicionit. Vendi pas trazirave dhe krizës politike po përgatitej për zgjedhjet e para të parakohshme në vend nën drejtimin e Qeverisë Teknike. Ndër 11 parti që konkurronin në zgjedhjet e parakohshme, më e rëndësishmja nga partitë e reja opozitare ishte PSD (Vickers dhe Pettifer, 1998: 76). Por vetëm 5 prej tyre u kualifikuan për të paraqitur listat, duke pasur kandidatë në më shumë se prej 1/3 e zonave elektorale dhe këto parti ishin: PD, PS, PSD, PR dhe PA.

Fushata e këtyre zgjedhjeve ishte më e bujshme se sa ajo e një viti më parë, por tashmë dukej ende pa filluar se socialistët e kishin humbur betejën (Laco, 1998: 113). Në këto zgjedhje të dyta në pluralizëm, por të para si të parakohshme, partia e parë opozitare Partia Demokratike pati një fitore të thellë. Në mitingjet e zhvilluara prej tyre dëgjoheshin thirrjet se “E duam Shqipërinë, pa Ramiz Alinë” (Zogaj, 2001 c: 308). Në këtë mënyrë

Ramiz Alia u detyrua të japë dorëheqjen dhe atë e pasoi Sali Berisha si Presidenti më i ri i Shqipërisë. Opozita ishte më e fuqishme dhe kishte më shumë mjete, kishte akses në media e kishte arritur të sigurate asnjësinë e forcave të armatosura e policisë (Biberaj, 2011:189)

Deputeti i PSD-së, Lisen Bashkurti, dorëheqjen e Alisë në postin e Presidentit të Shqipërisë e argumentoi se, *me dorëheqjen e tij merr fund edhe shkolla e politikës bolshevike* në vendin tonë. Bashkurti, theksonte se vetëm me largin e tij nga Presidenca mund t'i jepej fund kapitullit të gjatë të komunizmit në Shqipëri. Ndërsa për ndryshimin e pushtetit në vitin 1992, kishin kontribuar me vullnet të lirë jo vetëm pjesa opozitare e shoqërisë, por edhe nga radhët e Partisë së Punës (Shyti, 2001: 11).

Nga përpilimi i këtij ligji elektoral i vitit 1992, dalim në përfundim se dy partitë e mëdha e kanë formuluar dhe kanë vendosur pragun e lartë natyror 4 %, për mundësinë e alternimit të pushtetit midis dy forcave më të mëdha politike. Si rrjedhojë do të kemi më pak parti politike që do të përfaqësojnë elektoratin e tyre në Parlament, por do të kemi më shumë stabilitet qeverisës dhe jetëgjatësi të mandatit katër vjeçar të partisë në pushtet. PD duke parë se mbështetja e saj po rritej në tërë vendin ishte pro sistemit mazhoritar, ndërsa PS me partitë e vogla ishte për sistemin proporcional që të mund ti favorizonte ato. Si rrjedhojë, PD në zgjedhje të drejta fitoi 90 % të mandateve, ndërsa nga shpërndarja e vendeve plotësuese PS mori 32 mandate dhe PSD 6 mandate. Dhe nga sistemi proporcional kombëtar ka përfituar PS, e cila mori 32 nga 40 mandate të vlefshme, e cila bëhet edhe partia e dytë më e rëndësishme në vend.

Situata politike në vend në të cilën u zhvillua procesi zgjedhor u karakterizuar nga tensione politike, por megjithatë këto zgjedhje u vlerësuan si zgjedhje të rregullta. Këto

zgjedhje janë pranuar si zgjedhjet në të cilat, vullneti i popullit është shprehur më lirisht se në çdo zgjedhje tjetër (Kume, 2015:30). Edhe pse PD zotëronte shumicën absolute të mandateve në vitin 1992, ftoi në koalicion PSD dhe PR, për të ndërtuar në këtë mënyrë ‘koalicionin antikomunist’ dhe në vitin 1994 ky koalicion përfundoi (Çili, 2002: 27). Në përputhje me koalicionin parazgjedhor të PD-së me dy partitë opozitare, në qeverinë e re që u formua Fatos Bitincka i PR-së u emërua ministër i Transportit dhe i Komunikacioneve dhe Vullnet Ademi i PSD-së u caktua Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave.

Në këto zgjedhje u bë për herë të parë rotacioni politik, si edhe kemi ndryshimin defacto të sistemit politik. PS e pranoi humbjen dhe premtonte se do të luante një rol konstruktiv në opozitë (Zëri i Popullit, 24 mars 1992). Kuvendi (legjislacioni i vitit 1992-1996) funksionojë rregullisht në mandatin katër vjeçar, por nuk miratuan Kushtetutën e Shqipërisë. Votuan 1.826.142 zgjedhës ose rreth 90.35 % të tyre.

Tabela nr. 23: Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 1992.

N r.	Emërtimi i partive	Mandate të fituara në Kuvendin Popullor	% mandateve në raport me nr. total të mandateve	Përqindja e votave popullore
1	PD	90 + 2 = 92	65.71 %	62.08 %
2	PS	6 + 32 = 38	27.14 %	25.73 %
3	PSD	1 + 6 = 7	5 %	4.38 %
4	PBDNJ	2 + 0 = 2	1.43 %	2.90%
5	PR	1 + 0 = 1	0.71 %	3.11 %
6	Tjera	0	0	1.78 %

PD mund të konsiderohet si mazhorancë fituese sepse fitoi mazhorancën absolute të mandateve parlamentare edhe mazhorancën absolutete të votave popullore. Gjithashtu edhe kalimi i pushtetit (rotacioni politik) u bë në mënyrë të qetë dhe të rregullt nga një regjim politik në një tjetër. Pra me anë të këtyre zgjedhjeve të parakohshme për herë të parë pas një gjysëm dekade vjen në qeverisje një parti opozitare, e formuar vetëm katër muaj më

parë si një parti kundër regjimit komunist. Sistemi elektoral favorizonte dy partitë e mëdha dhe si rrjedhojë kemi këtë rezultat zgjedhor që do ta diskutojmë më gjërësisht më poshtë.

Grafiku Nr. 3: Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 1992.



Nga të dhënat e marrë nga faqa zyrtare e KQZ-së, pesë parti arritën të përfaqësojnë elektoratin e tyre në Kuvend, si PD, PS, PSD, PBDNJ dhe PR. Në ndryshim nga zgjedhjet e para parlamentare, PSD ka fituar një numër të konsiderueshëm të mandateve në krahasim me partitë e tjera të vogla dhe 6 mandate i ka marrë nga shpërndarja e 40 mandateve duke kaluar në këtë mënyrë pragun natyror në shkallë vendi. Përsëri kemi një sistem dypartiak edhe se kemi ekzistencën e tre partive të vogla politike, të cilat nuk ndikojnë në qeverisjen e vendit dhe pushteti alternohet midis dy partive kryesore.

Kemi një rotacion të pushtetit, ku Partia Demokratike (e para parti opozitare) për herë të parë fitoi të drejtën që të qeverisë vendin pas një periudhe shtypëse nga Partia Komuniste në vend. PD ka numrat e duhura që të qeverisë e qetë dhe e sigurt vendin për një periudhë normale katër vjeçare. Ajo ka fituar një mazhorancë absolute dhe ka përballë tashmë një opozitë të vogël. Ramiz Alia dha dorëheqjen dhe Sali Berishës u zgjodh President i Shqipërisë (09.04.1992-24.07.1997) me 96 vota pro në Kuvend. Partia Socialiste, me në krye Fatos Nanon, humbjen e këtyre zgjedhjeve i'a ngarkuan ndodhive në

Europë, ku ishte prirja drejt të djathtës politike. Edhe pse ai i cilësoi zgjedhjet me disa parregullsi gjatë fushatës elektorale, kjo forcë politike i pranoi ato edhe se i humbën ato.

***Analizimi i zgjedhjeve të parakohshme të vitit 1992 sipas teorisë së Arend Lijphart
“Ndikimi i sistemit elektoral në formën qeverisëse”***

Nëse do të analizojmë rezultatet e zgjedhjeve e para si të parakohshme të vitit 1992 sipas gjashtë teorive të koalicioneve, vëmë re se kemi një parti e cila ka 92 mandate, një mandat më pak se shumica e nevojshme prej 2/3 që nevojiten për ndryshime të Kushtetutës dhe ligjeve tjera të rëndësishme. Por, për formimin e qeverisë nevojiten vetëm 71 vota dhe në këtë rast kabineti i ri qeveritar u formua me bashkëqeverisjen e tre partive opozitare. Në këto zgjedhje u bë rotacioni i parë politik, kemi edhe ndryshimin defacto të sistemit politik. Kuvendi funksionoi rregullisht në mandatin katër vjeçar, por përsëri nuk kemi miratimin e Kushtetutës së Shqipërisë.

Në sistemet parlamentare të qeverisjes, kabinetet duhet të formohen në mënyrë që ata të gëzojnë besimin ose të paktën të tolerohet nga një shumicë parlamentare. Në qoftë se njëra parti ka shumicën e vende parlamentare, atëherë partia që ka shumicën ka gjasa të formojë një kabinet njëpartiak. Dhe nga 140 mandate parlamentare PD kishte 92 vende, PS 38 vende, PSD 7 vende dhe PBDNJ 2 vende. Duke krijuar një koalicion qeverisës me PSD dhe PR, PD siguroi një shumicë mbi dy të tretat në parlament. Në Kuvend 88 deputetë zgjidheshin për herë të parë në parlamentin e parë pluralist dhe vetëm 8 nga 140 deputetë ishin femra. Kabinetin qeveritar që u krijuar në këto zgjedhje do ta analizojmë sipas gjashtë teorive të koalicionit të Arend Lijphart.

Tabela nr 24: Partitë të cilat kanë fituar mandate parlamentare të radhitura sipas spektrit politik nga A deri në E, për zgjedhjet e para si të parakohshme të vitit 1992.

Partitë politike	PS (Majtas) A	PBDNJ B	PSD C	PR D	PD (Djathtas) E
Mandatet parlamentare	38	2	7	1	92

Teoritë:

1. Koalicion minimal i fituar: DE=93, BDE=95, BE=94 dhe CE=99.
2. Koalicionet me madhësi minimale: DE=93 (2 hapësirë spektri i djathtë)
3. Koalicionet me numrin më të vogël të partive: BE=94 dhe DE=93.
4. Koalicionet me varg minimal: ABC=x (2 hapësirë), BCD=x (2 hapësirë), CE=99 (1 hapësirë).
5. Koalicionet minimale fituese: ABC=x, BCD=x dhe CDE=100.
6. Koalicionet politike – praktike: BCE=101, BDE=95, CDE=100 dhe DE=93.

Dhe nga rezultatet zgjedhore të vitit 1992 dhe pas formimit të kabinetit qeveritar, kemi tre parti të cilat marrin përsipër qeverisjen e vendit në një periudhë kaq kritike për vendin tonë. PD, e cila në total ka marrë 92 mandate, respektoi koalicionin parazgjedhor dhe në përbërjen e kabinetit më të ri u përfshinë edhe PR, e cila fitoi 1 mandat dhe PSD fitoi 7 mandate parlamentare. Kabineti qeveritar kishte në total 100 mandate, më shumë se 2/3 e mandateve të shumicës dhe përbëhej nga Partia Demokratike, partia më e madhe opozitare dhe nga dy parti të vogla brenda spektrit të saj politik. Kjo ishte një votë për ndryshimin e sistemit të atëhershëm dhe Partia Demokratike e respektoi këtë verdikt të sovranit duke respektuar edhe koalicionin parazgjedhor midis tre partive politike.

Në zgjedhjet e para si të parakohshme të mbajtura në vendin tonë në vitin 1992, kemi formimin e koalicionet minimal fituese, ku u krijua koalicioni i pestë i renditur nga Arend Lijphart. Koalicionet do të formohen nga të dyja partitë që janë të

‘lidhur’ ose që janë ngjitur në politikë dhe pa partnerë të panevojshme. Supozimi themelor i kësaj teorie është se palët do të përpiqen për tu rritur së bashku me fqinjët e tyre të menjëhershëm dhe se palët e tjera fqinje do të të shtohen, deri në formimin e një koalicioni të shumicës, kjo teori është propozuar nga Robert Axelrod (1970, 165-87). Sipas teorisë së fundit, koalicioni CDE përmban një partner të tepërt, partinë C, por në teorinë e Axelrod-së, partia C është e nevojshme për të bërë një koalicion të lidhur dhe të qëndrueshëm.

Marrëdhënia parlament dhe presidencë pas zgjedhjeve të vitit 1992

Në zgjedhjet e vitit 1992 kemi krijimin e zonave elektorale “në përputhje me ligjin” elektoral dhe ligji elektoral ishte proporcional në thelb, ku diferencat midis zonave njëemërore nuk kishin efekt në rezultatin final të zgjedhjeve. Ky sistem favorizonte partitë e mëdha dhe krijonte lider të përhershëm në krye të partive. Sipas Çilit, kemi një shumicë shtetërore dhe rënie të parlamentarizmit nën dhunën e kartonit jeshil të 2/3-ave. Autori argumenton se ‘tregu elektoral bazë’ është i palëvizshëm, për lidhshëpin në fuqi nuk ekziston ‘shqetësimi’ se përjashtimi ose largimi i disidentëve do të sjellë rrjedhje në elektoral (Çili, 2002: 10). Si rrjedhojë, Çili ka dalë në konkluzion se, pluralizmi në vendin tonë e ka humbur rëndësinë sepse çdo gjë vendosej e miratohej me fuqinë e mandateve që kishte forca fituese e zgjedhjeve.

Kuvendi me anë të një shumice absolute votash miratoi disa ndryshime thelbësore në ligjin për dispozitat Kryesore Kushtetuese, që kishin lidhje me zgjedhjen e Presidentit dhe kompetencat e tij. Neni 26 që përcaktonte funksionet e papajtueshme me funksionin e presidentit u riformulua, ku lejohej funksioni i një anëtarit të kryesisë së një partie politike.

Pas këtyre ndryshimeve, Kuvendi zgjodhi Presidentin e Shqipërisë me 96 mandate kryetarin e PD-së, Sali Berishën. Ligji “Dispozitat Kryesore Kushtetuese” u plotësua me ligje kushtetuese të reja dhe të rëndësishme që i përkisnin organizimit gjyqësor si, krijimi e funksionimi i Gjykatës Kushtetuese, krijimi i Këshillit të Lartë së Drejtësisë, si edhe organizimi i Pushtetit Vendor. Pjesë përbërëse e ligjit për “Dispozitat Kryesore Kushtetuese” u bë dhe dekreti presidencial për “Të Drejtat dhe Liritë Themelore” të njeriut.

Sistemi gjyqësor ishte në gjëndje të keqe, ku korrupsioni ishte pothuajse i institucionalizuar (Biberaj, 2011: 209). Presidenti i Shqipërisë ishte përpara sfidave të rëndësishme dhe në një intervistë për Financial Times (marrë më 27 korrik 1994, fq. 31), presidenti Berisha argumentonte se *ndërtimi i një sistemi gjyqësor që të funksionojë, sipas tij është kusht themelor për ndërtimin e një shoqërie demokratike e për integrimin e Shqipërisë në Europë*. Shqipëria ndodhej në një periudhë të vështirë, ku tashmë kishte më shumë nevojë për klasën politike drejtuese për një të ardhme më të mirë demokratike.

Legjislacioni i vitit 1992-1996 nuk arriti të miratojë Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Pas daljes së PSD-së nga koalicioni, Partia Demokratike nuk kishte 2/3 e votave të nevojshme për miratimin e Kushtetutës. Dhe në mungesë të një marrëveshje me opozitën për shkak të mos dakortësisë për disa pika të projektkushtetutës, u mbajt një referendum popullor. Referendumi i 6 nëntorit 1994 e hodhi poshtë projektkushtetutën dhe si rrjedhojë kjo ngjarje shënoi fillimin e një krize të re politike.

Presidenti Berisha, miratoi disa ndryshime në paketën ligjore, ku Presidenti kishte kompetenca dhe influencë në gjyqësor. Zogaj thekson, se pas emërimit të Berishës, presidenca si institucion qendror mori shumë kompetenca të reja dhe në këtë mënyrë u bë një institucion me një rëndësi të madhe. Aleksandër Meksi do të formonte qeverinë e re

edhe se nuk ishte paeksperiencë politike, respektohej nga forcat politike për paanshmërinë e treguar në postin si Zv/Kryetar i Parlamentit prilli 1991 - mars 1992. Kabineti i ri ishte me njerëz të rinj dhe papërvojë, të cilët nuk kishin një eksperiencë politike ose kanë qenë në postin e ministrave në qeverinë e mëparshme teknike.

Në trajtimin që i është bërë këtij drafti nga Vickers dhe Pettifer, në librin e tyre “Shqipëria nga Anarkia te një identitet Ballkanik”, autorët kanë argumentuar se nëse ky draft do të miratohej, Kushtetuta e re do t’i jepte shumë pushtet dhe kompetenca Presidentit të Shqipërisë. Presidenti do të kishte shumë pushtet, i cili do të kishte ndikim mbi të gjithë emërimet më të rëndësishme ministrore, të ambasadorëve e emërimeve në drejtësi. Gjithashtu, Presidenti do kishte edhe kompetencën e ndërprerjes së hetimit për korrupsion ndaj qeverisë (1998: 259). Opozita e kundërshtoi fuqishëm këtë projekt kushtetutë dhe nga koalicioni qeverisës u largua PSD dhe PR.

Midis politikanëve kemi një mungesë të konsensusit midis zgjedhjes se cili sistem politik është më i përshtatshëm për vendin tonë, presidencial, parlamentar ose përzierje e tyre, pra të një presidenti të dobët dhe të një parlamenti të fortë ose anasjelltas. Shqipëria nuk arriti të miratonte një Kushtetutë dhe vendi ynë krijoi një sistem hibrid presidencial-parlamentar (Biberaj, 2011: 230-231), me një president me kompetenca të gjëra vendimmarrëse dhe nuk kemi një mbikqyrje të ekzekutivit nga ana e parlamentit.

Presidenti kishte kompetenca të gjëra edhe në një Republikë parlamentare. Presidenti emëron kryeministrin dhe me propozim të tij, anëtarët e kabinetit. Mund të shpërbënte parlamentin, pas këshillimit me kryeministrin dhe kryetarin e parlamentit. Me anë të këtij ligji kushtetues, presidenti kishte fuqi të posaçme edhe legjislative. Presidenti Berisha ishte shumë aktiv, përcaktonte programin e zhvillimit të vendit dhe iniciativat

politike më të rëndësishme vinin prej tij. Në këtë qeverisje vërejmë një bashkëpunim i jashtëzakonshëm midis presidencës, qeverisë dhe parlamentit (2011: 236). Edhe lufta politike midis pushteteve është më pak e ashpër sepse Partia Demokratike kishte shumicën e mandateve parlamentare.

Si rrjedhojë, periudha e Presidentit Sali Berisha ishte periudha kur Presidenti i Republikës së Shqipërisë kishte kompetenca të gjëra si, kishte kompetenca legislative dhe influencë në gjyqësor, formonte qeverinë etj. Kemi një president të fuqishëm, me kompetenca të gjëra edhe se vendi ynë është një Republikë Parlamentare. Dhe për herë të parë Shqipëria ka njohur një president kaq të fuqishëm dhe një kryetar qeverie (Kryeministër) që varej nga kreu i shtetit shqiptar. Por kjo periudhë do të jetë e shkurtër dhe do të kemi përsësi ndryshime, ku presidenti do të ketë kompetenca shumë të kufizuara deri në dhënien e dekoratave.

4.4 Ligji i zgjedhjeve Parlamentare të vitit '96

Sistemi elektoral i aplikuar në zgjedhjet parlamentare të vitit 1996 është sërish një sistem miks, por ndryshe nga sistemi miks i varur i vitit 1992, është miks i pavarur. Rezultatet në pjesën mazhoritare të subjekteve politike nuk korrigjohen nga rezultatet e subjekteve në pjesën proporcionale dhe të dyja pjesët e sistemit elektoral funksionojnë në mënyrë të pavarur. PD kishte kontrollin e shumicës parlamentare (Biberaj, 2011: 391) dhe miratoi një ligj zgjedhor me një sistem më të ndjeshëm ndaj kërkesave popullore dhe për një shumicë të qëndrueshme.

Ky ligj zgjedhor kishte tendencë të forconte pozitat e dy partive të mëdha dhe sistemi partiak shkon drejt dypartitizmit sepse limiti i pragut natyror nga 4 % shkoi në 7 %. Shpërndarja e mandateve nga lista shumëemërore favorizonte partitë që do të fitonin më shumë mandate në 115 zonat zgjedhore njëemërore. Ky ligj nuk i favorizonte partitë e vogla dhe shumë prej tyre nuk arritën të përfaqësonin elektoratin e tyre në Parlament. Gjithashtu u bë një ndarje e re administrative, që do të përfshinte një numër të caktuar rrethesh.

Sipas Ligjit Nr.8055, më datë 01.02.1996 “Për ndryshimet në ligjin Nr.7556, datë 04.02.1992, Për Zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, më 1 shkurt u miratua Ligji Nr. 8055 për ndryshime në ligjin e mëparshëm të zgjedhjeve. Qeveria miratoi një ligj që ruante kriterin bazë të korrigjimit së parimit mazhoritar me parimin proporcional dhe kandidatët e listës nga 40 reduktoheshin në 25 mandate, si rezultat thellonte më tej cilësinë mazhoritare të ligjit. Subjektet elektorale të formuara nga koalicionet partiake, duhet të kalojnë pragun elektorale të 4 %, shumëzuar me numrin e partive në koalicion (Fuga, 2008: 324). Ky ligj me 40 mandate, është projektuar me qëllim kompesimin politik për partinë e dytë politike. Teorikisht, një parti e vogël politike duhej të fitonte 20 % ose 25 % të vendeve në listën shumëemërore, pra 5 vende në mandatet shtesë (Krasniqi, 2009: 98).

Më konkretisht, Neni 3 nënvizonte se “Kuvendi Popullor përbëhet nga 140 deputetë, nga të cilët 115 zgjidheshin drejtpërdrejtë në zona një emërore, kurse 25 mandatet e tjerë shtesë u jepen kandidatëve që janë në listat e subjekteve politike në shkallë vendi, në bazë të votave të fituara në raundin e parë, sipas rregullit të përcaktuar në nenin 11”. Për sa i përket ndarjes së mandateve shtesë sipas Ligjit Nr. 8055, datë 01.02.1996 “Për ndryshimet

në ligjin Nr. 7556, datë 04.02.1992, Për Zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë” thuhet, se:

“Nga ndarja e 25 mandateve shtesë fitojnë vetëm subjektet që në shkallë vendi kanë marrë jo më pak se 4% të votave dhe grupimet elektorale të dy partive që kanë jo më pak se 8% të votave. Kur grupimi elektoral përbëhet nga më shumë se 3 parti, kufiri i përqindjes për çdo parti rritet me 4%”.

Për ndarjen e mandateve shtesë, llogaritet shuma e votave të vlefshme në raundin e parë për subjektet elektorale. Më pas llogaritet shuma e votave të vlefshme të hedhura për secilin nga subjektet politike që plotësojnë edhe kushtin e mësipërm. Numri i votave të vlefshme të secilit prej këtyre subjekteve politike, përpjesëtohet me shumën e votave të vlefshme të hedhura për mandatet shtesë dhe rezultati që del shumëzohet me numrin 25 të mandateve shtesë. Vendet që mbeten pa u ndarë, i jepen subjektit elektoral që ka fituar numrin më të madh të vendeve nga zgjedhjet në zonat një emërore.

Tre risitë ose shtrebbërimet që sjell sistemi i ri elektoral i aplikuar në vitin 1996-të, është forcimi i dimensionit mazhoritar të sistemit, nuk bëhet korrigjim nga pjesa e sistemit proporcional dhe rritet pragu elektoral për partitë e vogla, për të mos pasur mundësinë e përfaqësimit të elektoratit të tyre në Kuvend. Si rrjedhojë, do të kemi parti të mëdha më të fuqishme dhe një përfaqësim më të vogël të partive të treta ose të vogla.

Në bazë të një Raporti Informues mbi Tryezën e Komitetit AD Hoc të Kryetarëve të Grupeve Politike në Shqipëri (4–5 maj 1997-të), jepej një lloj opiniononi rreth Ligjit elektoral të vitit 1996-të. Ky ligj elektoral ishte një kombinim i mazhoritarit me proporcionalin, ku favorizonte mazhoritarin. Sipas këtij Raporti, PD ka dëshmuar se donte të ruante raportet e ligjit 1996, si edhe të forconte më tej komponentin mazhoritar. Ndërsa sipas përcaktimit të tyre, PS dhe shumica e partive pjesëmarrëse në Qeverinë e Pajtimit Kombëtar, kërkonin që

ligji në fuqi të reformohej duke i dhënë më tepër hapësirë përfaqësimit të sistemit proporcional (Këshilli i Europës, 2000: 346).

4.4.1 Rezultatet e zgjedhjeve Parlamentare të zhvilluara më 26 majit '96

Me ligjin e ri elektoral, teorikisht një parti e vogël politike duhej të fitonte 20 % ose 25 % të vendeve në listën shumë emërore, pra 5 vende në mandate shtesë (Krasniqi, 2009: 98). Kjo përqindje ndryshon nga madhësia e qyteteve në Shqipëri dhe varion nga numri i mandateve e numri i votuesve për çdo qytet. Nga 1.676.609 votues, 1.092.469 votuan PD, pra 65,16 %.

Këto ishin zgjedhjet e treta pluraliste që organizoheshin në historinë postkomuniste dhe të pestat në krejt historinë e shtetit shqiptar. Afrim Krasniqi (2009: 82), në librin e tij është shprehur se zgjedhjet parlamentare të vitit 1996 përbëjnë një nga momentet kryesore të zhvillimeve politike gjatë periudhës së tranzicionit. Sipas tij, këto zgjedhje ishin një test i rëndësishëm për forcat demokratike dhe për pretendentët e marrjes së pushtetit sepse në përballjen e parë politike në vitin 1992, ku përmes votimit plebishitar u bë edhe rotacioni i parë politik. Zgjedhjet u zhvilluan me incidente dhe u kontestuan nga opozita e cila bojkotoi procesin, ndërsa qeveria fitoi lehtësisht përqindjen më të lartë parlamentare në të gjithë vendet e ish – bllokut lindor.

Sistemi zgjedhor është ndryshuar para çdo zgjedhje të mbajtura në vendin tonë, duke dëshmuar në këtë mënyrë një konsensus të ulët midis forcave politike mbi rregullat e lojës dhe përdorim i ligjeve për përfitime elektorale të partisë në pushtet. Dhe në zgjedhjet e vitit 1996-të shpërndarja bëhej sipas numrave të fituara në listën proporcionle (Çili, 2002:

21). Me ligjin zgjedhor që u mbajtën dy zgjedhje parlamentare, karakteri mazhoritar është i plotë sepse vendet në dispozicion të listës shpërndahen në përpjestim të drejtë me votat e fituara (22). Ky ligj nuk bën korrigjimin dhe përputh diferencën midis ‘superpërfaqësimit’ e ‘nënpërfaqësimit’. Përgjatë viteve, këto ligje të ndryshme kanë arritur sëbashku të kultivojnë një ‘kulturë të dypartitizmit’ (Çili, 2002: 23).

Atëherë duke u dakortësuar me argumentin e Çilit, ku sistemi elektoral është hartuar për të favorizuar dy partitë e mëdha politike (PS-PD), i cili ka ndikuar në rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të mbajtuara në vendin tonë. Dhe si rrjedhojë, nga skena politike, partitë e vogla nuk kanë fuqi vendimmarrëse ose shantazuese ndaj forcave të para politike. Dy partitë e mëdha duke manovruar dhe duke e ndryshuar sistemin elektoral, me qëllim vetëm të marrjes së pushtetit dhe pasimin e qeverisjes midis njëra-tjetrën.

Në Rezolutën “Mbi zgjedhjet e fundit Parlamentare në Shqipëri” (bëhet fjalë për zgjedhjet e vitit 1996), theksohej në pikën 5 të saj, se “Në demokracinë shqiptare duhet të kthehet besimi. Thelbësore për këtë është pajtimi dhe dialogu midis forcave politike. Duhet garantuar liria e shprehjes dhe e vullnetit të gjithëve pjesëve të popullsisë shqiptare” (Këshilli i Europës, 2000: 194). Si rrjedhojë Asambleja Parlamentare propozonte ‘një tryezë të rrumbullakët me të gjitha forcat politike, me qëllim përgatitjen e një kuadri për dialogun demokratik ndërmjet forcave kundërshtarë, qeverisë dhe opozitës së Shqipëria pas zgjedhjeve të vitit 1996 sepse vendi ndodhej në një kaos, ku mungonte dialogu politik dhe bashkëpunimi midis dy forcave kryesore politike mungonte.

Sipas të dhënave zyrtare, në zgjedhje morën pjesë 89 % e zgjedhësve, ku 65,5 % votuan për PD-në dhe 20,4 % për PS-në. Vëzhguesit Ndërkombëtarë raportuan parregullsi në zgjedhje dhe mos plotësim të standarteve në procesin zgjedhor. Pas përsëritjes dhe

zhvillimit të raundit të dytë, opozita nuk njihte rezultatin përfundimtar dhe Kuvendin e dalur prej tyre. Subjektet zgjedhore të opozitës u ankuan në Gjykatën Kushtetuese, por ajo i rrëzoi kërkesat e paraqitura (Kume, 2015: 33).

Tabela nr. 25: Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 1996.

Nr.	Subjekti politik	Mandate të fituara në Kuvendin Popullor	% mandateve në raport me nr. total të mandateve	Përqindja në vota
1	Aleanca Demokratike	0	0	1.56 %
2	Balli Kombëtar	1 + 1 = 2	1.42 %	4.97 %
3	PBDNJ	2 + 1 = 3	2.14 %	4.04 %
4	Bashkimi Demokrat	0	0	0.72 %
5	Bashkimi Socialdemokrat	0	0	1.97 %
6	Partia Demokratike	105 + 17 = 122	87.14 %	55.53 %
7	Partia Demokristiane	0	0	1.28 %
8	PSD	0	0	1.52 %
9	Partia Republikane	2 + 1 = 3	2.14 %	5.74 %
10	Lëvizja Legalitetit	0	0	2.07 %
11	Partia Socialiste	5 + 5 = 10	7.14 %	20.37 %
12	Partia e Unitetit	0	0	0.24 %

Zgjedhjet u zhvilluan në datat 26 maj, 2 qershor dhe 16 qershor të vitit 1996. Mazhoranca mund të konsiderohet si mazhorancë fituese sepse PD ka fituar 122 mandate parlamentare ose 87.14 % (të mandateve në raport me numrin total në Kuvend), si edhe mbështetja popullore ka qenë mbi 50 % në rang kombëtar. Vërehet një pasqyrë jo e saktë të verdiktit popullor, ku mandatet e marra nuk janë në proporcion të saktë me votat e popullit. Gjithashtu vërehet një tkurrje më e madhe e PS, e cila në këtë legjislaturë ka fituar vetëm 10 mandate parlamentare dhe vetëm 20.37 % të mbështetjes popullore në vota.

Grafiku Nr. 4: Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 1996.



Sali Berisha ishte President i Shqipërisë (09.04.1992-24.07.1997), të cilit mandati i përfundonte pas një viti. Gjithashtu, kemi krijimin e Qeverisë po nga e njëjta forcë politike, ku partia fituese ishte PD, me 122 mandate parlamentare. Situata politike nuk ishte fare e mirë, por ajo që shkaktoi rebelimin e vitit 1997, e njohur si ‘Kriza piramidale’ ose ‘Anarkia në Shqipëri’ ishte një lëvizje antiqeveritare, e cila filloi më 24 janar në Lushnjë dhe përfundoi më 24 Korrik të vitit 1997-të, pas dorëheqjes së detyrueshme të Sali Berishës si President i vendit. Opozita arriti të përfitonte nga situata e rëndë e krijuar dhe i kanalizoi protestat në rrugë politike, duke kërkuar në këtë mënyrë dorëheqjen e qeverisë dhe të Presidentit Berisha.

***Analizimi i zgjedhjeve parlamentare të vitit 1996-të sipas teorisë së Arend Lijphart
“Ndikimi i sistemit elektoral në formën qeverisëse”***

Në këto zgjedhje u regjistruan 24 parti politike dhe votohej për 1.180 kandidatë për 140 mandate parlamentare. U zhvilluan dy ture votimesh, në datën 26 maj dhe 2 qershor të vitit 1996-të, ndërsa në datën 16 qershor u zhvilluan zgjedhjet për 17 zona zgjedhore për shkak të disa parregullsive të ndhoduara ditën e zgjedhjeve. Zhvillimi i turit të dytë u bojkotuan nga spektri i majtë, nga Partia Socialiste, Aleanca Demokratike dhe PSD. Kjo qeveri qëndroi në pushtet nga 11 korrik 1996 - 1 mars 1997 dhe nga vëzhguesit e nga ndërkombëtarët u cilësuan si zgjedhje jo të rregullta dhe u vlerësuan si një hap prapa duke i krahasuar me zgjedhjet e vitit 1992.

Duke u bazuar në rezultatet e zgjedhjeve të vitit 1996-të, PD ka arritur që të marrë 122 mandate parlamentare, numër ky që i mundësonte kësaj partie shumicën parlamentare. Si rrjedhojë, rezultatet përfundimtare nuk mund t’i analizojmë duke u bazuar në gjashtë

teoritë të cilat Arend Lijphart i ka renditur në librin e tij sepse nuk kemi një koalicion të krijuar midis dy ose tre partive politike. Rasti më ekstrem sipas Henri Çilit është parlamenti i vitit 1996-të, ku PD mori rreth 55.5 % të votave, ndërsa në parlament mori 87 % të mandateve parlamentare (2002: 31).

Ky është një shtrembërim i dukshëm i votës popullore, ku nuk kemi një pasqyrim të drejtë të votave me mandatet parlamentare. Nëse do të kishim aplikuar një sistem tjetër zgjedhor nuk do të kishim këtë rezultat të zgjedhjeve të vitit 1996-të. PD jo vetëm fitoi të drejtën të qeverisë vendin, por të gjithë pushtetin. Çili argumenton se të kesh shumicën e thjeshtë prej 50 + 1 % të votave në parlament, ke në dorë qeverinë (pushtetin ekzekutiv), ndërsa të kesh shumicën dërrmuese 2/3 e votave, ke në dorë sistemin gjyqësor dhe të gjitha institucionet / qelizat e shtetit (32).

Tabela nr 26: Partitë të cilat kanë fituar mandate parlamentare të radhitura sipas spektrit politik nga A deri në E, për zgjedhjet politike të vitit 1996.

Partitë politike	PS A (Majtas)	PBK B	PBDNj C	PR D	PD E (Djathtas)
Mandatet parlamentare	10	2	3	3	122

PD e vetme ka arritur të marrë mbi 4/5 e mandateve parlamentare (112 + 10 = 122) ose mbi 80 % të mandateve parlamentare. Dhe nga ky rezultat përmbytës për PS, filluan trazirat dhe pas një viti u mbajtën zgjedhjet e dyta të parakohshme për një periudhë shumë të shkurtër. **Në këto zgjedhje kemi krijimin e një kabineti një partiak (kabinet minimale fituese), ku partia e vetme fituese ka numrat e nevojshme për të miratuar reforma të mëdha e nuk ka domosdoshmëri që të negociojë me një ose më shumë parti joqeverisëse,** për të qëndruar në zyra dhe për të kërkuar mbështetje për propozimet e saj legislative. Lijphart bënte dallimin edhe të kabineteve një partiake dhe në këtë rast, një

parti e vetme kishte tërë pushtetin dhe fuqinë e numrave për të vendosur e miratuar ligje të rëndësishme për vendin.

4.5 Disa ndryshime në ligjin elektorral të vitit 1997

Në vitin 1997-të, sistemi zgjedhor pësoi disa ndryshime në ligjin e aprovuar nga Kuvendi i Shqipërisë me vendim të Gjykatës Kushtetuese. Në këto zgjedhje u aplikua sërish një sistem miks i pavarur (pjesërisht i varur sipas variantit fillestar të tij). Sipas Ligjit Nr. 8218, datë 16.05.1997, Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 7556, datë 04.02.1992 “Për Zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin Nr. 8143, datë 11.09.1996 theksohet në Nenin 3, se: “Kuvendi Popullor përbëhet nga 155 deputetë, nga të cilët 115 zgjidhen drejtpërdrejt në zona një emërore, kurse 40 mandatet e tjerë shtesë u jepen kandidatëve që janë në listat e subjekteve në shkallë vendi, në bazë të votave të fituara gjatë votimit në raundin e parë, sipas rregullit të përcaktuar në nenin 11”.

Dhe më poshtë, në Nenin 11 vijon se “Nga ndarja e 40 mandateve shtesë fitojnë vetëm subjektet që në shkallë vendi kanë jo më pak se 2% të votave”. Pas numërimit të votave të vlefshme të fituara në shkallë vendi për çdo subjekt politik gjatë raundit të parë, kryhen këto veprime: “Numri i votave të vlefshme të secilës nga dy partitë politike që kanë fituar numrin më të madh të votave, përpjesëtohet me shumën e votave të vlefshme të tyre dhe rezultati që del shumëzohet me numrin 10”. Secila nga këto parti merr fillimisht aq vende sa është numri i plotë që del nga veprimet e kryera më sipër, ndërsa vendi që mbetet deri në plotësimin e numrit 10, i jepet subjektit që ka pjesën dhjetore më të madhe. Në rast barazimi atëherë hidhet shorti për mandatet në përqindje për gjithë partitë e vogla.

Gjithashtu theksohet, se për ndarjen e 30 mandate të proporcionalit, veprimet që kryhen janë si vijojnë: “Numri i votave të vlefshme për secilin nga subjektet politike e tjera që plotësojnë kushtin e paragrafit të parë (pra ato subjekte që kanë më shumë se 2% të votave dhe kalojnë pragun elektoral zyrtar) pjesëtohet me shumën e votave të vlefshme të tyre dhe thyesa që del shumëzohet me numrin 30”.

Secili nga këto subjekte merr fillimisht aq vende sa është numri i plotë që del nga veprimet e kryera më sipër. Vendet që ngelen deri në plotësimin e numrit 30 u shpërndahen këtyre subjekteve sipas madhësisë të pjesës dhjetore. Në rast barazimi, përdoret shorti (përqindja e votave popullore pa mandate ose që kanë ndihmuar në fitimin e mandateve nga partitë e mëdha sipas sistemit elektoral të përdorur). Partia Socialiste ka dalë në përfundim se ky nen lejon që votat që jepen për një subjekt politik, grabiten nga parti e vogla dhe insistonin që krijohet një parlament fiktiv (Krasniqi, 2009: 167) që nuk përfaqëson vullnetin e lirë popullor. Dhe në fund, theksonin se kjo formulë bie ndesh me parimet bazë të së drejtës së zgjedhjeve. Pra, sipas këtij sistemi elektoral nuk kemi një pasqyrë të votave në Kuvend, por deformim i tyre dhe shumë vota kanë qenë të papërfqësuar.

Pjesa më e madhe e ndryshimeve u bazuan tek sugjerimet e ekipit të ekspertëve të ODHIR-it (“Vlerësim i zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 1996”), mbi bazën e rekomandimeve të dhëna pas zhvillimit të zgjedhjeve lokale në tetor të vitit 1996. Për sa i përket ndryshimeve thelbësore që i është bërë sistemit elektoral, kemi ndryshimin e numrit të mandateve nga 140 në vitin 1996 në 155 në zgjedhjet e vitit 1997. Numri i deputetëve të zgjedhur nëpërmjet sistemit mazhoritar me dy raunde mbetet i njëjtë 115, ndërkohë që ndryshon numri i deputetëve që zgjidhen në mënyrë proporcionale nga 25 në 40 mandate.

Për fitimin e mandateve shtesë në shkallë vendi kufiri minimal i votave të fituara u ulëj nga 4% (me ndryshimet e bëra në 1996) në 2%” (Bufi, 2010: 139).

Sipas specialistë të sistemeve zgjedhore, këto ndryshime në ligjin elektoral shikoheshin si tendenca për të forcuar sistemin mazhoritar. Ndërsa për specialistin Kristaq Kume, *“rritja e numrit të deputetëve të zgjedhur nga zonat njëemërore forcon prirjet mazhoritare të sistemit zgjedhor”* (Koha Jonë (1998) “Mbi ligjin e ri zgjedhor”, Kume, 6 Shtator, f. 2). Dhe nëse i referohemi rezultatit të zgjedhjeve të vitit 1997-të, konstatohet prirja mazhoritare e sjelljes së votuesve. Paritë e vogla pavarësisht se kanë një prag më të ulët (nga 4 % në 2 %) nuk arrinin të ulnin peshën e dy partive kryesore politike.

4.5.1 Rezultatet e zgjedhjeve parlamentare të parakohshme të 29 qershorit ‘97

Në Shqipëri në vitin 1997 kemi zhvillimin e luftës civile, ku pushteti dhe qeveria bien për një periudhë disa mujore. Një tregues i gjendjes kaotike në vend ishte shkatërrimi i ekonomisë, i bankave dhe i bizneseve private, ku u shfaqën firmat piramidale. Në mungesë të funksionimit të shtetit dhe të protestave popullore, opozita përfitoi nga situata e krijuar dhe i kanalizoi protestat në rrugë politike duke kërkuar edhe dorëheqjen e qeverisë dhe të Presidentit Sali Berisha.

Zgjedhjet e vitit 1997-të ishin zgjedhjet e dyta si të parakohshme që nga viti 1990-të. Zgjedhjet e vitit 1992 sollën rotacionin politik, duke i’ a dhënë pushtetin PD-së, ndërsa në zgjedhjet e vitit 1997-të ndodhi e kundërta. Këto zgjedhje parlamentare u bënë për faktin se, vendi kishte hyrë në krizë politike dhe mungonte stabiliteti qeverisës dhe ekonomik. Këto zgjedhje u përgatitën nga një qeveri politike koalicioni, e cila ishte e dominuar nga

konfliktet dhe nga një rivalitetit i brëndshëm politik (Krasniqi, 2009: 142). Në vend erdhën rreth 475 vëzhgues ndërkombëtarë nga 32 vende të ndryshme të botës dhe në raportin final arritën në përfundim se zgjedhjet ishin të pranueshme për kushtet në të cilat u krijuan (OSCE/ODHIR. EL.97/AL1/ver.1, 12 nëntor '97).

Në këtë zgjedhje morën pjesë 23 parti, me 1050 kandidatë për 155 vende. Partia Demokratike ishte përballë aleancës opozitare të përbërë nga Partia Socialiste, Partia Socialdemokrate dhe Aleanca Demokratike. Zgjedhjet u mbajtën me dy raunde, raundi i parë u zhvillua më 29 Qershor dhe raundi i dytë më 6 Korrik (zgjedhjet u përsëritën në 32 zona), në total PS fitoi 100 vende parlamentare. Vëzhguesit ndërkombëtarë i cilësuan këto zgjedhje si "të kënaqshme dhe të vlefshme" por jo "të lira dhe të ndershme", duke i'u referuar dhunës së ushtruar mbi përfaqësuesit e Partisë Demokratike. Numri i votuesve të regjistruar ishte 1.947.235 dhe votuan 1.412.929 qytetarë ose rreth 72.56%.

Në këto zgjedhje vërehet një humbje e madhe e Partisë Demokratike dhe ky rezultat shihet si një dënim ndaj referendumit të iniciuar nga kjo forcë politike dhe nga situata kaotike e krijuar në vend në vitin 1997-të. Për shkak të ndryshimit të këtij ligji, PS fitoi 22 vende në listën proporcionale (Krasniqi, 2009: 154) dhe në shkallë vendi fitoi rreth 53 % të votave. Tabela e mëposhtme paraqet rezultatet e dy zgjedhjeve, si edhe diferencat në mandate për partitë të cilat kanë kandiduar në këto zgjedhje:

Tabela Nr. 27: Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 1997.

Nr.	Subjekti politik	Viti 1996 Mandate parlamentare	Viti 1997 Mandate parlamentare	1996 - 1997 Diferenca
1	Partia Socialiste	10	100	+90
2	Partia Demokratike	122	27	-95
3	Lëvizja e Legalitetit	-	2	+2
4	Bashkimi për të Drejtat e Njeriut	3	4	+1
5	Aleanca Demokratike	-	2	+2
6	Partia Socialdemokrate	-	9	+9

7	Partia Republikane	3	1	-2
8	Partia Balli Kombëtar	2	1	-1
9	Partia Demokristiane	-	1	+1
10	Partia Agrare	-	1	+1
11	Partia Bashkimi Demokrat	-	1	+1
12	Partia Unitet Kombëtar	-	1	+1
13	DBSH	-	2	+2
14	Të pavarur	-	3	+3
	Total	140	155	-

Partia Demokratike është mundur në pjesën jugore dhe të mesme të vendit, madje edhe në pjesën veriore. Rexhep Meidani më 4 korrik u propozua si kandidat i vetëm i partive të koalicionit dhe u zgjodh President i Republikës, që në turin e parë gjatë një seance të shtendosur (Zogaj, 2001 c: 41). Në tabelën e mëposhtme për çdo subjekt politik do të paraqesim mandatet e fituara në zonën njëemërore dhe në shkallë vendi. Si edhe do ti paraqesim me përqindje, mandatet e fituara në raport me numrin total të mandateve, si edhe përqindjen e votave të marra.

Tabela nr. 28: Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 1997 në përqindje.

Nr.	Subjekti politik	Mandate të fituara në Kuvendin Popullor	% mandateve në raport me nr. total të mandateve	Përqindja në vota
1	Partia Socialiste	78 + 22 = 100	64.5 %	53.30 %
2	Partia Demokratike	16 + 11 = 27	17.4 %	25.16 %
3	Partia Lëvizja e Legalitetit	0 + 2 = 2	1.29 %	3.25 %
4	PBDNJ	3 + 1 = 4	2.58 %	2.86 %
5	Partia Aleanca Demokratike	1 + 1 = 2	1.29 %	2.76 %
6	Partia Republikane	1 + 1 = 2	1.29 %	2.43 %
7	Partia Balli Kombëtar	0 + 1 = 1	0.64 %	2.30 %
8	Partia Uniteti kombëtar	1 + 0 = 1	0.64 %	0.29 %
9	Djathta e Bashkuar Shqiptare	2 + 0 = 2	1.29 %	-
10	Partia Demokristiane	1 + 0 = 1	0.64 %	0.98 %
11	Partia Social Demokrate	8 + 1 = 9	5.80 %	2.63 %
12	Partia Agrare	1 + 0 = 1	0.64 %	0.81 %
13	Të Pavarur	3		

Në këto zgjedhje të parakohshme të vitit 1997-të, për herë të parë në Kuvend kemi një numër të madh të partive të vogla të cilat arritën të përfaqësojnë elektoratin e tyre. Dhe rreth 12 parti, si PS me 100 mandate, PD me 27 mandate, PSD me 9 mandate, PDK me 1

mandat, PBDNj me 4 mandate, PAD me 2 mandate, PA me 1 mandat, E djathta e Bashkuar 2 mandate, PUK me 1 mandat, PR me 2 mandate, PLL me 2 mandate dhe PBK me 1 mandat (KQZ). Në këto zgjedhje kemi një mazhorancë fituese sepse PS-së ka një numër mandatesh të madh, rreth 64,5% të mandateve edhe se kemi një numër të madh të partive të vogla politike në Parlament.

Grafiku nr. 5: Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 1997.



Në vitin 1997, socialistët ishin me idenë për një ‘qeverisje me bazë të gjërë’ edhe se fituan 2/3 e vendeve në parlament, ata krijuan një koalicion prej 5 partish nga qendra në të majtë (Çili, 2002: 27-28). Dy partitë e mëdha politike arritën të fitojnë sëbashku 127 mandate parlamentare ose rreth 81.9 %, si edhe rreth 78.46 % vota popullore. Partia fituese, PS ka fituar 100 deputetë ose rreth 64.5 %, ndërsa PD ka fituar 27 mandate ose 17.4 %. Ndërsa përsa i përket mbështetjes popullore, PS ka marrë rreth 53.30 %, ndërsa PD rreth 25.16 % të tyre. Ndodhi rotacioni politik dhe Partia Socialiste do të krijojë qeverinë e saj për katër vjeçar in e ardhshëm.

Pas ardhjes në pushtet të PS-së, ata deklaruan se pushteti i vërtetë do të jetë në duart e kryeministrit (Biberaj, 2011: 461) dhe se posti i presidentit do të ishte simbolik, me

kompetenca të kufizuara. Presidenti i Shqipërisë u zgjodh Rexhep Meidani (17 gusht 1944) më 24.07.1997 -24.07.2002 dhe ishte nga Partia e Punës së Shqipërisë. Fatos Nano u besua që të krijojë qeverinë e re në postin e Kryeministrit 24.07.1997-02.10.1998. Por në këtë legjislaturë të së majtës kemi ndryshimin e Kryeministrit tre herë. Pas Nanos, Kryeministër u zgjodh Pandeli Majko nga 02.10.1998-29.10.1999 dhe më pas u zgjodh Ilir Meta nga 29.10.1999-22.02.2002.

Të tre Kryeministrat e zgjedhur brenda legjislaturës 1997-2001, ishin nga po e njëjta forcë politike e Presidentit, nga ku kuptojmë se kemi një pushtet të madh të së majtës shqiptare, e cila kishte numrat e nevojshme për reformat e mëdha. Por gjithashtu duhet të nënvizojmë se ndryshimi i Kryeministrit tre herë brenda së njëjtes legjislature pohon për një mungesë stabiliteti në vend dhe të një kërkesë të antarësisë së partisë për ndryshimin e kreut të qeverisë së vendit.

Analizimi i zgjedhjeve të dyta parlamentare si të parakohshme të vitit 1997-të sipas teorisë së Arend Lijphart “Ndikimi i sistemit elektoral në formën qeverisëse”

Gjashtë teoritë e koalicionit: 1. Koalicion minimal i fituar; 2. Koalicionet me madhësi minimale; 3. Koalicionet me numrin më të vogël të partive; 4. Koalicionet me varg minimal; 5. Koalicionet minimale fituese; 6. Koalicionet politike – praktike.

Tabela nr. 29: Partitë të cilat kanë fituar mandate parlamentare të radhitura sipas spektrit politik nga A deri në M, për zgjedhjet e dyta të parakohshme të vitit 1997.

Partitë politike	PS (Majtas) A	PA B	PSD C	PAD D	PBD Nj E	Tëpa varur F	PB K G	PU K H	PL L I	PD K J	DBS h K	P R L	PD (Djathtas) M
Mandatet parlamentare	100	1	9	2	4	3	1	1	2	1	2	2	27

Fatos Nano formoi një kabinet me qeverisje të gjërë, ku nga 22 portofole ministrore, emëroi vetëm 13 përfaqësues nga partia e tij. Në 9 portofole ministrore emëroi përfaqësues nga Partia SocialDemokrate, Partia Agrare, Aleanca Demokratike dhe Partia e të Drejtave të Njeriut. Si rrjedhojë kemi 116 mandate nga koalicioni i gjërë qeverisës (100PS+1PA+9PSD+2PAD+4PBDNj=116 Tortal). Ky koalicion është formuar edhe se PS kishte numrin e nevojshëm të mandateve për të formuar një qeveri e vetme, preferoi të përfshijë në bashkëqeverisje katër parti të vogla politike. Këto emërimë Nano i bëri duke u bazuar më tepër për arsye politike edhe se partitë e vogla të së majtës nuk kishin shumë përkrahje në popull. Këta aleatë morën portofole të rëndësishme ministrore. Me këto zgjedhje politike me ndërrimin paqësor të pushtetit, Shqipëria arriti që të dalë nga një situatë kritike që ishte krijuar së fundmi në vend.

Në këtë rast kemi një koalicion të gjërë i formuar nga parti të një spektri politik, të së majtës qëndrore. Dhe nëse të dhënat ose rezultatet e zgjedhjeve të vitit 1997-të, do ti analizojmë duke u bazuar tek gjashtë koalicionet të renditura nga Arend Lijphart, atëherë në këtë rast **kemi një koalicion minimal fitues. Ky koalicion përfshin në total pesë parti politike dhe ka katër hapësirë, gjithmonë brënda të së njëjtës spektër politik (të së majtës).**

Dhe më specifikisht, **teoria e pestë e koalicionet minimale fituese**, do të formohen nga të dyja partitë që janë të "lidhur", është i përbërë nga partitë që janë ngjitur në politikë dhe pa partnerë të panevojshme. Supozimi themelor i kësaj teorie është se palët do të përpiqen për tu rritur së bashku me fqinjët e tyre të menjëhershëm dhe se palët e tjera fqinje do të të shtohen, deri në formimin e një koalicioni të shumicës.

4.6 Ndryshimet Kushtetuese të vitit 1998-të

Kushtetuta e re e Shqipërisë u miratua dhe hyri në fuqi në vitin 1998-të përmes një referendumi mbarëpopullor. Kushtetuta përkufizon Shqipërinë një Republikë parlamentare, shtet unitar e të pandashëm dhe me një qeverisje të bazuar "në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike". Organi ligjvënës përbëhet nga një dhomë dhe ka 140 deputetë, të cilët zgjedhin kreun e tyre të shtetit, Presidentin dhe Këshillin e Ministrave të ngarkuar me pushtetin ekzekutiv.

Kushtetuta e vitit 1998, përgjithësisht i plotëson standardet për krijimin e bazës ligjore për një sistem politik demokratik (Inc, 2006: 12). Shqipëria është Republikë Parlamentare, ku Parlamenti zgjedh Presidentin, i cili ka kompetenca të limituara. Vendi ka një Parlament njëdhomësh me 140 anëtarë, të cilët zgjidhen çdo katër vjet. Në nenin 96 të Kushtetutës, përcaktohet se Presidenti emëron Kryeministrin, por nëse Kryeministri i emëruar nuk miratohet nga Kuvendi, atëherë Presidenti emëron një Kryeministër të ri brënda 10 ditëve. Edhe ministrat emërohen e shkarkohen nga Presidenti me propozim të Kryeministrit dhe dekreti i Presidentit miratohet nga Kuvendi.

Në Nenin 64 të Kushtetutës, për sistemin elektorale nëvizohet se *Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë, 100 zgjidhen drejtpërdrejt në zona njëemërore me numër të përafërt zgjedhësish. Ndërsa 40 mandate zgjidhen nga listat shumëemërore të partive dhe/ose koalicioneve të partive sipas renditjes në to.* Numri i përgjithshëm i deputetëve të çdo partie ose koalicioni partish përcaktohet në raport sa më të afërt me votat e vlefshme të marra prej tyre në të gjithë vendin në raundin e parë të zgjedhjeve. Partitë që marrin më pak se 2.5 % dhe koalicionet e partive që marrin më pak se 4 % të votave në të gjithë vendin në raundin e parë të zgjedhjeve, nuk përfitojnë nga listat shumëemërore përkatëse.

Parlamenti ndikon në konsolidimin e demokracisë në vendin tonë. Parlamenti në Shqipëri ka tre funksione kryesore, si ligjvënës, mbikëqyrës dhe përfaqësues. Rregullorja e re e punës, strukturat e brendshme dhe marrëveshjet e komisionit, i dhanë parlamentit fuqi për të balancuar ekzekutivin. Le t'i analizojmë më gjërësisht tre funksionet kryesore të Parlamentit Shqiptar (Inc, 2006: 24-25):

a) *Ligjbërja*. Shqipëria ka një sistem parlamentar dhe nuk ka ndarje të theksuara të pushteteve Qeveri dhe Parlament. Ministrat janë anëtarë të parlamentit dhe qeveria inicion e harton legjislacionin. Në përgjithësi ministria përgjegjëse propozon akte ligjore, por Kryeministri mund të ngrejë një grup ekspertësh nga disa ministri me një interes në një çështje të caktuar. Ministria e Drejtësisë më pas rishikon propozimin e legjislacionit për pajtueshmërinë me Kushtetutën e me marrëveshjet ndërkombëtare dhe harmonizimin me legjislacionin ekzistues e çështje tjera teknike. Këshilli i Ministrave duhet të miratojë projektligjin para se të mund të paraqitet në Parlament, së bashku me një raport të adresuar me implikimet financiare, marrëdhëniet me legjislacionin tjetër e marrëdhëniet me legjislacionin Evropian.

b) *Mbikëqyrja*. Parlamenti mund të mbikëqyrur degën ekzekutive nëpërmjet pyetjeve drejtuar anëtarëve të Këshillit të Ministrave dhe përmes debateve parlamentare. Si rrjedhojë parlamenti ka krijuar komisione për të adresuar çështjet që do të diskutohen, të ndara sipas kategorive. Për të monitoruar zbatimin dhe ekzekutimin e ligjeve nga ana e Qeverisë, Kuvendi përdor mekanizmeve ligjorë kontrolli mbi pushtetin ekzekutiv dhe mbi institucione tjera qendrore kushtetuese (Republika e Shqipërisë “Legjislatura XVII (2005-2009)” 2007: 11). Kuvendi është një organ qendror kushtetues, me pushtet ligjvënës dhe kontrollues, por duke respektuar parimin e ndarjes së pushteteve (neni 7 i Kushtetutës).

c) *Përfaqësimi*. Shqipëria është një sistem parlamentar me një disiplinë të fortë partiake, ku deputetët kanë pak mundësi për të përfaqësuar zgjedhësit e tyre në seancë plenare dhe në komisione në një sistem presidencial. Kemi një dyzim midis mbajtjes së lidhjeve me zgjedhësit e tyre dhe midis besnikërisë ndaj partisë. Disa analistë kanë dalë në konkluzion se Shqipëria përballlet me një "krizë të përfaqësimit". Kjo vjen si rezultat se interesat e shoqërisë ose edhe grupeve të veçantë të interesit, nuk merren parasysh nga ligjvënësit sepse mungon komunikimi midis tyre.

Tek Manuali i përgatitur për “Legjislatura XVII (2005-2009)” të Republikës së Shqipërisë (2007: 10) është përcaktuar funksioni elektoral (për të zgjedhur). Anëtarët e Kuvendit kanë përgjegjësi sepse zgjedhin Kryeministrin, kabinetit qeveritar, Presidentin dhe miratojnë programin e Këshillit të Ministrave. Si rrjedhojë, nënvizojmë se shumica parlamentare është e rëndësishme dhe ndikon në stabilitetin e vendit.

Në Shqipëri, forma e qeverisjes është parlamentare dhe midis parlamentit e qeverisë ndërtohet raport besimi i ndërsjellë (Meidani, 2009 “Kushtetuta: Bilanci dhe Perspektiva”). Presidenti, në funksionin e kryetarit të shtetit, bashkëvepron me qeverinë (kryeministrin) dhe parlamentin nëpërmjet një sistemi kontroll-balancimi. Dhe në nenin 96 të Kushtetutës së Shqipërisë, specifikohet se emërimi i Kryeministrit bëhet nga Presidenti në 3 variante të mundshme. Në rast mos zgjedhje, tek Neni 96, pika 4, specifikohet se Presidenti shpërndan Kuvendin. Po kështu, në Nenin 98, theksohet në pikën e parë, se Ministri emërohet e shkarkohet nga Presidenti, me propozim të Kryeministrit, kjo brenda 7 ditëve dhe në pikën 2, specifikohet se Dekreti shqyrtohet brenda 10 ditëve nga Kuvendi.

Por le të analizojmë disa nga funksionet më kryesore të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, i cili është edhe figura qendrore dhe më e rëndësishmja në sferën politike.

Kjo vjen si rrjedhojë se Shqipëria është Republikë parlamentare dhe Presidenti ka funksione të kufizuara. Nëpërmjet analizimit të kompetencave të Kryeministrit dhe Presidentit, në këtë mënyrë analizojmë dhe studjojmë lidhjen që ekziston midis pushteteve, nëse ekziston marrëdhënie kontrolli të ndërsjelltë ose marrëdhënie varësie? Kush ka të drejtën legislative dhe të drejtën e emërimeve, kush e ka të drejtën e vetos etj.

Tabela nr 30: Kompetencat e Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë të përcaktuara (Neni 102) në Kushtetutën e Shqipërisë në vitin 1998-të.

Sipas Kushtetutës të miratuar në vitin 1998-të, Kryeministri i Republikës së Shqipërisë ushtron këto kompetenca:
1. Përfaqëson Këshillin e Ministrave dhe kryeson mbledhjet e tij;
2. Koncepton dhe paraqet drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe përgjigjet për to;
3. Siguron zbatimin e legjislacionit dhe të politikave të miratuara nga Këshilli i Ministrave;
4. Bashkërendon dhe kontrollon punën e anëtarëve të Këshillit të Ministrave dhe të institucioneve të tjera të administratës qendrore të shtetit;
5. Kryen detyra të tjera të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligje.

Presidenti, si përfaqësues i unitetit popullor, konsiderohet si organi më i lartë shtetëror nga pikëpamja protokollare, ku në një republikë parlamentare nuk bën pjesë në asnjë prej tri pushteteve (Vorpsi, (2006) “E drejta parlamentare dhe politikat ligjore,” Nr. XXIX). Presidenti si përfaqësues i shtetit shqiptar gëzon disa kompetenca, si: a) Mbikëqyrja e veprimtarisë shtetërore; b) Përfaqësimi i shtetit jashtë vendit; c) Integriteti shtetëror. Në vendin tonë, Presidenti mbetet dyshues dhe i pabesueshëm për opozitën e vendit sepse historikisht kreu i shtetit zgjidhet nga kreu i qeverisë. Si rrjedhojë, opozita nuk njeh kushtetutën dhe thuajse nuk i njeh edhe institucionet e dala prej saj (Çili, 2002: 39).

Tabela nr 31: Kompetencat e Presidentit të Shqipërisë të përcaktuara (Neni 92) në Kushtetutën e Shqipërisë në vitin 1998-të.

Sipas Kushtetutës të miratuar në vitin 1998-të, Presidenti i Republikës së Shqipërisë ushtron këto kompetenca:
1. I drejton mesazhe Kuvendit;
2. Ushtron të drejtën e faljes sipas ligjit;
3. Jep shtetësinë shqiptare dhe lejon lënien e saj sipas ligjit;
4. Jep dekorata e tituj nderi sipas ligjit;

5. Jep gradat më të larta ushtarake sipas ligjit;
6. Me propozim të Kryeministrit, emëron dhe liron përfaqësuesit e plotfuqishëm të Republikës së Shqipërisë në shtetet e tjera dhe në organizatat ndërkombëtare;
7. Pranon letrat kredenciale dhe tërheqjen e përfaqësuesve diplomatikë të shteteve të tjera dhe të organizatave ndërkombëtare të akredituara në Republikën e Shqipërisë;
8. Lidh marrëveshje ndërkombëtare sipas ligjit;
9. Me propozim të Kryeministrit, emëron drejtorin e shërbimit informativ të shtetit;
10. Emëron Kryetarin e Akademisë së Shkencave dhe rektorët e universiteteve sipas ligjit;
11. Cakton datën e zgjedhjeve për Kuvendin, për organet e pushtetit vendor dhe për zhvillimin e referendumeve;
12. Kërkon mendim dhe të dhëna me shkrim nga drejtuesit e institucioneve shtetërore për çështje që kanë të bëjnë me detyrat e tyre.

Por, le të analizojmë pozicionin e Presidentit në lidhje me emërimin e Kryeministrit dhe të ministrave të kabinetit qeveritar. Presidenti sipas Kushtetutës së Shqipërisë të vitit 1998-të, emëron dhe shkarkon anëtarët e Qeverisë. Por nuk mund të emërojë ose shkarkojë asnjë ministër pa propozimin e Kryeministrit, por vetëm mund të rekomandojë një emër në postin e ministrit. Në një regjim parlamentar, Qeveria merr votbesimin nga Parlamenti, përgjigjet para tij dhe mund ta rrëzoj atë. Presidenti ka funksione shumë të kufizuara, për të mos thënë simbolike dhe vetëm dekreton vendimet e marra nga Parlamenti/Kuvendi.

Neni 90/1 i Kushtetutës së Shqipërisë ndalon qeverisjen e Presidentit krahas ekzekutivit ose ligjvënësit. Presidenti nuk mund të bëjë politike të pavarur sepse qeverisja i është përcaktuar Kuvendit dhe Qeverisë. Presidenti nuk përgjigjet para Kuvendit se ndaj tij nuk mund të ndërmerret mocion mosbesimi ose të thirret në interpelancë. E vetmja mundësi është fillimi i një procesi para Gjykatës Kushtetuese për shkarkimin e tij nga detyra ose përgjegjësi penale për kryerjen e një veprë penale (Neni 90/2, 3 i Kushtetutës së RSH-së).

Presidenti në rolin e kryetarit të shtetit, është një presidentet joqeverisës dhe përgjigjet për ruajtjen e sigurisë juridike, zbatimin e së drejtës, kontrollit të rregullshmërisë së akteve të organeve më të larta shtetërore kushtetuese, përfaqësimit të shtetit dhe popullit si i tërë, mishërimit të unitetit të popullit dhe garantimit të Kushtetutës së vendit tonë. Neni

94 i Kushtetutës, parashikon se Presidenti nuk mund të ushtrojë kompetenca tjera, veç atyre që i njihen me Kushtetutë dhe që i jepen me ligje të nxjerra në pajtim me të.

Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Shqipërisë

Do të analizojmë mënyrën e zgjedhjes së presidentit përpara e pas miratimit të Kushtetutës së vitit 1998-të, ku në këtë mënyrë do të shohim fuqinë dhe kompetencat e kreut të shtetit shqiptar dhe lidhjen që ekziston me kreun e qeverisë. Do të bazohemi në “Dispozitat Kushtetuese” gjatë periudhës korrik 1997 - nëntor 1998 dhe në Kushtetutën e vitit 1998-të (nga nëntori 1998 - korrik 2002). Me miratimin e Kushtetutës së 1998-të, presidentit i’u hoqën disa kompetenca të rëndësishme, si iniciativa ligjvënëse, drejtimi i mbledhjeve të qeverisë në raste të veçanta dhe i’u reduktuan disa prej emërimeve të zyrtarëve më të lartë. Presidenti nuk mund të ishte anëtar në parti politike gjatë presidencës së tij. Dhe më specifikisht në nenin 89, nënvizohet se “*Presidenti i Republikës nuk mund të mbajë asnjë detyrë tjetër publike, nuk mund të jetë anëtar partie dhe as të kryejë veprimtari tjetër private*”.

Një prej ndryshimeve ka të bëjë me procedurën për zgjedhjen e Presidentit të ri, të argumentuar nga politikëbërësit si një procedurë e zgjatur dhe e ndërlikuar, që sipas tyre mund të rrezikonte edhe stabilitetin e vendit. U parashikua zhvillimi i dy raunde ‘zgjedhje’ parlamentare brenda 4 muaj, për të zgjedhur Presidentin me një shumicën absolute të gjithë votave të deputetëve. Nëse do të analizonim procedurën e mëparshme, ajo i vinte deputet përpara marrëveshjeve midis grupeve të ndryshme parlamentare ose pranimin e zgjedhjeve

të reja për zgjedhjen e Presidentit. Ky kompromis u arrit me zgjedhjen e Presidentit në zgjedhjet e vitit 2002 dhe 2007.

Ky ndryshim procedural prek frymën e Kushtetutës dhe cënon, qoftë tërthorazi, balancimin e pushteteve, si edhe raportin midis maxhorancës e opozitës në qeverisjen e vendit (Vorpsi, 2006). Në Kushtetutë, Presidenti është konceptuar si një figurë që qëndron jashtë pushteteve, por që ka ndikim në veprimtarinë e tyre. Presidenti luan rol në mbrojtjen e pavarësisë së Gjyqësorit dhe në ecurinë e procesit të punës. Zgjedhja e Presidentit me një shumicë të cilësuar e forcon pozitën e tij sepse zgjidhet nga një marrëveshje midis palëve kundërshtare politike dhe shihet si një figurë mbi palët ose asnjëse ose apolitike.

Në nenin 87, specifikohet nga pika 1-9, se Kandidati për President i propozohet Kuvendit nga një grup me 20 deputetë, zgjidhet me votim të fshehtë dhe me një shumicë prej 3/5 të anëtarëve të parlamentit. Për të zgjedhur presidentin e ri nevojiten 84 vota, e cila kërkon një mazhorancë me një shumicë të gjërë parlamentare që të ketë numrat e nevojshme. Nëse në votimin e parë nuk arrihet kjo shumicë, atëherë brenda 7 ditëve bëhet një votim i dytë dhe nëse përsëri në votimin e dytë nuk arrihet shumica e kërkuar, atëherë brenda 7 ditëve të tjera bëhet një votim i tretë.

Nëse nuk ka më shumë se dy kandidatë dhe asnjëri prej tyre nuk ka marrë shumicën e kërkuar, atëherë brenda 7 ditëve bëhet një votim i katërt ndërmjet dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave. Dhe nëse edhe në votimin e katërt dhe të pestë nuk zgjidhet Presidenti, Kuvendi shpërndahet dhe brenda 60 ditëve bëhen zgjedhjet e reja të përgjithshme. Në pikën 8, të këtij neni qartësohet se Kuvendi i ri zgjedh Presidentin sipas procedurës së parashikuar nga paragrafët 1 deri në 7 të këtij neni. Në rast se edhe Kuvendi i ri nuk e zgjedh Presidentin, ai shpërndahet dhe brenda 60 ditëve bëhen zgjedhje të reja të

përgjithshme dhe Kuvendi pasardhës zgjedh Presidentin e Republikës me shumicën e të gjithë anëtarëve të tij.

Në Dispozitën e mëparshme, presidentit i njihej mbajtja e pozicionit të anëtarit të kryesisë së partisë (rasti i Presidentit Berisha). Papajtueshmëria kushtetuese të presidentit me një funksion partiak, në fazën fillestare të një zhvillimi institucional demokratik, duhet të shihet si një valvul mbrojtëse demokratike sipas Meidanit, ndërkohë që në një faza të mëvonshme të emancipimit demokratik, një kërkesë e tillë mund të bëhet e panevojshme. Ruajtja e funksioneve partiake në disa raste e bën rolin e Presidentit më të fuqishëm, për të njëjtën shumicë parlamentare ose më të dobët në kushte kohabitacioni argumenton autori (kur presidenti i zgjedhur ka një bashkëjetesë politike me qeverinë dhe mazhorancën parlamentare që kontrollohet nga pala tjetër politike).

Por, e rëndësishme është të kemi një president mbi palët, ‘asnjanës’ edhe apolitik. Një president të zgjedhur nga bashkimi i votave të dy forcave politike kryesore, pra një emër i dalë nga një marrëveshje e gjërë mbi palët kundërshtarë. Një president apolitik do të ishte më i drejtë dhe nuk do të mbante anën e asnjë force politike, por do të ishte përkrah të drejtës dhe së mirës së përgjithshme të gjithë shoqërisë. Ndërsa një president i zgjedhur nga votat e një mazhorance të fortë, do të ishte jo i besueshëm për opozitën dhe një president i cili do të ishte i njëanshëm nga forca që e ka zgjedhur. Dalim në përfundim se ka ndikim nëse kemi një kandidat ose dy kandidatë për president, por këtë do ta analizojmë më gjërësisht më poshtë.

Përfundime

Në këtë kapitull analizuam zgjedhjet e para pluraliste të zhvilluara në vendin tonë në vitin 1991. Edhe se nuk kishim një rezultat përmbytës të Partisë Socialiste kemi rënien e regjimit komunist dhe për herë të parë u krijuan parti opozitare, të cilat disa prej tyre arritën që të përfaqësonin elektoratin e tyre në Kuvend. Zgjedhjet e para të cilësuar si shumëpartiake më 31 mars 1991, u zhvilluan me votim të përgjithshëm dhe të fshehtë. U votua me një ligj mazhoritar me dy turne për 250 mandate. Vetëm një parti politike ka fituar numrin më të madh të mandateve e në këtë rast formohet një kabinet njëpartiak (kabineteve minimale fituese), ku partia e vetme ka numrat e nevojshme për të miratuar reforma të mëdha e nuk duhet që të bashkëpunojë me parti tjera joqeveritare.

Në zgjedhjet e para si të parakohshme të zhvilluara në Shqipëri në vitin 1992, vëmë re se kemi një parti e cila ka 92 mandate, një mandat më pak se shumica e nevojshme prej 2/3 që nevojiten për ndryshime të Kushtetutës dhe të ligjeve të rëndësishme. Në këto zgjedhje u bë rotacioni i parë politik, si edhe kemi ndryshimin defacto të sistemit politik. Gjithashtu, u kalua nga një parlament me 250 deputetë në 140 dhe ndryshimin e sistemit elektoral, nga mazhoritar në një sistem elektoral miks i varur. Sipas gjashtë teorive të koalicioneve të Arend Lijphart, kemi krijimin e teorisë së pestë të *koalicionit minimale fituese* (CDE=100). Është formuar një koalicion i shumicës, ku kemi parti në qeverisje edhe se nuk kishte domosdoshmëri krijimi i një koalicioni, kjo për faktin për të pasur një koalicion të lidhur dhe të qëndrueshëm.

Ndërsa në zgjedhjet parlamentare të vitit 1996-të, sistemi elektoral i aplikuar është sërish një sistem miks, por i pavarur, ku performanca në pjesën mazhoritare të subjekteve politike nuk korrigjohet nga rezultatet në pjesën proporcionale. PD e vetme ka arritur të

marrë mbi 4/5 e mandateve parlamentare (112+10=122) ose mbi 80 % të mandateve parlamentare. Në këtë rast kemi një *kabinet një partiak (kabineteve minimale fituese)*, ku partia e vetme fituese ka numrat e nevojshme për të miratuar reforma të mëdha e nuk ka domosdoshmëri që të negociojë vazhdimisht me një ose më shumë parti joqeverisëse, për të qëndruar në zyra dhe për të kërkuar mbështetje për propozimet e saj legjislative.

Nga rezultati i zgjedhjeve të vitit 1996-të, filluan trazirat dhe pas një viti u mbajtën zgjedhjet e dyta të parakohshme. Sistemi zgjedhor ishte miks i pavarur, ku votohej për 155 mandate, nga të cilët 115 zgjidhen drejtpërdrejt në zona një emërore, ndërsa 40 mandatet e tjerë shtesë u jepen kandidatëve që janë në listat e subjekteve në shkallë vendi (40 mandate forcojnë prirjet mazhoritare të sistemit zgjedhor). Në vitin 1997, socialistët edhe se fituan 2/3 e vendeve parlamentare, ishin për një ‘qeverisje me bazë të gjërë’ dhe krijuan një koalicion prej pesë partish nga qendra në të majtë. Kemi krijimin e një *koalicioni të gjërë i formuar nga parti të një spektri politik, të së majtës qendrore* dhe sipas teorisë së Lijphart u krijua *koalicioni minimal fitues (5)*. Ky koalicion përfshin në total pesë parti politike dhe ka katër hapësirë, gjithmonë brënda të së njëjtës spektër politik (të së majtës).

Përsa i përket Kushtetutës së Shqipërisë, në vitin 1991 kemi përpjekjet e para për miratimin e një Kushtetute demokratike, por komisioni kushtetues i ngarkuar nga ish Partia e Punës së Shqipërisë nuk arriti të marrë miratimin e opozitës së atëhershme. Si rrjedhojë, në kushtet e anulimit të kushtetutës së vitit 1976, kemi miratimin e Ligjit Nr.7491, më datë 29.4.1991 “Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese” që shpalli Shqipërinë Republikë parlamentare (Neni 1).

Edhe në vitet në vazhdim u bënë përpjekje për të miratuar Kushtetutën nëpërmjet referendumit, por pa patur sukses. Vetëm në vitin 1998-të, u miratua dhe hyri në fuqi

Kushtetuta e re e Shqipërisë përmes një referendumi popullor. Kushtetuta e përkufizon Shqipërinë një Republikë Parlamentare, shtet unitar e të pandashëm dhe me një qeverisje të bazuar "në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike". Organi ligjvënës përbëhet nga një dhomë (Parlamenti) dhe ka 140 deputetë, të cilët zgjedhin kreun e shtetit, Presidentin dhe Këshillin e Ministrave, të ngarkuar me pushtetin ekzekutiv. Parlamenti zgjedh Presidentin, i cili ka kompetenca të limituara dhe simbolike.

Dhe në nenin 96, përcaktohet se Presidenti emëron Kryeministrin, emëron/shkarkon ministrat me propozim të Kryeministrit, më pas dekreti Presidentit miratohet nga Kuvendi. Siç vërejmë, presidenti ka funksione shumë të kufizuara, deri në simbolike. Presidenti është si albitër në fushën e lojës, por që ka vetëm bilbilin si mjet për ti tërhequr vëmëndjen dy skuadrave kundërshtarë. Edhe kartonat e verdhë dhe të kuq nuk i ka sepse dy skuadrat i'a kanë hequr me një vendim të përbashkët. Edhe se albitri vëren parregullsi ose faull gjatë ndeshjes, ai është i pafuqishëm dhe vetëm mund t'i tërheqë vëmëndjen lojtarëve. Në këto pozita ndodhet edhe Presidenti i Republikës së Shqipërisë, i cili është në pozitën e dhënies së dekoratave dhe dekretimin e vendimeve të marra nga Parlamenti. Presidenti nuk ka fuqi legislative dhe tërë pushteti politik qëndron tek kreu i qeverisë.

Shohim një figurë jo të fortë dhe me kompetenca të pakta të Presidentit, i cili nuk ndikon në qeverisjen e vendit. Dhe një Kryeministër, që në këtë Kushtetutë ka të gjitha kompetencat. Gjithashtu Kuvendi zgjedh/emëron/shkarkon Gjykatën e Lartë, Prokurorin e Përgjithshëm dhe zëvendësit e tij. Kuvendi është organi më i lartë i pushtetit shtetëror në Shqipëri dhe është i vetmi organ ligjvënës. Shteti kontrollohet dhe drejtohet nga Qeveria nëpërmjet Kuvendit.

KAPITULLI V

Ndikimi i sistemeve zgjedhore në sistemin partiak dhe formën e qeverisjes në Shqipëri

Në kapitullin e pestë do të analizojmë zgjedhjet parlamentare të zhvilluara në Shqipëri gjatë dekadës së dytë dhe fillim dekadës së tretë të tranzicionit. Njëkohësisht do të shqyrtojmë ligjin elektoral për çdo zgjedhje parlamentare dhe rezultatet paszgjedhore do t'i analizojmë sipas teorisë së Lijphart. Teoria *Ndikimi i sistemit elektoral në formën qeverisëse* e Arend Lijphart, konfirmohet në çdo zgjedhje të zhvilluara pas rrëzimit të komunizmit në vendin tonë. Autori ka trajtuar gjërësisht gjashtë teoritë e koalicionit të kabineteve qeveritare, si edhe kabinetet një partiake, duke vërtetuar kështu teorinë e tij. Duke u bazuar në rezultatet paszgjedhore, autori ka parashikuar krijimin e kabineteve qeveritare si në rastin e një kabineti një partiak edhe në rastin e kabineteve të koalicionit.

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2001 e 2005, kanë ndodhur fenomeni të tilla, si Dushku dhe Mega Dushku. Këto fenomene kaq të diskutuara janë pasojë e shtrembërimeve të sistemit elektoral, të cilat kanë ndikuar në rezultatin final të zgjedhjeve parlamentare. Kemi raste të shumta të shtrembërimeve të sistemit elektoral gjatë viteve të tranzicionit në Shqipëri, ku fituese mund të dalë një forcë politike ose një koalicion politik (e majta ose e djathta). Shtrembërimet e votës popullore (verdiktit të sovranit) janë pasojë e ndryshimeve që i bëhen sistemit elektoral dhe në çdo zgjedhje parlamentare të mbajtura në vendin tonë vëmë re se politikanët tanë e kanë ndryshuar atë. Kjo bëhet me një qëllim të paracaktuar,

për të arritur një objektiv të mirë studiuar më parë. Por një fenomen i tillë nuk i bën mirë një demokracie dhe aq më tepër një demokracie të brishtë si e jona.

Atëherë në këtë kapitull do të trajtojmë çështje të rëndësishme, si: *Si kanë ndikuar ose Cilat janë pasojat e shtrembërimet të sistemit zgjedhor në formën qeverisëse në vendin tonë? Si ka ndikuar aplikimi i sistemeve të ndryshme zgjedhore në çdo zgjedhje parlamentare të mbajtura në Shqipëri gjatë viteve 1991-2013? Cili është ndikimi i sistemit zgjedhor në formën qeverisëse në Shqipëri dhe Cilat kabinete qeverisëse formohen gjatë dekadës së dytë dhe fillim dekadës së tretë të tranzicionit në vendin tonë? Cilat janë pasojat e shtrembërimeve të sistemit elektoral? Cilat janë marrëdhëniet midis pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ pas Ndryshimeve Kushtetuese të vitit 2008-të? Si ka ndikuar trajtimi i Kodit Zgjedhor si një ligj më vete dhe jo më si pjesë e Kushtetutës së Shqipërisë?*

Një shtet me një demokraci të brishtë nuk duhet të eksperimentojë në çdo zgjedhje sisteme zgjedhore të ndryshme, por duhet të aplikojë një sistem elektoral të përshtatshëm me kushtet politike, kulturore, sociale të vendit. Dhe kjo mund të arrihet vetëm nga një mirëstudim i paanshëm i specialistëve, ku ata duhet të analizojnë situatën politike dhe kushtet sociale, kulturore të vendit. Gjithashtu duhet të shohin në retrospektivë, se si ka ndikuar një sistem elektoral në vendin tonë, por nuk duhet harruar edhe ndikimi i kulturës komuniste në të shkuarën e vendit.

Punimi tek konkluzionet do të identifikojë se cili sistem elektoral është më i përshtatshëm për vendin tonë, duke pasur parasysh ndikimet e çdo sistemi elektoral në Shqipëri gjatë viteve 1991-2013. Pra, punimi trajton gjërësisht ndikim e sistemit elektoral në formën qeverisëse, analizon kabinetet qeverisëse që formohen sipas teorisë së Lijphart dhe në fund do të identifikojë sistemin elektoral më të përshtatshëm për Shqipërinë.

Në vitin 2008-të kemi disa ndryshime kushtetuese, të cilat do t'i trajtojmë gjërësisht në këtë kapitull, ku do të analizojmë gjithashtu marrëdhëniet midis pushtetit ekzekutiv-legjislativ pas këtyre ndryshimeve. Punimi do të trajtojë gjërësisht ndryshimet midis Ligjit Nr 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe Ndryshimeve Kushtetuese Ligji Nr. 9904, datë 21.4.2008. Në këtë kontekst, do të trajtojmë marrëdhëniet midis dy pushteteve, mes pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ, me Kushtetutën e vitit 1998 dhe më pas me Ndryshimet Kushtetuese të vitit 2008-të.

5.1 Sistemi elektoral i zgjedhjeve Parlamentare të 24 Qershorit 2001

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2001 ishin një ngjarje e rëndësishme në politikën shqiptare dhe u zhvilluan në kushte normale e pa konflikte. Në aspektin politik, këto zgjedhje përveçse do të përcaktonin mazhorancën e re qeverisëse, do t'i jepnin përgjigje për zgjedhjen pas një viti të Presidentit të Republikës (Kume, 2015: 38).

Sistemi elektoral i përdorur në këto zgjedhje ishte miks i varur, ku pjesa mazhoritare e sistemit përdor formulë mazhoritare me dy raunde, ndërsa ajo proporcionale ka karakter kombëtar. Sipas Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë Nr.8609, më datë 08.05.2000: 'Kuvendi i Shqipërisë përbëhet nga 140 deputetë, nga të cilët 100 zgjidhen drejtëpërdrejtë nga zgjedhësit në zonat njëemërore dhe 40 zgjidhen sipas përqindjes proporcionale të votave të fituara në raundin e parë të zgjedhjeve nga listat shumëemërore të depozituara në KQZ'. Kodi Zgjedhor ishte pak a shumë i parimit të vitit 1992, që synonte që shpërndarja e vendeve të proporcionalit të korrigjojë 'nënpërfaqësimin' (Çili, 2002: 21).

Përsa i përket ndarjes së mandateve plotësuese sipas Kodit Zgjedhor theksohet se: “Partitë që fitojnë më pak se 2.5% të votave dhe koalicionet e partive që fitojnë më pak se 4% të votave të vlefshme në të gjithë vendin, në raundin e parë të zgjedhjeve nuk përfitojnë mandatet plotësues”. Pragu elektoral për partitë vendoset në nivelin 2.5% e për koalicionet, 4% të votave të vlefshme në të gjithë vendin. Dhe ato që e kalojnë këtë prag, përpjesëtohet me shumën e votave të vlefshme të fituara prej tyre në shkallë vendi, si edhe rezultati përfundimtar shumëzohet me 140. Secilës prej këtyre partive ose koalicioneve, i caktohet fillimisht një numër i përgjithshëm mandatesh, i barabartë ky me numrin e plotë që del nga llogaritja e mësipërme. Mandatet që mbeten, u caktohen partive ose koalicioneve me mbetjet dhjetore më të mëdha, por në rast se mbetjet dhjetore për mandatin e fundit janë të barabarta, më pas ai përcaktohet me short.

Në Nenin 66 të Kushtetutës, përcaktohet mënyra e mandateve plotësuese që përfiton çdo parti politike ose koalicion, nga numri i mandateve të caktuara sipas shkronjës “b” të këtij neni dhe zbritet numri i mandateve të fituara nga çdo parti ose koalicion në zonat njëemërore. Në rast se diferenca është negative ose zero, partia ose koalicioni përkatës mban vetëm mandatet e fituara nga zonat njëemërore dhe si rrjedhojë nuk përfiton asnjë mandat nga shpërndarja e mandateve në pjesën proporcionale.

Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2001

Në zgjedhjet e qershorit 2001, pavarësisht shfrytëzimit me një farë abuzimi ‘moral’ të hapësirave të lejuara nga kodi elektoral, pavarësisht mangësive të konsiderueshme të cituara në raportin përfundimtar mbi zgjedhjet, nuk mund të konsiderohet pak në rrugën e

përbashkët të konsolidimit të demokracisë institucionale, të vetë institucionit të votës së lirë, siç u veprua me ndërtimin e komisionit bipartisan (Meidani, 2003: 270-271) (Gazeta “Panorama”, 22 prill 2003). Autori argumentonte, se zgjedhjet si proces votimi dhe numërimi, pas mbajtjes së zgjedhjeve janë në dorën e komisionerëve të dy partive të mëdha politike dhe kjo sipas tij, grë dyshime rreth transparencës së rezultatit ose lë hapësirë për kundërshtim të rezultateve nga partitë e vogla.

Struktura zgjedhore përbëhej nga ‘ku votohet e ku numërohet vota’, ku në të dy rastet janë komisionerë partiakë të përcaktuar në Kodin Zgjedhor të vitit 2000. Por, duke u bazuar në kontekstimet e partive të vogla politike për rezultatet pas zgjedhore dhe për mos ruajtje të votës nga dy partitë e mëdha, konkludojmë se komisionerët kanë rëndësi dhe ndikojnë në rezultatet finale të zgjedhjeve parlamentare. Është me shumë rëndësi që komisionerët të jenë apolitikë dhe jo anëtarë të partive politike dhe kjo do të sillte një besueshmëri më të madhe si në popull si në partitë e vogla politike.

Martini, tek libri i tij “Refleksione politike” (2005: 60), theksonte rëndësinë e votës së lirë, e cila qëndron në qendër të demokracisë. Autori vë në dukje se Shqipëria duhet të ecë përpara me shpejtësi dhe kjo mund të arrihet në sajë të individit e jo të presim ecjen përpara të Shqipërisë nga koha (86). Preli thekson se elita politike e vendit bën që vendi të përparojë me ritme gjigante drejt një të ardhmëmë të mirë.

Tabela nr. 32: Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2001 sipas koalicionëve.

Nr.	Subjekti politik	Mandate të fituara në Kuvendin Popullor	% mandateve në raport me nr. total të mandateve	Përqindja në vota
1	PSSH	73 + 0 = 73	52.14 %	41.4 %
2	BF	25 + 21 = 46	32.85 %	36.8 %

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2001 kemi një rënie të votuesve, ku 1.389.238 zgjedhës ose 55.59 % të popullsisë kanë votuar. Kemi përballjen e dy koalicionëve, ku koalicioni i


majtë me në krye PS del fitues nëpërmjet një shtrembërimi të sistemit zgjedhor. Në këto zgjedhje ndodh fenomeni Dushku i vogël ose Mega Dushku, ku Partia Socialiste shfrytëzon sistemin elektoral. Ky fenomen është një pasqyrim i pastër i shtrembërimit të sistemit zgjedhor në këto zgjedhje parlamentare.

Grafiku nr. 6: Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2001.



Përsa i përket mazhorancës së fituar, ajo mund të konsiderohet si mazhorancë e fabrikuar sepse ka numrin më të madh të mandateve parlamentare të fituara, 73 mandate në 52.14 % me rreth 41.4 % të votave popullore. Ky rezultat tregon fuqinë e sistemit zgjedhor që me mbi 40 % të votave popullore të arrijë që një forcë politike të marrë 73 mandate, 50+1 mandate.

Grafiku Nr. 7: Shtrembërimi i sistemit elektoral (fenomeni Dushku), ku në këtë grafik paraqiten votat popullore në përqindje dhe mandatet parlamentare të paraqitura në përqindje.



Disa nga politologët shqiptarë, fenomenin e pagëzuar “Dushku”, e konsideruan si një megakorruption elektoral të krijuar nga Partia Socialiste sepse në zonën 60-të të Lushnjes, në zonën elektorale Dushku dolën 10 deputetë të partive të vogla. Sipas Fatos Lubonjës (“Dushku dhe mjerimi i pluralizmit tonë”, 17 gusht 2005) në kohën e socialistëve do vëmë re një fenomen tjetër, që sipas analistit është preçedenti i Dushkut. Lubonja fliste për lindjen e partive me ambicje të mëdha, si PSD ose Aleanca Demokratike, parti të cilat me kalimin e viteve u shëndrruan në parti satelite, me një elektorat minimal dhe me një identitet si të partive kryesore (në këtë rast, me identitet të njëjtë si të PS), që i shërbenin politikanëve në krye të tyre. Si rrjedhojë, këto parti në zgjedhjet parlamentare të vitit 2001 i ofruan liderit të PS-së fitoren e sigurt, por në këtë rast këto parti përfituan edhe vetë duke marrë mandate parlamentare e duke qenë pjesë e kabinetit qeveritar.

Dushku i vogël ose Mega Dushku

Në këtë pjesë të punimit, do t'i japim përgjigje pyetjes ose nënhipotezës se *Cilat janë pasojat e shtrembërimeve të sistemit elektoral?*

Partia Socialiste me në krye Fatos Nanon, për zgjedhjet parlamentare të qershorit 2001, bashkë me disa profesorë/specialistë të zgjedhjeve, menduan të përfitonin nga sistemi zgjedhor duke ndërhyrë. Ata ideuan se në 20 ose 30 zona të sigurta do të regjistronin kandidatë si të pavarur dhe ata do të fitonin me votat e PS-së dhe do mandatoheshin si të pavarur. Pra, në këtë mënyrë këta deputetë megjithëse të zgjedhur me votat e elektoratit të PS-së, nuk do ti llogariteshin kësaj force politike dhe do të mund të merrnin 15 ose 20 deputetë nga lista shumëemërore (Zogaj, 2003 b: 152).

Ky plan nuk arriti që të vihej në zbatim nga Partia Socialiste, nga kundërshtimi i fuqishëm i institucioneve ndërkombëtare dhe i partive politike. Por, në kod ishte specifikuar se partitë që fitojnë më pak se 2.5% të votave dhe koalicionet me më pak se 4% të votave të vlefshme në tërë vendin në raundin e parë, nuk përfitojnë nga mandatet plotësuese. Partia Socialiste duke njohur shumë mirë Kodin Zgjedhor, u mundua të shfrytëzojë disavantazhet e sistemit elektoral sepse kërkonte të fitonte 3/5 e mandateve parlamentare pavarësisht elektoratit (votave) që kishte.

Përsëri kemi një shtrembërim të sistemit zgjedhor në këto zgjedhje dhe si rrjedhojë njohim fenomenin Mega Dushku ose “Dushku i vogël”. PS pasi dështoi me kandidatët e pavarur, urdhëroi komisionerët e saj në KZZ-në e zonës 60 të Dushkut që të mos zhvillonin zgjedhjet ditën e dekretuar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë. Pasi doli rezultati i proporcionalit, Partia Socialiste u kërkoi elektoratit të saj që të mos votonin PS, por të votonin tre partitë aleate të saj. Pas dështimit të tentativës së PS-së që të dyfishoheshin mandatet përmes lojës me kandidatët e pavarur, ato u shumëfishuan nga rritja artificiale e partive të vogla në zonën e Dushkut.

Tabela Nr. 33: Rezultatet e zgjedhjeve parlamentare të vitit 2001 për subjekte politike për Zonën Nr. 60 (Zona e Dushkut).

Nr.	Subjektet politike	Votat	Votat në %
1	Partia Agrare e Shqipërisë	3614	28.487 %
9	Partia Bashkim për të Drejtat e Njeriut	2542	20.035 %
2	Partia Aleanca Demokratike	2307	18.183 %
11	Partia Demokratike+PLL+PR+PBK+PBL (BF)	2065	16.275 %
25	Partia Socialiste e Shqipërisë	711	5.604 %
24	Partia Social Demokrate	637	5.020 %
10	Partia Demokrate	435	3.428 %
5	Partia Bashkimi Demokrat	77	0.607 %
12	Partia Demokristiane e Shqipërisë	75	0.591 %
6	Partia Bashkimi Demokristian Shqiptar	53	0.418 %
15	Partia Komuniste Shqiptare	51	0.402 %
3	Partia Alternativa Liberale	24	0.189 %
21	Partia Lidhja Kombëtare Shqiptare	18	0.142 %
8	Partia Biznesi Shqiptar	17	0.134 %

26	Partia Socialkristiane e Shqipërisë	16	0.126 %
16	Partia Komunistëve të Bashkuar të Shqipërisë	15	0.118 %
18	Partia Lëvizja Monarkiste Demokrate Shqiptare	6	0.047 %
20	Partia Lidhja Fshatare	6	0.047 %
4	Partia Bashkësia Kombëtare Shqiptare	4	0.032 %
7	Partia Bashkimi Republikan Shqiptar	4	0.032 %
13	Partia Emigracioni Shqiptar	4	0.032 %
17	Partia Konservatore Shqiptare	3	0.024 %
28	Partia Unitetit Kombëtar	3	0.024 %
27	Partia Shqiptare Ambjentaliste	1	0.008 %
14	Partia Forca Albania	0	0.000 %
19	Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare	0	0.000 %
22	Partia Pajtimit Kombëtar Shqiptar	0	0.000 %
23	Partia Reformatore Demokratike Shqiptare	0	0.000 %

Të dhëna të marra nga faqja zyrtare e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, nga 27.043 zgjedhës, votuan 13.380 ose 49.48 % të votuesve. Në zonën 60 të Dushkut, zgjedhjet u mbajtën pas datës 24 Qershor, datë kjo e dekretuar nga Presidenti i Republikës për mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare. Vërejmë një fenomen të ri, ku tre parti politike të vogla të majta kanë marrë shumicën e votave, 8463 vota dhe në përqindje rreth 66.705 %. Dhe rreth 33.295 % të votave tjera janë ndarë midis dy partive të mëdha dhe 23 partive tjera politike. Ky rezultat vjen nga orientimi i elektoratit të Partisë Socialiste për të votuar aleatët e koalicionit dhe në këtë mënyrë do të kishte 3/5 e mandateve parlamentare për të pasur fuqi për të votuar ligje të rëndësishme.

Tre partitë politike të majta nuk do të kishin arritur kurrë të merrnin këto vota me mbështetjen e elektoratit të tyre. Si rrjedhojë, kemi Partinë Socialiste me 73 mandate dhe bashkë me aleatët e saj morën në total (spektri i majtë) 86 mandate parlamentare (PSD, PBDNJ, PA dhe PAD morën 13 mandate). Por, nëse zgjedhjet do të ishin zhvilluar në datën 24 Qershor edhe në zonën e Dushkut, nuk do të kishim këtë rezultat final.

Shtrembërimi i sistemit zgjedhor ka prodhuar në zgjedhjet parlamentare të vitit 2001 fenomenin Dushku i vogël ose Mega Dushku. Konkludojmë, se në Parlamentin

Shqiptar kemi një pasqyrim të një aritmetike të saktë të prodhuar nga Partia Socialiste. Këto pasoja të shtrebbërimit të sistemit, si Dushku i vogël (2001) dhe Dushku i madh (2005) nuk duhen toleruar sepse çdo votë është e rëndësishne dhe duhet të kemi një pasqyrim të saktë të verdiktit të sovranit në Kuvend.

Analizimi i zgjedhjeve parlamentare të vitit 2001 sipas teorisë së Arend Lijphart

“Ndikimi i sistemit elektoral në formën qeverisëse”

Teoritë e koalicionit: 1. Koalicion minimal i fituar; 2. Koalicionet me madhësi minimale; 3. Koalicionet me numrin më të vogël të partive; 4. Koalicionet me varg minimal; 5. Koalicionet minimale fituese; 6. Koalicionet politike – praktike.

Tabela nr 34: Partitë të cilat kanë fituar mandate parlamentare të radhitura sipas spektrit politik nga A deri në J, për zgjedhjet politike të vitit 2001.

Partitë politike	PS A (Majtas)	PA B	PSD C	PAD D	PBDNJ E	Të pavarur F	PDR G	PVD H	PR I	PD J (Djathtas)
Mandatet parlamentare	73	3	4	3	3	2	6	9	5	32

Më specifikisht kemi këto parti ose subjekte të cilat kanë marrë pjesë në zgjedhjet politike të vitit 2001: Partia Socialiste (PS) = 73 mandate parlamentare; Partia Agrare (PA) = 3; Partia Social Demokrate (PSD) = 4; Partia Aleanca Demokratike (PAD) = 3; Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ) = 3; Kandidatë të pavarur (PAV) = 2; Partia Demokratike e Re (PDR) = 6; Parti të vogla në të djathtë (PVD) = 9; Partia Republikane (PR) = 5; Partia Demokratike (PD) = 32.

Teoritë:

1. Koalicion minimal i fituar: AB=76, AD=76, AE=76, AF=74; AC=77; ABF=78; ADF=78; dhe AEF=78.

2. Koalicionet me madhësi minimale: AF=74 (spektri i majtë)

3. Koalicionet me numrin më të vogël të partive: AB=76, AD=76 dhe AE=76.
4. Koalicionet me varg minimal: ABC=80 (2 hapësirë), ACD=80 (3 hapësirë).
5. Koalicionet minimale fituese: ABC=80, ABCD=83, ABCDE=86 dhe ABCDEF=88.
6. Koalicionet politike – praktike: AB=76, AD=76, AE=76, AF=74; AC=77; ABF=78; ADF=78; dhe AEF=78.

Përsëri kemi krijimin e një Koalicioni minimal fitues (5), ku kabineti qeveritar përbëhet edhe nga aleatët e së majtës, edhe se PS e vetme mund të krijonte qeverinë e saj. Përfshirja e aleatëve të së majtës është bërë për faktin se duke bashkuar mandatet, 86 në total ose më shumë se $\frac{3}{5}$ e shumicës parlamentare, vota këto të nevojshme për zgjedhjen e presidentit të vendit. Por duke u bazuar në luftën e brendshme në PS, midis Nanos dhe Metës (arsyeja se Nano synonte postin e presidentit), rezultoi se ky bashkim mandatesh nuk ishte përcaktues për zgjedhjen e presidentit.

Zgjedhjet parlamentare që u mbajtën më 2001 ishte një proces i tejzgjatur dhe konfliktual (Rrjeti Shqiptar i të Drejtave të Njeriut dhe CRCA 2005 “Zgjedhjet parlamentare 2005 dhe të drejtat e njeriut në Shqipëri” Hazizaj, A. f. 7), ku për shkak të parregullsive ato u përsëritën në disa zonave zgjedhore. PS e udhëhequr nga Fatos Nano, mori shumicën vendeve në Kuvend (73) dhe formoi një koalicion qeveritar, ku gëzoi mbështetjen parlamentare të 13 deputetëve të zgjedhur nga 4 partitë tjera e 2 deputetëve të zgjedhur si kandidatë “të pavarur”.

Aritmetika elektorale nuk ka shtruar domosdoshmërisht nevojën e koalicioneve (Çili, 2002: 27). Shqipëria deri në vitin 2002 ka njohur dy qeveri me përbërje koalicioni, më tepër koalicione me simbolikë politike sesa të dala nga aritmetika elektorale (27). Si rrjedhojë, PS (73 mandate parlamentare) bashkë me aleatët e koalicionit arritën të merrnin

në total (spektri i majtë) 86 mandate parlamentare (PSD, PBDNJ, PA dhe PAD morën 13 mandate). Ndërsa Partia Demokrate dhe aleatët e saj, arritën të merrnin 46 mandate parlamentare (PD+PR+PVD). Dhe 8 mandatet e tjera u ndanë midis Partisë Demokratike e re të Pollos, që mori 6 mandate dhe 2 mandate i fituan kandidatë të pavarur (të dhënat e marrë nga faqja zyrtare e KQZ-së).

Në këtë legjislaturë kemi ndryshimin e Kryeministrit tre herë dhe zgjedhjen e një Presidenti i cili ishte asnjans ose apolitik (nuk bën pjesë në asnjë parti politike). Mund të dalim në përfundim se Partia Socialiste nuk ka tërë pushtetet sepse përveç pushtetit legjislativ ajo nuk e zotëron edhe pushtetin ekzekutiv (prezidencën). Dhe në zgjedhjet e vitit 2002, për zgjedhjen e Presidentit më të ri të Republikës së Shqipërisë, u zgjodh Alfred Moisiu me një mandat të rregullt 24 korrik 2002 deri në 24 korrik 2007. PS nuk arriti që të zgjidhte një president të dalë nga kjo forcë politike edhe se bashkë me aleatët e saj kishte 86 mandate. Kjo si pasojë e një luftë e brendshme midis Nanos dhe Metës dhe Fatos Nano nuk u zgjodh Presidenti i Shqipërisë.

5.2 Sistemi elektorale i zgjedhjeve Parlamentare të vitit 2005

Sistemi elektorale i përdorur në zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Shqipërisë së vitit 2005-së ishte sërish miks i varur. Ndryshimi i sistemit zgjedhor me zgjedhjet e vitit 2001 ishte se në pjesën mazhoritare u përdor formula e Shumicës Minimale, ndryshe nga viti 2001 ku u përdor formula e mazhoritarit me dy raunde. Pjesa tjetër e sistemit mbeti po e njëjtë.

Sipas Kodit Zgjedhor të nenit 65, shprehimisht thuhet se:

“Kuvendi i Republikës së Shqipërisë përbëhet nga 140 deputetë, nga të cilët 100 zgjidhen drejtpërdrejt nga zgjedhësit në zonat zgjedhore një emërore dhe 40 zgjidhen sipas përqindjes proporcionale të votave të fituara nga listat shumë emërore të subjekteve zgjedhore të depozituara në KQZ”.

Ndërsa në nenin 66, specifikohet se fiton ai kandidat që në zonën njëemërore ka numrin më të madh të votave të vlefshme. Nëse kemi dy kandidatë me të njëjtin numër votash, atëherë hidhet shorti nga KQZ, e cila përcakton rregullat e organizimit të shortit. Pragu zgjedhor mbeti po i njëjtë me vitin 2001, 2.5% për partitë dhe 4% për koalicionet. Pjesa për ndarjen e mandateve plotësuese, pra të pjesës proporcionale është e njëjtë me zgjedhjet e vitit 2001.

Me ndihmën dhe nën presionin e OSBE-ODIRIT, dy partitë e mëdha PS dhe PD ranë dakort që të formonin një komision të paanshëm bi-partizan për të reformuar Kodin Zgjedhor të vitit 2003, i cili ishte kontestuar nga opozita dhe partitë e vogla në atë kohë. Por, përsëri Komisioni nuk përfshiu partitë e vogla dhe gjithçka u vendos i ndikuar nga dy partitë e mëdha (PS-PD).

Në këto zgjedhje janë të regjistruar në listat zgjedhore 2.850.821 dhe pjesëmarrja në votime ka qenë 1.389.320 votues dhe rreth 49.23%. U regjistruan 57 parti si subjekte politike zgjedhore, ku 19 konkuruan si pjesë e katër koalicioneve. Rezultati i zgjedhjeve u pranua nga humbësit dhe Partia Socialiste deklaroi se për këtë parti politike më e rëndësishme ishte standarti i zgjedhjeve, se rezultati final i zgjedhjeve.

Në vendin tonë, PD dhe PS kanë pasur mbi 2/3 e vendeve parlamentare në Kuvend, ku ky numër ka qenë përcaktues për natyrën e jetës parlamentare dhe politike të vendit. Opozita duke pasur më pak se 1/3 e votave, ka qenë e panevojshme për mazhorancën dhe ka mbetur jashtë vendimmarrjeve politike. Shumica vendos për piramidën e ekzekutivit

(qeverisë), por edhe të institucioneve tjera që janë pjesë e shtetit, por nuk i përkasin ekzekutivit, siç është sistemi i drejtësisë, prokuroria, komisionet dhe institucionet e natyrës korrektuese dhe kontrolluese etj (Çili, 2002: 16). Lufta politike për zgjedhjet parlamentare bëhet për marrjen e 2/3 të mandateve, pra çdo forcë politike synon 83 mandate që të mund të zgjedhë Presidentin dhe të ketë mundësi që miratojë e vetme pa domosdoshmërinë e votave të opozitës, ligje të rëndësishme ose ndryshime të Kushtetutës. Edhe në këtë legjislaturë kemi numrat e nevojshme të mandateve, por nga mosmarrëveshjet brenda forcës së majtë politike nuk u arrit të zgjidhej presidenti i dalë nga forca e majtë shqiptare.

Rezultatet e zgjedhjeve parlamentare të 3 Qershorit të vitit 2005

Më 3 Qershor 2005 në Shqipëri u mbajtën zgjedhjet e gjashta parlamentare që nga rrëzimi i sistemit komunist në vitin 1991. Sipas opinionit të shumë vëzhguesëve ndërkombëtarë, këto zgjedhje ishin më të rëndësishmet, pas zgjedhjeve të mbajtura në vitin 1992, ku partia e parë opozitare (PD) erdhi në pushtet. Shqipëria synonte të bëhej pjesë e BE-së, ku të gjitha partitë politike shqiptare çështjen e integritetit në Evropë e kishin kthyer në objektivin kryesor politik të vendit. Kjo vjen si një domosdoshmëri e kohës, kushteve politike të vendit dhe si një vend pro-europian.

KQZ deklaroi zyrtarisht rezultatet zgjedhore më 1 shtator 2005, dy muaj pas mbajtjes së zgjedhjeve. Alfred Moisiu, Presidenti i Shqipërisë, i quajtur sesioni i ri i Kuvendit të Shqipërisë (RrShDNj dhe CRCA, 2005: 10), i cili solli në pushtet PD-në. Kemi një numër të madh të kandidatëve femra në zgjedhjet, ku nga 101 kandidate fituan vetëm 10 prej tyre (në zgjedhjet e vitit 2001 kanë fituar 9 deputete). Në këto zgjedhje vërejmë se

koalicioni parazgjedhor “Aleanca për Liri, Drejtësi dhe Mirëqenie”, ka fituar rreth 33.83 % të votave popullore.

Tabela Nr. 35: Përbërja e Kuvendit sipas subjekteve që i mbështesin për zgjedhjet e vitit 2005.

Subjekti	Drejtëpërdrejtë	Nga mandatet plotësuese	Gjithsej	% mandateve në raport me nr. total të mandateve	Përqindja në vota
PD	56		56	40	7.67 %
PSSH	42		42	30	8.89 %
PR		11	11	7.85	19.96 %
PSD		7	7	5	12.74 %
LSI	1	4	5	3.57	8.40 %
PDR		4	4	2.85	7.42 %
PAA		4	4	2.85	6.56 %
AD		3	3	2.14	4.76 %
PBDNJ		2	2	1.42	4.31 %
PDK		2	2	1.42	3.26 %
PDSSH		2	2	1.42	4.25 %
BLD		1	1	0.71	1.06 %
I pavarur	1		1	-	
SHUMA	100	40	140		

PD=Partia Demokratike; PSSH=Partia Socialiste e Shqipërisë; PR=Partia Republikane; PSD=Partia Socialdemokrate; LSI=Lëvizja Socialiste për Integrim; PDR=Partia Demokratike e Re; PAA=Partia Agrare Ambientaliste; AD=Aleanca Demokratike; PBDNJ=Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut; PDK=Partia Demokratike e Shqipërisë; PDSSH=Partia Demokratike Sociale e Shqipërisë; BLD=Bashkimi Liberal Demokrat dhe I pavarur ka fituar Spiro Kostandin Peçi në zonën elektorale nr. 098.

Grafiku Nr.8:Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2005.



Analizimi i zgjedhjeve politike të vitit 2005 sipas teorisë së Arend Lijphart

“Ndikimi i sistemit elektoral në formën qeverisëse”

Teoritë e koalicionit: 1. Koalicion minimal i fituar; 2. Koalicionet me madhësi minimale; 3. Koalicionet me numrin më të vogël të partive; 4. Koalicionet me varg minimal; 5. Koalicionet minimale fituese; 6. Koalicionet politike – praktike.

Tabela nr 36: Partitë të cilat kanë fituar mandate parlamentare të radhitura sipas spektrit politik nga A deri në M, për zgjedhjet politike të vitit 2005.

Partitë politike	PS A (Majtas)	PDSS H B	PS D C	A D D	LS I E	Të pavarur F	BL D G	PBDN j H	PD K I	P A J	PD R K	P R L	PD M (Djathtas)
Mandatet parlamentare	42	2	7	3	5	1	1	2	2	4	4	11	56

Numri i partive në sistem të cilat kanë arritur të përfaqësojnë elektoratin e tyre në Kuvendin e Shqipërisë në vitin 2005 janë 12. Dhe më specifikisht, Partia Demokratike ka fituar 56 mandate, Partia Socialiste 42 mandate, Partia Republikane 11 mandate, Partia Socialdemokrate 7 mandate, Lëvizja Socialiste për Integrim 5 mandate (Në vjeshtën e vitit 2004 Kryeministri i mëparshëm i PS Ilir Meta, u nda nga grupi socialist parlamentar dhe themeloi Lëvizjen Socialiste për Integrim), Partia Demokrate e Re 4 mandate, Partia Agrare 4 mandate, Partia Aleanca Demokratike 3 mandate, ku Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, Partia Demokristiane, Partia Demokracia Sociale kanë fituar me nga 2 dhe Bashkimi Liberal Demokrat 1 mandat parlamentar.

Në koalicionin fitues “Aleancës për Liri, Drejtësi dhe Mirëqenie” (ALDM), bëjnë pjesë tetë parti politike, ku Partia Demokratike është edhe partia drejtuese e këtij koalicioni të djathtë (marrë nga faqja zyrtare e KQZ-së):

Tabela Nr.37: Koalicioni i djathtë ALDM, subjektet politike dhe përqindja e votave të marra për çdo forcë politike.

Nr.	Subjektet politike	Përqindja e votave
1	Partia Demokratike e Shqipërisë (PD)	7.67 %
2	Partia Republikane (PR)	19.96 %
3	Partia Demokrate e Re (PDR)	7.42 %
4	Partia Demokristiane e Shqipërisë (PDK)	3.26 %
5	Bashkimi Liberal Demokrat (BLD)	1.06 %
6	Lëvizja për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut (LDLNJ)	0.66 %
7	Partia Balli Kombëtar Demokrat (PBKD)	0.56 %
8	Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar (PDSH)	0.54 %

PD + PAA + PDK + PR + PBDNJ = 75 mandate parlamentare

Teoritë:

1. Koalicion minimal i fituar: MLK=71;MLJ=71;MLIH=71;MLIGF=71;MLIB=71;MLHB=71;MLGFB=71;MLGD=71;MLFD=71;MCKJ=71;MCKIH=71;MCKGD=71;MCKFD=71;MCJIH=71;MCJGD=71;MCJFD=71;MCIHGF=71;MCED=71.
2. Koalicionet me madhësi minimale: MLK=71 (2 hapësira dhe përfshin spektrin e djathtë) dhe MLJ=71.
3. Koalicionet me numrin më të vogël të partive: MLE=72, MLK=71 dhe MLJ=71.
4. Koalicionet me varg minimal: MLK=71 (2 hapësirë).
5. Koalicionet minimale fituese: MLK=71 dhe MLJ=71. MLKIH=75 (4 hapësira dhe është brënda spektrit të djathtë) dhe MLJIH=75 (4 hapësira dhe është brënda spektrit të djathtë)
6. Koalicionet politike – praktike: MLK=71; MLJ=71; MLF=72 dhe MLKI=73.

Më sipër duke u bazuar në gjashtë teoritë e koalicionit të Arend Lijphart kemi bërë parashikimet se cilët kabinete qeveritare mund të formohen duke u bazuar në rezultatet zgjedhore. Por **në zgjedhjet parlamentare të mbajtura në vitin 2005 në Shqipëri, në bazë të analizimit të teorive të koalicioneve së Lijphart, mund të konkludojmë se kemi formimin e Koalicionit minimal fituese**, pra teoria e pestë e radhitur më sipër. Partia Demokratike ka krijuar kabinetin qeveritar duke përfshirë aleatët e koalicionit parazgjedhor (PD+PAA+PDK+PR+PBDNJ=75 mandate). Por, gjatë qeverisjes në katër vjet kemi disa lëvizje të ministrave, përfshirje ose heqje të disa aleatëve në qeverisjen e vendin.

Më 11 shtator të vitit 2005, partia fituese votëbeson Sali Berishën si Kryeministrin më të ri të Shqipërisë, i cili do të qëndrojë në këtë post të rëndësishëm prej dy legjislaturash të fituara nga PD, deri më 8 shtator 2013. Alfred Moisiu ishte Presidenti i Republikës së

Shqipërisë deri më 20 korrik 2007, pas dy vitesh përpara kësaj legjislature paraqitej edhe sfida e rëndësishme e zgjedhjes së presidentit. Bamir Topi (24 prill 1957), më 20.07.2007-24.07.2012, zgjidhet Presidenti i Shqipërisë, i cili vinte nga forca e djathtë e cila ishte në pushtet. Edhe pse nuk kishte fituar një numër të madh mandatesh parlamentare, pozita e kësaj partie fuqizohet me zgjedhjen e Bamir Topit si President i Shqipërisë.

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2005-së kemi fenomenin Dushku i madh, ku 40 mandate shpërndahen midis 10 partive të vogla dhe disa parti janë më të favorizuara se disa. Ndërsa dy partitë e mëdha, PD dhe PS nuk përfitojnë asnjë mandat në shpërndarjen e mandateve shtesë. Më poshtë do të trajtojmë më gjërësisht fenomenet Dushku i madh dhe fenomenin Demokristian e vitit 2006 që ndodhi në Parlamentin shqiptar të legjislaturë 2005-2009.

Fenomeni Dushku i madh dhe fenomeni Demokristian

Dushku i madh i ka fillesat tek Mega Dushku (zona elektorale 60), në zonën e Dushkut. Ky fenomen përsëritet edhe në zgjedhjet parlamentare të vitit 2005-së, por më gjërësisht dhe aplikohet nga të dyja forcat e mëdha politike (më shumë funksionon tek PS). Vëmë re se ka një marrëveshje të fshehtë midis lidërt të partive të mëdha me aleatët e tyre, që në disa zona zgjedhore, në votimin maxhoritar, do të orientonin elektoratin e tyre të votojnë kandidatët e partive të mëdha (PS-PD). Në këmbim partitë e mëdha në disa zona zgjedhore do të orientojnë elektoratin e tyre që në votimin proporcional të votojnë për partitë më të vogla aleate të saj. Ky fenomen ndodh për arsye se sistemi zgjedhor ka disa disavantazhe dhe

partitë e mëdha i shfrytëzojnë ato. Si rrjedhojë kemi shkelje të parimit të mbajtjes së zgjedhjeve të ndershme e të lira dhe një deformim të përfaqësimit politik në Kuvend.

Nga fenomeni Dushku i madh, në zgjedhjet parlamentare të vitit 2005-së, këto parti politike të vogla janë përfituese të 40 mandateve shtesë në pjesën proporcionale. Si Partia Republikane, e cila arriti të marrë 11 mandate, pastaj renditet Partia Socialdemokrate me 7 mandate. Ndërsa Lëvizja Socialiste për Integrim mori në total 5 mandate, 4 mandate në proporcional dhe 1 mandat në maxhoritar. Në zonën elektorale nr. 079 fitoi kryetari i kësaj force politike të majtë, Ilir Meta. Partia Demokrate e Re dhe Partia Agrare Ambientaliste morën nga 4 mandate. Aleanca Demokratike mori 3 mandate. Ndërsa Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, Partia Demokristiane dhe Partia Demokracia Sociale morën të treja me nga 2 mandate secila. Dhe Bashkimi Liberal Demokrat mori 1 mandat në proporcional.

Tabela Nr.38: Mandatet shtesë në proporcional të shpërndara midis 10 partive politike të vogla.

Subjekti	PR	PSD	LSI	PDR	PAA	AD	PBDNj	PDK	PDSSh	BLD
Mandatet plotësuese	11	7	4(+1 maxh)	4	4	3	2	2	2	1

Por, përveç faktit se nuk kemi një pasqyrim të drejtë të votës sepse ky rezultat paszgjedhor është pasojë e shtrembërimit të sistemit zgjedhor dhe rezultat i një aritmetike të saktë të liderve të partive të mëdha politike. Ndërsa në vitin 2006 Shqipëria njohu një tjetër fenomen, fenomenin demokristian, ku një grup deputetësh të partive të ndryshme u bashkuan bashkë duke formuar një grup parlamentar në emër të një partie që nuk ishte votuar më parë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2005. Ata nëpërmjet kërcënimeve për ta rrëzuar qeverinë, hynë në bashkëqeverisje me të.

Ndodhi një fenomen i ri, ku deputetë të dalë nga një forcë politike e braktisin atë për interesa personale. Një fenomen i tillë nuk duhet të ndodhë dhe duhet të parandalohen raste

të tilla sepse është e dëmshme për vendin. Një mënyrë parandalimi është vendosja e një neni ku deputetë të cilët dalin nga një forcë politike nuk mund të bashkohen në një forcë tjetër, në të kundërt humbasin mandatin parlamentar.

5.3 Ndryshimet Kushtetuese të vitit 2008-të

Me ligjin Nr. 9904, datë 21 prill të vitit 2008-të, Kuvendi miratoi disa ndryshime në Kushtetutën e Shqipërisë. Këto ndryshime janë shpallur me dekretin Nr. 5700, më datë 06.05.2008 të Presidentit të Republikës, Bamir Topi. Ndryshimet në Kushtetutë ndodhën si pasojë e kërkesave të dy aktorëve politik më të rëndësishëm dhe në vitin 2008-të kemi një konsensus midis PS-PD për të ndërhyrë në Kushtetutë.

Proçesi i ndryshimit të Kushtetutës u votua nga dy partitë kryesore në prill të vitit 2008-të, por edhe nga presioni i partive të vogla. Partitë e vogla kanë bërë kërkesë për ndryshime në KQZ për të pasur një balancimin politik, e cila krijoi krizën politike të vitit 2007 edhe konsensusin midis partive parlamentare për rritjen e numrit të anëtarëve të KQZ-së. Si rrjedhojë, Nenit 154 të Kushtetutës i'u bënë ndryshime, ku u shtua numri i anëtarëve të KQZ-së, nga 7 në 9 anëtarë. Dhe dy anëtarët e rinj, do të ishin përfaqësues të LSI-së dhe PDK-së. KQZ do të përbëhej nga 9 anëtarë me një mandat 7 vjeçar, të cilët gëzonin imunitetin e anëtarit të Gjykatës së Lartë, ku 4 anëtarë do zgjidheshin nga Kuvendi, 2 nga Presidenti dhe 3 anëtarët e tjerë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Ndërsa ndërhyrja e dytë u bë si pasojë e rritjes së mandatit të qeverisjes vendore. Që prej vitit 1998-të, mandati i qeverisjes vendore ishte tre vjet, ndërsa në vitin 2007-të

parlamenti ndryshoi kushtetutën duke e rritur mandatin e qeverisjes vendore në katër vjet. Mandati katër vjeçar i përcaktuar në ligjin Nr. 9675, datë 13.1.2007 “Për disa ndryshime në ligjin Nr. 8417, datë 21.10.1998 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, zbatohet për herë të parë për këshillat dhe kryetarët e bashkive/komunave që do të zgjidheshin në zgjedhjet e para (zgjedhjet parlamentare të vitit 2009) pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ndryshime tjera thelbësore që do t’i analizojmë gjërësisht më poshtë, si ndryshimi i sistemit elektoral, ku u kalua nga sistemi miks në sistemin proporcional rajonal; KQZ u hoq si institucion nga kushtetuta, ku u kalua me trajtimin si një ligj zgjedhor; si edhe u vendos mandat për Prokurorin e Përgjithshëm. Gjithashtu kemi ndryshim të mënyrës së zgjedhjes së Presidentit dhe si rrjedhojë, ndryshim në raportin Kuvend/President dhe rritje të pozitës së Kryeministrit në raport me Parlamentin. Kemi kalimin nga modeli i zgjedhjes së Presidentit me shumicë të cilësuar (me votim mbi 3/5 të mandateve parlamentare) në zgjedhje me shumicë të thjeshtë në dy raundet e fundit (me 71 mandate parlamentare).

Ndryshon Neni 149, ku specifikohet mandati i Prokurorit të Përgjithshëm. Në pikën e parë, përcaktohet se *Prokurori i Përgjithshëm emërohet nga Presidenti i Republikës, me pëlqimin e Kuvendit, për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë riemërimi*. Përpara këtij ndryshimi, Prokurori i Përgjithshëm nuk kishte asnjë mandat për kohëzgjatjen e tij në këtë detyrë. Prokurori i Përgjithshëm emërohet nga Presidenti, me pëlqim ose miratim të Kuvendit, ku shohim në këtë rast një fuqizim të figurës së Kryeministrit edhe në raport me gjyqësorin (pushteti gjyqësor).

Sistemi zgjedhor i aplikuar në zgjedhjet e përgjithshme të 28 qershorit 2009-të është proporcional rajonal me lista të mbyllura. Dhe më konkretisht, ndryshimi i sistemit zgjedhor është reflektuar në ndryshimet e Kushtetutës në vitin 2008-të, ku shprehimisht në

Nenin 1, kemi ndryshimin e Nenit 64 si më poshtë: "*Neni 6. 1.Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë, të zgjedhur me sistem proporcional me zona zgjedhore shumemërore*". Ndërsa në pikën e tretë të po këtij neni, specifikohet se kriteret, rregullat për zbatimin e sistemit zgjedhor, caktimi i zonave zgjedhore, numri i mandateve për secilën zonë përcaktohen në ligjin për zgjedhjet. Dhe në ndryshimet Kushtetuese të vitit 2008-të, në Nenin 10 nënvizohet se Pjesa e Dymbëdhjetë e Kushtetutës "Komisioni Qendror i Zgjedhjeve" shfuqizohet (pra Kodi Zgjedhor, është tashmë një institucion jashtë Kushtetutës së Shqipërisë).

Në Nenin 5, kemi ndryshimin e Nenit 87, ku specifikohet mënyra e zgjedhjes së Presidentit. Dhe në pikën tre të këtij neni, nënvizohet se "*Presidenti zgjidhet në votimin e parë, të dytë ose të tretë kur një kandidat merr jo më pak se tri të pestat e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në votimin e katërt dhe të pestë zgjidhet President, kandidati që siguron më shumë se gjysmën e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit*". Tashmë vetëm me një shumicë të cilësuar të votave, 71 mandate zgjidhet Presidenti i Shqipërisë. Në këtë mënyrë, mazhoranca fituese që do të dalë nga zgjedhjet e vitit 2009-të do të mundet që vetëm me 71 vota mund të zgjedhë presidentin e ri. Pra forca politike fituese e zgjedhjeve, e vetme mund të zgjedhë presidentin e vendit me mandatet e saj. Presidenti shihet si figurë politike, ku nuk është e nevojshme një konsensus i gjërë midis partive politike parlamentare

Në Nenin 7, kemi ndryshimin e Nenit 104, ku Kryeministri ka të drejtë t'i paraqesë Kuvendit mocion besimi ndaj Këshillit të Ministrave. Dhe në rast se votohet nga më pak se $\frac{1}{2}$ e gjithë anëtarëve të Kuvendit, atëherë Kryeministri brënda 48 orëve i kërkon Presidentit shpërndarjen e Kuvendit. Ndërsa në Nenin 8, Neni 105 i ndryshuar, pika e parë specifikohet se vetëm $\frac{1}{5}$ e deputetëve (ose 28 deputetë) kanë të drejtë të paraqesin për votim në

Kuvend një mocion mosbesimi ndaj Kryeministrit në detyrë, duke propozuar një Kryeministër të ri. Por, vetëm me votat e shumicës, pra më shumë se 1/2 e gjithë anëtarëve mund të zgjidhet një Kryeministër i ri. Si rrjedhojë, kemi një Kryeministër të parrëzueshëm nga Kuvendi sepse nevojitem mbi 71 mandate për ta rrëzuar atë.

Në këtë mënyrë kemi një President, i cili nuk ka peshë në jetën politike të vendit, duke i kufizuar maksimalisht funksionet e tij. Si edhe kemi rritjen e rolit të Kryeministrit, duke i dhënë më shumë fuqi politike në Parlament. Kryeministri zgjeroi kontrollin e tij mbi parlamentin përmes mocionit konstruktiv, ku me anë të mocionit të besimit mund të provokojë në çdo kohë zgjedhje të parakoshme, si edhe shkarkimi me mocion mosbesimi bëhet i pamundur. Sipas Krasniqit, ndryshimi kushtetues solli ndryshim edhe në jetën institucionale dhe politike të vendit, duke krijuar kështu interpretime mbi shanset reale për garantimin e parimeve kushtetuese të transparencës, ndarjes e të balancës së pushteteve.

Ndryshimet Kushtetuese sipas Servet Pëllumbit (“Etikokracia”, 2013: 55), u bënë më shpejt nga amendimi i një ligji të zakonshëm dhe pa u drejtuar popullit për mendim ose pa i informuar ata për ndryshimet kushtetuese. Autori thekson se në ndryshimet e vitit 2008-të, nuk u respektuan “*të drejtat e individit, të qytetarit, realisht u kufizuan për të fuqizuar atë të kreut të ekzekutivit*”.

Pëllumbi (2013: 56) thekson se këto ndryshime i shërbejnë forcimit të partitokracisë, zëvendësimit të institucioneve politike shtetërore me marrëveshjet partiake që mund të përfundojnë sipas autorit në ‘pazare liderësh’. Në pamje të parë, ky ndryshim duket demokratik, ku është përfshirë dialogu midis forcave politike, liria e mendimit, por sipas tij, do të kemi *deformime serioze të demokracisë reale*. Këto ndryshime kushtetuese të

vitit 2008-të janë bërë për të rritur fuqinë e kreut të qeverisë kundrejt dy pushteteve të tjera, pse jo edhe për t'i kontrolluar dhe pasur fuqi vendimarrëse ndaj tyre.

Këto ndryshime kushtetuese të votuara me votat e dy partive të mëdha politike, pa u konsultuar më parë me elektoratin e tyre, lë hapësirë për interpretime dashakeqëse. Por, sipas mendimit tim, një vend demokratik përpara se të bëj ndryshime të një rëndësie kaq të madhe për vendin dhe me një impakt të gjërë që ndikon në raportet midis katër pushteteve, duhet të konsultohet më parë me popullin dhe me anë të një referendumi duhet të votohet nga sovrani. Duke qenë se deputetët janë përfaqësuesit e popullit, të cilët janë votëbesuar për të qeverisur vendin për një periudhë katër vjeçare, ata nuk mund të vendosin pa u konsultuar më parë me sovranin për të ndërhyrë në ligjin themeltar të vendit.

5.4 Sistemi elektorale i përdorur në zgjedhjet politike të vitit 2009-të

Sistemi zgjedhor i aplikuar në zgjedhjet parlamentare të datës 28 qershor të vitit 2009-të është proporcional rajonal me lista të mbyllura. Këto zgjedhje janë zhvilluar pas Ndryshimeve Kushtetuese të vitit 2008-të. Dhe si rrjedhojë, këto ndryshime e ndryshimi i sistemit zgjedhor është reflektuar dhe në Kushtetutë ku shprehimisht në Nenin 64 thuhet se: *“Kuvendi i Shqipërisë përbëhet nga 140 deputetë, të zgjedhur me sistem proporcional me zona zgjedhore shumë emërore. Zona zgjedhore shumë emërore përputhet me ndarjen administrative të një prej niveleve të organizimit administrativo-territorial.”*

Në Nenin 68 nënvizohet se: “Kandidatët për deputetë paraqiten në nivel zone zgjedhore nga partitë politike, koalicionet zgjedhore të partive politike, si dhe nga

zgjedhësit”. Në këtë nen specifikohet se kandidat mund të paraqiten vetëm për një nga subjektet propozuese dhe renditja e kandidatëve për deputetë në listat shumëemërore nuk mund të ndryshohet më pasi është dorëzuar në Komisionin Zgjedhor përkatës.

Niveli i organizimit administrativo-territorial i vendit që përkon me zonën zgjedhore është përcaktuar në Kodin Zgjedhor. Ashtu edhe raporti ndërmjet zgjedhësve e mandateve parlamentare përcaktohet në Kodin Zgjedhor sepse zona zgjedhore përputhet me territorin e qarkut dhe shërben si njësi zgjedhore sipas rregullave të caktuara në Kod. Dhe në Nenin 75, theksohet se *“Numri i mandateve për çdo zonë zgjedhore përcaktohet në raport me numrin e shtetasve të secilës zonë zgjedhore. Çdo mandat përfaqëson një numër afërsisht të njëjtë shtetasish”*. Në këtë ligj përcaktohet pragu zgjedhor për subjektet politike 3% dhe për koalicionet partiake 5%.

Islamaj, pyetjes nr. 3 të intervistës së zhvilluar rreth Ndryshimeve Kushtetuese të vitit 2008-të, ka argumentuar se në kushtet e miratimit të një sistemi zgjedhor proporcional rajonal, miratimi i ndryshimeve kushtetuese ka qënë një domodoshmëri. Dhe del në konkluzion se ato kanë qënë opsione të arsyeshme, me avantazhet dhe dizavantazhet që shoqërojnë çdo ndryshim kushtetues. Islamaj nënvizon se ka pasur kritika nga një numër i vogël deputetësh të partive të vogla, kurse kritika të arsyeshme kanë qënë ato që kërkonin një proces më gjithpërfshirës, përse i përket diskutimit e debatimit të këtyre ndryshimeve, si edhe të një pjesëmarrje të lartë të ekspertëve konstitucionalistë. Ashtu siç e kam trajtuar më sipër rreth **Ndryshimeve Kushtetuese të vitit 2008**, që jam e një mendimi me Islamaj, ato **duhet të ishin më transparente dhe të hapura ndaj popullit e ekspertëve apolitikë.**

Vëzhguesit vendas dhe ndërkombëtarë i vlerësuan me nota pozitive këto zgjedhje të përgjithshme të vitit 2009-të. Në Raportin Përfundimtar të Koalicionit të Vëzhguesve

Vendor theksohet se në tërësi, vendi ynë ka një arritje pozitive në procesin për realizimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme. Kjo vlerësohet si një kontribut dhe arritje pozitive në procesin kompleks të zhvillimit demokratik të vendit tonë.

Një ndryshim i rëndësishëm i Kodit Zgjedhor janë Nenet 136 dhe 138, ku cilësohej se nëse partitë politike vërenin parregullsi ose aludonin se mund të jenë bërë manipulime gjatë procesit të votimit, atëherë kërkesa e tyre në Komisionin Zgjedhor do të merrej automatikisht parasysh nga ky institucion i pavarur, pa u hedhur në fillim në votim (Zogaj, 2010 a: 249). Dhe konkretisht, neni 136: “Paraqitja e pretendimeve dhe kërkitë për provave”; dhe neni 138: “Këqyrja e materialit zgjedhor”. Këto ishin në fakt nenet gurthemeli të konsensusit PD–PS gjatë viteve 2008–2009 për hartimin e Kodit të ri Zgjedhor (Zogaj, 2010 a: 250-251).

Bello, rreth ndryshimeve kushtetuese të vitit 2008-të është shprehur se kanë qenë jo vetëm të nxituara dhe të pakonsultuara, por edhe të dëmshme për tre arsye. Dhe në pikën 2 të intervistës, ka argumentuar, se:

Në radhë të parë, u prish balanca që kishte Kushtetuta e vitit 1998, si në drejtim të ekuilibrit të pushteteve, ashtu edhe në respekt të parimit të kontrollit reciprok. Së dyti, ndryshimet kushtetuese u bënë, nisur nga ngërçi që mund të krijohej, në rastin e zgjedhjes së presidentit, moszgjedhja e të cilit mund të provokonte një spirale zgjedhjesh të njëpasnjëshme. Paradoksi është se tani, Avokati i Popullit zgjidhet me 84 vota, kurse shefi i shtetit, pra Presidenti me shumicën dërrmuese ose 71 vota. Së treti, ndryshimet forcuan së tepërmi pushtetin e kryeministrit, duke i'a zbehur edhe më shumë rolin parlamentit. Në letër, de jure, ne jemi republikë parlamentare, por de facto jemi republikë ekzekutive. Pushtetin e kontrollon thajse tërësisht shefi i qeverisë, i cili, në cilësinë edhe të kryetarit të shumicës parlamentare, nga ku buron qeveria, praktikisht kontrollon edhe parlamentin.

Sipas Bellos, ndryshimet na sollën një president tërësisht partiak, duke minuar në këtë mënyrë konsensusin që në fakt impononte kushtetuta e vitit 1998-të. **Ndryshimet Kushtetuese u bënë për faktin, për të rritur rolin e Kryeministrit dhe për të pasur një President politik**, për arsyen se forca fituese vetëm me votat e saj mund të zgjidhte

Presidentin e ri të vendit. **Presidenti** kishte kompetenca deri në simbolike dhe **varej totalisht nga Kreu i Qeverisë**. Ashtu siç e ka trajtuar edhe Bello në intervistën e zhvilluar dhe që dakortësohem është, se tashmë **Presidenti zgjidhet pa pasur nevojë për marrëveshje politike midis dy forcave të mëdha politike dhe në këtë mënyrë ul rëndësinë e opozitës në vend**.

Sipas Tonin Gjuraj (2015: 127), cilësimi i sistemit proporcional si rajonal, është një manovër cinike për të krijuar idenë se politika është lokale dhe merr në konsideratë interesat vendore. Si edhe autori thekson se, sistemi aktual vështirë se justifikon edhe argumentin për një përfaqësim të gjërë politik sepse ai e kufizon pjesëmarrjen e partive të vogla në Parlament, duke rritur në këtë mënyrë përqindjen e votimeve të nevojshme që u duhen për këtë punë. Gjuraj thekson se ky sistem nuk është i favorshëm për demokracinë shqiptare sepse sistemi dobëson lidhjet deputet-votues dhe forcon më shumë varësinë e deputetit ndaj liderve partiakë. Gjithashtu ky sistem krijon vështirësi për partitë e vogla politike, ku i bën ato të varura ndaj koalicionëve me partitë e mëdha.

Dakortësohem me konkluzionin e Gjuraj, se ky **sistem zgjedhor** i aplikuar në zgjedhjet parlamentare të vitit 2009-të **rrit varësinë e deputetëve me kryetarin e partisë (brenda partisë politike) dhe rrit varësinë e partive të vogla ndaj kreut të partisë së madhe politike** (për sa i përket koalicionëve partiake para zgjedhore). Sistemi zgjedhor proporcional rajonal e largon deputetin nga elektorati i tij dhe e bën të varur ndaj liderit të partisë. Kjo **ndikon në performancën e deputetëve në Kuvend dhe në vendimet që merren**, duke u bazuar jo në atë çka kërkon elektorati/sovrani, por në atë çka kërkon lideri i partisë.

Zgjedhjet Parlamentare të 28 qershorit 2009-të

Zgjedhjet e 29 Qershorit, janë të parat zgjedhje të përgjithshme të zhvilluara në Shqipëri pas antarësimit të vendit në NATO. Si të tilla, për klasën politike dhe për shoqërinë në përgjithësi, u konsideruan si një sfidë shumë e madhe se shiheshin si plotësim i standarteve për zgjedhje demokratike që duhet të plotësojë një vend anëtar i Aleancës së Atlantikut. Në vënd ekzistonte optimizmi tek partitë politike, ndërsa Kryeministri i atëhershëm Berisha premtoi se *qeveria do të bëjë të pamundurën për të zhvilluar zgjedhje të ndershme*.

Gjithashtu, opozita dha konsensusin e saj për ndryshimet kushtetuese, për hartimin dhe miratimin e Kodit zgjedhor. Sipas Pëllumbit (2010 e: 67), Berisha e kishte kuptuar sekretin e këtij Kodi zgjedhor dhe të sistemit proporcional rajonal me lista të mbyllura, që favorizonte koalicionet e mëdha. Ndërsa krahu i majtë ndoqi një rrugë tjetër, nga drejtuesit e LSI-së u teorizua se është më mirë me dy koalicione për të marrë më shumë vota.

Në vështrimin e vëzhguesve ndërkombëtarë, zgjedhjet nuk ishin aq të mira por edhe jo aq të këqija sa të zhvilloheshin protesta dhe bojkot nga opozita. Rezultati i zgjedhjeve ishte shumë i ngushtë dhe pothuajse kemi një barazim të dy forcave të mëdha të mandateve të marra. Por diferencën e bënë mandatet e fituara të LSI-së dhe në momentet e fundit ndodhi një aleancë, ku më 4 korrik Berisha ftoi Metën në bashkëqeverisje. Në këtë mënyrë, kemi krijimin e qeverisë së koalicionit Berisha-Meta, e cila kishte një kohëzgjatje prej 4 vitesh.

Preç Zoga në librin e tij, “Të gjithë nëpër vendet e tyre” (2010: 274-275), shprehet për liderin e LSI-së, se Meta e dinte se si ishin zhvilluar zgjedhjet. Partia e tij ka marrë më shumë vota se mandate, që nënkupton se *LSI është viktimë e një sistemi të mbyllur* e të kontrolluar nga çdo qelizë nga PD-PS sipas Preçit. Meta do t’a përdorë notën e

ndërkombëtarëve si një alibi që i jepet falas dhe do të shfajësonte veten për koalicionin, si një mënyrë që në vend të mbizotëronte stabiliteti politik. Por në fakt, 4 mandatet e tij kishin një peshë shumë të madhe në një situatë të tillë. Metës i jepej mundësia e vendosjes, ose të krijonte qeverinë e koalicionit me kundërshtarin e tij politik, ose vendi do të hynte në zgjedhje të parakohshme. **Kjo parti politike me anë të këtyre zgjedhjeve parlamentare të 2009, fitoi një rëndësi të madhe në skenën politike si faktor decisiv dhe shantazues.**

Ndërsa në intervistën e zhvilluar me Ilir Rusmalin, të cilit i është kërkuar një opinion për qeveritë e koalicionit të vitit 2009-të dhe 2013-të, është shprehur se:

Debati për performancën e koalicioneve qeveritare apo për bashkëjetesën midis modeleve dhe praktikave korruptive me ato antikorrupive brenda të njejtës qeverisje, nuk është produkt i formulave kushtetuese “stabilizuese”. Ai është produkt i prioriteteve dhe qëndrimeve politike. Nëse korrupsioni “destabilizon”, atëherë ai destabilizon më shumë në një parlament të fragmentarizuar dhe me shumica fluide, se sa në një parlament me pak parti dhe me shumica të qëndrueshme. Prandaj përgjigja e pyetjes nëse qeveritë e “qëndrueshme” të koalicionit i kanë bërë mirë apo keq vendit, nuk mund të kërkohej tek ndryshimet kushtetuese. Ajo duhet të lexohet nga fushata, zgjedhjet dhe reagimi i opinionit publik ndaj qeverisë, lidershit politik dhe partive në tërësi.

Tabela nr. 39. Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2009.

Nr.	Subjekti zgjedhor	Mandate në Kuvend	Mandate në %	Vota në %
1	<i>Koalicioni Aleanca e Ndryshimit</i>	70	50 %	46.92 %
	Partia Demokratike	68	48.57 %	40.18 %
	Partia për Drejtësi dhe Integritet	1	0.71 %	0.95 %
	Partia Republikane Shqiptare	1	0.71 %	2.11 %
2	<i>Koalicioni Aleanca Poli i Lirisë</i>	0	0	1.82 %
3	<i>Koalicioni Aleanca Socialiste për Ndryshim</i>	4	2.85 %	5.56 %
	Lëvizja Socialiste për Integritet	4	2.85 %	4.85 %
4	<i>Koalicioni Bashkimi për Ndryshim</i>	66	47.13 %	45.34 %
	Partia Socialiste	65	46.42 %	40.85 %
	Partia për të Drejtat e Njeriut	1	0.71 %	1.19 %
5	<i>Abdullah Adil Omuri</i>	0	0	0.05 %
6	<i>Partia Ligj dhe Drejtësi</i>	0	0	0.32 %

Rezultati i zgjedhjeve të përgjithshme të zhvilluara në vitin 2009-të u ndanë sipas koalicioneve partiake, si (të dhënat e marra nga faqja zyrtare e KQZ-së):


Koalicioni "Aleanca e Ndryshimit", e cila përbëhej nga 16 parti politike dhe udhëhiqej nga Partia Demokratike, morën në total 70 mandate;

Koalicioni "Bashkimi për Ndryshim", e cila përbëhej nga 5 parti politike dhe udhëhiqej nga Partia Socialiste, morën në total 66 mandate;

Koalicioni "Aleanca Socialiste për Integrim" e cila përbëhej nga 6 parti politike dhe udhëhiqej nga Lëvizja Socialiste për Integrim, morën në total 4 mandate

Koalicioni Aleanca e Lirisë, përbëhej nga 6 parti politike, por nuk arritën që të merrnin asnjë mandat parlamentar.

Grafiku Nr. 9 :Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2009.



Ligji proporcional do të eliminonte hendekun mes përqindjes së votave të marra dhe përqindjes së vendeve parlamentare për një subjekt politik (Çili, 2002: 45). Ky sistem sipas Çilit eliminon edhe teorikisht që një parti e vetme të fitojë 2/3 se 3/5 e vendeve në kuvend (46). Pra, kemi më shumë parti të vogla në Kuvend, të cilat do të përfaqësojnë më mirë realitetin shoqëror duke përfaqësuar elektoratin e tyre. Një anë pozitive e sistemit është se do eliminohet ndarja elektorale ‘veri-blu dhe jug-e kuqe’ sepse historikisht me anë të


sistemit mazhoritar PD ka pasur një mbështje të gjërë nga veriu, ndërsa PS nga jugu i vendit (47). Ky sistem teorikisht siguron një kontroll të opozitës në jetën politike të vendit dhe e bën faktor në vendimmarrje, si edhe e bën të domosdoshme që palët politike kundërshtare të arrijnë në një marrëveshje.

Fenomeni Ruzhdie e Fierit

Fshati Ruzhdije në Fier tërhoqi vëmëndjen në zgjedhjet parlamentare të vitit 2009-të, i cili njihet si bastion i PD-së. Në këto zgjedhje ndodhi një tjetër fenomen zgjedhor i quajtur nga prokuroria, politologët dhe media “rruzhdie”. Pas largimit të komisionerëve të Partisë Socialiste dhe parregullsive të ndodhura ditën e votimeve, gjykata e Fierit nisi hetimet. Ka pretendime të ndryshme nga forcat politike për këtë fenomen që ndodhi në Ruzhdije, si edhe është trajtuar gjërësisht nga media e nga ndërkombëtarët në vend. Sipas pretendimeve të komisionerëve të PS-së, ata u larguan ditën e zgjedhjeve sepse janë kërcënuar, ndërsa përfaqësues nga Partia Demokratike e mohojnë këtë akuzë. Ata shtojnë dhe argumentojnë se nga ky fenomen Partia Socialiste ka përfituar.

Rezultoi se në qendrën Ruzhdije kanë votuar emigrantë, të cilët ditën e votimit kanë qenë jashtë vendit. Ka pretendime të ndryshme se kush ka votuar për këta persona dhe dy forcat politike japin versione të ndryshme. Në qarkun e Fierit votohet për 16 mandate, ku fituan tre subjekte politike, Aleanca e Ndryshimit mori 6 mandate (PD), Bashkimi për Ndryshim mori 9 mandate (PS) dhe Aleanca Socialiste për Integrim mori 1 mandat (LSI). Ruzhdija ishte molla e sherrit në këto zgjedhje sepse kjo zonë i dha mandatin e nëntë Partisë Socialiste, kur realisht kjo qendër ka qenë bastion i Partisë Demokratike.

Grafiku Nr. 10 : Votat e marra në Qarkun Fier sipas subjekteve politike në zgjedhjet e vitit 2009.



Fenomeni Ruzhdie sipas peretendimeve të forcës së djathtë dhe sipas analistëve të ndryshëm, kërkohet që të kthehet në një levë Arkimedi për të hedhur poshtë zgjedhjet parlamentare të vitit 2009-të. Dhe ata vazhdojnë të argumentojnë, se komisionerët e PS-së janë larguar me urdhër politik dhe jo për shkak të kërcënimeve nga forca politike e djathtë. Kjo mund të ketë ndodhur për frikën e një humbje nga PS, që pas zhvillimit të zgjedhjeve dhe daljes së rezultateve finale, kjo forca të ketë mundësi që të apelojë rezultatin final, duke u kapur fort pas këtij fenomeni. Ky ka qenë i vetmi rast problematik sepse në të gjitha qendrat zgjedhore puna ka vijuar rregullisht nga komisionerët e të dyja forcave politike (PS dhe PD). Partia Demokratike ka kërkuar që në këtë zonë elektorale zgjedhjet të përsëriten, por një kërkesë e tillë nuk është marrë parasysh nga KQZ.

Analizimi i zgjedhjeve politike të vitit 2009-të sipas teorisë së Arend Lijphart “Ndikimi i sistemit elektoral në formën qeverisëse”

Teoritë e koalicionit: 1. Koalicion minimal i fituar; 2. Koalicionet me madhësi minimale; 3. Koalicionet me numrin më të vogël të partive; 4. Koalicionet me varg minimal; 5. Koalicionet minimale fituese; 6. Koalicionet politike – praktike.

Tabela nr 40: Partitë të cilat kanë fituar mandate parlamentare të radhitura sipas spektrit politik nga A deri në M, për zgjedhjet politike të vitit 2009.

Partitë politike	PS A (Majtas)	PBDNJ B	LSI C	PDI D	PR E	PD F (Djathtas)
Mandatet parlamentare	65	1	4	1	1	68

Teoritë:

1. Koalicion minimal i fituar: FEDB=71, FC=72, FEDC=74.
2. Koalicionet me madhësi minimale: FEDB=71. (4 hapësirë dhe mbulon spektrin majtas-djathtas)
3. Koalicionet me numrin më të vogël të partive: FC=72.
4. Koalicionet me varg minimal: x.
5. Koalicionet minimale fituese: x.
6. Koalicionet politike – praktike: FEDC=74.

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2009-të, kemi krijimin e koalicionit politikë-praktike, i gjashti i radhitur nga teoritë e koalicionit të Arend Lijphart. Në qoftë se ne supozojmë se partitë me të vërtetë kujdesen vetëm në lidhje me politikën, në vend të mbajtjes së detyrës, por pushteti i vërtetë është te legjislatura, ku politikat e mëdha duhen miratuar. Në legjislaturë "thelbësore" është partia që ka rëndësi të madhe, pra partia kryesore është partia që në një shkallë politike dimensionale, si shkallë e majtë-djathtë, përmban anëtar mesatare të parlamentit. Kjo do të thotë, se në kushtet strikte të politikës, kjo është krejtësisht e parëndësishme se sa dhe cilat parti do të marrin pjesë në kabinetin qeveritar. **Në këtë koalicion, rëndësi ka arritja e numrit të nevojshëm për të krijuar një qeveri që të qeverisë vendin për legjislaturën e vitit 2009-2013.**

Vendi ndodhej në një situatë të tillë politike, ku pas deklarimit të votës pro qeveritare të të ndjerit Dritan Priftit (i cili u nda nga jeta më 12 tetor 2017), u krijua edhe

koalicioni 4 vjeçar midis dy forcave me bindje të ndryshme politike PD dhe LSI. U krijua qeveria Berisha 2, por tashmë nuk kishte fuqinë vendimmarrëse të mëparshme. Nga njëra anë mund të argumentojmë se, në një qeveri koalicioni, kur kemi një forcë politike në bashkëqeverisje me bindje të kundërta me atë të qeverisë, kjo në fakt i bën shumë mirë vendit dhe demokracisë sepse kemi një opozitë brënda në qeveri.

Por, duke parë situatën politike në vend, nuk mund të dalim në këtë konkluzion. Ilir Meta, në Qeverinë Berisha 2, mori postin e Ministrit të Jashtëm dhe të Zv/Kryeministrit, si edhe nga kjo lëvizje politike mori disa portofole ministrore të rëndësishme edhe se kishte vetëm katër mandate parlamentare. LSI zë një përqindje të konsiderueshme të posteve ministrore, pavarësisht indekseve të Siaroff dhe na shtyn të konkludojmë se LSI është parti relevante sipas konceptit të Sartorit (Xhaferraj, 2016). Siç e trajtuam edhe më sipër, **LSI** pavarësisht numrit të vogël të mandateve të marra, bëhet një **faktor decisiv në formimin e qeverisë Berisha 2**. Kjo forcë e së majtës shqiptare, duke bashkuar mandatet me forcën më të madhe të së djathtës, bëhet **partia me fuqinë më të madhe vendimmarrëse e shantazuese**, duke marrë një numër të madh të portofoleve ministrore e posteve shtetërore.

Shqipëria ndodhet në një situatë kritike, ku një mazhorancë nuk arrin e vetme që të qeverisë vendin, si rrjedhojë kemi krijimin e koalicionit qeveritar dhe ndarjen e portofoleve ministrore ndërmjet dy partive politike. Ky koalicion është krijuar midis dy forcave politike të kundërta, për nga ana ideologjike (PD-e djathtë, LSI-e majtë) dhe gjatë qeverisjes mbizotëronte një konsensus i gjërë dhe legjislacioni i dalur nga këto zgjedhje pati një jetëgjatësi normale, prej 4 vitesh. Në Parlament u përfaqësua edhe elektorati i tre partive të vogla politike. Në zgjedhjet e vitit 2009-të, sistemi duket sikur është dy partiak,

por, në fakt ky ndryshim vjen së bashku me ndryshimin e sistemit elektoral nga proporcional me mandate të përziera në proporcional rajonal me lista të mbyllura.

Në rast se LSI nuk do të kishte hyrë në koalicion me PD-në, vendi do të kishte hyrë në zgjedhje të parakohshme pavarësisht se dy partitë e mëdha (PD dhe PS) së bashku kanë 96% të vendeve në Parlament, por ato nuk kanë 50+1 mandate të vetme për të formuar qeverinë. Pritej një rezultat i tillë nga sistemi elektoral i aplikuar për herë të parë në Shqipëri, ku partitë e mëdha do të ndaheshin me një diferencë të vogël mandatesh dhe PD mori 68 mandate, ndërsa PS 65 mandate. Këto zgjedhje sollën një rritje të LSI-së, e cila së bashku me 4 mandatet e saj u bë një faktor deciziv në krijimin e qeverisë mbi bazën e një koalicioni. Kjo parti e vogël kishte një fuqi të madhe sepse kishte potencialin e bërjes së koalicionit dhe të shantazit.

Kryeministër ishte Sali Berisha, i cili ishte votëbesuar që në legjislaturën e vitit 2005, më 11 shtator të atij viti dhe do të qëndrojë në këtë post të rëndësishëm deri më 8 shtator 2013. Ndërsa Presidenti i Republikës së Shqipërisë ishte zgjedhur Bamir Topi (24 prill 1957), më 20 korrik të vitit 2007 deri më 24 korrik të vitit 2012, i cili vinte nga forca e djathtë, e cila ishte në pushtet. Marrëdhëniet e tyre (PD me Bamir Topin) do të vinë duke u përkeqësuar, derisa këtij të fundit ti përfundojë mandati si President i Shqipërisë dhe më pas do të formojë partinë e tij “Fryma e Re Demokratike”.

PD nuk kishte numrin e domosdoshëm të mandateve parlamentare që të qeveriste e vetme, si edhe marrëdhëniet me Presidentin e Republikës së Shqipërisë, Bamir Topit (edhe pse ishin nga e njëjta forcë politike e djathtë) vinin duke u përkeqësuar dita-ditës, si edhe qeverisja kushtëzohej shumë nga bashkëqeverisja me LSI-në. Kemi një qeverisje ‘të qetë’ dhe jetëgjatësia e këtij koalicioni ishte katër vjeçar dhe përpara kësaj legjislature ishte edhe

zgjedhja e Presidentit të Shqipërisë në vitin 2012-të, një vit para zgjedhjeve parlamentare të vitit 2013-të.

5.5 Ligji elektoral dhe zgjedhjet parlamentare të vitit 2013-të

Më 23 Qershor të vitit 2013-të, në Shqipëri u mbajtën zgjedhjet parlamentare të radhës. Sistemi elektoral ishte i njëjtë me zgjedhjet parlamentare të vitit 2009-të, sistem elektoral rajonal proporcional me lista të mbyllura. Deputetët e Kuvendit zgjidhen nga dymbëdhjetë zonat zgjedhore dhe numri i vendeve parlamentare për secilin vend (ndërmjet 4 dhe 32) ndahet në proporcion me numrin e banorëve, analoge me dymbëdhjetë qarqet. Brenda zonave zgjedhore, deputetët zgjidhen me përfaqësim proporcional në lista të mbyllura me prag natyror prej 3% dhe 5% për koalicionet. Kemi një ulje të pragut natyror për partitë e vogla brënda në koalicion. Shpërndarja e mandateve brënda koalicionit bëhet sipas sistemit d'Hondt, për partitë e pavarura politike përdoret metoda Sainte-Laguë.

Me Vendim Nr.2/2013 për “Caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2013”, në mbështetje të nenit 78, pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 76 të ligjit 11f.10019, më datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar, janë *140 mandate që ndahen midis 12 zonave zgjedhore*. Dhe më specifikisht kemi: Zona zgjedhore qarku Berat 8 mandate; Qarku Dibër 6 mandate; Qarku Durrës 13 mandate; Qarku Elbasan 14 mandate; Qarku Fier 16 mandate; Qarku Gjirokastrë 5 mandate; Qarku Korçë 12 mandate; Qarku Kukës 4 mandate; Qarku Lezhë 7 mandate; Qarku Shkodër 11 mandate; Qarku Tiranë 32 mandate dhe Qarku Vlorë 12 mandate.

Sipas Islamaj, partitë politike kryesore zgjedhën sistemin proporcional rajonal për këto arsye (Gazeta Panorama, Islamaj, K):

"Votimi në sistemin proporcional rajonal është më i thjeshtë; shmanget me dy raunde; "peshon" drejtë të gjithë partitë politike dhe dekurajon presionin e partive "të vogla"; garanton përfaqësim të drejtë dhe qeverisje të qëndrueshme; nuk eliminon partitë e vogla, nuk krijon sistem bipartiak, por konsolidon sistemin politik; i jep mundësi votuesit të përzgjedhë programin, ekipin, liderin; forcon rolin dhe kohezionin e partive politike; demotivon gjeneruesit individualë të tensioneve zgjedhore; krijon mundësi reale për promovimin e grave; shmang ndarjen e zonave zgjedhore të tipit "salamandër"; zhduk iluzionin e diferencave veri-jug; garanton respektin për partitë me përqendrim territorial; i jep prioritet programeve të zhvillimit kombëtar e rajonal; përfundimisht eliminon dukurinë negative të Dushkut..."

Sipas Bufit tek libri i tij "Tempulli i Demokracisë", autori thekson se momenti më i rëndësishëm i ligjit ka të bëjë me përllogaritjen e mandateve të subjekteve zgjedhore. Pas përfundimit të procesit, KQZ përllogarit për çdo zonë zgjedhore shpërndarjen e mandateve mbi bazën e numrit të votave të vlefshme që subjektet kanë marrë në nivel zone zgjedhore. Nga kjo shpërndarje përjashtohen partitë politike që konkurrojnë më vete dhe që kanë marrë më pak se 3 % të votave në nshkallë vendi, si edhe koalicionet që kanë marrë më pak se 5 % të votave të vlefshme që secili koalicion ka marrë.

Pas përfundimit të llogaritjes së rezultateve, KQZ përllogarit shpërndarjen e mandateve brenda koalicionit në çdo zonë zgjedhore, mbi bazën e numrit të votave të vlefshme që secila nga partitë pjesëtare të koalicionit kanë marrë në zonën zgjedhore përkatëse dhe numrit të mandateve që koalicioni ka fituar në zonën zgjedhore përkatëse. Më pas përcaktohen mandatet nominale për çdo parti politike, kjo në bazë të renditjes së kandidatëve në listën e depozituar. Kryetari i partisë, i regjistruar në më shumë sesa në një listë dhe që ka fituar mandat në më shumë se një zone zgjedhore, atëherë mban mandatin e fituar në zonën zgjedhore ku lista fituese ka marrë numrin më të vogël të votave sipas

përlllogaritjes së neneve 162 dhe 163 të Kodit Zgjedhor. Mandatet e tjera të fituara nga kryetari i partisë u shpërndahen kandidatëve të tjerë që renditen pas tij në listën përkatëse.

Rezultatet e zgjedhjeve parlamentare të vitit 2013-të

Numri i votuesve i regjistruar është 3.271.885 dhe në këto zgjedhje kanë votuar rreth 1.749.358 zgjedhës. KQZ miratoi regjistrimin e 66 partive politike dhe të dy kandidatëve të pavarur (NDI (2013) “Raporti i analizës së zgjedhjeve”, Numri 1, f. 3). U krijuan dy koalicione të mëdha, “Aleanca për Punësim, Mirëqenie dhe Integrim” ku partia kryesore ishte PD sëbashku me 24 parti të tjera të vogla dhe në total 25 parti politike; si edhe koalicioni “Aleanca për Shqipërinë Evropiane” ku partia kryesore ishte PS dhe LSI, sëbashku me 32 parti të tjera të vogla dhe në total 34 parti politike. Si edhe 3 Parti të Pavarura: Aleanca Kuq e Zi (AK), Fryma e Re Demokratike (FRD) dhe Lidhja për Drejtësi dhe Progres (LPD); dhe 3 kandidatë të pavarur, Arben Malaj në Vlorë, Dritan Prifti në Fier dhe Sazan Guri në Tiranë.

Tabela nr. 41: Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2013.

Nr.	Subjekti politik	Mandate të marra në Parlament	% e votave
1	Koalicioni Aleanca për Punësim, Mirëqenie dhe Integrim	57	39.46 %
2	Koalicioni Aleanca për Shqipërinë Evropiane	83	57.63 %
3	Aleanca Kuq e Zi (AK)	0	0.59 %
4	Fryma e Re Demokratike (FRD)	0	1.70 %
5	Lidhja për Drejtësi dhe Progres (LPD)	0	0.06 %
6	Arben Malaj	0	0.18%
7	Dritan Prifti	0	0.36 %
8	Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë	0	0.02 %
		140	100 %

Zgjedhjet e vitit 2013-të janë zgjedhjet e shtata parlamentare, pas vitit 1991. Pas më shumë se dy dekadash, Shqipëria nuk ka mbajtur ende zgjedhje që plotësojnë standardet

demokratike ndërkombëtare (NDI (2013) “Raporti i analizës së zgjedhjeve”, Numri 1, f. 1). U krijuan dy koalicione të mëdha, “Aleanca për Punësim, Mirëqenie dhe Integrim”, partia kryesore ishte PD mori 57 mandate dhe koalicioni “Aleanca për Shqipërinë Evropiane”, partia kryesore ishte PS dhe LSI dhe morën bashkë 83 mandate.

Grafiku Nr. 11: Rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2013.



***Analizimi i zgjedhjeve politike të vitit 2013-të sipas teorisë së Arend Lijphart
“Ndikimi i sistemit elektoral në formën qeverisëse”***

Teoritë e koalicionit: 1. Koalicion minimal i fituar; 2. Koalicionet me madhësi minimale; 3. Koalicionet me numrin më të vogël të partive; 4. Koalicionet me varg minimal; 5. Koalicionet minimale fituese; 6. Koalicionet politike – praktike.

Tabela nr. 42: Partitë të cilat kanë fituar mandate parlamentare të radhitura sipas spektrit politik nga A deri në M, për zgjedhjet politike të vitit 2013.

Partitë politike	PS (Majtas) A	PBDNj B	LSI C	PKDSH D	PDIU E	PR F	PD (Djathtas) G
Mandatet parlamentare	66	1	16	1	4	3	49

Teoritë:

1. Koalicion minimal i fituar: AC=82, GFEC=72, GEDCB=71.

2. Koalicionet me madhësi minimale: GEDCB=71 (5 hapësirë dhe mbulon spektrin majtas-djathtas)
3. Koalicionet me numrin më të vogël të partive: AC=82.
4. Koalicionet me varg minimal: ABC=83 (2 hapësirë dhe mbulon spektrin e majtë) .
5. Koalicionet minimale fituese: ABC=83 dhe ABCD=84.
6. Koalicionet politike – praktike: ABCD=84 dhe GCEF=72.

Edhe në zgjedhjet parlamentare të vitit 2013-të kemi krijimin e koalicionit politike-praktike. Fokusi mbi preferencat politike të partive është marrë për përfundimin e saj përfundimtar nga Teoria e koalicionit të politikë-praktikë. Pra, në këto zgjedhje të përgjithshme të mbajtura në vendin tonë **formohet koalicioni i gjashë i renditur nga Lijphart.** Kemi ndryshime në skenën politike, ku LSI hyri në koalicion parazgjedhor me PS dhe si rrjedhojë, prishi parakohe koalicionin me PD-në. Në këto zgjedhje parlamentare spektri i majtë hyri bashkë në zgjedhje kundra spektrit të djathtë.

PSSH merr 66 mandate (i njëjti rezultat nga zgjedhjet e mëparshme), PD merr 49 mandate (ulje të mandateve nga zgjedhjet e mëparshme dhe kjo vjen si rezultat i koalicionit me LSI-në, nga ku PD del e dëmtuar), LSI merr 16 mandate (vërejmë një katër fishim të numrit të mandateve nga zgjedhjet e vitit 2009-të), PDIU merr 4 mandate, PR merr 3 mandate, PBDNJ merr 1 mandat dhe PKDSH merr 1 mandat. Dhe koalicioni fitues “Aleanca për Shqipërinë Evropiane” siguron 83 mandate, ndërsa koalicioni “Aleanca për Punësim, Mirëqenie dhe Integrim” siguron 57 mandate.

Në Shqipëri sistemi partiak nuk është i fragmentizuar dhe është i dominuar nga dy parti kryesore, ndërsa partitë e vogla relevante kanë ndryshuar me rritjen që ka pësuar LSI. Vërehet, se ky sistem elektorale po thekson rëndësinë e një partie të tretë, LSI-së, e cila po

fiton një numër të madh mandatesh dhe bashkimi me të po bëhet e domosdoshme për krijimin e qeverisë (pavarësisht PD dhe PS). Në këto zgjedhje nuk kemi mazhorancë absolute nga ana e partisë fituese, PS-së, si nga madatet e marra, si nga votat popullore.

Forcat politike që bashkëqeverisin vendin janë të së njëjtës krah politik, të spektrit të majtë. Qeverisja funksionon mbi bazën e qeverisjes së gjërë partiake dhe mbi bazën e konsensusit. Të dyja forcat politike i kanë ndarë portofolet ministrore për nga numri dhe rëndësia e tyre politike, por në dy zgjedhjet e fundit të zhvilluara në Shqipëri, të vitit 2009 dhe 2013, LSI ka fituar një rëndësi të madhe si partia e parë e vogël. Ajo po rritet nga njëra zgjedhje në tjetrën, ku në zgjedhjet e vitit 2013 i ka 4-fishuar mandatet e saj parlamentare (nga 4 në 16) dhe ka qenë vendimtare në formimin e qeverisë Berisha 2 e Rama 1.

Bujar Nishani (29 shtator 1966) më 24 korrik të vitit 2012-të është zgjedhur President i Shqipërisë dhe mandati i tij përfundon më 24 korrik 2017. Ai është anëtar i Partisë Demokratike dhe me zgjedhjen e Edi Ramës si Kryeministrit më 8 shtator të vitit 2013-të, kompetencat e tij janë pothuajse simbolike. Si Kryetar i Kuvendit është zgjedhur kryetari i LSI-së, Ilir Meta, i cili po bashkëqeveris vendin me Partinë Socialiste. Viti 2017-të është një vit shumë i rëndësishëm për qeverisjen dhe të ardhmen e vendit tonë. Përpara kemi zgjedhjen e Presidentit të ri të vendit dhe zgjedhjet parlamentare, ku shqiptarët do të zgjedhin legjislaturën e vitit 2017-të ose legjislaturën e IX-të të Kuvendit të Shqipërisë.

5.6 Dallimet midis Ligjit Nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe Ndryshimeve Kushtetuese Ligji Nr. 9904, datë 21.4.2008

Kushtetuta është ligji më i rëndësishëm në çdo shtet demokratik sepse me anë të këtij Ligji themeltar funksionon një shtet i tërë. Në Kushtetutë përcaktohen qartë mandatet e drejtuesve të disa institucione kryesore të vendit. Në Kushtetutë (Meidani, 2003) specifikohen qartë çështje procedurale që mundësojnë realizimin e detyrave përkatëse, si realizimi i dy parimeve bazë demokratike-qeverisëse, siç është ndarja e pushteteve dhe kontroll-balancimi i tyre.

Shqipëria më 28 nëntor 1998 ka miratuar Kushtetutën aktuale të vendit tonë, e cila përcakton Shqipërinë si një Republikë Parlamentare, shtet unitar, i pandashëm dhe me një qeverisje të bazuar *"në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike"*. Sipas Kushtetutës, Kuvendi ka një legjislaturë njëdhomësh të përbërë nga 140 deputetë, ku 100 zgjedhen drejtëpërsëdrejti në zona njëemërore me numër të përafërt zgjedhësish dhe 40 nga lista shumëemërore të partive ose koalicioneve partiake. Pragu natyror për partitë është në 2.5 % dhe 4 % për koalicionet partiake. Kuvendi zgjedh kreun e shtetit, Presidentin dhe Këshillin e Ministrave që përbëhet nga Kryeministri, Zëvendëskryeministri dhe ministrat.

Kushtetuta e vitit 1998-të është e ndarë në 18 pjesë, të cilat sanksionojnë një demokraci parlamentare, sovranitetin e njerëzve dhe të drejtat themelore të qytetarëve. Në lidhje me procesin ligjvënës, Presidenti nuk e gëzon më të drejtën e iniciativës legjislative, e cila tashmë u përket Këshillit të Ministrave, çdo deputeti të Kuvendit dhe 20 mijë zgjedhësve. Nëse Presidenti nuk ushtron kompetencën e kthimit për rishqyrtim (vetëm një herë) dhe të shpalljes brënda 20 ditëve nga dita kur i është paraqitur projektligji, ligji quhet i shpallur vetvetiu. Pra vërejmë një President me kompetenca deri në simbolike, me pa të drejtë të iniciativës ligjore dhe pa të drejtë të kthimit të një projektligji.

Për sa i përket organizimit dhe funksionimit të Kuvendit, Kushtetuta ka një ndryshim thelbësor përsa i përket dispozitës për shpërndarjen e parakohëshme të parlamentit. Bashkim Dedja, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, argumentonte se më parë parashikohej e drejta e Presidentit për të shpërndarë Kuvendin kur përbërja nuk e lejonte atë të ushtronte funksionet e veta dhe e bënte të pamundur qeverisjen e vendit, pasi ishte marrë mendimi i Kryeministrit dhe të Kryetarit të Kuvendit.

Kushtetuta parashikohen vetëm dy raste të shpërndarjes së parakohshme të Kuvendit, kur Kuvendi nuk arrin të zgjedhë Presidentin sipas shumicës së kërkuar (Neni 87), dhe e dyta kur Kuvendi nuk arrin të zgjedhë Kryeministrin e ri (Neni 97). Në rastin e parë parlamenti shpërndahet vetvetiu, ndërsa në rastin e dytë shpërndahet me dekret të Presidentit. Dedja thekson se përcaktimi i prerë i dy rasteve të shpërndarjes së parakohëshme të parlamentit, ngushton hapësirën për të provokuar kriza politike dhe zgjedhje të parakohëshme për motive tjera.

Në vitin 2007-të, Bamir Topi u zgjodh President në votimin e katërt, me 90 mandate (nevojiteshin mbi 3/5 e mandateve). Zgjedhja e Presidentit të ri u zhbllokua nga votimi i një grupi deputetësh të PS-së sepse PD bashkë me aleatët e saj (PD+PAA+PDK+PR+PBDNJ) kishin 75 mandate parlamentare dhe nevojiteshin mbi 84 vota. Dhe në vitin 2007-të, për herë të parë Kushtetuta është ndryshuar. Ligji kushtetues u amendua në Kuvend në 13 janar 2007, me ndryshimin e Nenit 154, ku kemi ndryshimin e mandatit të zgjedhurve vendorë nga tre në katër vjet dhe numri i anëtarëve të KQZ-së, u shtua nga shtatë në nëntë anëtarë.

Midis miratimit të Kushtetutës në vitin 1998 dhe Ndryshimeve Kushtetuese të vitit 2008, vendi u qeveris nga dy mazhoranca të ndryshme, gjatë viteve 1998-2005 nga e majta dhe gjatë viteve 2005-2008 nga e djathta. Sipas Afrim Krasniqit, dy partitë politike filluan

të legjitimojnë aktet e tyre politike duke i'u referuar Kushtetutës dhe dokumenti themelor i shtetit në këtë mënyrë filloi të marrë rëndësinë dhe rolin që i takon në sistemin politik e qeverisës në vend. Ndërsa në vitin 1994 dhe 1998 janë mbajtur referendume, ku partitë politike nga mungesa e mbështetjes së kundërshtarëve politikë i janë drejtuar popullit për të miratuar draft Kushtetutën. Ndryshimet kushtetuese të vitit 2007 dhe 2008, janë kryer në mënyrë konsensuale, duke arritur një konsensus edhe më të gjërë politik tek aleatët politik.

Në vitin 2008-të është miratuar Ligji Nr. 9904, datë 21.4.2008, Ndryshimet Kushtetuese, ku disa nga ndryshimet thelbësore janë ndryshimi i sistemit elektoral, u kalua nga sistemi i votimit miks në sistemin proporcional rajonal; KQZ u hoq si institucion nga Kushtetuta, ku u kalua me trajtimin si një ligj zgjedhor; u vendos mandat për Prokurorin e Përgjithshëm. Por, ajo që duhet theksuar është ndryshimi i zgjedhjes së Presidentit dhe rritja e pozitës së Kryeministrit në raport me Kuvendin, pra mocioni i besimit ose mosbesimit ndaj Kryeministrit. Kemi kalimin nga zgjedhja e Presidentit me shumicë të cilësuar (me mbi 3/5 të mandateve parlamentare) dhe u kalua me zgjedhje me shumicë të thjeshtë në dy raundet e fundit (me 71 mandate parlamentare).

Nga zgjedhja e Presidentit me shumicë të cilësuar u kalua në zgjedhje me shumicë të thjeshtë në dy raundet e fundit, ka ulur ndjeshëm peshën dhe rolin e Presidentit në skenën politike. Kjo paketë e ndryshimeve kushtetuese është inicuar me vullnetin e dy forcave të mëdha politike (PD dhe PS) dhe është miratuar me një konsensus të gjerë në Parlament me 117 vota më 21 prill të vitit 2008-të. Lidërt e dy partive kryesore i kanë iniciuar këto ndryshime në Kushtetutë për të rritur rolin e Kreut të Qeverisë (Kryeministrit), duke pasur fuqi të plotë vendimmarrëse, për të zgjedhur Presidentin me votat e mazhorancës dhe për të pasur fuqi kontrolluese mbi pushtetet e tjera (Kuvend/Presidencë/Gjyqësor/Media).

Ndryshimet kushtetuese të vitit 2008 kanë sjellë një prishje të balancës, së ekuilibrit të pushteteve dhe të parimit të kontrollit reciprok. Me këto ndryshime kemi një president partiak, i cili zgjidhet me votat e mazhorancës (71 vota, 50% + 1), ku nuk nevojitet një konsensus i gjërë partiak. Ndërsa Kushtetuta e vitit 1998, impononte një konsensus sepse nevojiteshin mbi 3/5 e mandateve (84 vota), si rrjedhojë kemi një forcim të pozitës/pushtetit të Kryeministrit së vendit. **Me ndryshimet e fundit kushtetuese të vitit 2008, tërë pushtetin e ka Kreu i Qeverisë, i cili në cilësinë e Kryetarit të shumicës parlamentare, kontrollon edhe Kuvendin, edhe presidencën duke zgjedhur Presidentin e ri të vendit.**

Pëllumbi në librin e tij “Etikokracia” (2013: 56) argumentonte se Ndryshimet Kushtetuese 2008-të, i shërbejnë forcimit të partitokracisë, zëvendësimit të institucioneve politike shtetërore me marrëveshjet partiake, që mund të përfundojnë në ‘pazare liderësh’. Kjo vjen si pasojë e zgjedhjes së Presidentit vetëm një shumicë të brishtë prej 50% + 1 me ndryshimet kushtetuese, ndërsa me ndryshimet lidhur me mocionin bëhet shumë më e vështirë vënia në pikëpyetje e legjitimitetit të partive politike shqiptare.

Tabela Nr. 43: Lista e Presidentëve të Shqipërisë pas vitit 1990.

Presidenti	Mandati	Subjekti politik	Raundet	Votat
Ramiz Ali	30 prill 1991-9 prill 1992	PPSH		
Sali Berisha	9 prill 1992-24 korrik 1997	Partia Demokratike	1	113
Rexhep Meidani	24 korrik 1997-24 korrik 2002	Partia Socialiste	1	110
Alfred Moisiu	24 korrik 2002-24 korrik 2007	Pa parti	1	96
Bamir Topi	24 korrik 2007-24 korrik 2012	Partia Demokratike	4	85
Bujar Nishani	24 korrik 2012- në detyrë	Partia Demokratike	4	73

Tabela Nr. 44: Kryeministrat e Shqipërisë pas vitit 1990.

Zgjedhjet parlamentare	Kryeministri i Shqipërisë	Subjekti politik
Zgjedhjet më 31 mars 1991	Fatos Nano	PS
	Ylli Bufi	PS
	Vilson Ahmeti	Pa parti
Zgjedhjet më 22 mars 1992	Aleksandër Meksi	PD
Zgjedhjet më 26 maj 1996	Aleksandër Meksi	PD
Zgjedhjet më 29 qershor 1997	Fatos Nano	PS
	Pandeli Majko	PS
	Ilir Meta	PS

Zgjedhjet më 24 qershor 2001	Ilir Meta	PS
	Pandeli Majko	PS
	Fatos Nano	PS
Zgjedhjet më 3 korrik 2005	Sali Berisha	PD
Zgjedhjet më 28 qershor 2009	Sali Berisha	PD
Zgjedhjet më 23 qershor 2013	Edi Rama	PS

Ekzistojnë dallime thelbësore midis ligjit kushtetues të miratuar në vitin 1991 dhe Kushtetutës së Shqipërisë të miratuar në vitin 1998. Këto ndryshime qëndrojnë tek mënyra e përzgjedhjes së Presidentit, si rrjedhojë kemi ndryshime në marrëdhënien midis pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ. Në vitin 1991 kemi një President me kompetenca të gjëra, i cili kishte të drejtën e nxjerrjes së dekreteve me fuqinë e ligjit, nismës ligjore dhe drejtonte mbledhjet e qeverisë. Ndërsa në vitin 1998-të, kemi një President me kompetenca shumë të kufizuara, deri në kompetenca simbolike. Presidenti, kreu i shtetit me miratimin e Kushtetutës së vitit 1998-të është kthyer në një simbolikë pa fuqi politike dhe kontrolluese.

Nëse analizojmë Presidentët e zgjedhur me anë të Kushtetutës së vitit 1998, Rexhep Meidani (propozuar nga PS), Alfred Moisiu (zgjedhur në mënyrë konsensuale) dhe Bamir Topi (propozuar nga PD) e kanë mbyllur mandatin kushtetues në konflikt politik me forcën politike që i ka propozuar dhe me mazhorancat e radhës fituese . Afrim Krasniqi (2015: 11-12) argumenton se disa nga arsyet janë, si kultura e brishtë politike në bashkëpunim dhe bashkëjetesa institucionale midis palëve kundërshtarë politike. Dhe konflikti i paevitueshëm midis modelit të një Presidenti që i referohet vetëm përgjegjësi e pozitës kushtetuese dhe mazhorancave të radhës, që i referohen kryesisht premtimeve e pritshmërive të tyre elektorale.

Ndërsa Presidentët e zgjedhur me ligjin kushtetues të vitit 1991, Ramiz Alia dhe Sali Berisha, janë Presidentë me kompetenca të gjëra dhe tërë pushteti politik ndodhet në

këtë institucion. Presidentët zgjidhnin Kryeministrin (kreun e qeverisë) dhe rrjedhimisht, shohim një varësi të pushtetit legjislativ ndaj pushtetit ekzekutiv (me Kushtetutën e vitit 2008 ndodh e kundërta). Presidenti Ramiz Alia i detyruar nga rrethanat historike dha dorëheqjen. Edhe në mandatin kushtetues të Berishës si President, shohim një presidencë shumë të fuqishme. Por, pas trazirave që filluan në vitin 1997 për shkak të zhvillimit të luftës civile, ku pushteti dhe qeveria bien për një periudhë disa mujore, u zhvilluan edhe zgjedhjet e dyta të parakohshme.

Me Kushtetutën e vitit 1998-të zgjedhja e Presidentit me anë të një konsensusi të gjërë bëhej e domosdoshme sepse nevojiteshin mbi 84 vota. Formula e zgjedhjes në pesë raunde me 3/5 e votave kërkonte nevojën e konsensusit dhe të zgjerimit të votës politike të mazhorancës, siç ndodhi në zgjedhjet presidenciale të vitit 2002 dhe 2007. Me sistemin e zgjedhjes mbi 84 vota janë zgjedhur Presidenti Alfred Moisiu në vitin 2002 me 96 vota dhe Bamir Topi në vitin 2007 me 85 vota (3/5 +1).

Ndërsa me Ndryshimet Kushtetuese të vitit 2008-të, partitë e mëdha politike që do të fitonin zgjedhjet parlamentare, do të mund të zgjidhnin të vetme si mazhorancë edhe Presidentin e Republikës së Shqipërisë. Këtë e shohim edhe në zgjedhjen e Bujar Nishanit si President i Shqipërisë në vitin 2012 nga Partia Demokratike, me vetëm 73 vota. Si rrjedhojë, kemi një President me kompetenca shumë të kufizuara dhe një Kryeministër të fuqishëm, që vendos (zgjedh) edhe për kreun e shtetit. Shohim një pushtet ekzekutiv nën varësinë e pushtetit legjislativ dhe një president tërësisht politik, që vjen nga radhët e forcës politike.

Gjithnjë e më shumë po shohim në skenën politike të Shqipërisë se fati i vendit është në duart e dy lidërve të partive më të mëdha të vendit (PD dhe PS). Janë ata që

vendosin për listën e kandidatëve për deputet, për emrat në postet ministrore (kabinetin qeveritar), për kandidatët për kryetar Bashkie, për kandidatin për President. Tashmë Presidenti zgjidhet pa nevojën e një konsensusi me opozitën sepse çdo mazhorancë ka numrat e nevojshme (70+1) për ta zgjedhur. Shohim një pushtet legjislativ mbi dy pushtetet e tjera dhe që përtej varërisë, ushtron edhe kontroll ndaj këtyre pushteteve.

KAPITULLI VI: KONKLUZIONE

Konkluzione dhe përfundime

“Rregullat zgjedhore mund të bëjnë ose të zhbëjnë një parti, ose edhe një shtet”.

Në këtë studim shkencor disa vjeçar, kemi bërë të mundur shpjegimin dhe analizimin e lidhjes midis sistemit elektoral dhe formës së qeverisjes (sistemit politik) të vendit tonë, ku kemi përdorur gjërësisht teorinë e Arend Lijphart *Ndikimi i sistemit elektoral në formën e qeverisjes*. Në këtë punim është konfirmuar teoria e aplikuar në zgjedhjet e përgjithshme të zhvilluara në Shqipëri gjatë viteve 1991-2013. Nga analizi i rezultateve zgjedhore dhe formimit të qeverisë, kemi dalur në konkluzion se ekziston një lidhje e fortë midis sistemeve zgjedhore dhe sistemeve partiake, ku një ligj proporcional zgjedhor i cili ndan vendet parlamentare në bazë të përqindjes së votave të fituara favorizon krijimin e sistemeve multi-partiake; ndërsa një ligj shumice (mazhoritar) favorizon krijimin e një sistemi dypartiak.

Pasi kemi marrë rezultatet finale për çdo subjekt politik në zgjedhjet parlamentare në Shqipëri, në një tabelë kemi renditur sipas spektrit politik mandatet e marra nga partitë politike të cilat kanë arritur të përfaqësojnë elektoratin e tyre në Kuvend. Pasi kemi bërë një parashikim në lidhje me formimet e mundshme të kabineteve qeveritare, duke u bazuar në teorinë e Arend Lijphart, kemi përcaktuar llojin e kabinetit që formohet në çdo zgjedhje parlamentare. Ka pasur raste që një parti politike ka arritur të ketë numrat e nevojshme të mandateve parlamentare për të formuar qeverinë e vetme, por ato kanë preferuar të formojnë një qeveri të gjërë duke u bazuar edhe në kushtet politike të vendit. Këtë e kemi

specifikuar edhe më sipër, në analizimin e formës së qeverisjes për çdo zgjedhje parlamentare që është mbajtur në vendin tonë.

Si rrjedhojë, pasi kemi aplikuar një sistem zgjedhor të caktuar (mazhoritar ose proporcional) kemi edhe krijimin e kabinete të shumicës njëpartiake ose koalicione të gjëra shumëpartiake. Këto kabinete ndryshojnë nga njëri-tjetri në dy aspekte, e para, kabineti është i përbërë nga një parti ose nga një koalicion partish, e dyta, përsa i përket llojit të mbështetjes parlamentare që kabineti ka. Edhe një herë, vërtetohet se kemi një lidhje midis sistemeve elektorale dhe formës së qeverisjes.

Sistemi elektoral është elementi i parë i kësaj marrëdhënie shkakësie, i cili mund të përcaktohet edhe si konturuesi i sistemit partiak të një vendi. Studimi i rregullave elektorale është kaq me rëndësi, se përtej pasoja politike që mund të sjellë një sistem zgjedhor, ato janë edhe krijuese të vetë politikës. Nënvizojmë, se rregullat e sistemit elektoral janë aq të rëndësishme, sa këto mund të jenë edhe përcaktuese për rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve parlamentare, pavarësisht votave të marra.

Formulimet e ndryshme për shpërndarjen e votave dhe mandateve parlamentare, mund të ndikojnë në përfaqësimin parlamentar dhe të sigurojnë që asnjë parti politike të fitojë shumicën, e në këtë mënyrë do të kemi përfaqësimin e pakicave në Parlament ose mund të ndodhë e kundërta. Brënda zonës zgjedhore, ka dy mënyra për të kaluar votën në mandate parlamentare. *Sistemi proporcional* mund të zbatohet në zonat me shumë kandidatë, ku mandatet ndahen midis partive politike që marrin më shumë vota. Ndërsa *sistemi mazhoritar* praktikohet në zona me një kandidat, partia politike që merr më shumë vota fiton edhe mandatin e zonës. Për sa i përket pragjeve elektorale të përdorura, historikisht Shqipëria ka përdorur pragje jo të ulta, por jo penalizuese për minoritetet të

përqendruara demografikisht. Me përjashtim të zgjedhjeve të vitit 2009-2013, pragu elektoral është në nivel qarku, ndërsa në zgjedhjet e tjera pragu është në nivel kombëtarë.

Sistemet elektorale të aplikuara në Shqipëri gjatë viteve të tranzicionit kanë ndryshuar në çdo zgjedhje parlamentare. Pra, vërejmë ndryshimin sistematik të sistemit zgjedhor në çdo zgjedhje të përgjithshme të zhvilluara në Shqipëri pas viteve '90. Mund të përmendim sistemin mazhoritar me dy raunde, sistemin miks të varur, sistemin miks të pavarur, sistemin proporcional rajonal, sistemin miks ku dimensionin mazhoritar përcaktohet nga modeli mazhoritar me dy raunde në disa raste apo me Shumicë Minimale (zgjedhjet 2005). Ndër vite kemi vërejtur një zhvendosje nga familja mazhoritare drejt familjeve më proporcionale, por vitet e fundit është diskutuar për t'u rikthyer në familjen mazhoritare.

Legjislaturat ndër vite kanë pasur një numër të ndryshëm mandatesh në Parlament, ku në vitin 1991 kemi pasur 250 parlamentarë, në vitin 1992 dhe 1996 kemi pasur 140, në vitin 1997 kemi pasur 155 dhe duke filluar nga zgjedhjet e vitit 2001 kemi 140 deputetë. Nga analistë të ndryshëm po diskutohet mundësia për ndryshim të kodit zgjedhor pas zhvillimit të zgjedhjeve të 25 qershorit të vitit 2017-të, ku diskutohet për një sistem mazhoritar dhe reduktim të numrit të deputetëve në 100 mandate.

Një element tjetër i sistemeve zgjedhore të aplikuara në Shqipëri është fakti se me përjashtim të zgjedhjeve të viteve të fundit (2009 dhe 2013) në zgjedhjet e mbajtura, 100 mandate (kur kemi 140 mandate në total) ose 115 mandate (kur kemi 155 mandate në total) janë zgjedhur nëpërmjet formulave mazhoritare (Shumicë Minimale apo Mazhoritar me dy raunde). Kjo vazhdueshmëri prej nga zgjedhjet e viteve 1991, ka konturur një sistem dypartiak ku në skenën politike kanë mbizotëruar dy forca politike (PD dhe PS). Pasi u

ndryshua sistemi zgjedhor nga mazhoritar në proporcional në Ndryshimet Kushtetuese të vitit 2008-të, një parti e tretë është rritur nëpërmjet këtij sistemi.

Vendi ynë gjatë viteve të tranzicionit e ka ndryshuar disa herë Kushtetutën e Shqipërisë, kjo si rrjedhojë e kërkesave për forcim të pozitive të Presidentit (1994) ose forcim të pozitive të Kryeministrit (2008). Ndryshimi i Kushtetutës sjell ndryshim në marrëdhënien midis tre pushteteve dhe në qeverisjen e vendit. Sisteme të ndryshme elektorale kanë prodhuar marrëdhënie të ndërlikuar midis partive të mëdha dhe partive të vogla. Dhe në këtë mënyrë sistemi partiak ka reflektuar atë që Sartori quan *“fenomeni i potencialit për të bërë koalicion dhe për të prodhuar shantazh politik”* rasti i LSI-së në dy zgjedhjet e fundit parlamentare (2009 dhe 2013). Sisteme të ndryshme elektorale kanë prodhuar ekuilibra/qëndrueshmëri politike brenda Parlamentit, ku roli i partive të vogla ka qenë vendimtar, si rasti i zgjedhjeve të viteve 2009 dhe 2013. Ose sistemet zgjedhore të aplikuara kanë prodhuar thjesht numra të partive në Parlament, pa fuqi vendimmarrëse.

Në zgjedhjet e vitit 1991, 1997, 2001 dhe 2013, fituese ka qenë Partia Socialiste, ndërsa në zgjedhjet e vitit 1992, 1996, 2005 dhe 2009 fituese ka qenë Partia Demokratike. Në vitet 1991, 1992, 1996, 1997 dhe 2001, partitë fituese, si PS edhe PD kanë qenë në gjendje ta formojnë vetë qeverinë, pa qenë e domosdoshme për të hyrë në koalicion me parti tjera. Gjithsesi këto parti politike kanë respektuar në zgjedhjet parlamentare që janë zhvilluar, koalicionet parazgjedhore dhe kanë futur në qeveri partitë e vogla edhe se i kishin numrat e nevojshme për të formuar qeverinë. Ndërsa në vitet 2005, 2009 dhe 2013, ka qenë e domosdoshme krijimi i koalicioneve me partitë e vogla, për të krijuar qeverinë e koalicionit qeverisës (LSI). Në sistemet mikse të pavarura, partitë e vogla e kanë të vështirë të fitojnë mandate në pjesën mazhoritare të sistemit sepse nuk kanë elektorat në tërë vendin.

Ndërsa në sistemet mikse të varura, partitë e mëdha me ligj zgjedhor pengohen të marrin mandate shtesë nga proporcionali, nëse numri i mandateve të fituara drejtpërdrejtë është më i madh se numri i mandateve të përfutuara nga proporcionali. Në këto rrethana, partitë e mëdha delegojnë votën e tyre për partitë aleate të vogla, duke rritur në mënyrë artificiale peshën e tyre (fenomeni në vitin 2001-2005, Dushku dhe Mega Dushku). Nga sa diskutuam më sipër, partitë e vogla mund të arrijnë që të përfaqësojnë elektoratin e tyre në Kuvend me një sistem proporcional kombëtar me pragje të ulta dhe jo mazhoritar.

Partitë e vogla kanë interes që të jenë pjesë e koalicioneve të mëdha parazgjedhore që të mund të arrijnë të përfaqësojnë elektoratin e tyre në parlament. Ndësa partitë që nuk janë pjesë e koalicioneve, garojnë në kushte jo të barabarta me partitë e tjera, rasti i LSI-së dhe LZHK-së në zgjedhjet e vitit 2005 dhe 2009. Të dyja subjektet politike në këto zgjedhje parlamentare janë dëmtuar nga delegimi i votës të partive të mëdha drejt partive të vogla, si nga konkurrimi i pabarabartë në zgjedhjet e vitit 2005-së dhe nga përdorimi i formulave elektorale në vitin 2009-të. Këto deformime të rezultatit dhe pasqyrim jo i saktë i votës së sovranit janë pasojë e sistemit elektoral.

Nuk mund të konkludojmë se ekzistojnë sisteme zgjedhor ‘të mirë ose të keq’ sepse të gjitha sistemet zgjedhore janë demokratike. Por, përzgjedhja e sistemit elektoral duhet të prodhojë efekte pozitive për vetë sistemin politik dhe për shoqërinë ku aplikohet. Duhet të përzgjidhet një sistem zgjedhor duke u bazuar në kushtet politike, sociale, kulturore dhe historike të vendit, që sistemi zgjedhor të prodhojë efekte pozitive për vendin ku aplikohet. Si edhe është shumë e dëmshme për një vend ku në çdo zgjedhje parlamentare ndryshon sistemin zgjedhor. Sistemi zgjedhor në vendin tonë është diskutuar më shumë në aspektin e dëmtimeve që i bëhen partive të vogla, si pragu i lartë natyror që vendoset për partitë e reja

që dëshirojnë të futen në garë. Partitë e treta dhe të reja penalizohen nëse nuk duan të jenë pjesë e koalicioneve sepse e kanë të vështirë që të akumulojnë aq shumë vota në një qark të caktuar sa të mund të nxjerrin një deputet.

Sistemi zgjedhor aktual i detyron partitë politike të vogla, që në garën zgjedhore të jenë pjesë e një koalicion të gjërë. Si rrjedhojë, ky sistem krijon qeveri të gjëra të koalicionit, ku subjekte politike për të qeverisur vendin detyrohen të hyjnë në koalicion edhe me një forcë politike të spektrit tjetër politik, për të plotësuar numrat e nevojshme që të krijojnë qeverinë. Dhe sigurisht, këtë e vëmë re edhe në zgjedhjet e zhvilluara në Shqipëri në vitin 2009 dhe 2013, ku u krijuar Qeveria ‘Berisha 2 – Meta’ dhe Qeveria ‘Rama – Meta’. Në rastin e parë, forca e djathtë politike detyrohet që të bashkojë votat me një forcë të majtë, për të krijuar një qeveri koalicioni. Ndërsa rasti i dytë, kemi dy forca politike kundërshtare të së njëjtit spektër politik (spektri i majtë) që të bashkojnë votat për të qeverisur së bashku vendin.

Prania e partive të vogla në përbërjen e kabinetit qeveritar shpjegohet me faktin se për të aprovuar ligje nevojitet një shumicë e cilësuar sepse një shumicë e thjeshtë prej 50+1 nuk është e mjaftueshme. Në zgjedhjet e vitit 1992, 1996 dhe 1997 partitë fituese, fituan më tepër se 3/5 e vendeve në parlament dhe për pasojë nuk kishin nevojë për të krijuar qeveri koalicioni edhe se në kabinetin qeveritar përfshinë partitë e vogla. Partitë e mëdha PD dhe PS, me përfshirjen e partive të vogla në qeveri u përpoqën që të krijonin imazhin e një qeverisjeje gjithëpërfshirëse, në mënyrë që të rrisnin legjitimitetin e tyre politik në mjedisin e brendshëm e të jashtëm, për ndërkombëtarët. Këto parti të vogla nuk mund të kushtëzonin veprimtarinë parlamentare ose qeveritare të PD dhe PS ndër vite, prandaj mund të dalim në konkluzion se *ato parti ishin me të vërtetë jo-relevante për zgjedhjet e cituara më sipër.*

Por nëse do të analizonim dy koalicionet e krijuara në zgjedhjet e viteve 2009 dhe 2013, do të vëmë re se koalicionet në Shqipëri nuk janë shumë të përshtatshme për vendin tonë, duke u bazuar në kushtet politike dhe kulturën demokratike të vendit. Koalicionet qeverisëse në Shqipëri nuk kanë prodhuar stabilitet dhe brenda kabineteve qeverisëse, portofolet ministrore ndahen sikur të jenë pjesë e tortës, nga ku partia më e vogël pretendon pjesët më të mëdha të tortës. Por, në bashkëqeverisje mund të ndodhin ngjarje të rënda (kur ndërmerren reforma të pa studiara) dhe të dëmtuarit mund të jenë vetëm qytetarët, ndërsa partia e vogël qeverisëse distancohet dhe nuk mban përgjegjësi morale për vazhdimin e koalicionit qeverisës.

Në gjykimin tim personal, duke vështuar edhe në historikun e krijimit të kabineteve qeveritare në vendin tonë, mendoj se vetëm një parti politike duhet të ketë mundësinë të qeverisë vendin (rasti i SHBA-së, e cila ka demokraci të konsoliduar prej shekujsh) e vetme, që në këtë mënyrë të mbajë përgjegjësi përpara elektoratit dhe të gjithë shqiptarëve për reformat që ndërmerr përgjatë qeverisjes së saj. Kjo është mëse e domosdoshme, kur vendi ynë ndodhet në fazën e tranzicionit dhe është detyrë e partive politike t'a tejkalojë këtë fazë dhe më në fund të kemi një konsolidim të demokracisë. Ky konkluzion bazohet edhe në kushtet politike, kulturën demokratike të vendit, sigurisht duke analizuar faktorë tjerë, si opozita, media-pushteti i katërt, shoqëria civile, administrata shtetërore sepse vetëm me bashkëveprimin midis tyre mund të kemi progres dhe konsolidim të demokracisë.

Nëse do të bënim një përzgjedhje midis sistemeve elektorale të aplikuara ose jo në Shqipëri, atëherë sistemi aktual zgjedhor proporcional rajonal, por me lista të hapura dhe me korigjim ose sistemin proporcional me prim, do të ishin më të përshtatshëm me kushtet politike të vendit. Historikisht dy forcat kryesore politike ndahen nga fitorja vetëm për një

numër të vogël mandatesh dhe nëse aplikojmë sistemin zgjedhor me prim, forca fituese do të merrte 10 mandate shtesë. Ky sistem do eliminonte mundësinë e krijimit të koalicioneve qeverisëse, që kanë rezultuar të dëmshme për demokracinë e vendit këto vitet e fundit.

Përsa i përket listave të hapura, çdo kandidat për deputet gjatë garës elektorale dhe më pas, do të jetë përballë elektoratit dhe do të kemi një lidhje të fortë deputet-elektorat. Në këtë mënyrë do të ketë një llogari-dhënie dhe përgjegjësie përpara sovranit. Deputetët do të njohin mirë zonën zgjedhore, do të dinë problematikat e zonës dhe do t'a përfaqësojnë elektoratin e tyre më mirë në Kuvend. Gjithashtu, pragu elektoral duhet të jetë i lartë, që në parlament mos kemi shumë parti të vogla politike se nëse vështrojmë prapa në histori, vëmë re se një parti e tretë LSI, ishte deçizive për krijimin e qeverisë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2009 dhe 2013. Demokracisë i bën mirë pluralizmi i ideve, por në rastin e Shqipërisë është vërejtur se nuk i shërben demokracisë dhe vendit tonë me një kulturë politike post-komuniste.

Duhet korigjuar disa gjëra themelore për vendin, por këto problematika shihen tek partitë politike shqiptare. Një problematikë janë formulimi i listave të kandidatëve për deputetë, të cilat nuk duhet të dalin nga zyra e kryetarit të partisë, por duhet të votohen nga anëtarësia e partisë. Gjithashtu, anëtarësia duhet të zgjedhë me votë kabinetin qeveritar (ministrat), kandidatin për President, kandidatin për kryetar Bashkie etj. Në këtë mënyrë nuk do të kemi ndërvarësi të deputetëve ndaj kryetarit të partisë, por një marrëdhënie më të ngushtë me elektoratin që e kanë votuar. Si edhe do të kemi një marrëdhënie kontrolli dhe llogari-dhënie ndaj anëtarësisë së gjërë të partisë. Nënvizoj se nuk duhet të kemi një kryetar partie të plotfuqishëm që të vendosë për gjithçka, por kryetar partie i cili respekton statusin e partisë dhe përfaqëson sa më denjësisht elektoratin e tij në kuvend e në qeverisje.

Zgjedhja e sistemit zgjedhor ka një efekt të rëndësishëm në jetën politike të vendit dhe përzgjedhja e tij është një proces politik me rëndësi të madhe për demokracinë e vendit. Një sistem elektoral nuk mund të garantojë gjithë dimensionet ideale por zgjedhja e sistemit elektoral duhet të reflektojë një kompromis dhe të përfaqësojë në këtë mënyrë, interesat më thelbësore të shoqërisë shqiptare. Si rrjedhojë, çdo vend ndodhet përpara një zgjedhje të vështirë sepse efektet mekanike të çdo sistemi zgjedhor mund të parashikohen, por efektet psikologjike vështirë të parashikohen. Kjo për disa arsye, si të kuadrit institucional, politik, social e kulturor të vendit ku do të aplikohet sistemi zgjedhor. Që sistemi zgjedhor të prodhojë efekte pozitive duhet të përshtatet me vendin ku do aplikohet, si edhe për sistemin politik dhe shoqërinë në tërësi.

Nga rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të zhvilluara pas rënies së komunizmit në vendin tonë, vërejmë se sistemi elektoral ka rëndësi të madhe në konturimin e sistemit partiak edhe në formën e qeverisjes së vendit. Dhe dalim në përfundim, se në zgjedhjet e zhvilluara në Shqipëri pas vitit 1990-të, vërtetohet teoria e aplikuar në këtë dizertacion. Nëse analizojmë formulat zgjedhore të aplikuara ndër vite në vendin tonë, do të kuptojmë formën e qeverisjes dhe formimin e kabineteve qeverisëse. Po të analizojmë zgjedhjet e parakohshme të vitit 1992, qëllimi i formulës elektorale ishte forcimi i dimensionit mazhoritar të sistemit, eliminimi i korrigjimit që bënte pjesa e proporcionalit, si edhe rritjen e pragut elektoral për partitë e vogla, për të mos pasur përfaqësim të tyre në Kuvend.

Ndërsa në zgjedhjet e vitit 1997-të, sistemi elektoral miks, mazhoritarit me dy raunde dhe proporcional jo korrigjues, ka konturuar sistem multipartiak me një parti dominuese. Si rrjedhojë, kemi zbutje të tendencës mazhoritare që karakterizonin zgjedhjet e vitit 1996-të, si edhe partitë e vogla përfitojnë nga pjesa proporcionale, duke zbritur në këtë

mënyrë prapun elektoral. Në zgjedhjet e vitit 2001 sistemi elektoral i përdorur ishte miks i varur, ku në pjesën mazhoritare kemi dy raunde, ndërsa pjesa proporcionale ka karakter kombëtar. Për këtë arsye, Shqipëria në vitin 2001 njeht një sistem multipartiak të moderuar me dy parti dominuese. Qëllimi i këtij sistemi zgjedhor ka qenë dobësimi i partive të vogla, ku në proporcional të mos merrnin asnjë mandat parlamentar.

Sistemi elektoral i zgjedhjeve parlamentare të vitit 2005-së ishte sërish miks i varur, ku në pjesën mazhoritare u përdor formula e Shumicës Minimale, ndërsa pjesa tjetër e sistemit mbeti po e njëjtë. Në nenin 66-të, specifikohet se fiton ai kandidat që në zonën njëemërore ka numrin më të madh të votave të vlefshme. Pragu natyror mbeti po i njëjtë me zgjedhjet e mëparshme, pragu natyror për partitë 2.5% dhe për koalicionet 4%. Në këto zgjedhje, partitë e vogla jashtë një koalicioni janë të dëmtuara sepse ato nuk kanë elektorat të shtrirë në tërë territorin e vendit.

Ndërsa me ndryshimet kushtetuese të vitit 2008-të, në zgjedhjet që pasuan, zgjedhjet parlamentare të vitit 2009-të kemi një sistem elektoral proporcional me lista të mbyllura. Ky sistemin ishte ideuar që të jepte një rezultat të ngushtë midis dy forcave të mëdha politike se Kodi Zgjedhor favorizonte koalicionet e mëdha dhe dobësonte partitë e vogla politike. Gjithashtu, rritet figura e udhëheqëse të partive të mëdha, përmes kalimit në lista të mbyllura dhe rritet rëndësia e programeve politike të subjekteve politike. Si rrjedhojë, kemi reduktimin e partive parlamentare nga 12 në vitin 2005-së, në 6 parti në vitin 2009-të. Ky sistem elektoral rriti peshën e partive të mëdha dhe uli ndjeshëm peshën e partive të vogla, duke i penalizuar duke qenë jashtë një koalicioni partiak.

Edhe në zgjedhjet parlamentare të vitit 2013-të, kemi një sistem elektoral proporcional rajonal me lista të mbyllura, që konturoi një sistem dypartiak e gjysëm.

Vërehet rëndësia e një partie të tretë, LSI, e cila në këto zgjedhje fitoi 4-fishin e numrit të mandateve të legjislaturës së vitit 2009-2013. Ky sistem elektoral i jep mundësi partive për të marrë mandate në bazë të përqindjes së votave të marra në mbarë vendin. Edhe në zgjedhjet e vitit 2013-të, sistemi i shumicës çoi në krijimin e sistemit shumëpartiak.

Në këtë punim kemi përdorur teorinë e Arend Lijphart “*Ndikimi i sistemit elektoral në formën qeverisëse*”, e cila është pohuar në tërë zgjedhjet e përgjithshme të zhvilluara gjatë viteve 1991-2013. Dalim në përfundim, se një sistem elektoral ndikon në formën e qeverisjes së vendit dhe në formimin e kabineteve qeverisëse. Arend Lijphart ka përcaktuar gjashtë teori të kabineteve qeverisëse dhe në bazë të analizave të rezultateve finale të zgjedhjeve parlamentare të mbajtura në Shqipëri pas vitit 1990-të deri në zgjedhjet e fundit të vitit 2013-të, **në këtë punim voluminoz kemi kontribur duke përcaktuar formën e kabineteve qeverisëse sipas teorisë së Arend Lijphart.**

Lijphart ka përdorur gjashtë teori të koalicionit për të parashikuar rezultatet zgjedhore dhe formën e kabinetit qeverisës që formohet, duke u nisur nga sistemi zgjedhor që aplikohet dhe nga partitë që fitojnë mandate parlamentare. Gjashtë teoritë e koalicionit janë: 1.Koalicion minimal i fituar; 2.Koalicionet me madhësi minimale; 3.Koalicionet me numrin më të vogël të partive; 4.Koalicionet me varg minimal; 5.Koalicionet minimale fituese; 6.Koalicionet politike-praktike.

Gjithashtu, ai ka specifikuar se nëse vetëm një parti politike fiton numrin më të madh të mandateve, atëherë formohet një kabinet njëpartiak. Në sistemet parlamentare të qeverisjes, kabinetet duhet të formohen në mënyrë që të gëzojnë besimin ose të tolerohet nga një shumicë parlamentare. Kemi dy forma të kabineteve njëpartiake, kabinete të cilat kanë shumicën e nevojshme për të ndërmarrë reforma të mëdha dhe kabinete të cilat u

duhet të hyjnë në bisedime me opozitën, për të pasur aprovimin e tyre për miratimin e reformave të mëdha me rëndësi për vendin.

Atëherë dalim në konkluzion se **në zgjedhjet e para pluraliste** të mbajtura në Shqipëri vetëm një parti politike ka fituar numrin më të madh të mandateve dhe kemi formimin e një **kabineti njëpartiak**. Prej 250 zona elektorale njëemërore, PPSH mori 169 mandate, më shumë se 2/3 e mandateve dhe si rrjedhojë kemi një mazhorancë, e cila ka numrat e duhura për të qeverisur vendin e vetme. Nuk kemi krijimin e një koalicioni qeverisës sepse me mandatet e fituara, kabineti njëpartiak kishte numrat e nevojshme për miratimin e ligjeve të rëndësishme.

Ndërsa **në vitin 1992** u mbajtën **zgjedhjet e para të parakohshme** nën drejtimin e një Qeverie Teknike. Sipas gjashtë teorive të koalicioneve të Lijphart, kemi krijimin e teorisë së pestë, **koalicion minimal fitues**: CDE=100. Koalicionet formohen nga parti që janë të "lidhur", janë ngjitur në politikë dhe pa partnerë të panevojshme. Palët do të përpiqen për tu rritur së bashku me fqinjët e tyre të menjëhershëm, deri në formimin e një koalicioni të shumicës. PD ka fituar 92 mandate, një mandat më pak se shumica e nevojshme prej 2/3 që nevojiten për ndryshime kushtetuese. PD respektoi koalicionin parazgjedhor e në përbërjen e kabinetit më të ri u përfshinë PR (1 mandat) dhe PSD (7 mandate). Në këto zgjedhje u bë *rotacioni i parë politik*, ku kemi ndryshimin defacto të sistemit politik. Kuvendi funksionojë rregullisht në mandatin katër vjeçar, por nuk arriti të miratojë Kushtetutën e Shqipërisë.

Duke u bazuar në rezultatet e **zgjedhjeve të vitit 1996-të**, PD ka arritur të marrë 122 mandate parlamentare, numër ky që i mundësonte kësaj partie shumicën parlamentare dhe kemi krijimin e një **kabineti njëpartiak**. PD e vetme ka arritur të marrë mbi 4/5 e

mandateve parlamentare (112+10=122) ose mbi 80 % të mandateve parlamentare. Nga ky rezultat përmbytës për PS-në, filluan trazirat dhe pas një viti u mbajtën zgjedhjet e dyta të parakohshme për një periudhë shumë të shkurtër për Shqipërinë.

Analizimi i **zgjedhjeve të dyta të parakohshme të vitit 1997-të** sipas teorive të koalicionit të Lijphart, Nano formoi një kabinet me qeverisje të gjërë nga 22 portofole ministrore, emëroi vetëm 13 përfaqësues nga partia e tij. Në 9 portofole ministrore emëroi përfaqësues nga PSD, PA, AD dhe PDNJ. Si rrjedhojë kemi 116 mandate nga koalicioni i gjërë qeverisës edhe se PS kishte mandatet e nevojshme për të formuar një qeveri e vetme, përfshiu në bashkëqeverisje katër parti politike. Kemi një *koalicion të gjërë i formuar nga parti të një spektri politik, të së majtës qendrore dhe përfshin në total pesë parti politike, me katër hapësira*. Edhe në këto zgjedhje kemi krijimin e një **koalicioni minimal fitues**.

Edhe në zhvillimin e **zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2001**, përsëri kemi krijimin e një **koalicioni minimal fitues**, ku kabineti qeveritar përbëhet nga aleatët e së majtës edhe se PS mund të krijonte vetë qeverinë e saj. Si rrjedhojë, PS (73 mandate) bashkë me aleatët, arritën të merrnin në total (spektri i majtë) 86 mandate parlamentare (PSD, PBDNJ, PA dhe PAD arritën të fitonin 13 mandate parlamentare): ABCDE=86. Duke bashkuar mandatet së bashkë, *spektri i majtë kishte 86 në total, më shumë se 3/5 e shumicës parlamentare, vota të nevojshme për të zgjedhur Presidentin e ri të Shqipërisë*. Por duke u bazuar në luftën e brendshme brenda PS-së (Nano-Meta), bashkimi i mandateve nuk ishte përcaktues për zgjedhjen e presidentit.

Ndërsa në zgjedhjet e gjashta të zhvilluara në vendin tonë, në bazë të analizimit të teorive të koalicioneve të Lijphart, në **zgjedhjet e vitit 2005** kemi krijimin e **koalicionit minimal fituese, teoria e pestë**. PD ka krijuar kabinetin e saj qeveritar duke përfshirë

aleatët e saj të koalicionit parazgjedhor (PD+PAA+PDK+PR+PBDNJ=75 mandate). Por gjatë qeverisjes kemi disa lëvizje të ministrave, përfshirje ose heqje të disa aleatëve në qeverisjen e vendin.

Në zhvillimin e **zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2009-të**, kemi krijimin e **koalicionit politikë-praktike** (FEDC=74) i radhitur *i gjashti* nga teoritë e Arend Lijphart. Në qoftë se ne supozojmë se partitë me të vërtetë kujdesen vetëm në lidhje me politikën, në vend të mbajtjes së detyrës, pushteti i vërtetë është te legjislatura, ku politikat e mëdha duhen miratuar, në vend se në kabinetin qeveritar. Në legjislaturë është "thelbësore" partia që është me rëndësi të madhe, ku partia kryesore në një shkallë politike dimensionale, si shkallë e majtë-djathtë, përmban anëtar mesatare të parlamentit. Dhe në kushtet strikte të politikës, kjo është krejtësisht e parëndësishme se sa dhe cilat parti do të marrin pjesë në kabinetin qeveritar. Në këtë koalicion rëndësi ka *arritja e numrit të nevojshëm për të krijuar një qeveri* që të qeverisë vendin për katër vjeçarin e legjislaturës 2009-2013. PD nuk kishte numrin e mandateve që të qeverisë e vetme dhe bashkë me katër mandatet e Lëvizjes Socialiste për Integrim, parti e spektrit të majtë formoi qeverinë e saj.

Edhe në **zgjedhjet e fundit të mbajtura në Shqipëri në vitin 2013-të** kemi krijimin e **koalicionit politikë-praktike** (ABCD=84). Në këto zgjedhje *spektri i majtë hyjnë bashkë kundra spektrit të djathtë*. Dhe koalicioni fitues "Aleanca për Shqipërinë Evropiane" ka 83 mandate (PSSH 66 mandate, LSI 16 mandate), ndërsa koalicioni "Aleanca për Punësim, Mirëqenie dhe Integrim" ka 57 mandate (PD 49 mandate). Forcat politike që bashkëqeverisin vendin janë të së njëjtës krah politik, spektrit të majtë. Qeverisja funksionon mbi bazën e qeverisjes së gjërë partiake dhe mbi bazën e konsensusit. Të dyja forcat politike i kanë ndarë portofolet ministrore për nga numri dhe rëndësia e tyre

politike. Por theksohet rëndësia e LSI-së në dy zgjedhjet e fundit të zhvilluara në Shqipëri, të vitit 2009-të dhe 2013-të dhe LSI ka fituar një rëndësi të madhe si partia e parë e vogël.

Si përfundim, mund të konkludojmë se **në Shqipëri e pas vitit 1990-të pohohet/konfirmohet teoria e Arend Lijphart “Ndikimi i sistemit elektoral në formën qeverisëse”, në zgjedhjet e mbajtur gjatë pluralizmit shqiptar.** Në zgjedhjet e para pluraliste të mbajtura në vitin 1991 dhe në zgjedhjet e vitit 1996-të, në vendin tonë një parti politike e vetme ka krijuar kabinetin qeverisës, pra është krijuar kabinet një partiak. Si rrjedhojë, duke u bazuar në këto rezultate vendi ynë pas zhvillimit të këtyre zgjedhjeve ka hyrë në krizë dhe nën qeverisje teknike janë zhvilluar dy zgjedhje të parakohshme. Përkatësisht, në vitin 1992 janë zhvilluar zgjedhjet e para të parakohshme dhe në vitin 1997-të, janë zhvilluar zgjedhjet e dyta të parakohshme. Këto zgjedhje janë zhvilluar pas një intervali një vjeçar të zgjedhjeve parlamentare të vitit 1991 dhe 1996 dhe janë krijuar kabinete të koalicioneve minimale fituese. Specifikojmë se përcaktimi i gjashtë teorive të Lijphart, ka të bëjë me gjerësinë e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të popullit në degën ekzekutive të qeverisë.

Edhe në zgjedhjet e vitit 2001 dhe 2005 janë krijuar kabinete të koalicioneve minimale fituese, pra teoria e pestë e radhitur nga Lijphart. Kjo vjen si rezultat i sistemit zgjedhor të aplikuar në këto zgjedhje të përgjithshme dhe që ka sjellë më pas formimin e këtij lloji kabineti. Më konkretisht, vendi ynë nga zgjedhjet e vitit 1992 deri në zgjedhjet e vitit 2005-së, me përjashtim të zgjedhjeve të dyta të parakohshme të vitit 1996-të, ka njohur këtë lloj kabineti. Kemi kabinete qeveritare, ku forcat politike më të mëdha (PD-PS) kanë përfshirë në qeverisje parti aleate nga i njëjti spektër politik për të arritur shumicën e

cilësuar për zgjedhjen e Presidentit, ndryshime kushtetuese dhe miratime të ligjeve me rëndësi për vendin tonë.

Më konkretisht, koalicionet minimale fituese formohen nga të dyja partitë që janë të "lidhur", pra ky koalicion është i përbërë nga partitë që janë ngjitur në politikë dhe pa partnerë të panevojshëm. Supozimi themelor i kësaj teorie është se partitë do të përpiqen të rriten së bashku me fqinjët e tyre dhe se partitë fqinje do të shtohet deri sa të formohet një koalicion shumice. Sipas teorisë së fundit, koalicioni CDE përmban një partner të tepërt, partinë-D, por në teorinë e Axelrod-së, D është e nevojshme për të bërë koalicion të lidhur.

Ndërsa në zgjedhjet e vitit 2009 dhe 2013 kemi një ndryshim të sistemit zgjedhor, sistem proporcional rajonal me lista të mbyllura dhe si rrjedhojë në skenën politike ka dalë edhe një parti e vogël, e cila është rritur nga zgjedhjet e vitit 2005 (4 mandate) dhe në vitin 2009 (16 mandate). Në Shqipëri *sistemi partiak nuk është i fragmentizuar dhe dukshëm është i dominuar nga dy parti kryesore (PD-PS), ndërsa partitë e vogla relevante kanë ndryshuar me rritjen e LSI-së*. Vërehet, se sistem elektorale rajonale me lista të mbyllura po thekson rëndësinë e saj, e cila po fiton një numër mandatesh nga zgjedhjet në zgjedhje dhe bashkimi me të po bëhet e domosdoshme për krijimin e qeverisë (pavarësisht PD dhe PS).

Si rrjedhojë në zgjedhjet e vitit 2009 dhe 2013, sistemi elektorale ka formuar një kabinet qeverisës, koalicionet politike-praktike, teoria e gjashtë e radhitur nga Lijphart. Dhe pushteti i vërtetë është te legjislatura, ku politikave të mëdha duhen miratuar, në vend se në kabinetin qeveritar, kjo teori është ideuar nga Laver dhe Schofield. Laver e Schofield (1990, 55) theksojnë se duhet bërë një dallim mes pyetjeve të politikave të mëdha e çështjeve më të hollësishme të politikës. Për të ndikuar në çështjet e hollësishme, mund të jetë me rëndësi që të jenë në kabinet dhe në krye të një departamenti ministror, kjo

konsideratë "mund të ofrojë një nxitje të fortë për partitë që nuk janë të interesuara aspak për shpërblimet e brendshme të zyrës megjithatë për një vend në tryezën e kabinetit".

Tabela nr. 45: Zgjedhjet e zhvilluara në vendin tonë pas vitit 1990-të, sistemi elektoral i aplikuar, konturimi i sistemit partiak dhe forma e qeverisjes (kabineti i formuar).

Zgjedhjet Parlamentare pas viteve 1990-të	Sistemi elektoral i aplikuar ndër vite	Sistemi partiak	Kabineti qeverisës
Zgjedhjet e vitit 1991	Sistem elektoral mazhoritar	Sistem Dy-partiak	Kabinet i shumicës njëpartiake
Zgjedhjet e vitit 1992	Sistem elektoral miks, i mazhoritarit me dy raunde me proporcional korrigjues	Sistem Dy-partiak	Kabinet mbi bazën e koalicionit minimale fituese
Zgjedhjet e vitit 1996	Sistem elektoral miks, i mazhoritarit me dy raunde me proporcional jo korrigjues	Sistem Dy-partiak	Kabineti shumicës njëpartiake
Zgjedhjet e vitit 1997	Sistem elektoral miks, i mazhoritarit me dy raunde me proporcional jo korrigjues	Sistem Multi partiak me një parti dominuese	Kabinet mbi bazën e koalicionit minimale fituese
Zgjedhjet e vitit 2001	Sistem elektoral mazhoritar me dy raunde, duke rimarrë aspektin korrigjues të proporcionalitetit	Sistem Multi-partiak me dy parti dominuse	Kabinet mbi bazën e koalicionit minimale fituese
Zgjedhjet e vitit 2005	Sistem elektoral mazhoritar vetëm me një raund	Sistem Multi-partiak me dy parti dominuse	Kabinet mbi bazën e koalicionit minimale fituese
Zgjedhjet e vitit 2009	Sistem elektoral proporcional rajonal me lista të mbyllura	Sistem Dy partiak	Kabinet mbi bazën e koalicionit politike-praktike
Zgjedhjet e vitit 2013	Sistem elektoral proporcional rajonal me lista të mbyllura	Sistem Dy parti e gjysëm	Kabinet mbi bazën e koalicionit politike-praktike

Variablat themelore që karakterizojnë dallimin midis formave të shumicës dhe konsensusit të demokracisë, ka të bëjë me gjerësinë e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të popullit në degën ekzekutive të qeverisë. Ky variabël konsiderohet si variabli më tipik midis mazhoritar-konsensusit, ku kemi një dallim midis të qeverisurve me shumicë një-partiake dhe koalicioneve të gjëra shumëpartiake. Mishërojnë kontrastin midis parimit të shumicës, përqëndrim i pushtetit në duart e shumicës dhe parimit të konsensusit në ndarjen e pushtetit.

Kabinetet e shumicës një-partiake dhe koalicionet e gjëra shumëpartiake ndryshojnë nga njëri-tjetri sepse kabineti është i përbërë nga një parti (zgjedhjet e vitit 1991 dhe 1996 në vendin tonë) ose nga një koalicion partish (zgjedhjet e vitit 1992, 1997-2009 në vendin tonë) dhe llojit i mbështetjes parlamentare që kabineti ka. Përsa i përket bazës së mbështetjes, Lijphart është përqëndruar në klasifikimin e standartit të trefishtë në teori të koalicionit midis:

1-*Kabinete minimale të fituar*, të cilat janë "fituese" në kuptimin se partia ose partitë në kabinet kontrollojnë shumicën e vendeve në parlament. Por "minimale" në kuptimin se kabineti nuk përfshin asnjë parti që nuk është e nevojshme për të arritur një shumicë parlamentare (Rasti i formimit të kabineteve të dala nga *zgjedhjet e vitit 1992, 1997, 2001 dhe 2005*). 2-*Kabinete të tepërta*, të cilat përmbajnë më shumë parti se sa janë të nevojshme për mbështetjen e shumicës në legjislaturë, parlamentare (Rasti i formimit të kabineteve të dala nga *zgjedhjet e vitit 2005 dhe 2009*) dhe 3-*Minoritete ose kabinet "i vogël"*, të cilat nuk janë të mbështetura nga një shumicë parlamentare (Rasti i formimit të kabineteve të dala nga *zgjedhjet e vitit 1991 dhe 1996*).

Me anë të këtij punimi nënvizojmë se ekziston një lidhje e fortë midis sistemeve zgjedhore dhe sistemeve partiake. Ku një ligj proporcional zgjedhor i cili ndan mandatet parlamentare në bazë të përqindjes së votave të fituara, favorizon krijimin e sistemeve multi-partiake dhe një ligj shumice (mazhoritar) favorizon krijimin e një sistemi dypartiak. *Marrëdhëniet mes sistemeve zgjedhore dhe partive politike ndikojnë gjithashtu në krijimin e koalicioneve dhe në qëndrimet e vetë partive politike.* Gjithashtu, vërtetohet edhe lidhja midis sistemit elektoral dhe formës së qeverisjes (sistemit politik) të një vendi, ku kemi përdorur teorinë e Arend Lijphart *Ndikimi i sistemit elektoral në formën e qeverisjes.*

Dhe me anë të këtij punimi voluminoz disa vjeçar, duke përdorur literaturën përkatëse dhe teorinë e përdorur në këtë dizertacion, është argumentuar dhe konfirmuar empirikisht teza qendrore e studimit, **ndikimi i sistemit elektoral në formën qeverisëse të vendit**. Sistemi elektoral i aplikuar ndikon në konturimin e sistemit partiak, por gjithashtu në punim theksohet se sistemi partiak ndikon në formën e qeverisëse të vendit, dhe kjo mbrohet nga *teoria e përdorur të Arend Lijphart ‘Ndikimi i sistemit elektoral në formën e qeverisjes’*.

Në këtë punim doktoral arrijmë që të vërtetojmë këtë lidhje shkakësie dhe ndikimi midis tyre. Gjithashtu, një kontribut shumë i madh i këtij punimi është analizimi dhe përcaktimi i kabineteve qverisëse të formuara në Shqipëri pas viteve 1990-të sipas gjashtë teorive të formimit të kabineteve qeverisëse.

Këtë punim shkencor po e mbyllim me thënien e Montesque, “*Për të mos mundur të abuzohet me pushtetin, duhet që me anë të rregullimeve përkatëse, pushteti të ndalojë pushtetin*”. Nëpërmjet kësaj thënie nënkuptojmë, se shteti në radhë të parë duhet t’i nënshtrohet ligjit dhe vetë pushteti të kufizohet nga kushtetuta e tij. Dhe duke e përshtatur thënien me këtë punim shkencor, nënvizojmë rëndësinë e sistemit zgjedhor në qeverisjen e vendit. Lidërt partiak përpara se të miratojnë një Ligj zgjedhor duhet të analizojnë situatën politike dhe kushtet kulturore, sociale e historike të vendit. Dhe qëllimi i aplikimit të një sistemi zgjedhor, nuk duhet të jetë ardhja e partisë së tyre në pushtet, por arritja e një faze tjetër të demokracisë, konsolidimi i saj.

SHËNIME

Këtu përfshihet i gjithë materiali shtesë që nuk është integruar në tekst, kryesisht për arsye të kufizimeve në numrin e fjalëve.

SHTOJCA 1

Intervista e zhvilluar me Kastriot Ismailin në datën 3 shtator të vitit 2015.

1- Në vitet 1991-1992, ju Z. Islami keni qenë në pozicionin e Kryetarit të Parlamentit. Si mund t'i vlerësoni këto vite të 'transformimit të madh' të Shqipërisë, duke përfshirë këtu zgjedhjet e para pluraliste demokratike, si edhe miratimit të ligjit elektoral të vitit 1991. Ku në këtë periudhë, përpara deputetëve të zgjedhur të atij legjislacioni, qëndronte një problem i madh juridik dhe politik, i cili ishte abrogimi i Kushtetutës së vitit 1976-të, si edhe miratimi i Kushtetutës së re, që do të hidhte bazat e demokracisë në Shqipëri.

Shqipëria e filloi tranzicionin demokratik në fund të vitit 1990-të, një vit më vonë se vendet e tjera ish-komuniste. Zgjedhjet e para pluraliste të vitit 1991 nuk realizuan “largimin” e PPSH nga pushteti, gjë që u arrit vetëm në zgjedhjet e 22 marsit 1992, pra një vit më vonë. Sistemi zgjedhor në 1991 ishte mazhoritar, tashmë i vendosur nga Kuvendi monist dhe ndihmoi kandidatët e opozitës, PD në zonat urbane e sidomos në qytetet kryesore të fitonin përballë kandidatëve të PPSH ndërkohë që në zonat rurale, ku ende opozita ende nuk kishte penetruar dhe nuk kishte ende ndikimin e duhur, kandidatët e PPSH dolën fitues.

Gjatë periudhës 1991-1992 u miratuan Dispozitat Kryesore Kushtetuese pasi u shfuqizua Kushtetuta që ishte miratuar në 1974, një dokument i bazuar në parimet e një sistemi monist apo një partiak, në formën e diktaturës së proletariatit, parti-shtet, me ekonomi të centralizuar, ku vendin e të drejtave të njeriut e zinte lufta e klasave. Me miratimin e Dispozitave Kushtetuese në vitin 1991, i hapej rruga në një të ardhme të afërt hartimit dhe miratimit të një Kushtetute bazuar në parimet e i) pluralizimit politik, ii)

ekonomisë së tregut, iii) respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut. Dispozitat Kushtetuese i hapën rrugën institucionalizimit të pluralizimit politik apo krijimit të institucioneve demokratike, vendosjes së ekonomisë së tregut dhe respektimit të lirive themelore dhe të drejtave të njeriut sipas standarteve demokratike perëndimore. Në qershor të 1991 PPSH ndërroi emrin në PSSH duke filluar njëkohësisht transformimin nga një parti komuniste në një parti social-demokrate, një proces kompleks dhe i vështirë distancimi nga e kaluara dhe përqafimi të parimeve të partive demokratike të majta.

Nën presionin e opozitës demokratike, angazhimit të partnerëve ndërkombëtarë për kryerjen e tranzicionit demokratik, dhe të ndërgjegjësimit të vetë PSSH, u krye me konsensus të gjërë abrogimi i Kushtetutës së vitit 1974 dhe miratimi i Dispozitave Kryesore Kushtetuese. Kushtetuta i hapi rrugën ndërtimit të institucioneve kryesore kushtetuese sipas parimeve demokratike. Gjatë kësaj periudhe, që po përgatiteshin zgjedhjet e vitit 1992, u ndryshua edhe sistemi zgjedhor, nga një sistem mazhoritar në një sistem proporcional të personalizuar, të ngjashëm me sistemin gjerman, por me numër total të deputetëve që përcaktohej nga rezultati i zgjedhjeve, ndërkohë edhe numri i deputetëve u reduktua.

2-Në periudhën e gjatë të tranzicionit, Shqipëria ka njohur disa ndryshime në ligjin elektoral, nga sistemi mazhoritar me dy raunde në zgjedhjet e vitit 1991, në sistem miks të varur dhe të pavarur, në sistem proporcional të personalizuar, si edhe në sistem proporcional rajonal me lista të mbyllura. Si i vlerësoni këto ndryshime të ligjit elektoral, që kanë ndodhur në një periudhë kaq të shkurtër kohore, si edhe si kanë ndikuar këto ndryshime në stabilitetin e vendit?

Një nga parimet bazë për hartimin dhe miratimin e sistemit elektoral është qëndrueshmëria, pra nuk rekomandohet që sistemi elektoral të ndryshojë shpesh apo me frekuencë të lartë, madje shumë vende me demokraci të konsoliduar e ruajnë sistemin elektoral për një kohë shumë të gjatë. Për shkak të dinamikës së shpejtë të transformimit politik dhe mungesës së eksperiencës e kulturës demokratike, duhet pranuar se Shqipëria ka “vuajtur” nga ndryshimi i shpejtë dhe jo vizionar i sistemit zgjedhor. Beteja e ashpër apo konflikti politik ka ndikuar gjithashtu në frekuencën e lartë të ndryshimit të sistemit zgjedhor. Gjithashtu në disa raste është gjykuar se ndryshimi i sistemit zgjedhor do të ndikonte në cilësinë e zgjedhjeve, gjë që praktika nuk e ka provuar.

Interesat e çastit politike të grupimeve më të fuqishme politike, kanë luajtur po ashtu rol në ndryshimet e shpejta të sistemit të zgjedhor. Në disa raste ndryshimi i sistemit zgjedhor ka ardhur edhe si nevojë për të “shmangur”, korrigjuar apo eliminuar dukuri politike që janë konsideruar “negative” me ndikim në përfaqësimin politik, stabilitetin e qeverisjes, cilësinë e kuvendit, e tjerë. Gjykoj se në Shqipëri gjatë këtyre 25 vjetëve stabiliteti politik dhe cilësia e zgjedhjeve kanë qenë invariante nga sistemi zgjedhor, i cili ka pasur rol modest në konfigurimin politik të kuvendit dhe nëpërcaktimin e cilësisë së tij.

3-Z. Kastriot, si i vlerësoni ju ndryshimet kushtetuese të vitit 2008-të?

Ndryshimet Kushtetuese të vitit 2008 janë tri: 1) ndryshimi i sistemit zgjedhor, 2) ndryshimi i mënyrës së zgjedhjes së Presidentit dhe 3) vendosja e Mocionit të Besimit dhe të Mosbesimit konstruktiv për Qeverinë. Në kushtet e miratimit të një sistemi zgjedhor proporcional rajonal, miratimi i ndryshimeve kushtetuese ka qenë një domodoshmëri dhe

mund të thuhet se ato kanë qënë opsione të arsyeshme, me avantazhet dhe dizavantazhet që shoqërojnë çdo ndryshim kushtetues.

Këto ndryshime gjënden në Kushtetutat e pothuajse të gjithë atyre vëndeve që kanë sistem zgjedhor proporcional (Gjermani, Spanjë...). Këto janë ndryshimet Kushtetuese që janë miratuar me konsensusin më të madh politik në 25 vjet dhe me votën e të gjithë deputetëve të dy forcave kryesore politike. Ndërkohë ka pasur kritika nga një numër shumë i vogël deputetësh të partive të vogla kurse kritika të arsyeshme kanë qënë ato që kërkonin një proces më gjithpërfshirës përse i përket diskutimit dhe debatimit të këtyre ndryshimeve, si dhe të një pjesëmarrje më të lartë ekspertëve konstitucionalistë.

4- Në hartimin e listave me kandidaturat për deputet, çfarë mendoni se duhet të kenë parasysh liderët e partive politike? Mendoni se me ndryshimet e fundit në Kushtetutë, ku është aplikuar sistemi zgjedhor proporcional rajonal me lista të mbyllura, “sindromi” i servilizmit mund të ketë përfshirë Kuvendin Shqiptar?

Një nga problemet themelore të sistemit politik në Shqipëri është demokratizimi i partive politike. Më konkretisht zhvillimi i demokracisë së brëndshme, respektimi i kriterit të meritës e promovimit sipas vlerave, kapaciteteve e kontributeve dhe përzgjedhja transparente e kandidaturave partiake për deputetë, kryetar bashkie e tjerë. Transparenca e vendimarrjeve partiake dhe funksionaliteti i forumeve partiake mbetet ende larg standarteve demokratike. Përzgjedhja e kandidaturave për institucionet e zgjedhura apo të emëruara vuan nga subjektivizimi dhe është pothuajse tërësisht në duart e drejtuesit të partisë. Në disa parti, kryesisht në PS, kohët e fundit është ndeshur edhe një “dukuri e rrezikshme” për sistemin politik, që lidhet me afrimin e paramenduar dhe programuar të individëve me

rekorde kriminale, “të fortëve”, të individëve “biznesmenë” të pasuruar në mënyrë të dyshimtë përmes lidhjeve të pashëndetshme me zyrtarë të lartë apo politikanë ose përmes sigurimit të dyshimtë të lejeve të ndryshme (ndërtimi, koncensione, ...), apo përfitimit korruptiv të fondeve publike. Sistemi proporcional rajonal synoi ndër të tjera të shmangte një tendencë të re që filloi të bëhej shqetësuese në periudhën 1997-2005, futjes së ‘të fortëve’ dhe “individëve me pasuri të dyshimta”, por nuk ja arriti dot qëllimit plotësisht sepse disa parti, kryesisht PS, keqpërdori “listën e mbyllur” për të futur në parlament individë me rekorde kriminale apo oligarkë nga biznesi e media apo “të fortë”.

Kjo tendencë e re e cila paraqitet nga disa si defekt i sistemit proporcional rajonal e kryesisht për shkak të aplikimit të listave të mbyllura. Në realitet “kriminalizimi i kuvendit” nuk do të mund të shpjegohet dot vetëm me sistemin elektoral proporcional për zgjedhjen e deputetëve sepse e njëjta dukuri (kriminalizimi i kryetarëve të bashkive) vihet re edhe në rastin e përzgjedhjes së kandidatëve për kryetar të bashkive që zgjidhen me sistem mazhoritar. E thënë më shkurt, nëse një parti nuk ka demokraci të brëndshme, forumet partiake shpërfillen në përzgjedhjen e kandidaturave dhe përcaktimin e bën realisht kryetari i partisë, atëherë ky sindrom nuk mund të zgjidhet përmes sistemit zgjedhor, ndërkohë që praktika në Shqipëri po tregon se kjo dukuri është prezente si me deputetet ashtu edhe me kryetarët e bashkive, pra edhe kur aplikohet sistemi zgjedhor proporcional me lista të mbyllura ashtu edhe kur aplikohet sistemi zgjedhor mazhoritar.

5- Në këto 25-së vitet e fundit të pluralizmit shqiptar, gjatë zhvillimit të zgjedhjeve elektorale në realitetin shqiptar është krijuar kultura e kontestimit të rezultatit zgjedhor

nga humbësit e zgjedhjeve. Sipas mendimit tuaj, cilat mund të jenë arsyet e këtyre kontestimeve nga ana e kundërshtarëve politikë?

Ka ndër të tjera edhe këto tre arsye: 1) mungesë tradite demokratike, 2) kulturë demokratike e pamjaftueshme dhe 3) mungesë e vullnetit politik të forcave politike për zgjedhje të lira e të ndershme në përputhje me standartet demokratike. Këto shpjegojnë edhe pasojën tjetër që beteja zgjedhore mes forcave politike perceptohet si ‘luftë për jetë a vdekje’ ku njëra forcë fiton gjithçka dhe tjetra humbet gjithçka. Në themel të kësaj “luftë” politike qëndron fitimi i gjithçkaje për t’u pasuruar në mënyrë të paligjshme, pra korrupsioni.

6- *Sipas mendimit tuaj, duke u nisur edhe nga eksperiencia e gjatë në politikën shqiptare, si një aktor politik me një peshë dhe influencë të madhe, cili sistem elektorale është më i përshtatshmi për vendin tonë, duke pasur parasysh edhe situatën politike të vendit, kulturën politike dhe mungesën e theksuar të kulturës demokratike?*

Nuk mund të kem mendim ndryshe nga ai që kam mishëruar në dezinximin dhe miratimin e sistemit zgjedhor të aplikuar në zgjedhjet e vitit 2009-të, pra sistemi zgjedhor proporcional, me 12 zona zgjedhore, me lista zgjedhore të mbyllura. Si çdo sistem tjetër edhe sistemi proporcional rajonal ka disa avantazhe dhe disa dizavantazhe. Ky është një sistem që nuk i “shëron” të gjithë sëmundjet prezente në sjelljet politike por edhe sociale, elektorale e njerzore shqiptare, por gjykoj se ky është një sistem që për këtë periudhë vazhdoj është më “i mirëpërshtatshmi” me traditat demokratike, me kulturën demokratike, me nivelin arsimor dhe me objektivat afatmesme integruese të vendit.

SHTOJCA 2

Intervista e zhvilluar me Ilir Rusmalin në datën 10 shtator të vitit 2015.

1- Z. Rusmali, si mund t'i vlerësoni vitet 1991-1992, këto vite të 'transformimit të madh' të Shqipërisë, duke përfshirë këtu zgjedhjet e para pluraliste demokratike, si edhe miratimit të ligjit elektorat të vitit 1991. Ku në këtë periudhë, përpara deputetëve të zgjedhur të atij legjislacioni, qëndronte një problem i madh juridik dhe politik, i cili ishte abrogimi i Kushtetutës së vitit 1976-të, si edhe miratimi i Kushtetutës së re, që do të hidhte bazat e demokracisë në Shqipëri.

“Transformimi i Madh” është fjala kyçe e asaj periudhe. Ajo përshkruan dhe shpjegon të gjitha ngjarjet politike dhe shoqërore të kohës. Proceset juridike që ndodhën në fillimet e tranzicionit mbartin pa përjashtim karakteristikat e transformimit të madh. Zhvillimet/transformatimet ishin rrënjësore, kryheshin në terren të panjohur dhe në mungesë të ekspertizës teknike, kryheshin duke improvizuar dhe pa themele të forta teorike, kryheshin me instinkt më shumë se sa me llogjikë shkencore, me empirizëm më shumë se sa me studim dhe analizë, me nxitim dhe entuziazëm, më shumë se sa me qartësi dhe durim. Por zhvillimet kishin dhe një karakteristikë tjetër thelbësore: ato janë vlerësuar në tërësi si pozitive dhe të suksesshme.

Ballafaqimi midis kontekstit historik dhe metodologjisë nga njera anë dhe rezultateve të arritura nga ana tjetër mbetet sot e kësaj dite i pa kryer deri në fund. Për pasojë sot mungon opinioni i qartë shkencor, i cili të lidhë avantazhet/defektet e ngrehinës kushtetuese të viteve '90 me fenomenet e infantilitetit politik shqiptar.

Në atë periudhë lidërshipi i ri politik sapo ishte familiarizuar me konceptet bazë të politikës. Pluralizmi dhe konkurrueshmëria politike ishin në rendin e ditës dhe aktorët qartësoheshin çdo ditë për to. Ndërkohë që koncepte si ndarja e pushteteve (sidomos mekanizmat me të cilat realizohet kontrolli dhe ballanca midis tyre), shteti ligjor (shteti i së drejtës), organizimi dhe funksionimi i pushtetit gjyqësor nuk njiheshin me themel dhe nuk perceptoheshin në tërësinë e tyre. Dispozitat Kryesore Kushtetuese u zhvilluan si produkt i nevojës, dhe jo si produkt i analizës dhe debatit të shëndoshë politik dhe profesional. Sidomos përsa i përket gjyqësorit, defektet dhe pakënaqësia e sotme ndaj tij, me shumë gjasë, burimin e kanë tek fenomenet politike të kohës kur ato u ngjizën, ose më thjesht tek fakti se askush nuk u ndal (nuk pati kohë) të analizonte dhe parashikonte se çfarë do ndodhte dhe si do funksiononte *checks and balances* me sistemin e ri kushtetues.

Ky kontekst historik rimerr vlerë sot, për shkak se reforma kushtetuese që po zhvillohet, duke e lënë mënjanë analizën e plotë të tij, rrezikon të prodhojë për pushtetet kushtetuese të njejtat sëmundje, me të njejtën rrezikshmëri për shëndetin e shoqërisë, sikurse Transformimi i Madh në fillimet e viteve '90. Sigurisht, analiza i përket punës tënde shkencore dhe jo kësaj interviste, por për ilustrim të idesë dua të them se, nëse në fillim të viteve '90 politika shqiptare adoptoi modelin e parë të organizimit të pushtetit gjyqësor që i doli përpara, atë italian, pa u thelluar shumë në analizën e mekanizmave të kontrollit dhe balancës, sidomos të defekteve dhe mangësive që mbarte modeli, për shkak se kishte urgjencë dhe nuk dinte të vepronte më mirë, sot një mënyrë e ngjashme sjelljeje nuk e justifikon më klasën tonë politike. Sot duket sikur reforma po bëhet me të njejtin nxitim dhe empirizëm si para 25 vjetësh. Me shumë gjasë ka për të prodhuar të njejtin rezultat.

Ku është analiza e *checks and balances* të sistemit në fuqi? Ku është analiza e impaktit të modifikimeve të propozuara mbi mekanizmat e *checks and balances*? Kush ka kurajon të shpjegojë p.sh. pse përfshirja e Presidentit të Republikës në pushtetin gjyqësor ka ndikuar negativisht në pavarësinë dhe ndershmërinë e tij dhe pse largimi i rolit të tij nga sistemi do ta çlirojë gjyqësorin? Pse nuk analizon kush shkaqet që nxisin korrupsionin në sistem dhe rrugët që çlirojnë sistemin nga korrupsioni? Pse nuk ka një analizë krahasuese të modeleve, përpara se të dilet me propozimin se rritja e rrogave të gjyqtarëve është zgjidhja? Personalisht unë nuk kam një pozicion pro ose kundër modifikimeve të propozuara kushtetuese. Pyetjet që shtroj nuk mund të quhen pozicionim, sepse pozicionimi mund të bëhet vetëm nëse bëhet e qartë dhe transparente kjo analizë: Çfarë ka ndodhur me *checks and balances* këto 25 vjet? Çfarë do ndodhë me *checks and balances* pas kësaj reforme?

2- Në periudhën e gjatë të tranzicionit, Shqipëria ka njohur disa ndryshime në ligjin elektoral, nga sistemi maxhoritar me dy raunde në zgjedhjet e vitit 1991, në sistem miks të varur dhe të pavarur, në sistem proporcional të personalizuar, si edhe në sistem proporcional rajonal me lista të mbyllura. Si i vlerësoni këto ndryshime të ligjit elektoral, që kanë ndodhur në një periudhë kaq të shkurtër kohore, si edhe si kanë ndikuar këto ndryshime në stabilitetin e vendit?

Unë do preferoja ta konsideroja epokën tonë të pluralizmit si epokën e sistemit zgjedhor proporcional. Që pas zgjedhjeve të para pluraliste ne kemi kaluar nga një nënkategori e sistemit proporcional tek një tjetër, por pa i'u larguar kurrë përfaqësimit përpjestimor. Sistemi miks që kemi pasur në fuqi për një farë kohe (votimi në zonja njëemërore me korrektim të rezultatit nga zonat shumëemërore) ka krijuar iluzionin e një

votimi mazhoritar, por rezultati ka qenë gjithmonë proporcional. Sistemet maten dhe vlersohen nga rezultati që prodhojnë. Nëse produkti është përfaqësimi proporcional, atëherë dhe sistemi zgjedhor duhet të trajtohet si i tillë.

Për mua trajtimi si i tillë ka rëndësi, sepse sistemi proporcional konsiderohet si sistemi që prodhon partitokracinë. Epoka jonë e demokracisë pluraliste është epoka e partitokracisë. Në këtë këndvështrim, do ishte gabim që fenomenet e partitokracisë të lidheshin vetëm me listat e mbyllura të sistemit zgjedhor në fuqi. Ndikimi i tyre është irrelevant. Partitokracia ka lidhje me të gjithë epokën dhe me të gjitha sistemet që kemi pasur në fuqi në këto 20 e ca vjet.

Së dyti, ky këndvështrim relativizon disi trajtimin e modifikimeve të shpeshta të formulave zgjedhore si *per se* negative, sa kohë ato ngelen forma të të njejtit sistem. Ndryshimet e shpeshta meritojnë një analizë, por kjo analizë është politologjike, jo juridiko-kushtetuese. Dukshëm modifikimet e shpeshta (përpara pothuaj çdo zgjedhjeje) kanë lidhje me psikologjinë e lidërsipit politik, i cili kërkon të lidhë fitoren/humbjen elektorale me avantazhet/disavantazhet që prodhon sistemi zgjedhor, jo me politikat, platformat, strategjitë dhe depërtimin e partisë në popull. Nga këndvështrimi kushtetues mund të përfaqësohet lehtësisht teza se sistemet nuk mbartin avantazhe/disavantazhe kushtetuese. Ato mund të inkurajojnë/dekurajojnë taktika të caktuara elektorale, por ato nuk ndikojnë dot vetiu tek rezultati. Rezultatit elektoral të partisë e ka në dorë votuesi, jo sistemi.

3- Z. Rusmali, si i vlerësoni ju ndryshimet kushtetuese të vitit 2008-të?

Debati rreth ndryshimeve kushtetuese të vitit 2008 është relativisht kompleks, sepse ai është debat përmbajtjeje dhe forme, thelbi dhe perceptimi. Në këtë këndvështrim, ai nuk bëhet dot vetëm i bardhë, ose vetëm i zi. Ka për të ngelur gjithmonë gri.

Në mënyrë telegrafike dhe pa u shtrirë gjatë në argumenta, unë do të vlerësoja pozitivisht modifikimet në statusin kushtetues të Presidentit të Republikës, si modifikime që synonin shmangien e krizave të thella e të zgjatura kushtetuese, por do të vlerësoja negativisht mënyrën se si u prezantuan/perceptuan në publik këto modifikime, si një komplot ndaj Presidentit të kohës. Unë do të vlerësoja pozitivisht adoptimin e sistemit zgjedhor proporcional rajonal, si një sistem që synonte të frenonte fragmentarizimin e politikës, që nxiste rritjen e përgjegjshmërisë dhe pjekurisë së klasës politike, që kërkonte të lidhte përfaqësimin politik me platformat dhe elitat politike, që kërkonte të frenonte kapjen e politikës nga grupimet okulte dhe antishtet, por do të vlerësoja negativisht besimin e pajustificueshëm që ai i jepte leadershipit politik apo moskryerjen e një analize kritike ndaj kulturës politike të mungesës së demokracisë së brendshme në partitë politike shqiptare.

Unë besoj se adoptimi i formulës gjermane të mocionit të mosbesimit ka qenë zhvillim pozitiv në drejtim të forcimit të stabilitetit qeverisës. Modifikimi ka qenë në koherencë me synimet që ndiqte modifikimi i sistemit zgjedhor apo modifikimi i procedurës së zgjedhjes së Presidentit të Republikës. Të treja ishin masa që synonin të reduktonin potencialin e dispozitave kushtetuese ekzistuese për të prodhuar krizë institucionale. Fakti që qeveritë kanë funksionuar në mandat të plotë, pavarësisht “tërmeteve” brenda parlamentit, flet në favor të këtyre ndryshimeve.

4- Në hartimin e listave me kandidaturat për deputet, çfarë mendoni se duhet të kenë parasysh liderët e partive politike? Mendoni se me ndryshimet e fundit në Kushtetutë, ku është aplikuar sistemi zgjedhor proporcional rajonal me lista të mbyllura, “sindromi” i servilizmit mund të ketë përfshirë Kuvendin Shqiptar?

Servilizmi është çështje që ka lidhje me karakterin dhe personalitetin e individit. Nëse trupa parlamentare kërcënohet nga serviliz-i-mi, për shkak të “listave të mbyllura”, atëherë është e sigurtë se parlamenti kërcënohet nga depersonalizimi dhe humbja e dinjitetit dhe integritetit politik dhe institucional. Pas saj vjen humbja e autoritetit publik dhe humbja e autoritetit publik sjell në mënyrë të paevitueshme përçmimin popullor ndaj përfaqësuesve të vet dhe politikës në tërësi. Faza e fundit e fenomenit është mosbindja civile dhe revolta ndaj politikës dhe institucioneve.

E çova me qëllim në ekstrem arsyetimin për të bërë të qartë rrezikun që i vjen politikës nga ABUZIMI me “listat e mbyllura”. Por mua “revolta” e politikanëve, analistëve dhe studiuesve të sistemeve ndaj “listave të mbyllura” dhe preferenca ndaj sistemeve me “lista të hapura” më duket si një lëvizje e re “çartiste”, jo aq se shfaqet si një lëvizje kundër mjetit (makinës), se sa për shkak se më krijon asociacionin e “përçarjes”. E keqja nuk vjen dot nga “lista e mbyllur”, por e keqja vjen nga abuzimi i liderve politikë me tagrin e caktimit të kandidatëve dhe nga shkelja brutale dhe e hapur e rregullave statutore të partive që ata drejtojnë, kur caktojnë kandidatët pa respektuar demokracinë e brendshme dhe statutin. Prandaj zgjidhja nuk mund të gjendet tek adoptimi i “listave të hapura”, por tek adoptimi i mekanizmave që detyrojnë zbatimin e rregullave statutore për demokracinë e brendshme në parti. Lidershipi është problemi, nuk janë listat.

Nëse mund ta ruaj deri në fund metaforën e “sindromit”, do preferoja të thoja se serviliz-i-mi i parlamentit nuk mund të ketë lidhje me listat e mbyllura, por ka me siguri lidhje me “serviliz-i-min” e formumeve të partive politike.

5-Në këto 25-së vitet e fundit të pluralizmit shqiptar, gjatë zhvillimit të zgjedhjeve elektorale në realitetin shqiptar është krijuar kultura e kontestimit të rezultatit zgjedhor nga humbësit e zgjedhjeve. Sipas mendimit tuaj, cilat mund të jenë arsytet e këtyre kontestimeve nga ana e kundërshtarëve politikë?

Po në Shqipëri është krijuar një kulturë kontestimi, e cila nuk justifikohet dot nga problematika, difektet apo parregullsitë e zgjedhjeve. Kjo kulturë besoj se është në simbiozë (ushqejnë njera tjetrën) me kulturën e mungesës së llogaridhënies së lidershit politik. Që të dyja janë shfaqje të stadit të mangët të emancipimit politik.

6-Sipas mendimit tuaj Z. Rusmali, duke u nisur edhe nga eksperiencia juaj politike, cili sistem elektorale është më i përshtatshmi për vendin tonë, duke pasur parasysh edhe situatën politike të vendit, kulturën politike dhe mungesën e theksuar të kulturës demokratike?

Për të gjitha rrethanat që përmende në pyetje, unë besoj se sistemi aktual zgjedhor është sistemi me potencialin më të lartë ndikues në sistemin tonë politik. Duhet vetëm që ky potencial të lejohet të shpaloset dhe të rezonojë me faktorë dhe procese të tjera me ndikim. Fjala kyçe në këtë drejtim është: forcimi i demokracisë së brendshme në partitë politike, zbatimi detyrues i rregullave statutore!

SHTOJCA 3

Intervista e zhvilluar me Marko Bello.

1- Në periudhën e gjatë të tranzicionit, Shqipëria ka njohur disa ndryshime në ligjin elektoral, nga sistemi maxhoritar me dy raunde në zgjedhjet e vitit 1991, në sistem miks të varur dhe të pavarur, në sistem proporcional të personalizuar, si edhe në sistem proporcional rajonal me lista të mbyllura. Z. Bello, si i vlerësoni ju këto ndryshime të ligjit elektoral, të cilat kanë ndodhur në një periudhë kaq të shkurtër kohore?

Në thelb, ndryshimet kanë ardhur për shkak të mosfunksionimit apo më saktë, keqfunksionimit të sistemit të mëparshëm. Në parim, unë personalisht nuk jam kundër ndryshimeve, aq më tepër nëse ato janë të domosdoshme, por duhet pranuar se ndryshimet e shpeshta të ligjit zgjedhor i kanë përkeqësuar më tepër fushatat dhe proceset zgjedhore, sesa kanë kontribuar në arritjen e një sistemi apo modeli zgjedhor që i përshtatet më shumë karakteristikave të vendit tonë. Sistemi aktual, ai proporcional rajonal është i gabuar dhe nuk i shërben vendit tonë.

2- Z. Bello, si i vlerësoni ju ndryshimet kushtetuese të vitit 2008-të?

Tashmë është bërë e qartë se ndryshimet kushtetuese të vitit 2008 kanë qënë jo vetëm të nxituara dhe të pakonsultuara, por edhe të dëmshme. Ja përse: Në radhë të parë, u prish balanca që kishte Kushtetuta e vitit 1998, si në drejtim të ekuilibrit të pushteteve, ashtu edhe në respekt të parimit të kontrollit reciprok. Së dyti, ndryshimet kushtetuese u bënë, nisur nga ngërçi që mund të krijohet, në rastin e zgjedhjes së presidentit, moszgjedhja e të cilit mund të provokonte një spirale zgjedhjesh të njëpasnjëshme. Por, ndryshimet na sollën një president tërësisht partiak, duke minuar konsensusin që në fakt impononte

kushtetuta e 1998. Qëllimi kishte qënë që politikanët shqiptarë të zhvillonin kulturën e dialogut, dhe, në emër të interesave të vendit, të gjenin medoemos një president konsensual, ose një figurë mbi palët, i cili do të votohej me shumicë të cilësuar, me 3/5 apo 84 vota.

Paradoksi është se tani, Avokati i Popullit zgjidhet me 84 vota, kurse shefi i shtetit, pra Presidenti me shumicën dërrmuese, ose 71 vota nga 140 anëtarët e Kuvendit. Së treti, ndryshimet forcuan së tepërmi pushtetin e kryeministrit, duke ia zbehur edhe më shumë rolin parlamentit. Në letër, *de jure*, ne jemi republikë parlamentare, por *de facto* jemi republikë ekzekutive. Pushtetin e kontrollon thuajse tërësisht shefi i qeverisë, i cili, në cilësinë edhe të kryetarit të shumicës parlamentare, nga ku buron qeveria, praktikisht kontrollon edhe parlamentin.

3- *Në hartimin e listave me kandidaturat për deputet, çfarë mendoni se duhet të kenë parasysh liderët e partive politike? Mendoni se me ndryshimet e fundit në Kushtetutë, ku është aplikuar sistemi zgjedhor proporcional rajonal me lista të mbyllura, “sindromi” i servilizmit mund të ketë përfshirë Kuvendin Shqiptar?*

Mendoj se ndryshimet në ligjin zgjedhor sollën më shumë probleme, se sa zgjidhje. Të vetmit që përfituan nga ligji i ri ishin partitë e mëdha dhe sidomos kryetarët e partive respektive. Ligji zhbëri edhe ato elementë pozitivë në jetën e brendshme të partive, duke inkurajuar servilizmin, hipokrizinë, larguan të zgjedhurin nga zgjedhësi, duke mos i lënë thuajse asgjë në dorë këtij të fundit. Më keq akoma, duke ia dorëzuar “sovrانيتetin” tërësisht një njeriu, partitë varen tani nga oreksi dhe humori i kryetarit. Një kryetar i korruptuar do ta shfrytëzojë fushatën për të mbushur xhepat, ndërsa dikush tjetër që do të

fitojë me çdo kusht, do të guxojë të sjellë të ashtuquajturit e fortë apo oligarkët, kriminelët dhe banditët. A nuk kemi mbërritur në një rast të tillë sot?

4- Në diskutimet e fundit midis lidërve kryesorë të partive politike është diskutuar rreth sistemi elektoral, nëse do të aplikohet sistemi zgjedhor proporcional rajonal me lista të hapura apo të mbyllura? Sipas mendimit tuaj, cili sistem është më i përshtatshmi për vendin tonë duke parë avantazhet dhe disavantazhet e secilit sistem?

Më të interesuarit për listat e mbyllura janë drejtuesit e partive, të cilët synojnë të vendosin njerësit ose mbështetësit e tyre në vendet e para, duke iu imponuar bazës apo anëtarëve të thjeshtë të partisë që drejtojnë. Listat e hapura janë më demokratike, lejojnë garën, garantojnë konkurrencën dhe japin mundësi për t'u votuar më të mirët. Rreziku i vetëm, që vjen edhe nga mjedisi shqiptar është se në këtë rast, partia mund të rrezikojë kohezionin e saj të brendshëm, pasi gara mund të ashpërsohet dhe ajo të kthehet në njëfushatë denigruese brenda partisë, duke ndihmuar indirekt kundërshtarin politik. Nëse partitë i zgjedhin kandidatët për deputetë apo kandidatët për zgjedhjet vendore, sipas rregullave demokratike, edhe listat e mbyllura mund të jenë të pranueshme.

Pra, nëse përpara se listat t'i dërgohen Komisionit Qëndror të Zgjedheve, respektohen kriteret, kontributi, bëhet votim brenda partiseetj., atëherë nuk do të kishte asnjë problem që renditja e kandidatëve të bëhej edhe nga vetë Partia. Fatkeqësisht, partitë në Shqipëri janë zëvendësuar nga kryetari, nga njeshi, i cili ka të drejtën ekskluzive të hartojë listën, të cilën e vulos dhe firmos, pa pyetur as kryesinë apo forume të tjera drejtuese.

5- Në këto 25-së vitet e fundit të pluralizmit shqiptar, gjatë zhvillimit të zgjedhjeve elektorale në realitetin shqiptar është krijuar kultura e kontestimit të rezultatit zgjedhor nga humbësit e zgjedhjeve. Sipas mendimit tuaj Z. Bello, cilat mund të jenë arsytet e këtyre kontestimeve?

Është e vështirë t'i përgjigjesh në pak radhë kësaj pyetjeje, por shkurtimisht mund të them se arësytet kryesore lidhen me kulturën tonë të pakët demokratike, me reminishencat e regjimit të kaluar, me strukturën tonë tëorganizimit të shoqërisë mbi bazën e fisit, tarafit, fshatit, lagjes apo mikut. **Së dyti**, ai drejtues partie që humbet zgjedhjet, nuk lë gurë pa lëvizuar për t'ia lënë fajin kundërshtarit, duke evituar të marrë mbi vete përgjegjësitë dhe të largohet nga drejtimi i partisë, duke ia lënë vendin dikujt tjetër. Askush nuk pranon të mbajë fajin, por kërkon ta gjejë tek kundërshtari. Me këtë nuk dua të them se kundërshtari është pa faj, pasi ka raste kur sillen fakte se zgjedhjet mund të jenë manipuluar, vjedhur apo thjesht tjetërsohet vullneti i zgjedhësve me një mijë mënyra.

Së treti, më shumë se sedra për të mos pranuar humbjen, politika shikohet si një mundësi për të përfituar dhe jo si pasion për të shërbyer në sektorin publik. Mungesa e kulturës demokratike, etja për të përfituar nga pasuria publike apo funksioni zyrtar i bëjnë politikanët shqiptarë të paskrupuj dhe të pamoralshëm. Janë gati të shkelin “mbi kufoma”, në kuptimin figurativ vetëm e vetëm që t'ia arrijnë qëllimit. Në vend të shikohet si garë, procesi zgjedhor shikohet si dyluftim, si fushë beteje, ku asnjë nuk pranon humbjen. Edhe pse partitë kryesore, PS e PD janë alternuar në pushtet, sa kohë janë në opozitë qahen e ankohen ndaj kundërshtarit, duke kërkuar më shumë rregulla dhe garanci, por sapo vijnë në pushtet bëjnë sikur harrojnë dhe gjithë fokusi është si e si të qëndrojnë sa më gjatë në pushtet.

6- *Sipas mendimit tuaj, duke u nisur nga eksperiencia juaj e gjatë në sferën politike, cili sistem elektoral është më i përshtatshmi për vendin tonë, duke pasur parasysh edhe situatën politike të vendit, kulturën politike dhe mungesën e theksuar të kulturës demokratike?*

Është e vështirë të thuash se cili do të ishte sistemi elektoral më i mirë për kushtet e vendit tonë, pasi jam i sigurt se do ta kundërshtonin sa herë partitë humbasin dhe ia vënë fajin sistemit. Gjithsesi, nga sa kam parë, ndoshta një sistem i pastër proporcional kombëtar ose mazhoritar i pastër kombëtar do të ishte më pranë së vërtetës. Në rastin e sistemit proporcional, garantohej stabilitet, votohen partitë dhe vihet edhe një prag, duke mos ia ngrënë hakun askujt. Sigurisht, që për qytetarin, më mirë do të ishte ta njihje të zgjedhurin, ti kërkonte llogari dhe ta votonte, duke peshuar vlerat e tij individuale, integritetin dhe profesionalizmin. E këtë e garanton mazhoritari, zona një emërore, ku çdo parti ofron një kandidat, duke ia lënë zgjedhësve të vendosin. E keqja është se njerëz të dhunshëm, të tjerë që janë pasuruar brenda natës në mënyrë të dyshimtë, mund të imponohen, me forcë a me para dhe ta blenë një vend në parlament, duke spekuluar me varfërinë e njerëzve.

Prandaj, në shumë vende të BE preferohet proporcionali kombëtar, por me kusht që partitë ti shohisin mirë kandidatët dhe jo t'ia lenë në dorë një njeriu sikurse ndodh tek ne. Rezultati: kriminelë në parlament. Nëse partitë mbyllen, nuk lejojnë shprehjen e lirë, kritikën, llogaridhënien dhe garën apo konkurrencën, është e kotë të flasim pastat për institucione demokratike që pritet të krijohen prej tyre pas zgjedhjeve. Këtu qëndron, mendoj unë, thembra e Akilit. Parti serioze me liderë seriozë dhe të përkushtuar kanë mundësi të ruajnë elitat, t'i qarkullojnë ato dhe t'i japin zgjedhësve produkte të mira. Pak rëndësi ka pastaj se cila forcë politike fiton zgjedhjet.

SHTOJCA 4

Zgjedhja e sistemeve elektorale është një vendim shumë i vështirë dhe i rëndësishëm të marrë nga partitë politike. Ajo është përcaktuese në qeverisjen e vendit, si edhe ekzistojnë disa debate të ndryshme. Por le të analizojmë vetëm dy rrymat kryesore teorike mbi modelet e demokracisë atë të demokracisë mazhoritare dhe atë konsensuale.

Demokracia mazhoritare. Avantazhet dhe disavantazhet:

Autorët që mbështesin modelin mazhoritar të demokracisë shikojnë një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet votës dhe llojit të qeverisë që merr mandatin qeverisës. Sipas tyre qeveria duhet të jetë e ndërtuar nga një parti politike e cila ka mazhorancën në parlament, dimension ky që bën të mundur stabilitetin qeverisës për gjithë kohëzgjatjen e mandatit. Në këtë mënyrë do të kemi qeveri të cilat janë drejtpërdrejtë përgjegjëse për politikën dhe reformat të ndërmarra përpara publikut. Elektorati në zgjedhjet parlamentare pasuese ka mundësi të shohë dhe vlerësojë punën e bërë nga qeveria dhe qëndrimin alternativ të opozitës mbi këtë performancë.

Këta autorë pranojnë faktin se partitë e vogla janë të penalizuara nga ky lloj modeli demokracie, por e shikojnë këtë fakt si një kosto të domosdoshme që duhet paguar me qëllim sigurimin e qeverisjes së stabilizuar të vendit. Sipas tyre sistemet proporcionale janë jo efektive sepse prodhojnë mazhoranca jo të konsoliduara, zhvendosin pushtetin drejt partive më të vogla të cilat sillen në mënyrë kushtëzuese dhe nuk mundësojnë një përgjegjësi dhe transparencë të qartë qeverisëse.

Ekziston një lidhje e fortë ndërmjet votuesit dhe deputetit (llogaridhënia):

Në nivel lokal, autorët që mbështesin modelin e demokracisë mazhoritare, mendojnë se lidhja votues – deputet është shumë e forte. Mjeti kontrollit gjatë mandatit qeverisës, për qeveritë që dalin nga sistemet mazhoritare është votëbesimi i saj në parlament. Për atë kohë sa mazhoranca në parlament e përbërë nga një parti politike, është dhe mazhoranca qeverisëse dhe ku lideri i partisë së grupit mazhoritar në parlament është në pjesën më të madhe të rasteve dhe kryeministri vendit, probabiliteti i mos-besimit është i ulët. Për ata autorë që mbrojnë modelin mazhoritar të demokracisë dhe familjen e sistemeve mazhoritare, garantimi i stabilitetit qeverisës dhe efikasiteti i tyre janë elementë shumë të rëndësishëm për të bërë një demokraci funksionale.

Demokracia konsensuale. Avantazhet dhe disavantazhet:

Vizioni i demokracive konsensuale për sistemet elektorale thekson rolin e konsensusit, negociatave dhe koalicioneve në parlament dhe qeveri. Përfaqësimi i grupeve politike në parlament, parti këto që kalojnë pragun elektoral përmirëson ndjeshëm mekanizmin e përfaqësimit politik të shoqërisë. Në këtë mënyrë grupe të ndryshme brenda shoqërisë kanë zërin e tyre në parlament, duke minimizuar shanset e përjashtimit të grupeve të caktuara sociale-ekonomike - kulturore në mënyrë sistematike. Autorët që mbështesin sistemet elektorale proporcionale dhe demokracitë konsensuale argumentojnë se sistemet mazhoritare mundësojnë delegimin e një pushteti të tepërt tek partitë fituese sidomos në ato shoqëri që karakterizohen nga një nivel i lartë heterogjeniteti etnik, lingistik, fetar dhe kulturor. Sistemet mazhoritare sipas tyre prodhojnë “shumica diktatoriale” të cilat nuk kanë nevojën e negociimit dhe konsensusit në menaxhimin politik të vendit.

Qeverisje konsensuale:

Për ata autorë që mbështesin këtë model demokracie, funksioni kryesor i zgjedhjeve është që të mundësojë qytetarët që të përzgjedhin zëdhënësit e tyre për të diskutuar, negociuar dhe vendosur në emër të tyre. Ky lloj përfaqësimi ka më shumë karakter social sesa gjeografik. Vizioni që ndajnë mbështetësit e këtij modeli për demokracinë ka të bëjë me shpërndarjen e pushtetit sa më shumë të jetë e mundur tek të zgjedhurit, krijimin e një sërë mekanizmash institucional kontrolli dhe balance, parlamenti shumëpartiak, me qëllim dhënien zë të grupeve dhe interesave të ndryshme në shoqëri në procesin e vendimmarrjes. Një sistem elektoral proporcional mundëson përfaqësimin në parlament në mënyrë proporcionale të gjithë partive politike që garojnë dhe që arrijnë të kalojnë pragun elektoral. Duke lehtësuar garimin dhe shanset për t'u përfaqësuar me mandate për partitë e vogla, kjo familje sistemesh elektorale ofron dhe një gamë më të madhe përzgjedhëse për votuesin.

Maksimizimi i pjesëmarrjes në zgjedhje:

Në sistemet elektorale të familjes mazhoritare, votuesit e partive të vogla të cilat kanë një elektorat të shpërndarë gjeografikisht në gjithë vendin, shpesh demoralizohen si pasojë e vetë sistemit. Ata kuptojnë që vota e tyre për partitë që preferojnë (parti të vogla) nuk ka ndikim në faktin se cili kandidat është fituesi në zonën zgjedhore përkatëse dhe aq më pak se cila parti do të fitojë zgjedhjet dhe të formojë qeverinë. Perceptimi i votës nga votuesit e partive të vogla si jo të dobishme dhe të shkuar dëm është një motiv i fortë për të mos marrë pjesë në zgjedhje. Përkundrazi në sistemet elektorale proporcionale kombëtare, sidomos në ato vende ku aplikohet dhe një prag elektoral i ulët, mundësia e partive të vogla për të fituar mandate është shumë më e madhe. Në këtë logjikë dhe votuesit e këtyre partive

janë shumë më të motivuar për të marrë pjesë në votime sepse kuptojnë vlefshmërinë, dobinë dhe fuqinë e votës së tyre në zgjedhjen e përfaqësuesve në parlament. Kështu që besohet se sistemet elektorale proporcionale përgjithësisht prodhojnë një pjesëmarrje më të madhe në votime krahasuar me sistemet mazhoritare.

Sistemi i ndarjes së mandateve në rastin e zgjedhjeve.

Nga forma e ndarjes së mandateve, varet dhe vlera e vërtetë e votës së zgjedhësit.

Në teorinë politike janë të njohura dy sisteme të ndarjes së mandateve:

- Sistemi i shumicës (mazhoritar)
- Sistemi proporcional i përfaqësimit

Sistemi mazhoritar, sipas këtij sistemi mandatin e fiton kandidati, përkatësisht lista e kandidatëve e cila fiton shumicën e votave në një njësi zgjedhore. Sistemi i shumicës bazohet në shumicën absolute dhe atë relative, mund të zbatohet në njësi të mëdha ashtu edhe të vogla. Shumica absolute zbatohet atëherë kur në listë janë një ose dy kandidatë. Shumica relative zbatohet nëse në lista janë më shumë se dy kandidatë.

Sistemi i përfaqësimit proporcional, në këtë sistem secila parti ose grup politik që merr pjesë në zgjedhje, fiton numrin e mandateve në përpjestim me numrin e votave që ka fituar në zgjedhje. Qëllimi i zbatimit të tij ka qenë, që edhe pakicës ti mundësohet një numër i caktuar i mandateve, por në baza proporcionale. Ndër sistemet që kanë pretenduar të sigurojnë mandate për pakicën kanë qenë: sistemi i grumbullimit të votave, sistemi i minimumit zgjedhor dhe sistemi i votimit të kufizuar. Sistemet e zbatuara në ndarjen e mandateve janë:

- Sistemi i herësit

- Sistemi i D’Ont-it (matematicient belg)

Sipas sistemit të herësit numri i tërësishëm i votave së pari pjestohet me numrin e përfaqësuesve që zgjidhen në njësinë zgjedhore. Numri i fituar paraqet herësin zgjedhor. Secilës listë të kandidatëve i ndahen atëherë mandate sa herë të pjestohet numri i votave që ka fituar lista me herësin zgjedhor. Zbatimi i këtij qëllimi ka për qëllim ekzistimin e partive të vogla. Sistemi D’Onit ndarja e mandateve bëhet përmes operacionit matematikor i cili nënkupton shfrytëzimin e “ndarësit të përbashkët”.

PËRKTHIMI I VOTËS NË MANDATE

Tabela Nr. 46: Përkthimi i votës në mandate.

METODA	PËRKSHIRIMI
D’hondt	Formula: Sipas kësaj formule, mandatet e një zone zgjedhore nuk ndahen thjeshtë sipas përqindjes së fituar të një partie - pra kjo formulë nuk e bën një përkthim proporcional të votës, por llogaritë mesataret më të mëdha të partive. Nëse një zonë zgjedhore ka 10 mandate, çdo partie i pjesëtohet numri total i votave me të gjithë numrat nga 1 deri në 10. Mandate në kuvend fitojnë partitë të cilave nga ky proces i pjesëtimit u rezultojnë dhjetë numrat më të mëdhenj. Pasojat e zakonshme: Formula D’Hondt favorizon partitë ose koalicionet e mëdha (që mund të jenë dy ose tre, varësisht nga shteti) dhe dëmton partitë më të vogla. Megjithatë, efekti i keq ndaj partive të vogla zvogëlohet në rast se zonat janë më të mëdha dhe ofrojnë më shumë mandate, gjë që u jep më shumë rast partive të vogla të fitojnë mandate nëpër zona.
Sainte-Laguë	Formula: Sipas kësaj formule ndarja e mandateve bëhet në mënyrë proporcionale me anë të koeficientit. Numri total i votave të partisë pjesëtohet me numrin e vendeve të cilat partia i ka të ndara, që fillimisht është 0 për të gjitha partitë. Partia me koeficientin më të lartë merr vendin e radhës dhe pastaj i rikalkulohet koeficienti i ri deri sa të alokohen të gjitha mandatet. Pasojat e zakonshme: Sikurse edhe formula D’Hondt me anë të kësaj metode favorizohen partitë e mëdha.
Droop quota	Formula: Droop Quota është metodë e disjenuar në mënyrë që të pamundësojë që kandidatët të arrijnë kuotën pasi numri i mandateve është plotësuar. Pasojat e zakonshme: E meta më e madhe e përdorimit të kësaj formule është transferi i votave nga një kandidat në kandidatin pasardhës, duke lejuar që mandatet të fitohen edhe nëse kuota nuk është arritur nga vet kandidati.

Llojet e sistemit të zgjedhjeve

Sipas një literature të pasur mbi sistemet elektorale, klasifikimit dhe ndikimit të tyre që datojnë nga vitet 60' (Maurice Duverger, 1964 dhe Douglas Rae, 1967), sistemet elektorale mund të klasifikohen në tre familje kryesore, ku secila prej tyre përmbledh një numër të konsiderueshëm nënlllojesh. Ku përmendim: sistemi mazhoritar, sistemi i kombinuar dhe sistemi proporcional.

1-Familja e parë e sistemeve elektorale është ajo mazhoritare që përfshin nënlllojet si Sistemi i Shumicës Minimale, Sistemi Mazhoritar me dy Raunde, Sistemi i Votës Bllok, Sistemi i Votës së Vetme jo të Transferueshme dhe Sistemi i Votës Alternative. Në këtë sistem fiton dhe shpallet i zgjedhur kandidati që ka fituar shumicën e votave në zonën zgjedhore përkatëse. Fituesi, kështu i jepet atij kandidati që siguron më shumë vota se të tjerët, por jo detyrimisht shumicën e votave në zonën përkatëse.

2-Familja e dytë është ajo sistemeve elektorale të kombinuara ku përdoren formula mazhoritare dhe proporcionale. Dallohen këtu sistemi proporcional i korrigjuar me elemente mazhoritare dhe sistemi mazhoritar i korrigjuar me elemente proporcionale. Konsiderohet në përgjithësi sistem i preferueshëm pasi bashkon elementet pozitive të sistemit mazhoritar dhe të atij proporcional.

3- Familja e tretë e sistemeve elektorale është ajo proporcionale, e cila përfshin nënlllojet si Sistemin e Listës Partiake, dhe Sistemin e Votës së Vetme të Transferueshme. Pothuajse 1/2 e vendeve në gjithë globin përdorin sisteme të familjes mazhoritare, ndërkohë 1/3 e vendeve përdorin sisteme proporcionale dhe pjesa që mbetet përdorin sisteme të kombinuara. Në këtë sistem, secila parti mund të paraqesë një listë me aq emra sa janë vende në parlament. Pra, nënkuptohet votimi me listë.

Kriter kryesor për dallimin e sistemeve zgjedhore është vet përmbajtja e tyre. Duke u nisur nga kjo, në teorinë politike dhe shkencën kushtetuese-juridike janë bërë disa klasifikime të sistemeve zgjedhore në bazë të kriterëve përmbajtësorë.

- Ato që marrin për bazë parimet që përshkojnë sistemin e zgjedhjeve, këto sisteme i ndajnë në demokratike dhe jodemokratike ose përparimtare dhe reaksionare.
- Ato që marrin për bazë nivelin e përputhshmërisë si pjesë pozitive të një vendi, sistemet dhe zgjedhjeve i ndajnë në reale, formale dhe fiktive.

Sistemet e zgjedhjeve demokratike janë: zgjedhjet pluraliste, e drejta e zgjedhjeve të përgjithshme, të barabarta, të drejtpërdrejta, votimi i fshehtë etj. Ato sisteme që janë kundër këtyre parimeve dhe bëjnë vjedhjen e votave janë jodemokratike. Sistemet e zgjedhjeve reale janë ato sisteme kur praktika e zbatimit përputhet me normat si ato kushtetuese edhe ligjore etj, përmes të cilave rregullohen zgjedhjet. Sistemin e zgjedhjeve formale e kemi atëherë kur sistemi i zgjedhjeve përmban parime që nuk përkojnë me mardhëniet politike reale dhe me raportin e forcave politike në atë vend. Sisteme të zgjedhjeve fiktive kemi atëherë kur realiteti në zbatimin praktik të zgjedhjeve është në kundërshtim të plotë me normat kushtetuese.

Nëse do ti analizonin përkatësisht sistemet elektorale:

Karakteristikë e SMP është thjeshtësia e tij. Votuesit duhet të shënojnë një kandidat në listën e kandidatëve për parlament. Mandatet janë të ndara sipas zonave zgjedhore dhe mandatin e fiton kandidati që ka më së shumti vota në raport me kandidatët e tjerë, jo domosdo shumicën absolute të votave. Këtu është edhe kritika më e madhe ndaj këtij sistemi sepse deputetët nuk zgjidhen me shumicën absolute të votave, kurse një numër i

madh e votave të elektoratit humbasin. Karakteristikë tjetër është se SMP prodhon qeveri stabile dhe se politikat e qeverisë janë të parashikueshme. Po ashtu, SMP zakonisht sjell mbipërfaqësimin e partisë më të madhe dhe lehtëson krijimin e shumicës parlamentare. Si pasojë e kësaj, koalicionet janë të rralla, për dallim nga sistemet proporcionale në të cilat qeveria formohet pas zgjedhjeve në bazë të negociatave ndërmjet partive politike. Për më shumë, karakteristikë tjetër, dhe mbase më e rëndësishmja, është se në SMP votuesit nëpër zona zgjedhore përfaqësohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga kandidatët fitues, gjë që bën që përfaqësimi i qytetarëve të jetë më i qartë dhe ata e dinë se kujt mund t'i drejtohen me kërkesat e tyre.

Tabela nr. 47: Përparësitë dhe mangësitë e sistemit të shumicës relative me zonë njëmandatëshe (SMP).

PËRPARËSITË	MANGËSITË
Thjeshtësia	Shpërpjesëtimi në përfaqësim
Përfaqësimi i votuesve në mënyrë të drejtpërdrejtë	Shumica e votave humbasin
Qeveria stabile	Mundësitë për dialog politik janë më të vogla
Parashikueshmëria e politikave	Politikat mund të jenë më ideologjike dhe tensionet më të larta
Kufizon skenën politike në parti të mëdha dhe në ato me koncentrim gjeografik	Dëmton partitë më të vogla me shtrirje të gjerë dhe zvogëlon opsionet politike

Vota alternative

Vota alternative është përdorur për herë të parë në Australi në fund të shekullit XIX dhe përdoret në disa vende të Oqeanisë. Është sistem mazhoritar i komplikuar dhe i ngjason deri diku sistemit proporcional VVT për të cilin flitet në seksionin e ardhshëm. Megjithatë, vota alternative është shumë e rekomanduar për vendet shumë-etnike. Sipas Horowitz¹³, vota alternative bën moderimin e liderëve etnikë, për shkak se i shtyn ata që të kërkojnë votat e grupeve të tjera etnike. Ky parim do të ishte vështirë i aplikueshëm në Kosovë, për arsye se pakicat janë në një numër shumë të vogël, por shihet si sistem zgjedhor i përshtatshëm për vendet ku grupet etnike janë përafërsisht të barabarta në pikëpamje

demografike. Ky sistem përndryshe quhet sistem i votimit preferencial, sepse këtu votohet për preferencën e parë, të dytën etj. Kjo mund të ketë për pasojë që kandidati, i cili në raundin e parë të numërimit të votave ka më së shumti vota, por i mungon shumica prej 50% + 1 votë, të mos arrijë të zgjidhet në parlament për shkak se i mungon numri i mjaftueshëm i votave preferenciale, si preferencë e dytë, e tretë etj. Më poshtë po paraqesim disa përparësi dhe mangësi të votës alternative, sipas përvojës së vendeve të tjera.

Tabela nr. 48: Përparësitë dhe mangësitë e Votës alternative (VA).

PËRPARËSITË	MANGËSITË
Mundëson zgjedhjen në mes të shumë kandidatëve dhe lejon preferencat	Mundëson marrëveshjet në mes të partive/kandidatëve dhe votimin taktik që jo gjithmonë mund të jetë i shtyrë nga moderimi
Përfaqësimi i votuesve në mënyrë të drejtpërdrejtë	Një pjesë e konsiderueshme e votave të para humbasin
Ka efekt moderues	Numri i pakicave etnike në Kosovë është i vogël për të aplikuar këtë sistem

Vota e vetme e transferueshme (VVT)

Janë dy lloj sistemesh proporcionale: sistemet e listave dhe ato me garimin e kandidatëve individualë (VVT). Ky lloj i sistemit proporcional është më i rralli që përdoret, edhe pse literatura politologjike e konsideron si njërin prej sistemeve më të mira proporcionale.¹⁷ Në fakt, ky proporcional përdoret vetëm në vendet që kanë qenë të sunduara nga Britania e Madhe dhe që kanë zgjedhur një formë të sistemit proporcional të zgjedhjeve. Karakteristikë themelore që e tregon praktika, është se VVT përdoret në vendet me numër më të vogël të popullsisë. VVT-ja përdoret nga Australia (për Senat), Republika e Irlandës, Malta dhe Irlanda Veriore.

Çfarë dallon VVT nga nënsistemet e tjera proporcionale? Për dallim nga nënsistemet proporcionale me listat e mbyllura, këtu zgjedhësit mund të votojnë për më

shumë se një kandidat, madje edhe për kandidatët e partive të ndryshme, duke i renditur sipas preferencës së tyre: preferenca 1, preferenca 2, preferenca 3, e kështu me radhë. Në Republikën e Irlandës, p.sh., aplikohet preferenciali opcional, në të cilin votuesit mund të zgjedhin prej 1 e më shumë preferencave, kurse në Australi, aplikohet preferenciali i obligueshëm, në të cilin votuesit duhet të votojnë për më shumë se një kandidat dhe në disa zona, ata duhet t'i rreshtojnë preferencat e tyre në mesin e të gjithë kandidatëve.

Në rrethin e parë të numërimit, llogariten vetëm preferencat e para. Nëse ndonjëri prej kandidatëve arrin kuotën e përcaktuar, ai zgjidhet. Nëse jo, atëherë në rrethin e dytë të numërimit llogariten preferencat e dyta. Në rast se ndonjëri prej kandidatëve ka numrin e votave shumë të vogël për të vazhduar garën, ai eliminohet dhe numërohen preferencat e tij të dyta. Nëse nga këto preferenca, ndonjëri nga kandidatët arrin ose tejkalon kuotën prej 8352 votash, tjerë sipas preferencave të shprehura nga votuesit derisa edhe kandidati tjetër të arrijë kuotën e kështu me radhë derisa të gjithë kandidatët e arrijnë kuotën e përcaktuar. Pra, në VVT, numërohen edhe teprica e votave të kandidatëve të zgjedhur, edhe mbetja e votave të kandidatëve të eliminuar.

Tabela nr. 49: Përparësitë dhe mangësitë e sistemit proporcional (VVT).

PËRPARËSITË	MANGËSITË
Votohet drejtpërdrejt për kandidatin	Votimi mund të jetë i komplikuar dhe mund të shkaktojë huti tek votuesit
Përfaqësimi i votuesve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe u jep shanse të gjitha partive	Numërimi është i komplikuar
Ka efekte moderuese në vendet me diversitet etnik	Mund të ketë marrëveshje në mes të partive për ndarje të preferencave – Votimi taktik
Si pasojë e votimit taktik, mund të lehtësojë krijimin e koalicioneve	VVT arrin të gjenerojë përfaqësim proporcional në parlament, por mund të krijojë konfuzion të politikave.

FJALORTH:

Zonë – një zonë shpesh me nënzona në të cilën kemi më shumë se një kandidat ndajnë të njëjtin qark. Kryetari i Bashkisë mund të kandidojë “at – large” ndërsa anëtarët e këshillit të qytetit kandidojnë në zona.

Qëndrime – Termi qëndrime, se si ndihen votuesit kur shkojnë në zgjedhje – të kënaqur ose të inatosur, ndjehen më mirë ose më keq, etj.

Fletë votimi – Dokumenti zyrtar që përdorin votuesit për të hedhur votën e tyre, për të bërë kështu të ditur cilin kanë zgjedhur.

Renditje në fletëne votimit – Ky është emir ku shkruhet emri i kandidatit në fletën e votimit. Nëse në fletën e votimit ka shumë kandidatë ose ajo është e gjatë, shpesh votuesit nuk e lexojnë të gjithë listën deri në fund, prandaj kandidatët me emrin më sipër në listë kanë më shumë shanse.

Bordi i zgjedhjeve – Zakonisht një bord jopartiak ose shumë – partiak i formuar për të mbikqyrur zgjedhjet dhe për të garantuar zhvillimin me ndershmëri të tyre.

Buxhet – Buxheti zakonisht ka të bëjë me shumën e parave që pritet të shpenzoni për aspekte të ndryshme të fushatës. Partitë politike duhet të plotësoni gjithashtu sa njerëz do të duhen për të përmbushur cdo detyrë dhe sa kohë do të kërkojë përmbushja e cdo detyre. Në këtë mënyrë do të caktohen nga partitë politike edhe buxhetin e burimeve kohore dhe njerëzit.

Zgjedhjet plotësuesë – Zgjedhje që nuk mbahen në afatin e përcaktuar zakonisht, shpesh për të përmbushur një vend bosh për një funksion. Shpesh në zgjedhje të posacme ose zgjedhje plotësuese përqindja e votuesve është shumë më e vogël.

Kandidati – Ky është personi që kandidon për një pozicion të caktuar të zgjedhur me votim. Roli i kandidatit është të takojë votuesit dhe kontribuesit e mundshëm të fushatës, dhe t'i bindë ata të mbështesin kandidatin. Kandidati nuk mund të jetë menaxher i fushatës, përgjegjës për zhvillimin strategjik dhe organizimin e përditshëm të fushatës.

Zgjedhës – Një pjesë e popullsisë e përfaqësuar nga një udhëheqës ose organizatë e caktuar e zgjedhur me votim.

Zonë zgjedhore – Zonë e përcaktuar gjeografike ku do të mbahen zgjedhjet dhe, në vijim të tyre, do të përfaqësohet nga fituesi.

Komisioni i zgjedhjeve – Zakonisht bordi jopartiak për të mbikqyrur zgjedhjet dhe për të garantuar zhvillimin e tyre me ndershmëri.

Ditë e zgjedhjeve – Dita kur votuesit shkojnë në qendrat e votimit dhe heshin votat për të zgjedhur udhëheqësit e tyre.

Rregulla të zgjedhjeve – Ligjet ose rregullat e komisionit të zgjedhjeve, që në një farë mënyre ndikojnë në zgjedhjet.

Elektorat – Ky përbëhet nga ajo e pjesë e popullsisë që mund të votojë në zgjedhje.

Pushteti ekzekutiv – Pozicioni i zgjedhur me votim që mbikqyr administrimin e qeverisjes, për shëmbull, Kryetar Bashkie, Guvernator ose President.

VOTO – “Hidhe votën” ose *VOTO* është termi i përdorur për t’u kujtuar votuesve të shkojnë në votime dhe të votojnë për kandidatin e tyre. Shpesh fushata bën përpjekje të mëdha përpara Ditës së Zgjedhjeve për t’u siguruar që mbështetësit e tyre do të shkojnë të votojnë.

Pushteti legjislativ – Pushteti legjislativ është një pozicion në një këshill të zgjedhur me votim, kongres ose në ndonjë organ tjetër që merret me legjislacionin.

Shumicë e votës plus një (50 + 1) – Kjo kundrejtë një shumice të thjeshtë të votave ose numrit më të madh të votave të hedhura.

Kufiti i fitores – Numri i votave të nevojshme për të siguruar fitoren e kandidatit.

Jopartiake – Kur dikë lidhet me të gjitha partitë politike ose me asnjë parti të vecantë politike. Zgjedhjet jopartiake janë ato ku kandidatët nuk janë të lidhura me parti të vecanta dhe partia e tyre nuk ndodhet në listën e partive në fletën e votimit. Organizatë jo partiake është ajo që nuk është e lidhur me asnjë parti politike ose është e lidhur me shumë parti të ndryshme politike, duke shmangur lidhjen me një parti të vecantë.

Partiak – Cdo gjë ka të bëjë me partinë politike. Kur një process zgjedhor është partiak, kjo do të thotë se lidhjet partiake kanë rëndësi dhe se mund të radhiten në fletën e votimit.

Lista Partiake – Kjo është një formë votimi ku zgjedhësit votojnë për një parti dhe partia për zgjedh kandidatët në bazë të përqindjes së votave që ka marrë.

Shumicë a maxhorancë - Numri më i madh i votave të hedhura në një zgjedhje. Kjo ndryshon nga shumica e votave të hedhura ose 50 % + 1 votë.

Programi – Programi i kandidatit ose i partisë është cka ajo thotë se do të bëjnë në lidhje me çështje të ndryshme që kanë rëndësi për zgjedhjet. Programi nuk është mesazhi.

Pjesëmarrja – Kjo është ajo pjesë e elektoratit që zakonisht del e voton. Pjesëmarrja mund të jepet me përqindje ose me shifra reale.

Zhvendosja e votave – Kur zgjedhësit votojnë për një kandidat të caktuar në një process zgjedhor ndërsa në tjetrin, votojnë për një kandidat në një parti tjetër ose me ideologji tjetër. Zgjedhësit që zhvendosin kahun e votës së tyre konsiderohen si zgjedhës që mund të binden me anë të mesazhit të fushatës.

Ndarja e votës – Kur zgjedhësit brënda fletës së tyre të votimit, gjatë të njëjtit process zgjedhor, votojnë për një kandidat të caktuar por edhe për një kandidat tjetër nga një parti ose një ideologji e ndryshme. Zgjedhësit të cilët ndajnë votën e tyre konsiderohen si zgjedhës të cilët mund të binden përmes mesazhit të fushatës.

Zgjedhësi – Një person i cili është i aftë të votojë në zgjedhje për një post të vecantë.

BIBLIOGRAFIA

1. Agjencia e Informacionit e Shteteve të Bashkuara (USIA). “Cfarë është demokracia?”, Solidarnosc, Dhjetor, 1991.
2. Albania dhe Rilindja Demokratike, botuar më 24 janar 1996.
3. Aleanca Gjinore për Zhvillim, “Përfaqësimi dhe Cilësia e Demokracisë në Shqipëri një perspektivë gjinore”, Tiranë, 2006.
4. Amato, G. & Barbera, Augusto. “Manuale di diritto public”, 1977.
5. Barber, Benjamin. “Strong Democracy: Participatory Politics for a New Age”, Berkeley, University of California Press, 1984.
6. Bartolini, S. dhe Mair, P. (2007) “Identity, competition and electoral availability – the stabilization of european electorates 1885-1985”, ECPR Press.
7. Balukja, A. (2015) “The influence of political parties in the candidate selection, as well as in democratic consolidation of the society”, European Center of Sustainable Development Rome, Italy.
8. Beetham David dhe Kevin Boyle. “Duke Paraqitur Demokracinë: 80 pyetje dhe përgjigje”, Kembrixh: Polity press, 1995.
9. Beetham, David. & Boyle, Kevin. “Demokracia. 80 Pyetje dhe Përgjigje”, Botimi Dita, Tiranë, 2001.
10. Berlin, Isaiah. Sir. “Idetë filozofike të shek XX dhe katër ese mbi lirinë”, Onufri, Tiranë, 2003.
11. Bernard Grofman. “SNTV, STV, and Single-Member District Systems: Theoretical Comparisons and Contrasts.” In Elections in Japan, Korea and Taiwan under the Single Non-Transferable Vote: The Comparative Study of an Embedded Institution”

- Grofman. B, Lee. S.Ch, Winckler. E.A, and Woodall. B, Eds. Ann Arbor, MI: University of Michigan Press, 1997.
12. Blondel, J. (1969)“An introduction to comparative government”, London: Weidenfeld & Nicolson.
 13. Bogdanor, V. Ed. “Representatives of the People? Parliamentarians and Constituents in Western Democracies. Aldershot, Hants, U.K.Gower, 1985.
 14. Bravo, Gian Mario. & Malandrino, Corrado. “Il pensiero politico del novecento”, PIEMME, 1994.
 15. Biberaj, Elez. “Shqipëria në Tranzicion. Rruga e vështirë drejt demokracisë 1990 – 2010”, Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë, 2011.
 16. Bingham Powell, Contemporary Democracies: Participation, Stability and Violence “Demokraci Bashkëkohore: Stabilitet dhe Dhunë”, Cambridge, Mass, Harvard University Press, 1982.
 17. Birch, S. (2001) “Electoral Systems and Party System Stability in Post-Communist Europe”, Paper prepared for presentation at the 97th annual meeting of the American Political Science Association, San Francisco, 30 August – 2 September, 2001.
 18. Cami Shpëtim. “Gjeopolitika elektorale”, Shtëpia Botuese Albas, Universiteti Ndërkombëtar i Strugës, Strugë, Maqedoni, 2010.
 19. Carey, J and Shugart, M.S. “Incentive to cultivate a personal vote: A rank-ordering of electoral formulas.” Electoral Studies 14(4): 417–440, 1995.
 20. Carey. J.M. “Parchment, equilibria and institutions”. Comparative Political Studies 33(6–7): 735–761, 2000.

21. Cejku, Arben. “Demokracia e imponuar”, Esse, Shtypshkronja “Mbrothësia”, Tiranë, 2000.
22. Çeka, B. (2013) “Tezë Doktrate: Marrëdhënia mes Sistemeve Zgjedhore, Sistemit Partiak dhe Sjelljes Zgjedhore në Shqipëri. Parë më 15 prill 2015”, parë në: <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/ëp-content/uploads/2013/08/Doktorature-Blendi-Ceka-Fakulteti-i-Shkencave-Sociale-Departamenti-i-Shkencave-Politike.pdf>
23. Cili, Henri. “Kundër – Reforma”, Një shpjegim (subjektiv) për 23 Qershorin, Fondacioni për Liri Ekonomike, Tiranë, Shtator, 2013.
24. Charles Alexis Clevel de Tocqueville, ‘Nga demokracia në Amerikë’, Paris, GF – Flammarion, 1981
25. Cox, G.W. “Centripetal and centrifugal incentives in electoral systems.” American Journal of Political Science 34(4): 903–935, 1990.
26. Dahl, Robert. a “Poliarkia Pjesëmarrja dhe Opozita”, Pegi, Tiranë, 2005
27. Dahl, Robert. b “On democracy”, Aspekt Press, Moskva, 2000.
28. Dalton, R. S. and Wattenberg, M. P. “Parties without Partisans: Political Change in Advanced Industrial Democracies” Oxford: Oxford University Press, 2001.
29. Donatella Della Porta, “Bazat e shkencës politike”, Prishtinë, 2006, Kolegji Universitar “Victory”.
30. Duverger, M. “Duverger’s Law: Forty Years Later.” In Electoral Laws and their Political Consequences” Bernard Grofman and Arend Lijphart. Eds. New York: Agathon Press, 1986.
31. Duverger, M. “Political Parties, Their Organization and Activity in the Modern State” New York: Wiley, 1954.

32. Duverger, M. "Political Parties: Their organizations and activity in modern states", 3d ed. London: Methuen, 1964.
33. Duschinsky, M.P. "Overview." Handbook on Funding of Parties and Election Campaigns. Stockholm: International IDEA, 2002.
34. Elia, Leopoldo (2011) "Costituzione, partiti, istituzioni", Italian Edition, 1 Janar.
35. Epler, Erhard. "Rikthimi i politikës", ISPS & Rinia 2000, Tiranë, 2001.
36. Elster, J. Ed. "Deliberative Democracy" Cambridge,U.K.: Cambridge University Press, 1998.
37. Elster, J., Offe, C., & Preuss, U. F. "Institutional design in post-Communist societies: Rebuilding the ship at sea" Cambridge, UK, Cambridge University Press, 1998.
38. Ferreto, G. "Il potere", Milano, 1947.
39. Filo, Llambro. "Sistemet politike bashkëkohore", Botimet Ideart, Tiranë, 2011.
40. Fuga, Artan. "Media, Politika, Shoqëria (1990 – 2000). Ikja nga kompleksi i Rozafës", Botimet Dudaj, Tiranë, 2008.
41. Fuga, Artan. "Tranzicioni si mbivendosje", Botimet Dudaj, Tiranë, 2013.
42. Goodwin - Gill, Guts. S. "Zgjedhjet e drejta dhe të lira. E drejta Ndërkombëtare dhe praktika", Inter-Parliamentary Union, Gjenevë, 1994.
43. Gallagher, M. Mitchell, P., "The Politics of Electoral Systems", Oxford University Press Inc., New York, 2005.
44. Gjuraj Tonin, "Nova Demokratia" 15 ese për tranzicionin dhe për demokratizimin, UET PRESS, Tiranë, 2015.
45. Helsinki. "Report on Albania", Human rights ëatch, 1994.

46. Institutit Republikan Amerikan (IRI), “Observation Report on the Albanian Parliamentary Elections of May 26, 1996”, NY, Tiranë, 30 maj 1996.
47. IPU, “Report on Election in Albania”, (www.ipu.org)
48. Jaho, Niazi. a “Reforma zgjedhore të presim? Deri kur?”, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Tiranë, Qershor, 2004.
49. Jaho, Niazi. b “Reforma zgjedhore. Përsëri me vonesë”, Komiteti Shqiptar i Helsinkut, Tiranë, 2006.
50. Joseph, Emmanuel. “Cështë shteti i tretë?”, Paris, PUF, 1982.
51. Kajsiu, B. (2004) “Albanian Political Parties”, f.9-38 në Georgi Karasimenov (eds.), Political Parties and the Consolidation of Democracy in South Eastern Europe, Gorex Press Publishing House: Sofia.
52. Katz, R.S. & Mair, P “Changing Models of Party Organization and Party Democracy: The emergence of the cartel party.” *Party Politics* 1(1): 5–28, 1995.
53. Katz R.S., & Mair, P. (1996) “Cadre, Catch-All or Cartel?: A Rejoinder”, *Party Politics*, Vol.2 (4), 525-536.
54. Katz, R. “Role Orientations” Katz, R.S. and Wessels, B. Eds. In *The European Parliament, the National Parliaments, and European Integration*. Oxford: Oxford University Press, 1998.
55. Katz, R. “Democracy and Elections” Oxford: Oxford University Press, 1997.
56. Kitschelt, H. “Linkages between citizens and politicians in democratic polities”. *Comparative Political Studies* 33(6–7): 845–879, 2000.

57. Kirchheimer, O. "The Transformation of Western European Party Systems." In Political Parties and Political Development. Eds. J. La Palombara and M. Weiner. Princeton, NJ: Princeton University Press, 1966.
58. Krasniqi, Afrim. "Zgjedhjet në Shqipëri (1991 – 2008). Historia, Proçeset zgjedhore, Partitë, Kandidatët, Fushatat elektorale", Shtëpia Botuese "Konica Color", Tiranë, 2009.
59. Krasniqi, A. (2006) "Partitë Politike në Shqipëri: 1920-2006", Instituti Shqiptar i Studimit te Politikave, Tirane.
60. Krasniqi, Afrim. a "Rënia e demokracisë, Shqipëria në muajt janar-qershor 1997", Ribotim, Publicistikë Politike, EUR RILINDJA, Tiranë, 1997.
61. Krasniqi, Afrim. & Hackaj, Ardian. "Shqiptarët dhe modeli social evropian. Demokracia e brëndshme në partitë politike shqiptare", Botimet Kumi, Friedrich Ebert Stiftung, Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim Shteti web.com.
62. Këshilli i Europës, "Për Shqipërinë. Përmbledhje dokumentash 1991 - 1997", albin, Tiranë, 2000.
63. Kriik Albania "Pjesëmarrja në demokraci, një ABC...", Përmbledhje leksionesh të referuara në Universitetin e Verës, 'Demokracia dhe rinia, konceptet dhe pjesëmarrja në vendimmarrje', Vlorë, 1 – 9 shator, 2002. Tiranë, 2002.
64. Kirkpatrik, Xhejn. "Diktaturat dhe standartet e dyfishta", 1979
65. Kirchheimer, O. "The Transformation of Western European Party Systems". In Political Parties and Political Development. Eds. J. La Palombara and M. Weiner. Princeton, NJ: Princeton University Press, 1966.
66. Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve. "Deklaratë", 8 nëntor 1994.

67. Kume, Andon. “Legjislacioni zgjedhor dhe zbatimi i tij gjatë periudhës së tranzicionit në Shqipëri”, Monografi, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Durrës, Tiranë, 2015.
68. Kuvendi i Shqipërisë. “Seria Punime të Kuvendit”, nr. 1, Raport i deputetit Sotir Kokeri, më datë 17 prill 1991.
69. KVAL-MELLBYE-TRANQY, “Politika dhe Demokracia”, Botime Onufri, Tiranë, 2006.
70. Laco, Teodor. “Kohë për të kujtuar. Kohë për të harruar”, Botimet Toena, Tiranë, 1998.
71. Lami, R. (2013) “Paqartësia e Strukturimit të Raporteve: Parti politike – Ideologji” Tezë doktorale e mbrojtur pranë Universitetit të Tiranës. Parë më 12 tetor 2014.
<http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2013/12/Doktorature-Roland-Lami-Fakulteti-i-Shkencave-Sociale-Departamenti-i-Sociologjise.pdf>
72. Laswell, H. D. (1958). Politics: Who Gets What, When, How. New York: Meridien Books. Ligji, Nr. 8218, “Për disa ndryshime ... në ligjin për zgjedhjet e Kuvendit”, më datë 16 maj 1997.
73. Lijphart, Aarend. a “Democracies: Patterns of Majoritarian & Consensus Government in Twenty-one Countries”, New Haven: Yale University Press, 1984.
74. Lijphart,A; “Patterns of Democracy”,Yale University Press, New Haven and London, 1999.
75. Lijphart, A. “Electoral Systems and Party Systems: A Study of Twenty-Seven Democracies, 1945–1990”New York: Oxford University Press, 1994.

76. Lijphart, A. b (1991) "Constitutional Choices for New Democracies", Journal of Democracy, 2.
77. Lijphart, A. c (1994) "Electoral Systems and Party Systems: A study of Twenty-Seven Democracies", 1945-1990, New York: Oxford University Press.
78. Lijphart Arend dhe Grohman Bernard (2003) "Electoral Laws and Their Political Consequences", AGATHON PRESS, New York.
79. Linz Juan and Alfred Stepan, Democratic Ttransitions and Democratik Consolidation: Southern Europe, South America, and Post-Communist Europe "Tranzicionet Demokratike dhe Konsolidimi Demokratik: Europen Jugore, Ameriken Jugore dhe Shtetet Post-Komunist", Mimeo, 1991.
80. Linz, H. dhe Stepan, A. "Problems of Democratic Transition on consolidation Southen Europe, South Amerika and Post-comunist Europe", Baltimore, London, 1996.
81. Linz, Juan. & Stepan, Alfred. "Political Identities and Electoral Sequences", Spain, New Brunswck & London: Transactions Publishers, 1993.
82. Lipset, S. M. and Rokkan, S. (1967) 'Cleavage Structures, Party Systems and Voter Alignments: an Introduction', in S. M. Lipset and Stein Rokkan (eds) Party Systems and Voter Alignments, pp. 1-63. New York: The Free Press.
83. Locke, John. "Traite du Gouvernement civil", Flammarion, Paris. (Botime).
84. Loku John. "Dy traktate mbi qeverisjen", 1960.
85. Locke, John. "Trajtesë për qeverinë civile", Paris, GF – Flammarion, 1984 (1690).
86. Machiaveli, Niccolo. "Princi, Politika dhe Kodi Moral", Shtëpia Botuese Uegen, Tiranë, 2003.

87. Mair, P. "Party System Change: Approaches and Interpretations", Oxford University Press, 1997.
88. Martini, Prel. "Refleksione politike", Shtypshkronja "Kumi", Tiranë, 2005.
89. Mano, Minella. S. "Konkurimi dhe të drejtat në demokraci", Analizë për Shkencat Sociale, Drejtësinë dhe Mjekësinë, LOGORECI, Tiranë, 2005.
90. Meidani, Rexhep. "Politika, Morali dhe Shteti. Refleksione korrik 2002 – qershor 2003", Botimet Toena, Tiranë, 2003.
91. Mercier, Benoit. & Duhamel, Andre. "Demokracia, themelet, historia dhe zbatimi i saj", Qendra e studimeve Shqiptare "Shqipëria Europiane", Shtypshkronja "MirGeerAlb", Tiranë, 2003.
92. McNair Brian, "Hyrje në komunikimin politik", Tiranë, 2009, UET PRESS.
93. Monroe, B. L. Rose, A. G. "Electoral Systems and Unimagined Consequences: Partisan Effects of Districted Proportional Representation", American Journal of Political Science, 46/1: 67–89, 2002.
94. Montesquieu, "Nga fryma e ligjeve", Paris, GF – Flammarion, 1979, pjesa e I.
95. Nania, R. (2014) "Forma di governo e sistema dei partiti: rileggendo Leopoldo Elia", 27 Mars.
96. National Democratic Institute for International Affairs, "Fletore e demokracisë: Etika dhe zgjedhjet, Dan Redford, Tiranë: Pegi, 2005
97. National Democratic Institute for International Affairs, "Politikani i Ri: fletore e Akademisë për udhëheqësi dhe reformë politike", Dan Redford, Tiranë: Pegi, 2005.
98. National Republican Institute for International Affairs (NRIIA). "The 1991 Elections in Albania", Washington. April 1991.

99. NDI (2013) “Raporti i analizës së zgjedhjeve”, Numri 1.
100. NENI 21. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut.
101. Neumann, S. (1956) 'Towards a Comparative Study of Political Parties', in Sigmund Neumann (ed.) *Modern Political Parties*, f.395-421. Chicago, IL: Chicago University Press.
102. Norris, P “The puzzle of constituency service.” *The Journal of Legislative Studies* 3(2): 29–49, 1997.
103. Norris, P. (2004) “Electoral Engineering: Voting Rules and Political Behaviour”, Cambridge University Press.
104. O’Day J. Brian. “Manuali i Planifikimit të Fushatës Zgjedhore Politike”, USAID From The American People, NDI National Democratic Institute For International Affairs, Pegi, Tiranë, 2005.
105. Omari, Luan. “Shteti i së drejtës”, Tiranë, 2002.
106. OSCE / ODHIR. “Albania: Parliamentary elections, 29 qershor 1997, EL. 97 / AL1 /ver. 1, 12 nëntor 1997.
107. Partia Demokratike, “Kontrata e Partisë Demokratike me Shqipërinë. Eksozeja e Presidentit të Republikës, Sali Berisha ‘Tre vjet qeverisje e PD, angazhimet dhe përmbushja e tyre’, Paraqitur në takimin e tij me shtypin më 22 mars 1995”, Botimi i Gazetës “Rilindja Demokratike”, Tiranë, Prill 1995.
108. Pedersen, M. (1979) “The Dynamics of European Party Systems: Changing Patterns of Electoral Volatility”, *European Journal of Political Research* 7, 1-26.
109. Përpali, Lush. “Kohë të vështira tranzicioni”, Marlin Barleti, Tiranë, 2004.

110. Pëllumbi, Servet. a “Bashkëbisedim për politikën”, Instituti i Sociologjisë, Tiranë, 2007.
111. Pëllumbi, Servet. b “Demokracia dhe zëri i moralit”, Instituti i Sociologjisë, Tiranë, 2008.
112. Pëllumbi, Servet. c “Edhe politika do moral”, Rinia & ISPS, Tiranë, 2000.
113. Pëllumbi, Servet. d “Etikokracia” Refleksione mbi teorinë dhe praktikën e demokracisë, Botimet Morava, Tiranë, 2013.
114. Pëllumbi Servet. f “Pluralizmi Politik”, Përvojë dhe sfida, Instituti i Sociologjisë, Tiranë, Rinia, 2006.
115. Pippa, Norris. “Building political parties: Reforming legal regulations and internal rules”, Stockholm, IDEA, 2004.
116. Pitkin Hanna Fenichel. “The concept of Representation”, University of Clifornia Press, 1972.
117. POLIS 11. 2011. “Ndërveprimi midis partive politike dhe organizative të shoqërisë civile”, Elezi, Gentian. fq. 31 – 42.
118. POLIS 11. 2011. “Struktura dhe organizimi i partisë në Shqipëri post-komuniste: Një studim mbi Partinë Demokratike të Shqipërisë”, Xhaferaj, Anjeza. fq. 42 – 61.
119. Powell, Jr. (2000) “Elections as Instruments of Democracy”, Chapter 1.
120. Powell, B. (1982) “Contemporary Democracies: Participation, Stability and Violence”.
121. Quermonne, Jean – Louis, “Regjimet politike perëndimore”, Paris, 1986.
122. Rae, D. W. “The Political Consequences of Electoral Laws” New Haven, CT: Yale University Press [1971 revised edition], 1967.

123. Raporti i Grupit Britanik të Helsinkut për të Drejtat e Njeriut, “Për një mbrojtje të zgjedhjeve të zhvilluara në Shqipëri”, Oksford, Korrik, 1996.
124. Ranciere, Jacques, “Demokracia, Republika, Përfaqësimi”, Polis 4.
125. Republika e Shqipërisë, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, “Buletini i zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvendin e Shqipërisë 24 qershor 2001”, Miratuar me Vendim të KQZ-së Nr. 384, më datë 20 dhjetor 2001, Tiranë, 2001.
126. Riker, W. H. “The two-party system and Duverger’s Law: An essay on the history of political science.” American Political Science Review 76(4): 753–766, 1986.
127. Robert, P. “*Bowling Alone*” New York: Simon & Schuster, 2000.
128. Rohrschneider, R “Mobilizing versus chasing: How do parties target voters in election campaigns?” Electoral Studies 21(3): 367–382, 2002.
129. Rokkan, S. (2009) “Citizens, elections, parties – approaches to the comparative study of the processes of development”, ECPR Press.
130. Rousseau, Jean Jacques. “Nga kontrata sociale”, Paris, Botimet e Seuil, 1977 (1762), libri i I.
131. Rustow, Dankward, “Transitions to Democracy Towards a Dynamic Model”, “Tranzicionet Demokratike Drejte një Modeli Dynamik”, Columbia University Press, 1970.
132. Rrjeti Shqiptar i të Drejtave të Njeriut dhe CRCA (2005) “Zgjedhjet parlamentare 2005 dhe të drejtat e njeriut në Shqipëri” Hazizaj, A. f. 10
133. Sakamoto, T “Explaining electoral reform – Japan versus Italy and New Zealand.” Party Politics 5(4): 419–438, 1999.
134. Sartori, Giovanni. a “Cështë demokracia?”, Shtëpia Botuese Dituria, Tiranë, 1998.

135. Sartori. Giovanni b “Për teorinë e demokracisë”, Shtëpia Botuese Dituria, Tiranë, 2010.
136. Sartori, Giovanni c (1986) “The Influence of Electoral Systems”: Faulty Lines or Faulty Method? In Bernard Grofman and Arend Lijphart (eds.) “Electoral Laws and Their Political Consequences” New York: Agathon Press.
137. Scarrow, S. “Implementing Intra – Party Democracy”. Political Parties and Democracy in Theoretical and Practical Perspectives. National Democratic Institute, 2005.
138. Scarrow, S. E. (2015) “Beyond Party Members. Changing Approaches to Partisan Mobilisation” ECPR Press & Oxford University Press.
139. Schmitt Philippe dhe Trechol Alexander, “E ardhmja e demokracisë në Europë”, Politika, 2007, 14 Prill
140. Schmidt, Manfred G. “Teoritë e Demokracisë”, Botart, Tiranë, 2012.
141. Sikk, A. “How Unstable? Volatility and the Genuinely Neë Parties in Eastern Europe,” European Journal of Political Research, 44 (1): 391 – 412, 2005.
142. Strom, K. “Minority Government and Majority Rule”New York: Cambridge University Press, 1995.
143. Strom, K “Delegation and a ountability in parliamentary democracies. European Journal of Political Research”37(3):261–289, 2000.
144. Szajkowski, “The Albanian Elections”, 1992.
145. Sherifi, Elmaz. “Një dekatë në politikë. Artikuj, diskutime, polemika, fjalime, intervista”, Botimet Toena, Tiranë, 2002.

146. Shyti, Xhovani (Gazetar). “Vota të lira. Vota të vjedhura”, Shtëpia Botuese “Jonalda”, Berat, Maj 2001.
147. Taagepera, Rein. & Shugart, Matthew Soberg. “Votat & Mandatet. Efektet dhe përcaktuesit e sistemeve zgjedhore”, Libri I, Qendra për Politikat Publike, Shkencat Politike dhe të Drejtën, 2004.
148. Tarifa, Fatos. “Europa e pabashkuar”, OMBRA GVG, Tiranë, 2009.
149. Tarifa, Fatos. & Krisafi, Ksenofon. & Tarifa, Eneda. “Paradigma e tranzicionit demokratik” ‘Fundi’ i tranzicionit apo një tranzicion ‘pa fund’?, OMBRA GVG, Tiranë, 2009.
150. Tip O’Neil dhe Himel Gari, “Politika ëshë vendore dhe rregullat e tjera të lojës”, Tiranë, 2001, Botimet Dudaj.
151. Tushi, Gëzim. “Politika dhe Qytetari”, Shtëpia Botuese ‘Emal’, Tiranë, 2006.
152. UNDP, Raporti i Zhvillimit Njerëzor, 2002
153. Vorpsi, A. (2006) “E drejta parlamentare dhe politikat ligjore,” Nr. XXIX.
154. Vickers Miranda dhe Pettifer James. “Shqipëria nga Anarkia te një identitet Ballkanik”, Botimet Toena, Tiranë, 1998.
155. Xhaferaj, Anjeza. “Struktura dhe organizimi i partisë në Shqipërinë post-komuniste, Polis 11, UET PRESS, Tiranë, 2011.
156. Xhaferaj, A. (2016) “Sistemi partiak – struktura dhe organizimi i partive politike në Shqipëri 1991-2013” Tezë doktorale e mbrojtur pranë Universitetit Europian të Tiranës. Parë më 10gusht 2016.
http://www.uet.edu.al/images/doktoratura/Anjeza_Xhaferaj.pdf
157. Zaganjori, Xhezair. “Demokracia dhe shteti i së drejtës”, Tiranë, 2002.

158. Zogaj, Preç. a, “Të gjithë nëpër vendet e tyre”, Botimet “Dita 2000”, Tiranë, 2010.
159. Zogaj, Preç. b, “Nga hiri”, Botimet “Dita 2000”, Tiranë, 2003.
160. Zogaj, Preç. c, “Paradhoma e një Presidenti”, Botimet ORA, Tiranë, 2001.
161. Zogaj, Preç. d, “Esse. Rënia e zgjedhjeve”, Shtëpia Botuese Dita, Tiranë, Prill, 1997.
162. Zogaj, Preç. e, ‘Në kërkim të zgjedhjeve të humbura’, Ese politike, UET PRESS, Tiranë, 2012.
163. Zogaj, Preç. f, Botime II, “Fillimet. Ngjarje, dëshmi, kronikë, refleksione nga vitet 90 - 92”, UET PRESS, Tiranë, Nëntor, 2014.
164. Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Europë, Vëzhgime mbi zgjedhjet parlamentare të mbajtura në Republikën e Shqipërisë, 26 Maj dhe 2 Qershor, ODIHIR OSBE, Varshavë, 11 Korrik 1996-të.
165. Weber, Max. “The Theory of Social and Economic Organization”, Glencoe, Illinois, 1947.
166. Wiingard, Helge. “Demokracia – Një sfidë e vlefshme”, Botimi i Qendrës Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, Tiranë, 1999.
167. <http://www.fjalori.shkenca.org/>
168. APKB rez. 46 / 137, “Rritja e efektivitetit të parimit të zgjedhjeve të lira dhe të rregullta”, 17 dhjetor 1992.
169. APKB rez. 47 / 130, 18 dhjetor të vitit 1992.
170. APKB rez. 48 / 124, dhjetor të vitit 1993.

Gazetat (Shtypi i shkruar):

1. Affairs. Tiranë: Pegi, 2005, fq. 6. Rexhep Meidani, “Për një etikë normale në politikë”, fq. 1-14.
2. Gazeta “Koha Jonë”, e botuar më 18 gusht 1998.
3. Gazeta “Koha Jonë”, e botuar më 27 tetor 2002.
4. Gazeta “Metropol”, artikulli “Kriza e politikës dhe ideokracia”, botuar më 7 prill 2005.
5. Gazeta “Panorama”, 22 prill 2003.
6. Gazeta “Panorama”, artikulli: “Politika interes apo përgjegjësi?”, botuar më 7 dhjetor 2004.
7. Gazeta “Panorama” (2008) “Ndryshimi i sistemit zgjedhor”, Nurellari, A. Tiranë: Panorama Group, 14 Prill, f. 19
8. Gazeta “Rilindja Demokratike”, 27 shkurt 1991. Artikull nga Alfred Kempe.
9. Gazeta “Shenja” (2014) “Qeverisja njëpartiake”, Besnik Murati Marrë nga: <http://www.shenja.mk/index.php/mobile/opinion-analize/12462-qeverisja-nje-partiake.html> (parë më 15 korrik 2015)
10. Gazeta “Shekulli”. “Zgjedhjet, ligji zgjedhor ...”, e botuar më 21 tetor 2003.
11. Gazeta “Shekulli”, artikulli “Modeli elektorale që i nevojitet Shqipërisë”, botuar më 18 Prill 2014.
12. Gazeta “Zëri Popullit”, 27 korrik 1991.
13. Gazeta “Zëri i Popullit”, 21 janar 1994.
14. Gazeta “Zëri i Popullit”, 4 tetor 1996.
15. Gazeta “Zeramerikes”, “Sistemi politik dypartiak”, 27 shkurt 2010.

BURIME INTERNETI

1. <http://www.shenja.mk/index.php/mobile/opinion-analize/12462-qeverisja-nje-partiake.html>
2. <http://documents.tips/documents/partite-politike-leksion-5.html>
3. <https://prezi.com/phnjuveemagf/tema-sistemi-zgjedhor-dhe-votimi-ne-shqiperi/>
4. <http://www.dadalos.org/alb/democracia/GRUNDKUR S3/Wahlen/wahlrecht.htm>
5. <http://www.zeriamerikes.com/a/a-30-a-2004-10-03-4-1-85712877/438421.html>
6. <http://www.dadalos .org/alb/democracia/GRUNDKURS3/Wahlen/wahlrecht.htm>
7. <http://www.ads.gov.mk/ WBStorage/ Files/poglavje04 AL.pdf>
8. <http:// shtetiweb.org/2012/09/04/si-klasifikohen-sistemet-partiake/>
9. www.unkorce.edu.al/sites/default/files/ dokumente .../buletini shoqeror 2011.pdf
10. <http://sbunker.net/ teh/79239/ pragu-zgjedhor-dhe-kostoja-demokratike/>
11. <http://documents.tips/documents/ partite-politike.html> (parë më 6 mars 2015)
12. http://www.kipred.org/repository/docs/Cili_eshte_ndikimi_i_partive_politike_ne_kon_solidimindemokratik_272866.pdf
13. <http://documents.tips/documents/partite-politike.html>
14. www.agora.stm.it/elections/alllinks.htm
15. <http://www.ifes.org/eguide /elecguide.htm>
16. <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/ albanien/11316.pdf>
17. <http://shtetiweb.org/2012/09/04/partite-politike-ne-shqiperi-2/>
18. <https://sq.wikipedia.org/wiki/Qeverisja> (parë më 5 dhjetor 2015)

Intervistat e zhvilluara:

- 1- Bello, Marko. Intervista e zhvilluar në muajin shkurt të vitit 2016-të.
- 2- Islami, Kastriot. Intervista e zhvilluar në muajin tetor të vitit 2015-të.
- 3- Rusmali, Ilir. Intervista e zhvilluar në muajin tetor të vitit 2015-të.